



ISSN 2413-1334



Policimi dhe **SIGURIA**

Nr. 1
DHJETOR
2015

Revistë periodike shkencore
Botim i Akademisë së Sigurisë, Tiranë 2015



POLICIMI DHE SIGURIA
AKADEMIA E SIGURISË

POLICIMI
dhe **SIGURIA**

B O T I M P E R I O D I K
Botuar nga Akademia e Sigurisë, Tiranë

NR 1
DHJETOR
2015

Copyright © 2015. Akademia e Sigurisë, Tiranë.

Të gjitha të drejtat e botimit dhe ribotimit janë të Akademisë së Sigurisë. Asnjë material nuk mund të riprodhohet, kopjohet, ripublikohet, modifikohet, shpërndalet apo shitet në asnjë mënyrë, i plotë apo pjesë të tij në formë elektronike apo në letër, pa autorizimin e shkruar të Akademisë së Sigurisë. Përdorimi i materialeve të kësaj reviste, pa autorizim, përbën shkelje penale të të drejtave të autorit.



Botues

AKADEMIA E SIGURISË
Rruga e Elbasanit, Sauk, Tiranë

NR **1**
DHJETOR
2015

BORDI EDITORIAL

Kryetari i Bordit

Dr. Xhavit SHALA

Anëtarët e Bordit

Prof. Dr. Ilirjan MANDRO

Prof. Dr. Ismet ELEZI

Prof. Asc. Pandeli TAÇI

Prof. Asc. Irakli KOÇOLLARI

Prof. Asc. Ferdinand ELEZI

Prof. Asc. Fatmir TARTALE

Redaktor shkencor

Albert HITOALIAJ

Përkthyes

Vangjel LILI

Lavdim KAZAZI

Punimet grafike

Andi OSMANI

Realizimi teknik

Qendra Kërkimore Shkencore,
Akademia e Sigurisë

Revista shkencore “**Policimi dhe Siguria**”, botohet nga “Qendra Kërkimore Shkencore” e Akademisë së Sigurisë, me qëllim përmbushjen e standardeve më të larta në veprimtarinë kërkimore-shkencore në aktivitetin e Akademisë së Sigurisë.

P Ë R M B A J T J A

1. **Drejtues Madhor Haki ÇAKO**
Fjalë përshëndetëse për fillimin e botimit të revistës
“Policimi dhe Siguria”
2. **Drejtues i Lartë Bilbil MEMAJ**
Lidershipi policor..... 10
3. **Prof. Dr. Ilir MANDRO**
Histori dhe progres në arsimimin policor - progres drejt
një policie evropiane 20
4. **Prof. Asc. Dr. Pandeli TAÇI**
Programi i studimeve “Bachelor” për Rendin dhe Sigurinë Publike
dhe reformimi i institucioneve të arsimit policor..... 39
5. **Prof. Asc. Dr. Qetësor ORHANI**
Shoqëria Civile dhe Policia e Shtetit 52
6. **Dr. Xhavit SHALA**
Çështja shqiptare dhe kompleksi ballkanik i sigurisë..... 62
7. **Dr. Mimoza XHARO**
Ekstremizmi i dhunshëm kërcënim potencial afatgjatë..... 76
8. **Dr. Sofokli DUKA, Dr. Stavri SINJARI**
Hetimi i vetëvrasjes..... 96
9. **Dr. Myzafer ELEZI**
Rëndësia e bashkëpunimit policor me organizatat partnere për
eficencë në luftën kundër krimit..... 108
10. **Drejtues Pëllumb NAKO**
Migracioni i parregullt si sfidë ndërmjet humanizmit dhe sigurisë
kombëtare..... 118

Fjalë përshëndetëse me rastin e fillimit të botimit të revistës “Policimi dhe Siguria”



■ DREJTORI I POLICISË SË SHETIT

Drejtues Madhor
Haki ÇAKO



Revista shkencore "Policimi dhe siguria", që del sot për herë të parë, ka qëllim e mision të njëjtë me vizionin e Akademisë së Sigurisë dhe me strategjinë e Policisë së Shtetit: arsimim cilësor policor. Kontributi i saj do të jetë pikërisht në këtë rrafsh, në rrafshin e shtimit të hapësirës së kërkimit shkencor, një hapësirë e cila uroj që të mbushet me punime kërkimore sa më kontribuuese. Kontributi ynë kundrejt qytetarëve fillon që në këtë moment, që në momentin që arsimohen oficerët e ardhshëm të policisë dhe vijon në këtë vazhdë, hap pas hapi në ngjitjen në karrierë dhe paralelisht edhe në formimin akademik.

*Drejtues
Madhor
Haki Çako*
« Fjalë
përshëndetëse
me rastin
e fillimit të
botimit të
revistës
‘Policimi dhe
Siguria’ »

Policimi
dhe
Siguria
nr.1, 2015

Që një institucion arsimor të jetë i plotë, ai nuk mund të përfytyrohet pa botimin e një ose disa periodikëve studimorë, kërkimorë e shkencorë - të ketë njësinë e vet shkencore funksionale, e cila nëpërmjet instrumenteve të duhur të shfaqë e të zhvillojë kërkimin shkencor. Problemi që ka lidhje me kërkimin shkencor në Shqipëri është thënë dhe është ngritur në rrafsh diskutimi nga ekspertët e arsimit e jo vetëm, në mënyrë të vazhdueshme, aq sa sot, është një prioritet i cili gjen mbështetje në iniciativën për zhvillim, si nga bota akademike edhe nga ajo politike.

Por, edhe pse arsimimi apo kërkimi shkencor nuk janë thelbi i punës sime të përditshme, në njëfarë mënyre e gjithë organizata, është e varur nga arsimimi policor. Kjo për shkak se prurjet që sillen nga arsimit policor ndikojnë drejtpërsëdrejti në cilësinë e punës. Arsimimi profesional policor është kryefjala e suksesit për punën e Policisë së Shtetit dhe oficerët policie të arsimuar në mënyrë cilësore, do të thotë sukses i garantuar i policimit.

Revista shkencore "Policimi dhe siguria", që del sot për herë të parë, ka qëllim e mision të njëjtë me vizionin e Akademisë së Sigurisë dhe me strategjinë e Policisë së Shtetit: arsimim cilësor policor. Kontributi i saj do të jetë pikërisht në këtë rrafsh, në rrafshin e shtimit të hapësirës së kërkimit shkencor, një hapësirë e cila uroj që të mbushet me punime kërkimore sa më kontribuuese. Kontributi ynë kundrejt qytetarëve fillon që në këtë moment, që në momentin që arsimohen oficerët e ardhshëm të policisë dhe vijon në këtë vazhdë, hap pas hapi në ngjitjen në karrierë dhe paralelisht edhe në formimin akademik.

E shoh hapjen e kësaj reviste si një shenjë pozitive, të një përpjekje serioze për të ngritur nivelin e arsimimit dhe si një hap pozitiv në drejtim të plotësimit të standardeve të kërkimit shkencor, kërkim i cili synohet të jetë pjesë e fuqizimit të nivelit të hapësirave të kërkimit shkencor e analizës profesioniste brenda radhëve të Policisë së Shtetit.

Megjithatë, uroj që ajo të ofrojë një hapësirë diskutimi për të gjithë ekspertët e fushave të tjera, të ndryshme, të cilat gërshetohen brenda ekspertizës së policimit, duke synuar hapjen dhe gjithëpërfshirjen në trajtesa të nivelit të lartë. Shpresoj që kjo revistë të shohë të angazhuar nëpërmjet artikujve ambiciozë, emra që tashmë i njohim të gjithë për aftësitë e tyre profesionale. Megjithatë, krahas këtyre emrave, shpresoj dy herë më tepër që të lexoj në faqet e revistës "Policimi dhe siguria", zërin e studiuesve të rinj, të talenteve të reja, zërin e atyre brezave që po dalin e që do të dalin nëpërmjet kryerjes së cikleve të studimit që ofron Akademia e Sigurisë. U takon atyre që të na vërtetojnë se kishim të drejtë me (ri)hapjen e Akademisë...

**Drejtues
Madhor
Haki Çako**
« Fjalë
përhëndetëse
me rastin
e fillimit të
botimit të
revistës
'Policimi dhe
Siguria' »

Policimi
dhe
Siguria
nr.1, 2015



POLICIMI DHE SIGURIA
AKADEMIA E SIGURISË

Siguria publike dhe menaxhimi policor



■ Drejtues i Lartë **Bilbil MEMAJ**
Drejtore i Përgjithshëm, Akademia e Sigurisë

Abstrakt

Policia është një aktor i rëndësishëm në tërë mjedisin e sigurisë, por roli i saj del më shumë në pah për sa i përket çështjeve të sigurisë publike. Misioni kryesor i policisë është ruajtja e rendit dhe sigurisë publike, parandalimi i krimit dhe mbështetja e të gjithë komponentëve të sigurisë që rrisin cilësinë e jetës së shoqërisë. Policia e Shtetit përveç detyrës së ruajtjes së rendit, luan një rol të rëndësishëm edhe në mbështetje të agjencive të tjera që kanë si mision parësor ruajtjen e sigurisë kombëtare. Për realizimin me sukses të kësaj detyre dhe të këtij misioni, është e nevojshme rritja e kapaciteteve menaxhuese, përmirësimi i strukturave, modernizimi i vazhdueshëm i policisë, etj.

Nëse shoqëria shqetësohet për situatën e sigurisë, do të thotë që ka faktorë të cilët e prodhojnë këtë pasiguri, në këtë mjedis sigurie kaq të komplikuar e global. Këta faktorë kombëtarë e ndërkombëtarë duhet të njihen së pari e për to të ketë plane të gatshme për t'i zbatuar, me qëllim kontrollimin dhe menaxhimin e mjedisit të sigurisë. Ky është një mision i të gjithë agjencive dhe institucioneve shtetërore, por në mënyrë të veçantë i takon Policisë së Shtetit, si struktura më specializuar, që të luajë një rol kryesor në garantimin e sigurisë.

Fjalëkyçe:

Siguria publike, mjedisi i sigurisë, misioni i policisë, menaxhimi i policisë, siguria e brendshme.

MEMAJ, B.
« Siguria
publike dhe
menaxhimi
policor »

Policimi
dhe
Siguria
nr.1, 2015

Hyrje

Nëse i referohemi pjesës më të madhe të studuesve të sigurisë, vëmë re se siguria është më e ndjeshme kur ajo kërkohet për *individin*, pra kur secili nga ne e ka të pasigurt dhe të pagarrantuar jetën¹. Por më tej, pothuajse të gjithë e lidhin këtë aspekt të sigurisë me sigurinë kolektive, me sigurinë e shoqërisë, me atë që quhet siguria e shtetit - si garanti institucional i sigurisë, për shoqërinë (shtetin). Po kështu, atë e lidhin edhe me sigurinë ndërkombëtare. Pra, thënë ndryshe, siguria është individuale, shtetërore (kombëtare) dhe ndërkombëtare.²

Lidhur me sfidat e reja të sigurisë nevojitet që të kryhen analiza më të shpeshta të rrezikut, të situatave të veçanta kriminale apo mafioze dhe të ketë bashkëpunime pa paragjykim ndërmjet policive të vendeve të rajonit e më gjerë. Heqja e burokracisë në shkëmbimin e informacionit midis policive, duke fuqizuar bashkëpunimin direkt, do të kërkonte ndërtimin e një marrëdhënie me besim reciprok midis policive. Të gjitha këto dhe të tjera, duhet të bëhen objekt studimi për të gjetur shkaqet dhe faktorët që e përbëjnë të gjithë këtë zhvillim, me qëllim që të përcaktohen edhe rrugët e instrumentet e duhura që do të shërbenin për të dominuar krimin e për të krijuar kushte të mira për qytetarët.

1. Shikim literature

1.1 Siguria individuale vs. sigurisë kolektive

Në botën e sotme nuk ka dhe nuk mund të ketë garanti të jetës në një shoqërizim relativisht të vogël shoqëror, pa u bërë pjesë e unioneve të fuqishme të disa shtetesh e kombesh. Kjo është një kërkesë e zhvillimit të përgjithshëm shoqëror. Shoqëritë e vogla e kanë të pashmangshme futjen nën kupolën e globalizimit dhe vënien e individëve të tyre në funksion të zhvillimit të megashoqërive prodhuese. Falë zbulimeve të paimagjinueshme më parë, bota tani duket *më e vogël*, më e menaxhueshme dhe kjo për arsye të zhvillimit të teknologjisë³. Kur marrim në shqyrtim impaktin që ka zhvillimi i madh i teknologjisë të siguria, duhet të kemi parasysh, se teknologjia i shërben njësoj, si atyre që e duan sigurinë, ashtu edhe atyre që janë kundër saj.⁴

¹ Hope, T. & Sparks, R. *Crime, Risk and Insecurity: Law and Order in Everyday Life and Political Discourse*. London: Routledge, 2012: 202.

² Kelsen, H. *Collective Security Under International Law*. New Jersey: The Lawbook Exchange, Ltd., 2001:3.

³ Cummings, Th. G., Worley C. G. *Organization Development and Change*. Cengage Learning, 2009: 615.

⁴ United States Congress, Senate, Select Committee on Intelligence. *Report on Impacts to US National Security of Advanced Satellite Technology Exports to the People's Republic of China (PRC)*. Volume 106, Issue 25 of S. U.S. Government Printing Office, 1999: 7.

Po cilat janë të përbashkëtat dhe të veçantat që kanë sigurinë e individit me sigurinë shoqërore dhe atë kombëtare? Për t'ju përgjigjur saktë kësaj pyetje duhet që të përcaktojmë për secilën në mënyrë të ndarë se nga i vjen rreziku ose nga cilët elementë përbëhet sigurinë. Siguria e individit në shoqërinë tonë kërcënohet nga kriminaliteti, krizat ekonomike, cilësia e ushqimeve dhe e lëngjeve, aksidentet me mjetet e transportit, aksidentet në punë, dëmtimi i mjedisit, sëmundjet epidemike etj.⁵

Çdo individ i shoqërisë, kërkon siguri për ta pasur jetën të garantuar dhe për këtë gjë ai paguan edhe taksa. Atëherë, si rrjedhojë, duhet që institucionet e ngarkuara me ligj ta garantojnë këtë siguri. Në këtë rast, pjesa më e madhe e shkeljeve kriminale, p.sh. krimet kundër jetës, krimet kundër pronës, por edhe krime të tjera të moralit, etj., janë punë e mirëfilltë e specialistëve të policisë, të trajnuar për parandalimin e krimeve; dhe nëse ato ndodhin, edhe për më tej, për zbulimin, dokumentimin ligjor procedural të tyre, etj. Megjithatë, edhe nëse policia e bën këtë punë shumë mirë, përsëri individit nuk është i sigurt në jetën e tij, për shkak të faktorëve që nënvizua më lartë. Për këtë arsye kërkohet që për rritjen e sigurisë së jetës të marrin pjesë të gjithë pjesëtarët e shoqërisë, madje këta janë në njëfarë mënyre të përfshirë në atë që quhet policim (termin policim do ta shpjegojmë në vijim).⁶

Policia është një institucion i administratës publike, që ka për funksion të shërbejë në komunitet, duke bërë të mundur garantimin dhe zbatimin e ligjit. Ajo është një organizatë unike, me strukturë të centralizuar dhe me një sistem zinxhir drejtimi.

Energjia që konsumon kjo strukturë, së bashku me gjithë komunitetin dhe institucionet e tjera ligjzbatuese për arritjen e një sigurie publike të pranueshme, përbëjnë atë që ne e quajmë "policim". Ose ndryshe, policimi është pjesëmarrje e të gjithë aktorëve për arritjen e sigurisë publike. Një komunitet do të jetë i sigurt, nëse ka një polici të edukuar profesionalisht në mënyrë të tillë, që ta konsiderojë punën natyrshëm shërbim ndaj komunitetit dhe kur të gjithë bashkëveprojnë me policinë, duke e konsideruar sigurinë publike detyrë të së gjithëve dhe e shohin policimin, si një detyrim qytetar.⁷

Do të kemi një individ të sigurt, atëherë kur institucionet e caktuara me ligj, bëjnë punën e tyre dhe kur çdo individ e konsideron sigurinë si një detyrë jo vetëm për vete, por për të gjithë shoqërinë.

1.2 Çfarë përshihet në sigurinë kolektive (të shtetit)

Në pjesën më të madhe të vendeve, forcat e armatosura janë ngarkuar të mbrojnë integritetin dhe sovranitetin e kufijve të tyre nga kërcënimet e jashtme, në bashkëpunim me agjencitë e tjera. Detyra e forcave ushtarake është mbrojtja e territorit dhe sovranitetit, por edhe e sistemit të vlerave demokratike njerëzore, të cilat janë të shenjta dhe sublimë. Në kuadrin e pjesëmarrjeve në organizata ndërkombëtare, misioni i forcave të armatosura është po ai mision që kanë të gjithë pjesëtarët e unioneve, të garantojnë paqen nga kërcënimet për vendet

⁵ Kelsen, H. *Collective Security Under International Law*. New Jersey: The Lawbook Exchange, Ltd., 2001: 1-5.

⁶ Encyclopaedia Britannica, Inc. "Communitarianism", in: *Britannica Book of the Year 2012*. Encyclopaedia Britannica, Inc., 2012: 502-504.

⁷ P. A. J. Waddington. *Policing Citizens: Authority and Rights*. Hove, UK: Psychology Press, 1999: 2.

pjesëmarrëse. Forcat e armatosura angazhohen edhe në raste të emergjencave civile duke ju ardhur në ndihmë qytetarëve dhe duke bashkëpunuar ngushtë me Policinë e Shtetit. Një shoqëri (një shtet-komb) e ka të kërcënuar sigurinë e vet nga lufta, terrorizmi, epidemitë masive, kriminaliteti, prishja e rendit kushtetues, shkatërrimi i rrjeteve të transmetimit dhe të komunikimit strategjik etj.⁸

Çdo shtetas (qytetar) e ka detyrë kushtetuese pjesëmarrjen në mbrojtjen e vendit.⁹ Politika e sigurisë kombëtare është e lidhur ngushtë me politikën e sigurisë individuale, po aq sa edhe me politikën e sigurisë ndërkombëtare. Sigurimi i kufijve, i sovranitetit është detyrë parësore e forcave të armatosura. Sigurimi i këtyre të fundit nga kërcënimet e jashtme, përfshin edhe sigurinë e anëtarëve të kësaj shoqërie, duke qenë në këtë mënyrë njëkohësisht edhe siguri për jetën.¹⁰

Në periudhën e Luftës së Ftohtë koncepti i sigurisë lidhej pikërisht me këtë siguri, me shtetëroren (kombëtare). Rreziku ndaj saj përbënte edhe rrezikun më të madh dhe ky kërcënim ishte i vazhdueshëm. Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, koncepti mbi sigurinë publike u bë më real dhe perceptimi se kush ishin faktorët që e shkaktojnë pasigurinë shoqërore dhe individuale u bë më i vërtetë. Tashmë ishte krijuar një kuptim apo konceptim i avancuar, nisur edhe nga shkalla e rrezikut që e shkaktonte pasigurinë.¹¹

Më parë, nuk mendohej për shembull, që të studioheshin faktorë të cilët sot prodhojnë pasiguri siç është ndotja e ambientit, por sot kjo gjë është realitet përballë të cilit duhet qëndruar, duhet studiuar dhe duhet marrë seriozisht¹². Kërcënimet që i bëhen shtetit janë me efekte shoqërore ndaj është detyrë e Policisë së Shtetit që të punojë për garantimin e jetës së pjesëtarëve të shoqërisë. Këto kërcënime nëse nuk kontrollohen dhe nuk parandalohen, shkaktojnë pasoja të rënda shoqërore, por mund të çojnë edhe në prishje të rendit kushtetues, pra në anarki shoqërore. Një shpjegim që mund të japim mbi dualitetin midis sigurisë shtetërore dhe asaj shoqërore është ky:

“Ndërsa siguria shtetërore shqetësohet për kërcënimet ndaj sovranitetit të shtetit (nëse një shtet e humbet sovranitetin e tij ai nuk do të mbijetojë si shtet), siguria sociale shqetësohet për kanosjet që i bëhen identitetit të saj. Në mënyrë të ngjashme, nëse një shoqëri humbet identitetin e saj ajo nuk do të mbijetojë dot si shoqëri”.¹³

Policimi, nisur edhe nga krahasimi i kërcënimeve, si në nivel shtetëror edhe në nivel individual, është në kohët tona një “mision” mbarë shoqëror dhe me rëndësi jetike. Është me rëndësi të nënvizohet që mbrojtja e një shoqërie të hapur përcakton në politikën e saj kombëtare se misioni i parë i shtetit është të sigurojë jetën e qytetarëve të vet. Bëhet fjalë për një lloj vazhdimësie dhe ndërlidhje midis sigurisë personale, sigurisë kombëtare dhe sigurisë ndërkombëtare.¹⁴

Duke ju referuar Johannes F. Spreen, Michigan, sherifit të famshëm të Miçiganit

⁸ Council of Europe. *Armed Forces and Security Services: What Democratic Controls? Point de vue, point de droit; Points of view, points of law.* Strasbourg, France : Council of Europe, 2009: 238.

⁹ Parlamenti Shqiptar. “Artikulli 166”, në: *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*. Tiranë: OSCE (Organization for Security and Cooperation in Europe), 1998: 38.

¹⁰ Council of Europe. *Armed Forces and Security Services: What Democratic Controls? Point de vue, point de droit; Points of view, points of law.* Strasbourg, France: Council of Europe, 2009: 40-41.

¹¹ Foster, Gregory D. *In Search of a Post-Cold War Security Structure.* DIANE Publishing, 1994: 9-18.

¹² Broadus James, Vartanov Raphael V. *The Oceans and Environmental Security: Shared U.S. And Russian Perspectives.* Washington D.C.: Island Press, 1994: 13-18.

¹³ Collins, Alan. *Studime Bashkëkohore të sigurisë.* Tiranë: UET press, 2009: 216.

¹⁴ Watson, Cynthia Ann. *US. National Security: A Reference Handbook.* California: ABC-CLIO, 2008: 40.

(një oficer policie i shkëlqyer dhe njeriu që ndihmoi në ristrukturimin dhe zhvillimin e programit të trajnimit të Akademisë së Policisë si një program kolegji, një lloj “West Point”-i për oficerët e policisë – sot kolegji “John Jay College” i drejtësisë penale), ashtu siç ai ju drejtua disa reporterëve: “Fjala *Polici* (Police), është akronimi i POLICE, i cili do të thotë “*Protector Of Liberty for the Individual, the Community, and Everyone Equally*” (Mbrojtëse e Lirisë për Individin, Komunitetin dhe Barazisë së Kujtdo).¹⁵

2. Diskutimi kërkimor

2.1 Polica dhe objektivat e sigurisë

Policia është struktura e specializuar për të mbajtur barrën më të madhe të garantimit të sigurisë publike dhe ndaj kërkohet që kjo strukturë të përbëhet nga oficerë të kualifikuar dhe të përkushtuar. Ata që përbëjnë këtë strukturë janë autoritete në emër të ligjit, ndaj thuhet që “polici” identifikohet me shtetin, me mbrojtësin e ligjit.¹⁶ Policia harton Strategji për sigurinë e shoqërisë, objektivat e kësaj strategjie janë të planit afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë. Realizimi i këtyre objektiveve synon të krijojë një lidhje thelbësore ndërvepruese të interesave kombëtare, nevojave dhe mundësive të vendit.

Në planin afatshkurtër dhe afatmesëm qëndron angazhimi për realizimin e këtyre objektiveve parësore:

Paqe dhe siguri në vend dhe stabiliteti i brendshëm i vendit është produkt i forcimit të shtetit ligjor për të mbrojtur qytetarët, shoqërinë civile dhe shtetin nga veprimet antiligjore kjo bëhet më një policim efikas. Niveli i lartë i sigurisë do të krijojë premisa shumë të favorshme, për konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.¹⁷

Forcimi i institucioneve shtetërore është një garanci tjetër për zhvillimin e shoqërisë demokratike. Një shoqëri me institucione të konsoliduara është domosdoshmëri për zbatimin e normave dhe standarde dhe garanton ligjin. Nuk duhet të vazhdohet me faktin që të bëjmë ligje të mira por për zbatimin e tyre të mos interesohemi, fenomen që po shoqëron momentet e zhvillimit shoqëror në Shqipëri. Institucionet e shtetit duhet të garantojnë respektimin e të drejtave të njeriut (kërkesa kushtetuese në RSh)¹⁸ pasi ato përbëjnë një garanci për një mjedis të sigurt dhe raporte harmonike individ-shoqëri. Individu, shoqëria dhe shteti kanë detyrime të përbashkëta për sigurimin e vendit. Shkelja e këtyre detyrimeve qoftë edhe nga njëra palë, dëmton rëndë sigurinë e tij.

Një rol aktiv për sigurinë kanë edhe organizatat joqeveritare pasi ato kontribuojnë në konsolidimin e standardeve demokratike të shoqërisë për të shprehur gjithmonë problematikën që lind në mos respektimin e të drejtave të njerëzve. Fjala e tyre është e pa ndikuar nga interesa dhe konsiderohen si një grup

¹⁵ Holloway, Diane. *Legendary Lawman: Johannes F. Spreen*. Bloomington: iUniverse, 2009: 75

¹⁶ Spreen Johannes F., Holloway Diane. *American Police Dilemma: Protectors Or Enforcers?* Bloomington: iUniverse, 2003: 108.

¹⁷ De Maillard, Jacques. “International Perspectives in Policing: Challenges for 2020”, 173-177. In: (eds.) Wankhade, Paresh & Weir, David, *Police Services: Leadership and Management Perspectives*. Springer, 2015: 176.

¹⁸ Parlamenti Shqiptar. “Kreu II”, në: *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*. Tiranë: Alb Juris, 2009: 16.

interesi ku mund të jetë më afër me shqetësimin e shoqërisë. Të gjitha këto duhen parë si një aftësi për të mbrojtur interesat kombëtare dhe si një përgjegjësi për të vepruar ndaj çdo situatë.¹⁹

Ato konsiderohen si faktorë vendimtarë në suksesin e demokracisë dhe ekonomisë së vendit që kërkon të zhvillohet në demokraci. Për të gjitha këto ka një shërbim shtetëror të specializuar i cili është garant për sigurinë publike ky shërbim është Policia e Shtetit. E gjithë kjo që nënvizuar më lartë është një proces që kërkon planifikim, organizim dhe realizim të planeve të veprimit si dhe një kontroll të rreptë për realizimin e tyre.

Në planin afatmesëm dhe afatgjatë do të mbahen parasysh këto objektiva parësore:

Integrimi në strukturat evropiane dhe euroatlantike. Anëtarësimi në BE mbetet objektiv final në funksion dhe në dobi të tij bëhet dhe politika e sigurimit të vendit. Përafrimi i legjislacionit me standardet e Bashkimit Europian për të funksionuar shtetit ligjor janë garanci afatgjata për të mbrojtur interesat kombëtare dhe për integrimin e Shqipërisë.

Stabiliteti rajonal konsiderohet si kusht drejt integritit të vendeve të rajonit në Europë. Shqipëria synon të jetë një partner aktiv në politikës rajonale. Në këtë kuadër çështja Kombëtare Shqiptare synohet të arrihet nëpërmjet integritit evropian dhe euroatlantik të vendeve të rajonit si edhe zgjidhjeve që sigurojnë garanci afatgjatë dhe të pranueshme për bashkësinë ndërkombëtare.²⁰

Lufta kundër terrorizmit angazhon drejtpërdrejt të gjitha strukturat e specializuara të Policisë së Shtetit, Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Forcave të Armatosura. Në këtë kuadër, në bashkëpunim me organizmat e specializuara ndërkombëtare, strukturat përkatëse do të punojnë në drejtim të pasurimit dhe përmirësimit të bazës ligjore dhe në ristrukturimin e organeve të specializuara. Objektivi i tyre është efikasiteti maksimal në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit do të vazhdojë të jetë për një kohë të gjatë në qendër të veprimtarisë së shtetit dhe shoqërisë shqiptare. Institucionet ligjore shqiptare kanë për detyrë të ndërveprojnë mes tyre në mënyrë efikase. Zbatimi dhe përmirësimi i legjislacionit në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit përbën një element të rëndësishëm të Sigurisë së RSH-së.

Shumë me rëndësi është forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve institucionale, menaxhuese dhe reaguese të mbrojtjes civile dhe sigurisë publike nga fatkeqësitë natyrore dhe të llojeve të tjera, me synim parandalimin, përballimin dhe menaxhimin efektiv të emergjencave, si dhe zvogëlimin e rreziqeve dhe të fatkeqësive²¹. Forcimi i menaxhimit dhe kontrollit demokratik në mbrojtjen civile nga fatkeqësitë, mbi një bazë ligjore të re në përshtatje me filozofinë e BE-së, duke zgjidhur më mirë mekanizmat e drejtimit dhe të koordinimit, me synim kryesor krijimin e stabilitetit në zhvillimin ekonomik e social të vendit. Kjo gjë kërkon një

¹⁹ International Business Publications. *Albania Foreign Policy and National Security Yearbook, Volume 1, Strategic Information and Developments*. Washington DC: IBP USA, 2013: 171.

²⁰ International Business Publications. *Albania Foreign Policy and National Security Yearbook, Volume 1, Strategic Information and Developments*. Washington DC: IBP USA, 2013: 11.

²¹ Bailey, John & Dammert, Lucia. "Public Security and Police Reform in the Americas", in: (Ed.) John Bailey, Lucia Dammert, *Public Security and Police Reform in the Americas*. Pittsburgh: University of Pittsburgh Pre, 2005: 11.

polici profesionale, të pa korruptuar dhe bashkëpunuese me institucionet e tjera të zbatimit të ligjit.

2.2 Policia dhe qëndrimi ndaj kërcënimeve dhe rreziqeve të brendshme

Një pyetje e vlefshme për vlerësimin e situatës së sigurisë është: Cilat janë kërcënimet që lindin brenda shoqërisë së një vendi dhe sa është e ekspozuar Shqipëria nga tyre? Krimi i organizuar në vend, duke u perfeksionuar dhe profesionalizuar, është rrezik për shoqërinë dhe sigurinë e Republikës së Shqipërisë. Shpërpjesëtimet ndërmjet instrumenteve të pamjaftueshme për të zbuluar, luftuar e ndëshkuar krimin dhe përmasat e tendencat që ka zhvillimi i krimit, përbëjnë rrezik real për të sotmen dhe të ardhmen e sigurisë së Republikës së Shqipërisë.²²

Destabiliteti politik është rrezik për sigurinë e Republikës së Shqipërisë dhe mbrojtjen e interesave kombëtare. Përvoja e deritanishme e demokracisë në Shqipëri provon se destabiliteti politik ka qenë i pranishëm në mjedisin e brendshëm. Ky fenomen rrezikon mosfunksionimin e mirë të institucioneve, mungesën e paqes sociale e të qetësisë publike, mosarritjen e konsensusit politik për çështje shumë të rëndësishme të vendit dhe cenon prestigjin e Shqipërisë në kuadrin ndërkombëtar. Stabiliteti politik është një çështje jetike për shoqërinë shqiptare pasi nga andej burojnë të gjitha lëvizjet e institucioneve të tjera të shtetit dhe vet pushteti. Kjo gjendje e ulët e stabilitetit çon në rritjen e kontrabandës dhe korrupsionit, ngadalësimin e reformave, deformimin e institucioneve, simulimin e papunësisë, trafikëve dhe krimit të organizuar.²³

Zhvillimi i pamjaftueshëm ekonomik dhe mosplotësimi i nevojave elementare jetike, përbëjnë një element paqëndrueshmërie të sigurisë njerëzore në Shqipëri. Fenomenet negative që rrjedhin prej tyre, duke përfshirë të gjitha llojet dhe figurat e krimit janë në njëfarë mënyre pasojë e kësaj gjendje.

Emigracioni i paligjshëm i qytetarëve shqiptarë drejt vendeve të tjera përbën rrezik për kombin shqiptar, zhvillimin e vendit dhe sigurinë e Republikës së Shqipërisë. Efektet e këtij fenomeni shprehen në humbje jetësh, rrjedhjen e pakontrolluar e inteligjencës shqiptare, plakjen artificiale të popullsisë, mungesën e dëshirës për të punuar dhe forcimin e ndjenjës së largimit nga vendlindja.

Fatkeqësitë natyrore përfaqësojnë një rrezik për sigurinë e Republikës së Shqipërisë. Fatkeqësitë natyrore më të mundshme janë tërmetet, fatkeqësitë gjatë periudhës së dimrit, si përmbytjet, rrëshqitjet masive, zjarret masive në pyje, epidemitë e ndryshme. Fatkeqësitë mund të vijnë edhe nga veprimtaria njerëzore, siç janë aksidentet industriale, tokësore, ajrore e detare, pasojat që mund të shkaktojnë veprimet kriminale dhe terroriste etj.²⁴

Në aspektin e sigurisë, problemet demografike paraqesin një shqetësim serioz në Republikën e Shqipërisë. Lëvizjet e pakontrolluara të popullsisë, kryesisht nga zonat rurale të vendit drejt qendrave urbane, kanë krijuar shpërpjesëtime të konsiderueshme jo vetëm në drejtim të mbipopullimit, por edhe të largimit të

²² Newman, Graeme R., (eds.). *Crime and Punishment around the World*. California: ABC-CLIO, 2010: 8.

²³ Bugajski, J. (2011). Center for Strategic and International Studies (CSIS): *Albania's Challenges*. [vizituar në ueb, 12 dhjetor 2015] Available from World Wide Web: <http://csis.org/files/attachments/ts110601Bugajski.pdf>

²⁴ Hoti, M., Axhemi, S. "Natural Risks in Albania and the Role of Related Warning". In: Zschau, Jochen & Küppers, Andreas (reds.), *Early Warning Systems for Natural Disaster Reduction*. New York: Springer Science & Business Media, 2013: 103-105.

njerëzve nga zonat që, për sot dhe për të ardhmen, do të kenë nevojë për burime njerëzore.

Këto situata kërkojnë një analizë të problemeve dhe përcaktimin e saktë të premisave që çojnë në këto situata. Qëllimi është për të marrë vendime të cilat i përgjigjen pritshmërisë së ekipeve që menaxhojnë Policinë. Është kjo arsyeja që kërkohet ngritje e performancës së policisë, ngritje e nivelit të inteligjencës së policisë për të dominuar mbi kriminalitetin dhe për të garantuar rendin dhe qetësin në vend.

Konkluzione

Mbrojtja e një shoqërie konsiston në marrjen e masave në perspektivë, për të mos u gjetur në befasi kur ndodh një fatkeqësi natyrore apo edhe për akte terroriste. Këto masa janë plane të gatshme me skenarë, të cilët pavarësisht se nuk kanë ndodhur, ka gjasa që mund të ndodhin. Masat shërbejnë për përcaktimin e detyrave për institucionet, por edhe që popullata të mund të njihet nëpërmjet medias me mënyrën se si mund ta shmangin rrezikun nga akte të tilla. Është pa diskutim vendimmarrje për tu përshëndetur, që politika dhe shumë struktura policore në Europë rriten kontrollin nëpërmjet njësive të specializuara, të dedikuara vetëm kundër terrorit, por dhe me vënien në këtë funksion të gjithë bazës së informacioneve, me qëllim kontrollin dhe parandalimin e akteve të tjera. Në kushtet e organizimit të ri të pushtetit vendor është i nevojshëm që të bëhet një rishikim i të gjithë politikave të pushtetit vendor në lidhje me detyrimet që ka ky i fundit kur duhet të reagojë ndaj kërcënimeve të cilat lidhen me pushtetin vendor.²⁵

Siguria kombëtare, në kuadrin e sigurisë publike përfshin politikën dhe programet që lidhen me luftën kundër krimit të organizuar e trafikëve të paligjshme, luftën kundër terrorizmit, menaxhimin e integruar të kufijve, rendin dhe sigurinë publike, sigurinë rrugore, sigurinë në komunitet, ndihmën ndaj popullsisë në rastin e fatkeqësive natyrore etj.

Për arsye të karakterit ndërkombëtar, shumica e kërcënimeve të vlerësuara që kanë lidhje me vendin dhe që futen në atë që e quajmë *siguri kombëtare*, janë të lidhur ngushtë me sigurinë ndërkombëtare. Paralelisht, një numër në rritje i kërcënimeve ndërkombëtare, lidhet me incidente direkt në sigurinë kombëtare të vendit dhe përbëjnë rrezikshmëri për shoqërinë.

Shqipëria është përherë e më e integruar në një botë komplekse dhe të ndërvarur, ku rreziqet e brendshme dhe të jashtme janë të lidhura ngushtë. Përballja me këto rreziqe kërkon një qasje kombëtare dhe të integruar, që vë në përdorim burimet e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FA), agjencive të zbatimit të ligjit dhe shërbimeve inteligjente.²⁶

²⁵ European Commission (2015). Spokesperson: Natasha Bertaud, "Fighting terrorism at EU level, an overview of Commission's actions, measures and initiatives". Press Release, Brussels, 11 January 2015. [Accessed 12th January 2016] Available from World Wide Web: http://europa.eu/rapid/press-release_MEMO-15-3140_en.htm.

²⁶ *Strategjia Kombëtare e Republikës së Shqipërisë*, (2014), pika 5. [vizituar në ueb, 10 dhjetor 2015] gjendet në: http://www.parlament.al/web/pub/teksti_17880_1.pdf.

Referenca

1. Hope, T. & Sparks, R. *Crime, Risk and Insecurity: Law and Order in Everyday Life and Political Discourse*. London: Routledge, 2012.
2. Kelsen, H. *Collective Security Under International Law*. New Jersey: The Lawbook Exchange, Ltd., 2001.
3. Cummings, Th. G., Worley C. G. *Organization Development and Change*. Cengage Learning, 2009.
4. United States Congress, Senate, Select Committee on Intelligence. *Report on Impacts to US National Security of Advanced Satellite Technology Exports to the People's Republic of China (PRC)*. Volume 106, Issue 25 of S. U.S. Government Printing Office, 1999.
5. Kelsen, H. *Collective Security Under International Law*. New Jersey: The Lawbook Exchange, Ltd., 2001.
6. Encyclopaedia Britannica, Inc. "Communitarianism", in: *Britannica Book of the Year 2012*. Encyclopaedia Britannica, Inc., 2012.
7. Waddington, P. *Policing Citizens: Authority and Rights*. Hove, UK: Psychology Press, 1999.
8. Council of Europe. *Armed Forces and Security Services: What Democratic Controls? Point de vue, point de droit; Points of view, points of law*. Strasbourg, France : Council of Europe, 2009.
9. Parlamenti Shqiptar. "Artikulli 166", në: *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*. Tiranë: OSCE (Organization for Security and Cooperation in Europe), 1998.
10. Council of Europe. *Armed Forces and Security Services: What Democratic Controls? Point de vue, point de droit; Points of view, points of law*. Strasbourg, France: Council of Europe, 2009.
11. Foster, Gregory D. *In Search of a Post-Cold War Security Structure*. DIANE Publishing, 1994.
12. Broadus, James; Vartanov, Raphael. *The Oceans and Environmental Security: Shared U.S. And Russian Perspectives*. Washington D.C.: Island Press, 1994.
13. Collins, Alan. *Studime Bashkëkohore të sigurisë*. Tiranë: UET press, 2009.
14. Watson, Cynthia Ann. *US. National Security: A Reference Handbook*. California: ABC-CLIO, 2008.
15. Holloway, Diane. *Legendary Lawman: Johannes F. Spreen*. Bloomington: iUniverse, 2009.

16. Spreen, Johannes F.; Holloway, Diane. *American Police Dilemma: Protectors Or Enforcers?* Bloomington: iUniverse, 2003.
17. De Maillard, Jacques. "International Perspectives in Policing: Challenges for 2020", 173-177. In: (eds.) Wankhade, Paresh & Weir, David, *Police Services: Leadership and Management Perspectives*. Springer, 2015.
18. Parlamenti Shqiptar. "Kreu II", në: *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*. Tiranë: Alb Juris, 2009.
19. International Business Publications. *Albania Foreign Policy and National Security Yearbook, Volume 1, Strategic Information and Developments*. Washington DC: IBP USA, 2013.
20. International Business Publications. *Albania Foreign Policy and National Security Yearbook, Volume 1, Strategic Information and Developments*. Washington DC: IBP USA, 2013.
21. Bailey, John; Dammert, Lucia. "Public Security and Police Reform in the Americas", in: (Ed.) John Bailey, Lucia Dammert, *Public Security and Police Reform in the Americas*. Pittsburgh: University of Pittsburgh Pre, 2005.
22. Newman, Graeme R., (ed.). *Crime and Punishment around the World*. California: ABC-CLIO, 2010.
23. Bugajski, J. (2011). Center for Strategic and International Studies (CSIS): *Albania's Challenges*. [vizituar në ueb, 12 dhjetor 2015] Available from World Wide Web: <http://csis.org/files/attachments/ts110601Bugajski.pdf>
24. Hoti, M.; Axhemi, S. "Natural Risks in Albania and the Role of Related Warning". In: Zschau, Jochen & Küppers, Andreas (reds.), *Early Warning Systems for Natural Disaster Reduction*. New York: Springer Science & Business Media, 2013.
25. European Commission (2015). Spokesperson: Natasha Bertaud, "*Fighting terrorism at EU level, an overview of Commission's actions, measures and initiatives*". Press Release, Brussels, 11 January 2015. [Accessed 12th January 2016] Available from World Wide Web: http://europa.eu/rapid/press-release_MEMO-15-3140_en.htm.
26. *Strategjia Kombëtare e Republikës së Shqipërisë*, (2014), pika 5. [vizituar në ueb, 10 dhjetor 2015] gjendet në: http://www.parlament.al/web/pub/teksti_17880_1.pdf.

MEMAJ, B.
« Siguria
publike dhe
menaxhimi
policor »

Policimi
dhe
Siguria
nr.1, 2015

Histori dhe progres në arsimimin policor - progres drejt një policie europiane



■ Prof. Dr. Ilir MANDRO
Dekan, Fakulteti Hetimit të Krimit, Akademia e Sigurisë

Abstrakt

Arsimi policor ka pasur oshilacione dhe kurba e zhvillimit të tij herë ngrihet dhe herë ulet në varësi të mentaliteteve, nivelit intelektual të drejtuesve, apo dhe vetë kërkesave të kohës. Informacioni që ju do të keni në këtë shkrim, është produkt i një eksperience individuale të gjatë në sistemin arsimor policor dhe i mjaft materialeve të përgatitura në vite në pozicionet që unë kam pasur si asistent pedagog, pedagog, përgjegjës departamenti zëvendësudrejtor i Akademisë së Policisë dhe së fundmi dekan i Fakultetit të Hetimit të Krimit. Titulli materialit, në vetvete është atraktiv dhe jo pa qëllim, për të tërhequr vëmendjen e asaj pjese studentësh të cilët janë diplomuar në auditorët e kësaj shkolle, asaj pjese intelektualesh të cilët duan të çojnë përpara këtë arsimim, me të gjitha mundësitë e tyre, administrative dhe vendimmarrëse të kontribuojnë në zhvillimin e arsimit policor shqiptar si pjesë e arsimit universitar në vendin tonë dhe model i përparuar i një arsimit policor europian e më gjerë.

Nuk marr përsipër të bëj një historik të plotë të kurbës së zhvillimit të arsimit policor, herë në ngritje dhe herë në ulje, mbasi do të duheshin faqe të tëra, por e ndjej detyrim që për këto vite në këtë shkollë të evidentoj rezultatet dhe mangësitë, anët e forta dhe të dobëta të zhvillimit të procesit arsimor policor. Në material, përmes analizës së situatës, eksperiencës tradicionale e aktuale të këtij institucioni, ballafaqimit të realitetit me standardet e kërkuara, të afrojtë prioritete që çojnë në realizimin në të ardhmen, të një arsimit policor ku kompetenca akademike e cilësia e lartë profesionale të shoqërohet me elementë të një strukture dhe infrastrukture bashkëkohore. Çështjet e rendit dhe të sigurisë publike janë delikate. Prej tyre varet cilësia e qetësisë në jetën qytetare. Standardi i tyre është tregues i ekzistencës ose jo i shtetit të së drejtës. Në realitetin e sotëm kur lufta me kriminalitetin është bërë më e ashpër dhe më e sofistikuar, roli i shkollës së policisë në përgjithësi dhe kontributi që ky gjeneron përmes kursantëve¹ dhe studenteve² që arsimon në veçanti, mbetet ende një sfidë së cilës nuk mund t'i përgjigjesh me metoda të vjetra ose jo aq të avancuara sa kërkohet prej ritmeve të zhvillimit aktual. Cilësia e zhvillimit të planeve, kurrikulave mësimore e progresiste në arsimimin policor, kontribuojnë në garantimin e rendit dhe sigurisë publike në luftën kundër krimit në mbrojtje të lirive dhe të drejtave të njeriut.

Fjalëkyçe:

arsimim policor, infrastruktura ligjore, Akademia e Policisë, strategjitë e arsimit policor

MANDRO, I.
« Histori dhe progres në arsimimin policor - progres drejt një policie europiane »

Policimi dhe Siguria nr.1, 2015

1. Retrospektivë

Formimi profesional i strukturës policore daton 21 maj 1938³ dhe në tetor të vitit 1945 filloi organizimi i kurseve të shkurtra për përgatitjen profesionale të policisë kryesisht në prefekturën e Tiranës, Peshkopisë dhe Shkodër⁴.

Shkolla e Policisë, e cila filloj funksionimin në shtator të vitit 1946, kurset për formimin policor i zhvillonte me programe që shtriheshin nga 2 javë deri në 6 muaj dhe në përfundim kursanti do të titullohej “nënoficer” ose “oficer”⁵ police në varësi të kohëzgjatjes së programit mësimor që ai kryente.

Konsolidimi mësimdhënies nëpërmjet kurseve 4 mujore (janar 1948), dhe hapja e kursit të parë policor me kohëzgjatje 1 vit për oficerë e nënoficerë në vitin 1951, tregon një zhvillim progresiv për kohën dhe vlerësim për arsimimin e strukturave policore. Ky sistem kurseesh vazhdoi deri në vitin 1953 dhe më 20 janar të vitit 1954 krijohet “Shkolla e Bashkuar e Ministrisë së Punëve të Brendshme”⁶, e cila arsimonte specialiste për një periudhë 1,2-vjeçare.

Në vitin 1960 sistemi arsimor policor filloj të funksiononte me sistemin arsimor 3 vjeçar, e barasvlershme kjo me “Shkollën e Mesme Profesionale”. Në vitin 1968 shkolla filloi përgatitjen e personelit të saj me kurse nga 6 muaj deri në 1 vit, ky sistem arsimimi vazhdoi deri në vitin 1971.

Po në dhjetor të vitit 1971, krijohet “Shkolla e Lartë e Ministrisë së Punëve të Brendshme”⁷, ndërsa në shtator të vitit 1972, kjo shkollë filloi funksionimin e saj të rregullt duke aplikuar kërkesat e sistemit të lartë arsimor (jouniversitar). Në dhjetor të vitit 1972, me VKM u miratuan kriteret e pranimit në Shkollën e Lartë. Programi mësimor në këtë sistem arsimor, zhvillohej për 2 vjet në auditorët e kësaj shkolle dhe 1 vit në formën e një praktike pranë organeve policore. Në përfundim të këtij sistemi arsimor studenti mbronte diplomën dhe titullohej “Oficer Policie”.

Struktura organizative e Shkollës së Lartë përbëhej nga: Komandanti, struktura e degës mësimore, katedra e filozofisë, katedra e policisë, katedra e sigurimit, katedra e kufirit, katedra ushtarake, katedra juridike, struktura komanduese e kurseve,

³ Kursantë - në kuptimin e organizimit të brendshëm të Akademisë së Sigurisë vazhdojnë studimet në "Shkollën Bazë të Policisë", në përfundim të së cilës marrin certifikatën e përfundimit të kësaj shkolle dhe gradën policore "Inspektor" (sistemi arsimor 2015).

² Studentë - në kuptimin e organizimit të brendshëm të Akademisë së Sigurisë vazhdojnë studimet në Fakultetin e Hetimit të Krimi dhe Fakultetin e Sigurisë, në përfundim të së cilës marrin "Diplomë" në nivelin "Bachelor" dhe gradën policore "nënkomisar" (sistemi arsimor 2015).

³ Guidë e Akademisë së Policisë "Arben Zylyftari", Botim i vitit 2002, faqe 13.

⁴ Guidë e Akademisë së Policisë "Arben Zylyftari", Botim i vitit 2002, faqe 13.

⁵ Emërtimet e gradave dhe niveli i tyre në kohë të ndryshme kanë kuptime menaxheriale të ndryshme.

⁶ Guidë e Akademisë së Policisë "Arben Zylyftari", Botim i vitit 2002, faqe 13.

⁷ VKM nr. 184 dt. 20.12.1971 "Për krijimin e Shkollës së Lartë 3-vjeçare të oficerëve të MPB".

MANDRO, I.
« Histori dhe
progres në
arsimimin
policor -
progres drejt
një policie
europiane »

Policimi
dhe
Siguria
nr.1, 2015

sektori i kuadrit dhe prapavijës. Përveç zhvillimit të kurseve të studimit me kohëzgjatje 3 vjet, në shkollë kishte edhe kurse kualifikimi me afat, 6 dhe 9 mujor për studentë të cilët vinin në strukturat e Ministrisë së Punëve të Brendshme mbasi kryenin një shkollë të lartë universitare.

Shkolla funksiononte mbi bazën e një plani mësimor, i miratuar në vitin 1972, i cili ishte i organizuar në 2965 orë mësim teorike e praktike si dhe 384 orë punë prodhuese⁸. Përmbajtja e planit të parë mësimor të profilit të policisë kishte elementë të përbashkët me profilet e tjera të kësaj shkolle (Sigurim dhe Kufi), sidomos për lëndët e kulturës së përgjithshme, ideopolitike, përgatitjes ushtarake dhe fizike.

Plani mësimor për lëndët e arsimit të përgjithshëm miratohej nga Ministri i Arsimit, ndërsa për lëndët e përgatitjes profesionale nga Ministri i Punëve të Brendshme, pra Plani Mësimor i përgjithshëm në shkollë zbatohet kundrejt dy firmave të titullarëve të ministrive respektive.

Kurrikula e kësaj shkolle ishte e organizuar në 29 lëndë mësimore, ndërsa përmbajtja e tyre sipas grup-lëndëve ishte: lëndët ideopolitike, lëndët speciale, lëndët e përgjithshme speciale (juridike), lëndët ushtarake dhe fizike. Lëndët e fushës së specialitetit kishin përparësi (37-45.7 %) në raport me lëndët e tjera, pastaj në raporte më të ulëta ishin lëndët e formimit juridike dhe ato të disiplinave ushtarake. Në lëndët “speciale” bënin pjesë: shërbimet e policisë, përgatitja operative, procedura penale, kriminalistika, automobilizmi dhe praktika mësimore⁹.

Për të plotësuar nevojat e policisë me specialistë profesionistë, në vitin 1973, në Shkollën e Lartë, filloj të funksionojë edhe sistemi i arsimit policor me korrespondencë (pa shkëputje nga puna) 4-vjeçar. Plani mësimor i vitit 1974 mbi bazën e nevojave, bëri ndryshimet e nevojshme në përshtatje dhe me zhvillimet e kohës. Në vitin 1975 doli grupi i parë i të diplomuarve nga kjo shkollë, me 118 studentë të tre profileve¹⁰.

Në vitin 1977, pranë këtij institucioni filloi të funksiononte “Këshilli Shkencor i Shkollës së Lartë” ndërsa në vitin 1979 pranë Shkollës së Lartë u ngrit dhe “Komisioni i Aftësisimit Profesional”.

Plani mësimor i studimeve të vitit 1979 evoluoi duke rritur në 21 % orët në planin mësimor në krahasim me planin mësimor të vitit 1972. Struktura e planit mësimor për vitin akademik 1979-1980 kishte: 39 javë mësimore (3780 orë mësimore), 4 javë punë prodhuese, 2 stërvitje dhe 6 javë pushim. Në planin mësimor u bë një rigrupim i lëndëve të përgatitjes ushtarake dhe fizike, si dhe u pa e domosdoshme futja e lëndës “Gjuhë shqipe”. Në këtë plan mësimor vihet re rritja e orëve mësimore në lëndët e gjuhës së huaj dhe lëndëve ideologjike. Ajo që duhet të veçojmë nga përvoja e kësaj shkolle në ato vite, është fakti se, pas vitit 1979, ka filluar një lëvizje e brendshme për kualifikimin e mëtejshëm të personelit mësimdhënës, njihjen e gjuhëve të huaja, rritjen e cilësisë së përgatitjes profesionale të studentëve dhe nxitjen e tyre për përvetësimin e programit me rezultate të larta për kualifikimin e tyre në vazhdimësi.

Në vitin 1980, filluan për herë të parë të jepen provimet e formimit pasuniversitar nga trupa pedagogjike pranë Fakultetit të Shkencave Politiko-Juridike. Deri në mesin e viteve ‘80, në Shkollën e Lartë, 33 % e stafit pedagogjik

⁸ Punë e cila zhvillohej në bujqësi, industri, sipas një planifikimi të mëparshëm nga drejtuesit e Ministrisë.

⁹ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme. Dosje nr. 464. Viti 1972.

¹⁰ Profilet arsimore në këtë periudhë: Profili Polici, Profili Kufirit dhe ai i Sigurimit.

vazhdonin kualifikimin pasuniversitar, ku dhe më pas mbrojtën grada dhe tituj shkencorë në fushat profesionale, juridike dhe shkencave sociale.

Sipas dokumentacionit arkivor, vlerësojmë se në vitet 1980-1990, kjo shkollë mori një fizionomi më të plotë në drejtim të ndryshimit të planit e programeve mësimore, aktivitetit kërkimor e shkencor të trupit pedagogjik, të bazës didaktike dhe nivelit të studentëve që diplomoheshin. Në vitin 1982 në strukturën e shkollës u krijua edhe “katedra e gjuhëve të huaja”¹¹.

Kërkesat gjithnjë në rritje për nivelin e studentëve bënë që, në planin mësimor të vitit 1984, të shtohen disiplina të reja si Logjika, Kontabiliteti, Kriminologjia, Informatika etj, ndërsa plani i vitit 1985 i dha prioritet shtimit të disiplinave juridike¹².

Bashkëpunimi me universitetet në këtë periudhë ishte i frytshëm, çka dëshmonte me faktin se mjaft lëndë universitare jepeshin nga pedagogë të tyre. Theksi u vu në hartimin e planeve dhe programeve mësimore me nivel sa me të lartë shkencor dhe informacione të kohës. Planin mësimor, pavarësisht nga përçindja e lëndëve ideologjike, në përgjithësi u siguronte studentëve një kulturë të përgjithshme profesionale dhe juridike.

Gjatë periudhës 1975-1990, në Shkollën e Lartë janë përgatitur 365 studentë për oficer policie, 638 studentë për oficer sigurimi dhe 369 studentë për oficer kufiri¹³ si dhe janë kualifikuar e specializuar shumë punonjës policie të rolit të mesëm e të lartë sipas profileve përkatëse.

Terreni, kërkonte që dhe punonjësit e policisë të në nivel patrulle, inspektorë të policisë rrugore apo punonjësit e policisë në zonë, të kishin një nivel arsimor më të lartë, për t’ju përgjigjur me profesionalizëm luftës kundër kriminalitetit. Në nëntor të vitit 1986 në bazë të detyrave që do të kryente ky nivel policor, hartohen programet mësimore dhe hapet shkolla 2-vjeçare për punonjës policie të këtij roli¹⁴. Në vitin 1991 kjo shkollë emërtohet “Instituti i Policisë” dhe programet mësimore u “tkurrën” për tu zhvilluar në një vit akademik. Kursantët në përfundim të këtyre studimeve në institut titulloheshin “Punonjës Policie”. Gjatë kësaj periudhe u hapën dhe mjaft kurse formimi një dhe tremujore për punonjësit e policisë të rolit bazë.

Me fillimin e ndryshimeve demokratike në shtator të vitit 1991, në një periudhë transitore, ndryshon emërtimi nga “Shkolla e Lartë e Ministrisë së Punëve të Brendshme”, në “Instituti i Lartë i Rendit”¹⁵. Sistemi i studimit dhe me këto ndryshime ishte me dhe pa shpëputje nga puna.

Ky organizimin nuk vazhdoi gjatë derisa në shtator 1992¹⁶ u krijua “Akademia e Rendit Publik”, si institucion i lartë arsimor për përgatitjen e oficerëve të përgjithshëm të policisë. Ndryshimet organizative të kësaj kohe konsistonin në krijimin e strukturave të reja sipas shërbimeve si: Katedra e Policisë Kriminale, Katedra e Shërbimeve të Rendit, Katedra Juridike, Katedra e Përgjithshme, Katedra e Përgatitjes Ushtarake dhe Fizike. Në këtë periudhë u bënë ndryshime të

¹¹ Në shkollë zhvilloheshin gjuhët e huaja si Anglisht, rusisht, serbo-kroatisht.

¹² Me iniciativën e prof. dr. Luan Gjonçaj, një grup pedagogësh nga Universiteti i Tiranës, asistuan në hartimin e Planit Mësimor miratimi i të cilit bëri hop cilësor në dhënie e njohurive juridike duke filluar aktivizimin në mësimdhënie staf nga Fakulteti i Drejtësisë të Universitetit të Tiranës.

¹³ Arkivat e Akademisë së Policisë (Zyra e personelit dhe AMZA e kësaj shkolle).

¹⁴ Shkolla 2-vjeçare e Policisë.

¹⁵ Shih Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 339, datë 02.09.1991.

¹⁶ Shih Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 405, datë 15.09.1992.

MANDRO, I.
« Histori dhe
progres në
arsimimin
policor -
progres drejt
një policie
europiane »

Polici
dhe
Siguria
nr.1, 2015

rëndësishme në planin dhe programet mësimore duke u zhveshur programet nga lëndë me terminologji politike, dhe duke i zëvendësuar me disiplina të reja mësimore.

Për herë të parë në vitin 1993, u fut disiplina e sociologjisë dhe disa lëndë të reja të formimit juridik. Sistemi arsimor ishte 3 vite akademikë për formimin e “oficerëve të përgjithshëm të policisë” me shkëputje nga puna dhe 4 vjet për sistemin pa shkëputje nga puna. Në sistemin pa shkëputje nga puna prej vitit 1991 filloj të ketë një rritje të numrit të femrave që studionin për specialiste të larta policie.¹⁷ Në shtator të vitit 1993, në Akademi pranohen 25 studente femra me shkëputje nga puna për “Specialiste të Larta Policie”¹⁸.

Vitet e studimit me shkëputje nga puna	Numri të diplomuarve studente femrave (studime me shkëputje nga puna)	Vitet e studimit pa shkëputje nga puna	Numri të diplomuarve studente femrave (studime pa shkëputje nga puna)
1993-1996	25	1978-1981	2
1994-1997	36	1985-1989	1
1995-1998	69	1991-1995	2
1996-1999	73	1993-1997	10
1997-2000	-	1994-1998	45
1998-2001	-	1995-1999	30
1999-2002	17	1996-2000	4
2000-2003	24	1997-2001	9
2001-2004	8		
2002-2005	8		
2003-2006	12		
2004-2007	8		

Aktiviteti i Akademisë në periudhën 1990-2000 ishte tepër i ngjeshur. Me një staf të reduktuar, mësimi zhvillohej në kushte e mjedise mësimore e akomoduese shumë të rënduara, të cilat impononin “*Specialistë policie*”, prej të cilëve 1633 me sistemin me shkëputje nga puna dhe 2264 me sistemin pa shkëputje nga puna. Emërtimet e shkollës, dhe veprimtaria brenda saj evoluojnë në të gjithë parametrat, derisa në vitin 2000 mbi bazën e një tradite të gjatë shkollimi policor, krijohet “Akademia e Policisë”¹⁹ në përbërje të së cilës ishte edhe “Instituti i Policisë”. Hartimi i planit të ri mësimor në vitin 2001-2002, pati si objektiv përafrimin me standardet e shkollave homologe të larta (përsa i përket disiplinave, orëve mësimore, raporteve teori-praktikë etj., si dhe zhvillimin e programeve të përshkallëzuar sipas roleve të punonjësve të policisë).²⁰

U rregulluan raportet midis mësimave teorike e praktike në kuotat 51 % me 49

¹⁶ Shih Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 405, datë 15.09.1992.

¹⁷ Prej vitit 1978-1981 në shkollën e Ministrisë së Punëve të Brendshme (profile sigurim), diplomohen në sistemin me korrespondencë 2 specialiste të larta (femra), dhe në vitet 1985-1989, diplomohet një specialiste e lartë.

¹⁸ Fluksi i pranimeve erdhi gjithmonë në rritje.

¹⁹ Shih Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 281, datë 02.06.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Policisë”.

²⁰ Referoju tabelës nr. 4 në pjesën “Aneksë” të këtij materiali.

%, u reduktuan njohuritë paralele të dhëna në lëndë të ndryshme, si dhe u futën një serë disiplinash të reja universitare dhe profesionale si: “Psikologji e personalitetit”, “Psikologji e komunikimit”, “Sociologji dhe etikë profesionale”, “E drejta e policisë”, “Taktikat e ndërhyrjes”, “Teknikat e sigurisë”, “Investigimi i krimin”, “Teknikat informative”, etj. Në vitin 2009²¹ mbyllet Akademia e Policisë “Arben Zylyftari” dhe prej vitit 2006 kishte filluar organizimi i një sistemi arsimor në funksionimin e një “Qendre të Formimit Policor” si hap i parë për zhvillimin e karrierës në polici. Kjo qendër do të jetë pjesë përbërëse e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit”.

2. Infrastruktura ligjore

Baza juridike mbi të cilën ka funksionuar shkolla në të gjitha fazat e zhvillimit të saj kanë qenë ato arsimore dhe konkretisht: Ligji për Policinë e Shtetit²², Ligji për arsimin e lartë²³, VKM “Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Policisë”²⁴. Ndërsa akte specifike nënligjore që normonin e rregullonin veprimtarinë e Akademisë sidomos procesin mësimor, disiplinën, standardet e përzgjedhjes së personelit dhe kandidatëve të rinj për studentë e kursantë mungonin. Akademia për çdo aktivitet të saj i referohej Rregulloreve të miratuara si ajo e vitit 1993, e cila me disa ndryshime të vitit 1998, përsëri nuk plotësonte nevojat dhe dinamikën që kishte nxjerrë koha. Domosdoshmëri ishte krijimi i një bazë ligjore specifike për Akademinë e Policisë. Ligji i arsimit të lartë, praktikat universitare tregonte se shkollat e arsimit të lartë duhej të udhëhiqeshin nga një dokument bazë siç ishte “Statuti” dhe mbi bazën e tij të bëhej “Rregullorja e shkollës”.

Ndryshimet ligjore e nënligjore në Akademi synuan në krijimin dhe përsosjen jo vetëm të bazës juridike të Akademisë, por edhe të rregullimit e harmonizimit të së gjithë aktivitetit dhe veprimtarisë së këtij institucioni si në procesin e mësimdhënies edhe të trajtimit ekonomik e social të studentëve e kursantëve, për përsosjen e standardeve të rekrutimit të kandidatëve për studentë dhe kursantë policie, si dhe demokratizimin e tërë veprimtarisë së shkollës. Në funksion të këtij objektivit në periudhën e vitit 2001 u hartuan dhe miratuan nga ministri i Rendit Publik dokumente të rëndësishme juridike si: Statuti i Akademisë së Policisë²⁵, “Rregullorja e brendshme e funksionimit të Akademisë”²⁶, “Aneksi” i rregullores së brendshme mbi “Detyrat funksionale të personelit sipas organikës”²⁷, “Rregullorja për konkurrimet e pranimit në Akademi”,²⁸ “Programi i pranimit për nëninspektorë dhe agentë policie”.

Miratimi i dokumenteve bazë kanë synuar në normimin e rregullave që krijojnë më shumë hapësira për zhvillimin e veprimtarisë mësimore dhe shkencore, forcimin

²¹ VKM nr.135, datë 11.2.2009 pushon të funksionuari “Akademia e Policisë “Arben Zylyftari”

²² Ligji Nr 8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”.

²³ Ligji nr. 8461 datë 25.2.1999 “Për Arsimin e Lartë në RSH”.

²⁴ VKM nr. 281 datë 02.06.2000 “Për organizimin e funksionimin e Akademisë së Policisë”.

²⁵ “Statuti i Akademisë së Policisë Arben Zylyftari”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Rendit Publik Nr. 1550 datë 11.09.2001.

²⁶ “Rregullorja e Brendshme e Akademisë”; propozuar nga Këshilli i Akademisë dhe miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Akademisë Nr. 342 datë 31.10.2001.

²⁷ “Detyrat e Personelit sipas organikës”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Akademisë Nr. 342 datë 31.10.2001.

²⁸ “Rregullorja për Konkurrimet e Pranimit në Akademi”, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Rendit Publik Nr. 2001 datë 11.09.2004.

e rregullit dhe disiplinës në procesin e mësimit, rritjes së autoritetit profesional, si dhe për një evidentim dhe përsosje të vlerave pedagog-student dhe anasjelltas. Në kuadrin e ndryshimeve të infrastrukturës ligjore, mbart vlera të veçanta edhe ndryshimi i realizuar me Vendim të Këshillit të Ministrave²⁹ lidhur me afatet e kurseve të kualifikimit dhe specializimit, i cili kontribuoi shpejt në cilësinë e kualifikimit profesional të punonjësve të policisë si dhe në shtimin e prurjeve të specialistëve në auditorët e kësaj shkolle. Me gjithë ndryshimet e bëra dhe aktet ligjore të nxjerra, koha ecën dhe kërkesat për reflektimin ndaj tyre sa vjen dhe bëhet me konkrete për t'i lënë dhe hapur rrugë emancipimit të vazhdueshëm.

2.1 Statusi i Akademisë së Policisë

Statusi³⁰ i Shkollës së Policisë, qysh prej krijimit të saj e deri në ditët e sotme ka ardhur gjithnjë në përmirësim dhe rritje. Miratimi i kuadrit ligjor për Policinë e Shtetit, në nëntor 1999, bëri të mundur krijimin e statusit të ri për Akademinë e Policisë. Në dispozitat e këtij ligji përcaktohet pozicioni juridik dhe misioni i Akademisë së Policisë³¹

Disa muaj më vonë, në qershor të vitit 2000, përcaktohet organizimi dhe funksionimi i Akademisë së Policisë³² dhe përgjegjësitë kryesore të saj. Ndërsa në janar të vitit 2001, Akademië së Policisë, iu dha emri i Dëshmorit të Policisë "Arben Zylyftari"³³. Sipas ligjit "Për Arsimin e Lartë në RSH", Akademia e Policisë përfshihet në sistemin e shkollave të larta duke përfitur në statusin e saj të gjithë të drejtat e detyrimit që rrjedhin nga ligji në fjalë. Statusi i saj juridik është shoqëruar edhe me ndryshime në fushën e demokratizimit të jetës së brendshme të Akademisë, të shprehura në autonominë dhe lirinë akademike në procesin mësimor, në fushën e mësimdhënies dhe kërkimeve shkencore si dhe në respektimin e opinioneve, të ideve e metodave me bashkëkohore.

2.2 Misioni dhe objektivat

Në strategjinë e reformës në Policinë e Shtetit, Akademië së Policisë, si institucion i lartë arsimor, i lihet detyrim institucional për riorganizimin e saj për të realizuar misionin e formimit dhe kualifikimit të personelit të policisë.³⁴ Në programin e zhvillimit strategjik të Akademisë si institucion i lartë mësimor dhe kërkimor shkencor, janë përcaktuar misioni dhe objektivat e saj për: "...formimin, përgatitjen dhe kualifikimin e specialistëve të së gjithë roleve të Policisë së Shtetit, për të qenë të aftë e të përkushtuar për mbrojtjen e rendit dhe të sigurisë publike, si dhe për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore në fushën e policimit.³⁵ Në funksion të këtij misioni, janë përcaktuar dhe detyrat institucionale të

MANDRO, I.
" Histori dhe
progres në
arsimin
policor - progres
drejt një policie
europiane"

Policimi
dhe
Siguria
nr.1, 2015

26

²⁹ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 605 datë 13.10.2001, "Për kurset e formimit profesional të kualifikimit e specializimit në Akademinë e Policisë "Arben Zylyftari".

³⁰ Statusi juridik i Akademisë mbështetet në ligjin nr. 8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit", ligjin nr. 8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e Lartë në RSH", VKM nr. 281, datë 2.6.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Policisë" si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore.

³¹ Ligji Nr 8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit", neni 18 "Formimi dhe Kualifikimi".

³² Shih Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 281, datë 02.06.2000.

³³ Shih Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.663 datë 13.12. 2000.

³⁴ "Strategjia e Reformës në Policinë e Shtetit", Botim i "Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut", Tiranë, prill 2001, faqe 49.

³⁵ Shih Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 281 dt. 02.06.2000, "Për organizimin e funksionimin e Akademisë së Policisë", si dhe "Statutin e Akademisë së Policisë", miratuar me Urdhrin e Ministrit të Rendit Publik Nr. 1550 datë 11.09.2001 Neni 1.

Akademisë:

- a. Përgatitja e punonjësve të rinj të policisë.
- b. Formimi dhe kualifikimi i punonjësve të policisë së rolit bazë.
- c. Formimi dhe kualifikimi i punonjësve të policisë të rolit të mesëm.
- d. Kualifikimi i punonjësve të policisë të rolit të mesëm, të lartë dhe madhor.
- e. Përgatitja e kapaciteteve dhe realizimi i kërkimeve e studimeve policore.
- f. Realizimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e shkëmbimit të eksperiencave, kualifikimit dhe kërkimit shkencor.

Në dokumentin strategjik³⁶ janë përcaktuar dhe objektivat kryesore:

1. Riorganizimi dhe konsolidimi i Akademisë së Policisë si institucion arsimor për formimin dhe kualifikimin e personelit të policisë sipas roleve.
2. Hartimi dhe zbatimi i programeve të reja mësimore për formimin dhe kualifikimin e punonjësve të policisë.
3. Kualifikimi i stafit mësimdhënës të Akademisë.
4. Rehabilitimi i infrastrukturës për krijimin e kushteve mësimore e jetësore në funksion të procesit mësimor.
5. Bashkëpunimi me institucionet arsimore të vendit, ato homologe perëndimore, misionet e huaja policore dhe shoqërinë civile.

Realizimi i misionit dhe objektivave të Akademisë së Policisë shprehet në produktin që ajo nxjerr: “Në përfundim të studimeve 1-vjeçare, kursanti në Institutin e Policisë titullohet “Polic” dhe pajiset me “Dëshmi”. Në përfundimin e studimeve 3-vjeçare, studenti i Akademisë, titullohet “*Specialist i Lartë Policie*” e pajiset me “*Diplomë*”; ndërsa kursantët e të gjithë kurseve të kualifikimit pajisen me “*Certifikatë*”. Studentët e Shkollës së Lartë Pasuniversitare në Akademinë e Policisë, në përfundim të saj pajisen me “*Diplomë të Studimeve të Thelluara Pasuniversitare*”(Master)³⁷.

Specifike e kësaj shkolle është dhe arsimimi dhe kualifikimi i punonjësve të policisë të rolit bazë në Institutin e Policisë, institucion arsimor ky që funksiononte³⁸ brenda Akademisë së Policisë. Reformimi dhe ristrukturimi i kësaj njësie arsimore ka filluar dhe vazhdoj më tej me ndihmën e misionit MAPE.

3. Strategjitë e arsimimit policor

Në zbatim të Strategjisë së Reformës në Policinë e Shtetit, Akademia e Policisë, duke u gjendur në dilemën e zigzaget nëpër të cilat ka kaluar kjo shkollë si dhe duke u nisur nga kërkesat bashkëkohore për zhvillimin arsimor dhe shkencor, në vitin 2001, hartoi për herë të parë programin strategjik 5-vjeçar³⁹ të arsimimit policor, duke hyrë kështu në rrugën e reformës institucionale. Synimi i kësaj reforme ishte konsolidimi i sistemit të arsimimit dhe kualifikimit të punonjësve të policisë në Akademinë e Policisë me qëllim, ngritjen e nivelit profesional sipas standardeve të

³⁶ “Programin Strategjik të Akademisë së Policisë”, prill 2001. Kapitulli II, “Synimet dhe Objektivat”, faqe 16.

³⁷ VKM nr. 524 datë 01.08.2003 “Miraton hapjen e Shkollës Pasuniversitare pranë Akademisë së Policisë ‘Arben Zylyftari’ “. Kjo shkollë nuk mundi të nxjerrë brez të diplomuarish për shkak të pezullimit së saj si pasojë e dorëheqjes së drejtuesit të saj Prof. Dr. Ilirjan Mandro.

³⁸ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 281 dt. 02.06.2000, “Për organizimin e funksionimin e Akademisë së Policisë”.

³⁹ “Programi Strategjik i Akademisë së Policisë” u hartua në prill të vitit 2001. Ky program u bë publik në konferencën shkencore, “Për Strategjinë e zhvillimit të arsimimit dhe kualifikimit të Policisë së Shtetit” (2001-2005).

MANDRO, I.
« Histori dhe
progres në
arsimimin
policor -
progres drejt
një policie
europiane»

Policimi
dhe
Siguria
nr.1, 2015

përafuara të policimit perëndimor. Para se të bëheshin strategjitë e zhvillimit arsimor u bë një analizë e gjendjes së arsimit dhe për këtë qëllim në prill të vitit 2001 u zhvillua konferenca shkencore “Për strategjinë e zhvillimit të arsimit dhe kualifikimit të Policisë së Shtetit”⁴⁰.

Programi i hartuar përcakton vizionin dhe konceptin modern për shkollimin e policisë, drejtimet kryesore, rrugët, mënyrat dhe mjetet për të ndërtuar një sistem bashkëkohor arsimimi dhe kualifikimi. Njëkohësisht për të zhvilluar një aktivitet kërkimor shkencor nisur nga nevojat e kohës dhe ato të perspektives së policimit, ky program përbën bazën për ndryshimet në vijim të akteve normative, ndërtimin strukturor, hartimin e planit e programeve të reja mësimore dhe zhvillimin e kërkimeve dhe studimeve shkencore në fushën e policimit.⁴¹ Për të bërë një implementim eficient të kësaj strategjie, në fazën e parë u përcaktuan detyrimet prioritare si:

- Rishikimi dhe krijimi i një infrastrukture të re ligjore e organizative.
- Rehabilitimi i mjediseve dhe normalizimi nivelit profesional të punonjësve të policisë.

Në këtë fazë prioritet mori hartimi dhe zbatimi i një plani të veçante për të kaluar emergjencën për kualifikimin e punonjësve të policisë të rolit bazë dhe atij të mesëm. Për të gjitha këto u përcaktuan detyra konkrete në programin strategjik të Akademisë së Policisë.⁴²

Në fazën e dytë, 2003-2005, objektivi kryesor dhe më prioritar ishte normalizimi i shkollës me të gjitha parametrat e kërkuar dhe zhvillimi cilësor i programeve për të formuar punonjës policie me nivel të lartë profesional.⁴³ Me gjithë arritjet cilësore kësaj faze i del detyrë që të përmirësohen mjaft momente për zhvillimi më cilësor të aktivitetit të shkollës.

Në zbërthim të programit strategjik, u hartua plan-veprimi për implementimin e programit sipas fushave të reformës dhe fazave përkatëse. Implementimi i këtij programi, është nisur nga përcaktimi i disa prioritetëve të rëndësishme që lidhen me:

- Krijimin e infrastrukturës ligjore e nënligjore.
- Ristrukturimin dhe konsolidimin e Akademisë së Policisë si institucion i lartë arsimor dhe përgjegjës për arsimin policor;
- Zhvillimin e programeve të reja mësimore sipas standardeve perëndimore.
- Përforcimin e kriterëve dhe procedurave në përzgjedhjen e stafit dhe punonjësve të rinj të policisë.
- Rritjen e aktivitetit kërkimor shkencor.
- Përmirësimin e kushteve të akomodimit dhe studimit në Akademi.

Ndryshimet ligjore e nënligjore që u bënë në këtë periudhë kanë synuar në krijimin dhe përsosjen e bazës juridike të Akademisë, rregullimin dhe harmonizimin e gjithë aktivitetit dhe veprimtarisë së këtij institucioni sipas legjislacionit të ri, plotësimet dhe rregullimet e nevojshme të akteve të ndryshme për mësimdhënien

⁴⁰ Përpara se të ndërmerrej një reformë në arsimimin policor, në prill të vitit 2001, u organizua një konferencë me mbështetjen e misionëve policore evropiane.

⁴¹ Vitet 2001-2005, kanë qenë kulmore në zhvillimin e sistemit arsimor jo vetëm në formë, por dhe në përmbajtje. Sistemi arsimor i prezantuar në këto vite u vlerësua si institucion i lartë arsimor nga Ministria e Arsimit, duke bërë vlerësimet e jashtme dhe i dhanë statusin “Akreditim i Akademisë së Policisë” (me kusht).

⁴² “Programi strategjik i Akademisë së Policisë”, prill 2001, faqe 28.

⁴³ “Programi strategjik i Akademisë së Policisë”, prill 2001, faqe 29.

dhe trajtimin ekonomik e social të studenteve dhe kursanteve, për përforcimin e standardeve të rekrutimit të kandidatëve për studentë dhe kursantë policie, si dhe demokratizimin e tërë veprimtarisë së shkollës.


4. Struktura organizative

Akademia e Policisë trashëgoi një strukturë organizative të përzierë me elementë ushtarakë të komandimit e drejtimit dhe që nuk përputhej me ligjin e ri të Policisë së Shtetit dhe ligjin për arsimin e lartë. Kishte struktura komanduese të ngjashme me ato të shkollave ushtarake. Strukturat mësimore ishin të shkëputura, madje disa dhe të izoluar nga njëra-tjetra, për arsye të “sekretomanisë”. Si rrjedhojë eficensa e tyre ishte shumë e ulët dhe në të njëjtën kohë edhe produkti i shkollës ishte jo cilësor. Për të kapërcyer këtë pengesë strukturore, në zbatim të plan-veprimit u bë riorganizimi i Akademisë dhe institucioneve vartëse të saj. Për t’i paraprirë fillimit të suksesshëm të vitit të ri mësimor, në mars të vitit 2001 emërohet staf i ri drejtues. Ky staf i sapoemëruar për herë të parë, vinte me arsim bazë policor, eksperiencë pune në këto struktura.⁴⁴ Pas një pune disamujore, në shtator 2001 filloi implementimi i strukturës së re të Akademisë dhe Institutit të Policisë⁴⁵.

Synimi i organizimit të ri ishte ngritja dhe konsolidimi i një institucioni arsimor e kërkimor shkencor në funksion të nevojave të Policisë së Shtetit, të demilitarizuar, me struktura fleksibël, rregulla e procedura të qarta funksionimi. E veçanta e ndryshimeve organizative të Akademisë qëndron në krijimin e strukturave të reja e të kompaktësuar sipas specifikave të formimit të përgjithshëm universitar dhe profesional, duke qenë në përputhje me kërkesat e ligjit të arsimit të lartë, mbi bazën e departamenteve si njësi bazë mësimore shkencore dhe seksioneve përkatëse si:

- sektori i plan-programeve;
- departamenti i formimit të përgjithshëm (sek. i disiplinave psikosociale, juridik dhe i gjuhëve të huaja);
- departamenti i formimit profesional (seksioni i së drejtës së policisë, ai i

Skema Organizative e Akademisë së Policisë



MANDRO, I.
« Histori dhe
progres në
arsimin
policor -
progres drejt
një policie
europiane»

⁴⁴ Drejtor i Akademisë emërohet dr. Bajram Yzeiri (2001-2003); zv. drejtor, prof. asc. Ilirjan Mandro (2001-2006) dhe kancelar, Albert Dervishi (2001-2002).

⁴⁵ Shih në strukturën e Akademisë së Policisë miratuar me Urdhër të Ministrit të Rendit Publik shtator 2001.

teknikave të sigurisë publike, investigimit të krimit, vetëmbrojtjes dhe i kualifikimit);

- qendra e Studimeve dhe Kualifikimeve (seksioni i studim-botimeve dhe kualifikimeve).

Kjo strukturë organizative u shoqërua me një infrastrukturë ligjore, e cila përfundoi me Statutin, “Rregulloren e Brendshme të Akademisë”, “Aneks-rregullorja” për detyrat e çdo posti pune në Akademi, disa ndryshime në “Rregulloren për konkurrimet e pranimit në Akademi”⁴⁶, duke përcaktuar standarde të reja për rekrutimin e personelit mësimdhënës dhe punonjësve të rinj të policisë (studentëve e kursantëve).

4.1 Standardet e pranimeve të studentëve në akademi

Deri në vitin 1990 studentët regjistroheshin në shkollë me urdhrin e Ministrit. Vendosja e shkollës mbi akte ligjore në përputhje me ligjin e arsimit të lartë, statuti i Akademisë normon regjistrimin në shkollë me konkurs si për aplikantët për kursantë dhe për aplikantët për studentë. Aplikantët duhej të plotësonin disa kriteret⁴⁷. Konkurrimi i aplikantëve për kursantë apo studentë në Akademinë e Policisë zhvillohej në tre faza:

- verifikimi i aftësive shëndetësore (testimi mjekësor) dhe cilësive fizike (testimi fizik);

- verifikimi i aftësive dhe cilësive intelektuale (testimi intelektual);

- intervista me aplikantët.

Procedurat e pranimit dhe konkurrimit përcaktoheshin në rregulloren përkatëse të miratuar nga ministri i Rendit Publik dhe kriterëve të përcaktuara në aktet e tjera ligjore e nënligjore. Programet e lëndëve për të cilat duhet të përgatitet aplikanti miratohen nga drejtori i Akademisë dhe iu vihen në dispozicion të gjitha drejtorive dhe komisarivateve në qarqe. Studimet në Akademi apo Institutin e Policisë do të frekuentoheshin nga shtetasit që fitonin konkursin mbi bazën e rezultateve të arritura në rend zbritës, deri në kufirin e kuotës së pranimeve për vitin akademik në vijim. Për nevojat e sektorëve në polici, ku kërkoheshin njohuri të posaçme, mund të pranohen specialistë me arsim të lartë.⁴⁸ Edhe në këto raste aplikantët i nënshtrohen konkurrimit. Në Akademi mund të studiojnë apo kualifikoheshin punonjës të policive të tjera të njohura me ligj në Republikën e Shqipërisë, në bazë të marrëveshjes midis Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe titullarit të organit të tyre.

4.2 Kontrata e punës

Kontratat e punës me personelin e Akademisë nënshkruhej nga drejtori ose personi i autorizuar prej tij. Kushtet e kontratës së punës, zgjidhen sipas legjislacionit në fuqi. Ato lidhen:

⁴⁶ Shfuqizuar dhe miratuar rregullorja e re për “Pranimet e studentëve dhe kursantëve në Akademinë e Policisë” me Urdhër të Ministrit të Rendit Publik Nr. 2001 datë 11.09.2004.

⁴⁷ Të kenë zotësi të plotë për të vepruar; të kenë kryer arsimin e mesëm; të kenë kryer shërbimin ushtarak (vetëm për kursantë-meshkuj); të kenë sjellje të mira qytetare; të mos jenë dënuar penalisht; të kenë mbushur moshën 19 vjeç.

⁴⁸ Ky grup studentësh duhet të plotësonte disa kushte: të kenë zotësi të plotë për të vepruar; të kenë kryer arsimin e lartë; të kenë vjetërsi pune mbi 3 vjet në specialitetin përkatës; të mos jenë të dënuar penalisht; të kenë sjellje të mirë qytetare.

- midis pedagogut të jashtëm i afruar në mësimdhënie në procesin mësimor dhe drejtorit të Akademisë së Policisë;
- studentëve fitues të konkursit për të vazhduar Akademinë e Policisë dhe kësaj akademie ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve;
- midis punonjësit civil, të cilët ofrohen në Akademi për poste të veçanta pune për një sezon të caktuar dhe drejtorit të Akademisë së Policisë.

5. Programet e studimit

5.1 Planifikimi dhe programimi

Para fillimit të vitit mësimor 2001-2002, ekzistonin plane dhe programe mësimore me koncepte të vjetra dhe strukturë të lëndëve të trashëguara, që krijojnë konfuzion, ishin të ngarkuara me material të tepërt teorik, dhe nuk i përgjigjeshin rolit e detyrave që do të kryente punonjësi i policisë në mjedisin e ri demokratik. Lëndët profesionale nuk kishin konceptet e reja të policimit dhe nuk pasqyronin si duhet standardet ndërkombëtare të respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut dhe teknikat e reja të investigimit. Nga studimi i bërë planeve dhe programeve mësimore, konstatohet një mbivendosje njohurish në lëndë të ndryshme. Tema të njëjta jepeshin në disiplina juridike dhe ato profesionale. Gjatë hartimit të planit dhe programeve të reja për formimin e nëninspektorëve të Policisë së Shtetit, u mbajt parasysh misioni, përgjegjësitë dhe detyrat e Akademisë së Policisë, programet mësimore të shkollave homologe, përafrimi në strukturë dhe përmbajtje e planit mësimor me nevojat e policimit në një shoqëri demokratike, përshkallëzimi i programeve duke i lënë hapësirë zhvillimit të programeve të kualifikimit për karrierë apo specializimit të ngushtë të punonjësve të policisë.

Mbi bazën e programit të zhvillimit të Arsimit Policor; programeve vjetore, të miratuara nga MRP, planeve të punës dhe ato shkencore me të cilat funksiononte Akademia, brenda një kohe relativisht të shkurtër u synua, në hartimin e planeve mësimore të përshkallëzuara sipas standardeve të përafruara të shkollave të huaja homologe, sipas roleve e niveleve. Për formimin, kualifikimin dhe specializimin, kryesisht në lëndët e formimit profesional u hartuan programe mësimore të veçanta si:

- për agjentët e policisë me 4 module, raporti teori-praktike në masën, 40% me 60%, në favor të praktikës;
- për specialistët e lartë (nëninspektor), raporti teori-praktikë 48% me 52%, në favor të praktikës;
- program trajnimit për grada të rolit të mesëm, rolit të lartë, kurse 4-mujore;
- dhe, sipas strukturave (rend, krime, qarkullim rrugor, kufi etj).

Në planet e reja mësimore të formimit të nëninspektorëve të Policisë së Shtetit, ra koncepti lëndë të emërtuara si më parë, me bazë strukturë sipas forcave të policisë, por u hartuan programe mbi bazë përmbajtje e konceptesh teorike e shkencore për rendin dhe sigurinë, investigimin e krimin dhe menaxhimin e integruar të kufijve. I gjithë ky proces u monitorua dhe u ndihmua nga zyra e trajnimeve dhe kualifikimeve pranë misionit MAPE.⁴⁹

MANDRO, I.
« Histori dhe
progres në
arsimin
policor -
progres drejt
një policie
europiane»

Policimi
dhe
Siguria
nr.1, 2015

⁴⁹ Shefi i zyrës së trajnimit dhe kualifikimit David Tingle.

5.2 Formimi profesional policor në Akademinë e Policisë

Procesi i formimit profesional policor, kualifikimi e specializimi i punonjësve të policisë të rolit të bazë të mesëm dhe të lartë realizohen në Akademinë e Policisë, nëpërmjet zhvillimit të planeve dhe programeve mësimore të hartuara mbi bazën e akteve ligjore dhe nënligjore me të cilat mbështet veprimtarinë e saj Policia e Shtetit⁵⁰, Akademia e Policisë.⁵¹

- *Programi mësimor i formimit të agjentëve të policisë ka qëllim të përgatisë punonjës policie të rolit bazë, me dije e koncepte të qarta juridike e profesionale për misionin dhe rolin e tyre në ruajtjen e rendit e sigurisë dhe shërbimin ndaj komunitetit; të edukojë tek ata vlera morale dhe virtytet me të larta etike për të arritur një formim të përgjithshëm profesional dhe për të përballuar situata të vështira gjatë karrierës së tyre profesionale.*⁵²

Objektiv i këtij programi është shpjegimi i koncepteve bazë të policimit në demokraci; njohja dhe zbatimi në praktikë i akteve ligjore që ngarkojnë me detyra dhe attribute Policinë e Shtetit; respektimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut si dhe të kenë aftësitë e duhura fizike dhe profesionale për zgjidhjen në praktike të detyrave dhe situatave.⁵³

Programi mësimor për vitin akademik 2001-2002⁵⁴, për formimin e rolit bazë është i ndarë në:

modulet teorike (210 orë mësimore),⁵⁵

modulet profesionale (222 orë mësimore)⁵⁶,

modulet tekniko-praktike (240 orë mësimore)⁵⁷,

praktikë profesionale (390 orë mësimore)⁵⁸.

Raporti midis mësimave teorike me ato praktike në këtë program, e shprehur në përqindje është 35.2 % mësimave teorike dhe 64.8 % mësimave praktike ndaj totalit të orëve.

- *Programi mësimor i formimit të specialistëve të lartë të policisë (nëinspektorëve) zhvillohet me studentët që pranohen rishtas me konkurrim në Akademinë e Policisë (Shkollën e Lartë të Policisë), me kohëzgjatje 3 vite akademike.*

⁵⁰ Ligji nr .8553 dt. 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit".

⁵¹ VKM nr. 281 dt. 02.06.2000 "Për riorganizimin dhe funksionimin e Akademisë së Policisë".

⁵² "Program për formimin e punonjësve të policisë të rolit bazë", miratuar në mbledhjen e Këshillit të Akademisë dhe institucionalizuar me Urdhrin e Drejtorit të Akademisë nr. 22-b, datë 31.10.2001.

⁵³ Po aty.

⁵⁴ "Program për formimin e punonjësve të policisë të rolit bazë", miratuar në mbledhjen e Këshillit të Akademisë dhe institucionalizuar me urdhrin e drejtorit të Akademisë nr. 22-b, datë 31.10.2001, ka ardhur duke u evoluar në drejtim të vlerësimit të praktikave mësimore. Në programin mësimor të vitit 2004-2005 duket dukshëm raporti teori-praktik në favor të praktikës në masën 33% me 67%.

⁵⁵ Ky program synon pajisjen e kursantit me njohuritë e nevojshme teorike si: "Koncept bazë të policisë", "Detyrat institucionale", "Strukturat organizative", "Aktet ligjore të Policisë së Shtetit", "Etika", "E drejta kushtetuese", "Veprat penale dhe ato procedurale".

⁵⁶ Ky program synon që kursantët të marrin njohuri e të kuptojnë detyrat e policisë për ruajtjen e rendit e sigurisë publike me atributet që ato gëzojnë, të njohin metodat e policisë kriminale për parandalimin zbulimin e krimeve, shërbimin e policisë rrugore, metodat shkencore që përdoren për zbulimin e krimeve si dhe njohuri të formimit bashkëkohor.

⁵⁷ Ky program ka si qëllim të aftësojë kursantët me mënyrën e kryerjes së veprimeve praktike që kanë të bëjnë me teknikat e sigurisë që përdor Policia e Shtetit për realizimin e detyrave institucionale dhe misionin e saj.

⁵⁸ Zhvillimi i këtij programi në komisariate synon që kursantët të ushtrohen për kryerjen e detyrave konkrete në të gjitha shërbimet e policisë të rolit bazë për të konkretizuar njohuritë që kanë fituar gjatë zhvillimit të programit.

Qëllimi i këtij programi⁵⁹ është të përgatisë specialistë të lartë policie të cilët të shërbejnë në rolin e mesëm (nëninspektor policie) me dije të nivelit universitar (në fushën e shkencave psikosociale e juridike), profesionale (të shkencave të sigurisë) me shprehje aplikative për realizimin e detyrave policore me standarde të profesionale, sjellje dhe qëndrim etik; si dhe me aftësi praktike për zbatimin e taktikave dhe teknikave në parandalimin e shkeljeve të ligjit dhe kontrollin e krimit. Raporti midis mësimëve teorike dhe atyre praktike është 51% me 49% ndaj totalit të orëve. Studentët përveç praktikave mësimore në shkollë e komisariatet e policisë, në fund të vitit të tretë zhvillojnë dhe 10 javë praktikë profesionale në organet e policisë vendore. Programi u hartua dhe mbi bazën e praktikave për zhvillimin e arsimit të lartë policor sipas standardeve të përafëruara të arsimit të lartë shtetëror me disa vende evropiane,⁶⁰

Për nevoja pune, programin e formimit të rolit të mesëm (4 muaj deri në një vit) e zhvillonin kandidatët që kishin arsim të lartë universitar. *Qëllimi* ishte që brenda këtij afati kohor të përgatiten punonjës policie të rolit të mesëm sipas strukturave dhe shërbimeve policore (4 muaj) dhe atyre që pranohen rishtazi në polici me arsim të lartë (1 vit). Programi i zhvilluar i pajis ata me dije të nivelit universitar (psikosociale e juridike) e profesional; shprehje aplikative për realizimin e detyrave policore me standarde të larta etike e profesionale si dhe me aftësi praktike për zbatimin e taktikave dhe teknikave bashkëkohore në parandalimin e shkeljeve të ligjit dhe kontrollin e krimit.

5.3 Programet e kualifikimeve

Në Akademinë e Policisë zhvilloheshin programe trajnimi kualifikimi apo specializimi për: “Menaxhimin e vendit të ngjarjes në vrasje”; “Menaxhimi i vendit të ngjarjes në vjedhjet e pasurisë së shtetasve”; “Për trafikimin e qenieve njerëzore”; “Menaxhimin e kufijve”; “Veprimet e para të oficerit të policisë kufitare në vendin e ngjarjes”; “Veprimet e policisë në aksidentet rrugore; “Organizimi i shërbimit në trafikun rrugor”. Këto programe zhvilloheshin me një afat kohor nga 1-2 javë. Qëllimi i këtyre programeve ishte të profilizojnë në mënyrë të ngushtë njohuritë teorike-profesionale dhe ligjore të punonjësve të policisë sipas shërbimeve; t'i aftësojnë ata me shprehjet aplikative për kryerjen e detyrave; në zbatimin e teknikave bashkëkohore policore për kontrollin e rendit e sigurisë publike, gjurmimin e investigimin krimit të organizuar, terrorizmit, trafikëve të paligjshme, si dhe zbatimin me korrektësi të standardeve ligjore në

⁵⁹ Plani i studimeve për vitin 2001-2004:

A – Lëndët e formimit të përgjithshëm: “E drejta kushtetuese”, “Elementët e së drejtës publike”, “Psikologjia e personalitetit”, “Psikologjia e komunikimit”, “Sociologji”, “Gjuhë e huaj”, “Njohuri në ekonominë e tregut”, “E drejta administrative”, “Informatizim”, “E drejta penale” (pjesa e përgjithshme), “Histori e shtetit dhe së drejtës”, “E drejta ndërkombëtare publike”, “Njohuri në të drejtën civile”, “Njohuri në kontabilitet e financë”, “E drejta penale” (pjesa e posaçme), “Etika profesionale”, “E drejta procedurale penale”.

B – Lëndët e formimit profesional: “Rregullore policie”, “Përgatitje fizike”, “Njohuri për armët”, “E drejta e policisë”, “Kriminologji & penologji”, “Mjekësi ligjore”, “Psikiatri ligjore”, “Vetëmbrojtje”, “Teknikat e qitjes”, “E drejta e policisë evropiane”, “Kriminalistikë”, “Taktikat e ndërhyrjes”, “Teknikat e sigurisë publike”, “Teknikat informative”, “Investigimi i krimit”, “Administrim dokumentacioni”.

⁶⁰ Nëse duam të bëjmë një krahasim me disa vende të cilat aplikojnë arsimimin e lartë profesional policor do t'i referohemi vendeve si: Gjermani, Norvegji, Belgjike, Greqi, Finlandë, Poloni, Hungari, Republika Çeke, Ukrainë, Kroaci dhe Slloveni. Shkollat në disa vende janë në varësi vetëm të Ministrisë së Brendshme; ka vende si në Slloveni ku Shkolla është pjesë e Universitetit të Lubjanës; në disa vende studentët e pranuar duhet të jenë punonjës policie (Holandë, Turqi, Greqi, Zvicër, Finlandë, Kroaci); në disa të tjera ky nuk është parakusht, (Norvegji, Hungari, Republika Çeke, Slloveni).

kryerjen e procedurave të punës.

Kualifikimet për karrierë shtriheshin në një kohë zgjatje programi prej 12 javë. Aplikantët për këto kualifikime konkurrojnë për të vazhduar kurset me qëllim për të marrë gradë më të lartë dhe zhvillojnë karrierën e tyre profesionale për t'u ngritur në detyrë.⁶¹ Programet e rolit madhor (drejtues) zhvilloheshin me kurse afatshkurtra për drejtimin e planifikimin strategjik, bashkërendimin dhe kontrollin gjatë detyrës.

5.4 Kërkimet shkencore

Krahas punës mësimore, një vend të rëndësishëm në Akademinë e Policisë, zinte edhe veprimtaria kërkimore shkencore e stafit mësimdhënës, e cila shënoi rritje në krahasim me periudhat e mëparshme. Disa drejtime kryesore në fushën e kërkimeve shkencore:

a. *Botimi i monografive dhe librave shkencore.* Në fushën e policimit nga personeli akademik në vitet 2001-2005 u botuan⁶² 11 monografi dhe libra shkencorë, si “Stresi në fokus”, “Psikologjia e policimit”, “Kriminalistika mbi identifikimin e armëve të zjarrit”, “Në labirintet e balistikës kriminalistike”, “Këqyrja e vendngjarjeve të vrasjeve me armë zjarri”, “Metodika e hetimit të ngjarjeve automobilistike”, “Ligji dhe Policia”, “Menaxhimi i Policisë”, “Taktikat e vetëmbrojtjes”, “Kriminologji-Penalogji”, “Legjislacioni i Policisë Shqiptare” (zhvillimi historik dhe analizë krahasuese dhe “Për veprimtarinë gjurmuese”). Gjithashtu është botuar dhe një “Fjalor terminologjik për Policinë Kriminale”.

b. *Botimi i teksteve universitare* ka qenë objektiv i rëndësishëm i veprimtarisë kërkimore shkencore të stafit mësimdhënës në Akademi. Mungesa për një kohë të gjatë e teksteve mësimore bëri që studentët në ato vite të ishin në rolin pasiv dhe të ndërvarur nga metoda e diktimit të leksionit nga pedagogët. Në këto rrethana nuk mund të përdoreshin metodat interaktive në mësimdhënie. Studenti duke qenë pasiv në orën e mësimit kishte shumë vështirësi integrimi në detyrat policore si dhe në shkallën e aftësimin profesional. Në kuadrin e zbatimit të objektivave të programit strategjik, në tetor të vitit 2004, u botuan kryesisht për studentët e Akademisë, tekstet mësimore të nivelit universitar⁶³. Disa prej tyre janë: “Psikologjia e policimit”, “Etika e policisë”, “Kriminologji & penalogji”, “Njohuri në të drejtën procedurale penale” “Ekonomia”. Për disiplinat juridike shërbejnë të gjitha tekstet universitare të botuara kohët e fundit nga fakulteti juridik.

c. *Tekste profesionale (makete të rezervuara)*⁶⁴ mund të përmendim, “ Policia shkencore”; “Taktikat e ndërhyrjes policore”, “E drejta e policisë”, “Teknikat e sigurisë publike”, “Investigimi i krimit”; “Teknikat informative”.

Botimi i këtyre materialeve i ka dhënë impakt pozitiv ngritjes së nivelit shkencor e profesional të stafit pedagogjik dhe të studentëve. Por për sa i përket brendisë së tyre, ato duhen vlerësuar në vazhdimësi në përputhje me ndryshimet dhe kërkesat e kohës për t’ju përgjigjur dhe përshtatur me të gjitha parametrat nivelit të sistemit të arsimit të lartë policor në frymën e “Deklaratës së Bolonjës”.

⁶¹ Në Akademinë e Policisë është zhvilluar vetëm një kurs i tillë për kalimin nga grada nëninspektor-nënkomisar me asistencën e misionit PAMECA.

⁶² Botimet e bëra në këtë kohë administrohen në Bibliotekën e Akademisë së Sigurisë.

⁶³ Këto tekste administrohen në Bibliotekën e Akademisë së Sigurisë.

⁶⁴ Këto tekste administrohen në Bibliotekën e Akademisë së Sigurisë.

Përveç teksteve mësimore, monografive e librave të përmendura më lart, nga stafi mësimdhënës janë hartuar edhe disa manuale dhe metodika shkencore në bashkëpunim me specialistët e Ministrisë së Brendshme dhe organizatat joqeveritare, si: manuali “Policia dhe të drejtat e njeriut”, libri “Policia dhe qytetarët”; “ABC-ja e policimit” e të tjerë.⁶⁵

Akademia e Policisë, në këtë periudhë, botonte dy herë në vit revistën shkencore “Kriminaliteti, rendi dhe policimi”. Kjo revistë synonte të nxiste mendimin teorik dhe kërkimor shkencor të personelit mësimdhënës, specialistëve e drejtuesve të policisë të çdo niveli si dhe studentëve që aspirojnë në fushën e kërkimeve policore lidhur me krimin, rendin e sigurinë publike e policimin demokratik.⁶⁶

Akademia e Policisë organizoi dhe aktivitete shkencore të rëndësishme si:

- Konferencën e parë shkencore “Për Strategjinë e zhvillimit të arsimit dhe kualifikimit të Policisë së Shtetit”.⁶⁷

- Sesionin shkencor me temë “Policia përballë sfidave të realitetit”⁶⁸, në të cilën u mbajtën disa kumtesa nga personeli i shkollës.

Me gjithë këtë ritëm të lartë zhvillimi arsimor, ishin arritur të gjithë parametrat për implementimin e sistemit arsimor policor në procesin e sapofilluar të Bolonjës,⁶⁹ pra në akreditimin e Akademisë së Policisë.

Procesi i vlerësimit të cilësisë dhe standardeve, ka efekt të drejtpërdrejtë te fokusimi mbi misionin dhe vlerësimin periodik të qëllimit dhe objektivat që i kishte vënë vetes Akademia e Policisë si një prej institucioneve të larta arsimore në vend. Bërja e bilanceve mbi realizimet dhe mos realizimet (shkaqet e faktorët e tyre), zotërimi i situatës dhe ballafaqimi i saj me kërkesat e kohës, me qëllim përmirësimin e standardeve dhe proceseve të punës e menaxhimit, është një përvojë e re, por e vlefshme.

Grupi i punës për realizimi i procesit të vetëvlerësimit (akreditimit) të Akademisë së Policisë, nisi nga puna në nëntor të vitit 2004 dhe drejtohej nga zëvendës drejtori i kësaj akademie.⁷⁰ Jo pa shumë debat, kaloi puna me departamentet dhe sektorët. Pati staf pedagogjik, që me vështirësi mund të kuptojnë se çdo të thotë të vetëvlerësohesh, pra të japësh një pamje reale të gjendjes aktuale të kësaj shkolle për pesë vitet e fundit. Megjithatë, përqindja e lartë e atyre që mbështeten materialin tregoi se ishte bërë një punë e mirë, realiste për gjendjen që ishte në këtë shkollë dhe ndryshimet që do të bëheshin në të ardhmen.

⁶⁵ Kopje të këtyre botimeve ndodhen në Bibliotekën e Akademisë së Sigurisë.

⁶⁶ Me vendimin e Komisionit të Rikonsiderimit të Periodikëve Shkencore në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës Nr. 1643 datë 19.03.2001, kjo revistë është e klasifikuar si organ periodik shkencor.

⁶⁷ Konferenca u zhvillua me 29 prill 2001, në bashkëpunim me misionin policor evropian.

⁶⁸ Ky sesion u mbajt në bashkëpunim me MRP dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë më 25 nëntor 2004 me rastin e 60-vjetorit të Çlirimit të Atdheut.

⁶⁹ Në konkluzionet e nxjerra nga grupi i kontrollit që u ushtrua në Akademi në bazë të urdhër-shërbimi nr. 125, dt. 19.05.2004 “Për kontrollin e efektivitetit të masave tekniko-organizative, ekonomiko-financiare dhe shkencore, të parashikuara për realizimin e procesit të reformimit në Akademinë e Policisë “Arben Zylyftari”, një ndër detyrimet thelbësore për zhvillimin e ndryshimin e kësaj shkolle, ishte fillimi i procesit të akreditimit.

⁷⁰ Në grupin e punës për të bërë Akreditimin e Akademisë u caktuan prof. dr. Ilir Mandro (zv. drejtor i Akademisë së Policisë); dr. Hasan Shkëmbi (sektori i Studim-Botimeve); kryekomisar Sokol Bizhga, (sektori i Degës Mësimore); nënkomisar Ilia Cepo (zyra e Financës në Akademinë e Policisë), nënkomisar Sherif Musabelli (zyra e Personelit dhe Administratës); Ilir Proda (student viti i III-të); Matilda Aliu (studente viti i II-të). Në këtë proces u përfshinë pedagogë dhe specialistë të cilët e përkrahen dhe nënshkruan dokumentin në masën 87%, personeli mbështetës mësimor përkrahu dhe mbështeti materialin në masën 100% si dhe 176 studentët të vitit të parë, të dytë dhe të tretë përkrahen dhe mbështeten materialin e vetëvlerësimit.

MANDRO, I.
« Histori dhe
progres në
arsimin
policor -
progres drejt
një policie
europiane»

Policimi
dhe
Siguria
nr.1, 2015

Zhvillimet e kohës dhe “vizionet” e drejtuesve të lartë të Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit, kërkonin një reformim rrënjësor të sistemit.

6. Progres

Të analizosh situatën për vite të tëra është një detyrë e vështirë, por shumë e rëndësishme nëse duam të ecim përpara. Problematikat e trajtuara në material, na lejojnë të bëjmë një analizë të kujdesshme të:

- Bazës ligjore dhe nënligjore që ndikon veprimtarinë e Akademisë së Policisë (ligjin për Policinë e Shtetit, “Strategjinë e zhvillimit të arsimit policor”, ligjin për Arsimin e Lartë, udhëzimet e ministrit të Rendit Publik, ministrit të Arsimit dhe urdhër-shërbimet e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë).

- Bashkëpunimit me misionet e huaja policore dhe disa shkolla homologe të huaja.

- Planeve dhe programeve mësimore

- Kualifikimit të specialistëve të së gjitha roleve të Policisë së Shtetit për të qenë të aftë dhe të përkushtuar për mbrojtjen e rendit dhe të sigurisë publike.

- Ballafaqimit me korrelacionin teori-praktikë dhe të kuptojmë drejt pozicionin aktual, distancën që kemi me standardet e kërkuara dhe mjetet për të shkuar deri në këtë destinacion!⁷¹

Është e rëndësishme që objektivat e arsimit të lartë policor në çdo mënyrë dhe këndvështrim duhet të korrespondojnë me nevojat e praktikës policore. Sigurimi i cilësisë⁷² arsimore në Akademinë e Policisë, në përshtatje me kërkesat e standardet e shkollave policore evropiane dhe më gjerë, ishte një nga drejtimit kryesore të reformës institucionale të arsimit policor shqiptar. Kryerja e një vlerësimi të plotë i veprimtarisë së kësaj akademie si i vetmi institucion i lartë mësimor, kërkimor e shkencor që ka për mision formimin, përgatitjen dhe kualifikimin e specialistëve të lartë policorë për të gjitha rolet e funksioneve të Policisë së Shtetit si dhe zhvillimin e veprimtarisë kërkimore shkencore në fushën e policimit⁷³ konsiston në zhvillimin e kësaj shkolle drejt standardeve të arsimit të lartë dhe sigurimit të një cilësie të këtij arsimimi.

Vëzhgimi i ekspertëve⁷⁴ dhe ekspertiza e bërë prej tyre për zhvillimin e kësaj shkolle, konstatoi se në të gjithë elementët e saj si atë organizativ, institucional, programor, strukturor të ketë bashkëpunim me institucionet e tjera, mbështetje më të madhe financiare dhe logjistike. Vizioni i shkollës në këtë proces zhvillimi

MANDRO, I.
« Histori dhe
progres në
arsimimin
policor - progres
drejt një policie
europiane »

Policimi
dhe
Siguria
nr.1, 2015

36

⁷¹ Aspektet e vetëvlerësimit të cilësisë në Akademinë e Policisë “Arben Zylyftari”, mars 2005, faqe 39.

⁷² AAAL është institucion përgjegjës për vlerësimin e cilësisë së AL si në aspektin e zhvillimit të programeve mësimore ashtu dhe në ato institucionale. Vlerësimi nga kjo agjenci ushtrohet nëpërmjet një grupi ekspertesh i vlerësimit të jashtëm të institucionit arsimor që vlerësohet. Ky proces kryhet sipas kriterëve e procedurave të hartuara nga AAAL dhe miratuar nga Këshilli i Akreditimit. Në materialin e vlerësimit evidentohet misioni dhe objektivat e institucionit, programet kurrikulat mësimore, strukturat organizative, analizat e kurseve të studimit, dispencave, programeve të studimit, bashkëpunimi me institucionet e tjera homologe jashtë vendit. Vlerësohet për nivel dhe cilësi në mësimdhënie stafit pedagogjik, kërkimet shkencore, fasilitetet, burimet materiale, logjistike, financiare e burimet e tyre.

⁷³ “Raport i vlerësimit të Akademisë së Policisë “Arben Zylyftari”, nga grupi i ekspertëve të jashtëm të AAAL datë 20.06.2005, faqe 2.

⁷⁴ Programi i Agjencisë së Akreditimit, prej datës 25.04.2005 deri më 15.06.2005, grupi i ekspertëve i përbërë prej prof. dr. Luan Gjonça (kryetar); prof. dr. Adem Tamo; msc. Çlirim Duro, këshilluar në procesin e vlerësimit të jashtëm prej z. Anthony Finnerty, këshilltar i misionit PAMECA, pranë Akademisë së Policisë, nën vëzhgimin e zbatimit të procedurave dhe standardeve nga znj. Renata Qatipi (specialiste në AAAL), realizoi vlerësimin e jashtëm të Akademisë së Policisë “Arben Zylyftari”.

tashmë do të jetë: “Përgatisë punonjës policie të aftë për të ofruar një shërbim policor profesional, cilësor dhe demokratik me besim tek publiku”. Misioni⁷⁵ i kësaj shkolle do të ishte:

- Edukimi, trajnimi i punonjësve të policisë të aftë për të ofruar një shërbim profesional e cilësor, të përshtatshëm ndaj nevojave të shoqërisë shqiptare.

- Zhvillimi i drejtuesve të policisë për të qenë në gjendje të menaxhojnë me profesionalizëm, efikasitet e efektivitet burimet njerëzore materiale apo teknike të shërbimit të policisë shqiptare në përputhje me standardet ndërkombëtare.

- Të afrojo trajnim profesional e cilësor për të gjitha shërbimet dhe specialitetet nëpërmjet profilizimit të njohurive.

- Të bëhet një qendër perfeksionimi që afron motivim për të mësuarit gjatë gjithë jetës me anë të një personeli të përkushtuar e të angazhuar, i cili mbështetet nga drejtuesit e policisë.

Detyrat e lëna nga grupi i vlerësimit të jashtëm ishin konkrete të prekshme dhe të realizueshme më vullnet dhe përkushtim.

Së pari: Misioni i Akademisë së Policisë kërkon që formimi policor të shihet si një proces tërësor që ka të bëjë me të gjitha nivelet. Në këtë kontekst ky arsimim kërkohet të këtë një stad unik duke filluar nga formimi i rolit bazë deri në trajnimet e roleve më të larta policore. Për realizimin e kësaj detyre u ngritën grupe pune për: “Integrimin e mësimdhënies në Akademinë e Policisë “Arben Zylyftari” dhe Institutin e Policisë⁷⁶ në një institucion të vetëm të shkollimit policor”. Pra, implementimi i strukturës së Institutit të Policisë brenda misionit të Akademisë si institucion i vetëm.⁷⁷

Së dyti: Problemi i vlerësimit të arsimit të lartë policor, rritjes së cilësisë së tij për ta afuar me atë universitar ishte prioritet në këtë akademi. Ky problem ishte sa i gjerë në konceptim aq edhe i vështirë në implementim për faktin se rritja e këtij niveli nuk i referohet vetëm përgjegjësisë së shkollave policore për përmirësime në kurrikula apo rritjes së angazhimit dhe veprimtarisë shkencore ose vlerësimit të stafit mësimdhënës, studentëve apo infrastrukturës së shkollës, çka është njëra anë, por ajo ka të bëjë në tërësi me mjedisin akademik, që përbën një tregues të rëndësishëm të rritjes së cilësisë së shkollës së lartë, që materializohet në rinovimin e kurrikulës, përmirësimin e performancës dhe bashkëpunimit policor si një shërbim që asiston të qytetarët.⁷⁸

Grupi i punës i ngritur për përmirësimin e kurrikulave duhet të fillonte me rishikimin dhe “Hartimin e planeve të reja mësimore dhe kurrikulave në sistemin arsimor policor” duke filluar me përmirësimin e kurrikulave të rolit bazë policor.⁷⁹

Së treti - Struktura organizative e Akademisë së Policisë evidentonte probleme. Në strukturë implementoheshin organizime strukturore të arsimit të lartë pa pasur parasysh veçoritë e kësaj shkolle.⁸⁰ Për hir të së qenit njësoj si arsimi universitar,

⁷⁵ Mandro, I. “Ecuria e zhvillimit të procesit të ndryshimeve në institucionin arsimor policor”; Material i referuar përpara Bordit Këshillimor për Standardet e Trajnimit Policor, dt. 24.11.2005, Tiranë.

⁷⁶ Shih VKM Nr. 281, datë 02.06.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Policisë”.

⁷⁷ Për realizimin e kësaj detyre u ngrit grupi i punës për: “Integrimin e mësimdhënies në Akademinë e Policisë “Arben Zylyftari” dhe Institutin e Policisë në një institucion të vetëm të shkollimit policor”. Grupi drejtohej nga: prof. asc. dr. Piro Lazi (drejtor i Akademisë së Policisë “Arben Zylyftari”).

⁷⁸ “Raport-vlerësimi i AP Arben Zylyftari”, Grupi i Ekspertëve të Jashtëm të AAAL, 20.06.2005 faqe 7.

⁷⁹ Përgjegjës Grupi: prof. dr. Ilir Mandro (zv. drejtor i Akademisë së Policisë “Arben Zylyftari”).

⁸⁰ Në Akademi funksionojnë seksioneve fiktive pranë departamenteve me nga 2-3 vetë, çka mund të krijojë vështirësi në menaxhimin e tyre.

në Akademinë e Policisë funksiononin në mënyre fiktive hallka të tepërta

Së katërti - Rivlerësimi dhe eliminimi i kontradiktave në sistemin ligjor dhe aktet nënligjore që rregullojnë arsimin e lartë universitar dhe legjislacionit dhe aktet që rregullojnë marrëdhëniet në Akademinë e Policisë ishte moment i vështirë dhe delikat. Funksionimi normal me parametrat ligjor të Akademisë së Policisë kërkonte ndërhyrje në bazën e saj ligjore.⁸¹

Varësia e dyfishte dhe nga Ministria e Arsimit do të rriste ndjeshëm nivelin e kurrikulave mësimore, si dhe kërkesat pedagogjike të stafit mësimdhënës.⁸²

Së pesti -Trajnimi dhe kualifikimi i strukturave të tjera policore ishte moment që do vlerësohej jo vetëm për krijimin e planeve dhe programeve të përshtatshme në shërbim të këtij formimi, por dhe në një kënd vështrim me të gjerë.

Përqendrimi i përgatitjes së personelit të strukturave të tjera policore⁸³ në një institucion të vetëm jo vetëm që rrit nivelin tekniko-shkencor të mësimdhënies në akademi, por në këndvështrimin financiar ka interes ekonomik. Duke i përqendruar në një shkollë të vetme këto trajnime, do të eliminohen shpenzimet buxhetore për shkollat e ndryshme të hapura për këtë qëllim.⁸⁴ Investimet do të përqendroheshin dhe Akademia e Policisë do të bënte një hop cilësor, si në drejtim të modernizimit të ambienteve me pajisje didaktike dhe profesionale ashtu dhe në rritjen e cilësisë së akomodimit të studentëve dhe kursantëve.

⁸¹ Amendamente, apo përmirësime në Ligjin e Policisë së Shtetit; Ligjin e Arsimit të Lartë; VKM nr. 281, datë 02.06.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Policisë" ndryshuar me VKM Nr. 299, datë 14.05.2004; Statutin e Akademisë së Policisë "Arben Zylyftari"; Rregulloren e Brendshme e Akademisë së Policisë; Aneksin e Rregullores "Për detyrat e Personelit sipas Organikës"; Udhëzimin e MRP Nr. 1232 dt. 03.05.2000 "Për Normën Mësimore të Punës në Shkollën në Akademinë e Policisë".

⁸² Stafit mësimdhënës i lëndëve profesionale do të ishte mirë të qarkullonte në policitë vendore të paktën çdo 5 vjet, për të sjellë në Akademi pedagogë të tjerë të cilët mbartin mbi vete praktika dhe metoda të reja të luftës kundër krimit.

⁸³ Shënim i autorit: Ideja është e trajnimit të specialisteve të policisë bashkiake, tatimore, financiare, ushtarake e të tjerë.

⁸⁴ Në Ministrinë e Drejtësisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve funksionon shkolla për arsimimin e punonjësve të policisë; në institucione te ndryshme si Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave, Ministria e Transporteve kryhen kurse kualifikimi për personelin e tyre.

Referenca

1. Guidë e Akademisë së Policisë "Arben Zylyftari", botim i vitit 2002.
2. VKM nr. 184 dt. 20.12.1971, "Për krijimin e Shkollës së Lartë 3-vjeçare të oficerëve të MPB".
3. Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme. Dosje nr. 464. Viti 1972.
4. Arkivat e Akademisë së Policisë (Zyra e personelit dhe AMZA e kësaj shkolle).
5. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 339, datë 02.09.1991.
6. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 405, datë 15.09.1992.
7. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 281, datë 02.06.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Policisë".
8. VKM nr.135, datë 11.2.2009, (pushon të funksionuari "Akademia e Policisë "Arben Zylyftari").
9. Ligji Nr 8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit".
10. Ligji nr. 8461 datë 25.2.1999 "Për Arsimin e Lartë në RSH".
11. VKM nr. 281 datë 02.06.2000 "Për organizimin e funksionimin e Akademisë së Policisë".
12. "Statuti i Akademisë së Policisë Arben Zylyftari", miratuar me urdhrin e ministrit të Rendit Publik, Nr. 1550 datë 11.09.2001.
13. "Rregullorja e Brendshme e Akademisë"; propozuar nga Këshilli i Akademisë dhe miratuar me urdhrin e drejtorit të Akademisë Nr. 342 datë 31.10.2001.
14. "Detyrat e Personelit sipas organikës", miratuar me urdhrin e drejtorit të Akademisë Nr. 342 datë 31.10.2001.
15. "Rregullorja për Konkurrimet e Pranimit në Akademi", miratuar me urdhrin e ministrit të Rendit Publik Nr. 2001 datë 11.09.2004.
16. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 605 datë 13.10.2001, "Për kurset e formimit profesional të kualifikimit e specializimit në Akademinë e Policisë "Arben Zylyftari".
17. Ligji Nr 8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit", neni 18 "Formimi dhe Kualifikimi".
18. Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 663 datë 13.12. 2000.
19. "Strategjia e Reformës në Policinë e Shtetit", botim i "Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut", Tiranë, 2001.
20. "Programi Strategjik i Akademisë së Policisë", kapitulli II, "Synimet dhe Objektivat", Tiranë, prill 2001.
21. VKM nr. 524 datë 01.08.2003 "Miraton hapjen e Shkollës Pasuniversitare pranë Akademisë së Policisë 'Arben Zylyftari' ".
22. "Programi Strategjik i Akademisë së Policisë", prill 2001.
23. Ligji nr .8553 dt. 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit".
24. "Program për formimin e punonjësve të policisë të rolit bazë", miratuar në mbledhjen e Këshillit të Akademisë dhe institucionalizuar me urdhrin e drejtorit të Akademisë nr. 22-b, datë 31.10.2001.
25. Plani i studimeve për vitin 2001-2004, Akademia e Policisë.
26. "Raport i vlerësimit të Akademisë së Policisë "Arben Zylyftari", nga grupi i ekspertëve të jashtëm të AAAL datë 20.06.2005."
27. Mandro, Ilirjan. "Ecuria e zhvillimit të procesit të ndryshimeve në institucionin arsimor policor", material i referuar përpara "Bordit Këshillimor për Standardet e Trajnimit Policor", Tiranë, dt. 24.11.2005.

MANDRO, I.
« Histori dhe
progres në
arsimimin
policor -
progres drejt
një policie
europiane»

Policimi
dhe
Siguria
nr.1, 2015

Programi i studimeve “Bachelor” për rendin dhe sigurinë publike¹ dhe reformimi i institucioneve të arsimit policor



■ Prof. Asc. **Pandell TAÇI**

Dekan i Fakultetit të Sigurisë Publike, Akademia e Sigurisë

Abstrakt

Përfshirja e institucioneve të arsimit policor në reformën madhore të arsimit të lartë në vend është ndër qasjet efikase me anë të së cilave shteti adresoi e vuri në rrugën e zgjidhjes nevojat e rritjes së aftësive dhe kapaciteteve profesionale të policisë, në pëmbushje të kërkesave të komunitetit për një polici efçente e korrektë në shërbim të tyre. Rihapja e Akademisë së Sigurisë dhe miratimi i kërkesës për çeljen e “Programit të studimeve “Bachelor” për rendin e sigurinë publike”, shënojnë një ndër momentet e rëndësishme për policinë shqiptare, për eliminimin e pasojave negative në fushën e edukimit, shkaktuar nga mbyllja e Akademisë së Policisë dhe ndërprerja pa motiv e studimeve të larta për rendin, sigurinë publike dhe luftën ndaj krimit.

Në analiza të ndryshme për shkaqet e faktorët që kanë ndikuar në gjendjen e rendit, sigurisë e luftës kundër krimit dhe të situatës së paligjshmërisë në tërësi, përveç faktorëve të tjerë evidentohet dhe mos efica e institucioneve të arsimit të lartë e të kualifikimit policor, aq më tepër mbyllja apo ndërprerja e aktivitetit të tyre. Ndaj dhe, veç nevojës për një trupë policore të arsimuar e kualifikuar, kjo gjendje sjell dhe një herë në vëmendje kërkesën që veprimtaria e institucioneve akademike e shkencore të policisë, veçse efica e duhet të jetë e integruar e në pajtim me nevojat konkretë të vendit. Është kjo një nga arsytet që, në punën që bëhet për reformën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor vlerësohet kujdesi i qeverisë që, këtij procesi zhvillimi e modernizimi, t’i bashkoheshin të gjitha institucionet e shkollimit dhe arsimimit të strukturave të sigurisë, më konkretisht të gjitha nivelet e personelit të Policisë Shqiptare, si institucion apo strukturë me rol të rëndësishëm dhe me kontribute e pritshmëri të veçanta për të ardhmen dhe integrimin e vendit në institucionet evropiane.

Objektivat për të përgatitur specialistë të lartë policie me kulturë e dije të nivelit universitar, me standarde të larta etike e profesionale, njohës të mirë të ligjit, misionit dhe përgjegjësi të Policisë, për t’i u kundërvënë perfeksionimit të metodave të elementeve kriminalë dhe veprimtarisë së tyre, si dhe përvetësimi i shprehive inovative e iniciativës për menaxhimin e situatave të rendit e sigurisë, përbëjnë një sfidë të vërtetë për studentët dhe personelin akademik. Pikërisht këto, pra problematikat e rritjes së produktit të veprimtarisë akademike e kërkimore të strukturave, institucioneve dhe personelit, por dhe rritja e përgjegjshmërisë e një roli me aktiv i studentëve dhe pedagogëve, përbëjnë thelbin e këtij punimi.

Fjalëkyçe:

Program studimi, dokumente akademike, plan mësimor, provime, lëndë mësimore, disiplina mësimore, kreditë ECTS, rend e siguri, personel akademik, metoda kërkimi

TAÇI, P.
« Programi i studimeve “Bachelor” për rendin dhe sigurinë publike dhe reformimi i institucioneve të arsimit policor »

Policimi dhe Siguria nr.1, 2015

Hyrje

Programi i studimeve “Bachelor”, të Fakultetit të Sigurisë Publike të Akademisë së Sigurisë (në vijim Programi), së bashku me dokumentacionin² që shoqëron atë, është një ndër dokumentet themelore që pasqyron tërësinë e veprimtarive formuese (leksioneve, seminareve, praktikave, etj.) që ofrohen për kryerjen e studimeve dhe marrjen e diplomës së specialistit për rendin e sigurinë publike në Policinë Shtetit. Ai mbështetet në legjisllacionin arsimor dhe aktet nënligjore e normative të kësaj fushe, (veçojmë udhëzimin e MASH, Nr.15, datë 04.04.2008, “Për Organizimin e Studimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”); në ligjin Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” (kreu VII, neni 37 e 38); në VKM nr. 185, datë 25/02/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë”, në Urdhrin e MPB Nr. 294, datë 05.06.2015 “Për Strukturën Organike të Akademisë së Sigurisë”, në Programin e Zhvillimit Strategjik të Policisë së Shtetit, si dhe në Statutin e AS-së.

Programi u hartua duke konsultuar si modele referimi programet e disa shkollave policore perëndimore si, planin me lëndët e formimit fillestar (nënkomisarë) të Shkollës së Oficerëve të Policisë Franceze, në Programin e Akademisë së Sigurisë-Kosovë, të Maqedonisë, etj., si dhe në programet e planet mësimore të viteve 1971, 1984, 2001 e 2004 të Shkollës së Lartë të Policisë Shqiptare. Ai është produkt i një veprimtarie të gjerë studimore e konsultative me grupe e ndryshme të interesit, brenda e jashtë policisë, me specialistë të policimit, me ish-drejtuës të shkollës policore shqiptare, si dhe me studiues të rendit, sigurisë, kriminologjisë, sociologjisë e jurisprudencës. Si rrjedhojë e gjithë këtyre, u përftua një listë e plotë lëndësh e disiplinash me impakt të konsiderueshëm në procesin mësimor, duke e orientuar atë drejt profesionalizmit dhe aplikimit praktik të shprehive dhe njohurive të fituara.

Programi përbëhet nga disa pjesë kryesore; nga pjesa e parë që trajton argumente për nevojën e hapjes së studimeve të larta policore; nga pjesa e dytë që shtjellon planin mësimor dhe elementet përbërës të tij, pjesa e tretë, që përfshin sillabuset e të gjitha lëndëve dhe nga pjesa e katërt, e cila i kushtohet “Rregullores mësimore të programit”.

Përveç analizës së kushteve, rrethanave dhe faktorëve që diktuan hartimin e programit të studimeve, apo evidentimit të kërkesave, qëllimeve dhe objektivave që lakmon të arrihen në fushën e edukimit tërësor profesional të personelit policor,

¹ Programi i studimeve “Bachelor”, për “Rendin dhe Sigurisë Publike”, është miratuar me urdhër të ministrit të Arsimit dhe Sporteve Nr. 7669, datë 06.10.2015 dhe me urdhër të ministrit të Punëve të Brendshme Nr. 7379, datë 05.10.2015.

² “Programi” përbëhet nga disa pjesë: argumentimi i nevojës për studime të larta policore, plani mësimor nga sillabuset e lëndëve/moduleve dhe nga “Rregullorja mësimore e programit”.

TAÇI, P.
« Programi i studimeve “Bachelor” për rendin dhe sigurinë publike dhe reformimi i institucioneve të arsimit policor »

Policimi dhe Siguria
nr.1, 2015

në planin mësimor përfshihen tërësia e disiplinave mësimore. Këto kategorizohen në disiplina të formimit bazë, disiplina karakterizuese, disiplina integruese, lëndë me zgjedhje, veprimtaritë formuese për njohjen e gjuhës së huaj, për aftësitë informatike, praktikat mësimore apo stazhet profesionale, përgatitja e tezës së diplomës, etj. të vlerësuara si të nevojshme për plotësimin e procesit akademik formues për specialistët dhe menaxherët e Policisë së Shtetit.

Programi “Bachelor” dhe dokumentet bashkëshoqëruese u hartuan në përputhje me kriteret metodiko-akademike dhe përmbajnë të gjithë elementët e nevojshëm si: kohëzgjatjen e aktivitetit akademik, numrin mesatar të krediteve ECTS, listën e lëndëve/moduleve dhe numrin total të provimeve, ngarkesën totale të orëve mësimore në auditor, ngarkesën në orë mësimore javore, kreditet dhe orët mësimore për çdo lëndë/modul apo aktivitet tjetër formues, ndarja e lëndëve/moduleve sipas karakterit të lëndës; grupimi në veprimtari formuese dhe vlerësimet e tyre në ECTS, shtrirja e lëndëve në plan-kalendarin semestral dhe shpërndarja e orëve mësimore sipas formave të mësimdhënies.

Një vështrim analitik mbi planin mësimor, për lëndët e karakterit formues, raportet midis mësimave teorike me ato praktike, ndarjen e orëve dhe krediteve ECTS, evidenton se:

- Në grupin e lëndëve dhe moduleve profesionale, (të kategorisë “B”) janë 14 lëndë dhe kanë 91 kreditë ECTS, të cilat zënë rreth 50.55 % të orëve të Programit (2275 nga 4500 orë gjithsej).

- Pjesa tjetër, e lëndëve i përkasin formimit të përgjithshëm universitar (të kategorizuara në grupin “A”, “C”, “D” dhe “E”) të cilat kanë 89 kreditë ECTS, dhe zënë rreth 49.44 % të orëve (2225 nga 4500 ore gjithsej).

- Nga orët e mësimimit në auditor, 1085 orë, ose rreth 49.2% janë leksione dhe 1120 orë, ose rreth 50.8% janë seminare e punë praktike; ndërkohë që brenda zërit mësimave praktike, seminarët janë 550 orë dhe zënë rreth 49.1% dhe mësimet praktike janë 570 orë ose 50.9% të tyre.

Qëllimi. Nëpërmjet një trajtimi gjithëpërfshirës të kuadrit ligjor, normativ e metodik të përgjithësohet përvoja e fituar nga puna për hartimin e programit të studimeve, duke synuar formimin e një përvoje referuese tek e cila mund e duhet të drejtohem për hartimin e programeve analoge dhe të niveleve të tjera master e doktoraturë.

Metodologjia. Sikurse hartimi i krejt programit, zgjidhja e detyrave shkencore të shtruara dhe interpretimi i rezultateve kërkimore, lypi përdorimin e metodave dhe teknikave të ndryshme për arritjen e standardeve akademike e shkencore, edhe realizimi i këtij punimi, kërkoi përdorimin e metodave të pajtueshme me natyrën dhe qëllimet e punimit. Kështu u përdorën:

- Metoda e analizës se çështjeve dhe problemeve të evidentuara në fushën e edukimit dhe kualifikimit profesional ballafaquar me nevojat e policimit për rend, siguri e luftë ndaj krimit, si dhe metoda e sintezës për të dale me konkluzione sa me të bazuara për hapat e ndërmarra.

- Metoda statistikore, tabelore dhe e grafikëve me të cilat, rezultatet e të dhënat numërore mundem t'i kthejmë në mjete shprehëse, për njohjen e gjendjes dhe krahasimet e nevojshme.

- Metoda e referimit tek instrumentet juridike dhe dokumentet metodiko-akademike për të nxjerre dinamikën dhe trendin e fenomenit në kohë konkretë dhe për të evidentuar e argumentuar nevojën e përmirësimeve.

1. Përgjegjësitë institucionale dhe referencat ligjore të “Programit”

Studimet e nivelit “Bachelor” për rendin dhe sigurinë publike, organizohen dhe realizohen në Akademinë e Sigurisë, nën përgjegjësinë e Fakultetit të Sigurisë Publike dhe departamenteve e strukturave përbërëse të tij. Ai u hartua në ushtrim të përgjegjësisë dhe të drejtave që burojnë nga legjislacioni për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë dhe nga ligji për Policinë e Shtetit, ndërkohë që autorizimet konkrete ligjore për ofrimin dhe organizimin e këtij programi jepen me anë të VKM, nr. 185, datë 25.02.2015, “Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë”.

E gjithë kjo veprimtari realizohet në korrelacion me përgjegjësitë e Akademisë e cila ka për mision: *“Formimin bazë, specializimin dhe kualifikimin e punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit të nivelit operues, administrativ dhe menaxherial, në të tre ciklet e studimeve universitare; zhvillimin e kërkimeve e të studimeve në fushën e policimit e të sigurisë...”*. Nëse mbajmë parasysh detyrën themelore të programit të studimeve “Bachelor” për Rendin dhe Sigurinë Publike, e cila është: *“Të përgatisë specialistë për Policinë e Shtetit, të aftë për të shërbyer në funksionet operuese e menaxheriale të shërbimeve policore për rendin e sigurinë publike..”*, është evidente përqsja me misionin e Akademisë.

Akademia e Sigurisë është institucioni me përfaqësues i arsimit të lartë policor dhe ligjërishit përcaktohet si institucion arsimor përgjegjës për përgatitjen dhe formimin profesional të specialisteve të lartë të rendit e sigurisë dhe kualifikimin e vazhdueshëm të punonjësve të tyre. Ajo është vazhduese e Shkollës së Lartë të Policisë Shqiptare (shkolla e lartë u hap në vitin 1971) dhe bart e përçon vlerat me të spikatura të atdhetarisë, profesionalizmit dhe akademizmit në fushën e rendit, sigurisë dhe luftës ndaj krimit. Në këto dyzet vjet të zhvillimit të kësaj shkolle, si një ndër degët specifike të arsimit të lartë publik, evidentohet se; pavarësisht formës se organizimit shtetëror, apo kushteve sociale, politike e ekonomike në të cilat kalonte vendi, arsimit dhe kualifikimi policor është vlerësuar si pjesë integrale e arsimit të lartë. Ai ka qenë në një proces të paprerë zhvillimi, për edukimin e brezave të aftë profesionistësh, për zgjidhjen në kohë të nevojave dhe kërkesave për rend, siguri e luftë ndaj krimit. Në përcjelljen e problematikave të vështira të rendit, të sigurisë shtetërore e të individit dhe luftës me dukuritë e reja kriminale të tranzicionit tonë të vështirë, trupa e policisë dhe menaxherët e saj, të edukuar profesionalisht në institucionet e arsimit bazë e të lartë policor, kanë rolin dhe kontributin e tyre të pamohueshëm.

Është e natyrshme që ky program studimesh, sikurse veprimtaria e Akademisë së Sigurisë, të mbështetet në legjislacionin arsimor, Udhëzimin e MASH, Nr. 15, datë 04.04.2008, “Për Organizimin e Studimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë” dhe aktet nënligjore e normative të kësaj fushe; në ligjin Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” (kreu VII, neni 37 e 38) dhe në VKM nr. 185, datë 25/02/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë”, si dhe në statutin dhe rregulloret e brendshme të saj.

Përveç referencave të mësipërme ligjore, hartimi i Programit dhe planit mësimor është mbështetur edhe në “Programin e Zhvillimit Strategjik” të Policisë

TAÇI, P.
« Programi i studimeve “Bachelor” për rendin dhe sigurinë publike dhe reformimi i institucioneve të arsimit policor»

Policimi dhe Siguria
nr.1, 2015

së Shtetit dhe Akademisë së Sigurisë, në statutin dhe rregulloren e brendshme të saj, si dhe diskutimet e propozimet e bëra nga stafi akademik i institucionit. Po ashtu, gjatë procesit të hartimit u mbajtën në konsideratë standardet e shkollave policore perëndimore për formimin e punonjësve të policisë sipas përgjegjësive të nesërme në terren, duke i orientuar drejt profesionalizmit dhe aplikimit praktik të njohurive. Programi dhe plani mësimor e venë theksin sa të formimi shoqëror e juridik aq dhe të zbatimi i procedurave ligjore dhe respektimi i lirive e të drejtave të njeriut, duke synuar që të integroje dhe vendose ekuilibrat e nevojshëm akademike midis disiplinave social-psikologjike dhe atyre juridike e të organizimit; dhe të gjitha këto se bashku, t'i kombinoje e adresojë të formimi solid i studentëve.

2. Faktorët e impaktit të studimeve dhe objektivat e “Programit”

Hapja e studimeve të nivelit të parë (“Bachelor”) “Për Rendin dhe Sigurinë Publike”, u diktua nga faktorë të shumtë, në mes të cilëve veçohen “nevojat e tregut të punës”, konkretisht nevojat e policisë për shtimin dhe diversifikimin e kapaciteteve njerëzore të saj dhe përshtatjen me hapat e zhvillimit shoqëror e kulturor të vendit.

Me konkretisht, çelja e këtij programi synon të zgjidhë nevojat e policisë për specialistë të lartë policie për rendin dhe sigurinë publike, të aftë për të shërbyer në të gjitha strukturat, shërbimet dhe funksionet operuese e menaxheriale, me kulturë e dije të nivelit universitar, me standarde të larta etike profesionale dhe njohës të mirë të ligjit, të misionit dhe përgjegjësive institucionale të policisë, por dhe me aftësi praktike e shprehi inovative në menaxhimin e situatave të rendit e sigurisë.

Përpos kësaj, eliminohen sa më parë mangësitë dhe pasojat negative në fushën e edukimit të ardhura nga ndërprerja pa motiv e studimeve të larta për rendin, sigurinë publike dhe luftën ndaj krimit. Niveli i sotëm i cili nuk i përgjigjet nevojave të policimit dhe dinamikës së kriminalitetit, madje është bërë pengesë në garantimin e rendit dhe sigurisë në parametra e standarde evropiane. Kujtoj se, gjatë vitit 2014, 1219 punonjës të policisë ose më shumë se 11 % e gjithë trupës së policisë i janë nënshtruar procedimeve disiplinore ndëshkuese.

Në këtë kuadër zgjidhen nevojat e edukimit dhe trajnimit të vazhdueshëm të forcave të policisë, për të rritur më tej shkallën e besimit të publikut tek Policia e Shtetit, ç’ka do të vijë me rritjen e mirësjelljes së punonjësve dhe patrullave të policisë në terren, apo në veprim, për të treguar faktin se kjo trupë ekziston për të mbrojtur qytetarin dhe shoqërinë nga keqbërësit, si forcë që garanton sigurinë e jetës dhe të pronës publike e private.

Edhe më shumë ndjehet nevoja e këtij programi studimesh akademike, në kushtet e një vendi të NATO-s, që aspiron për të hyrë në BE, si dhe kërkesave gjithnjë në rritje të komunitetit për një polici profesionale e korrektë në shërbim të tyre. Është për këtë arsye që prej personelit të saj, kërkohet më shumë profesionalizëm, dinamizëm, pastërti morale, paanësi dhe bindje për të garantuar zbatimin e ligjit dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Përmbushjen gjithnjë e më mirë të detyrimeve për bashkëpunimin policor

TAÇI, P.
« Programi
i studimeve
“Bachelor” për
rendin dhe
sigurinë publike
dhe reformimi i
institucioneve
të arsimit
policor»

Policimi
dhe
Siguria
nr.1, 2015

ndërkombëtar dhe me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit, veçanërisht në luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikeve kriminale, duke njohur natyrën transnacionale dhe karakterin global të luftës ndaj tij dhe vlerësuar se, bashkëpunimi ndërkombëtar nuk është thjeshtë një kërkese, por nevojë jetike për shtetin dhe shoqërinë.

Disa nga objektivat e përcaktuara dhe rezultatet e pritshme. Natyrisht që pritshmëritë prej një programi studimesh janë të shumta dhe kondicionohen nga nevojat që ka policia për kualitete të spikatura profesionale dhe detyrat për goditjen e formave dhe metodave të krimit të organizuar, por objektivat me specifike që synohet të realizohen me anë të tij, janë:

- Plotësimi i nevojave që ka Policia e Shtetit për resurse të afta profesionalisht dhe specialistë me nivel të lartë kulturor të përputhur me zhvillimin social e ekonomik të vendit, të cilët do të mbështesin zhvillimin me tej të interesave dhe vlerave kombëtare.

- Rritja e kapaciteteve të formimit policor, duke respektuar angazhimet, parimet dhe përvojat e shkollës shqiptare të policisë dhe shkollave më të mira perëndimore, në kuadër të angazhimit dhe integritimit në BE.

- Realizimi i studimeve universitare bashkëkohore, të cilat krahas vlerësimit të përvojave, marrin në konsideratë kërkesat në rritje të komunitetit për një polici profesionale, por dhe mangësitë e ardhura nga ndërprerja pa motiv e studimeve të larta në fushën e rendit, sigurisë publike dhe luftës ndaj krimit.

- Parashikimi në rregulloren e programit dhe në planin mësimor të studimeve i njohjes dhe transferimit të krediteve në institucione të tjera të larta arsimore, i unifikimit të moduleve apo lëndëve mësimore, si dhe i bashkëpunimit me institucionet e larta arsimore brenda e jashtë vendit.

- Studentët të fitojnë elementët e parë dhe shprehitë e punës kërkimore studimore si objektivi i posaçëm i studimeve akademike, në klasë e jashtë saj, nëpërmjet detyrave praktike si: punimi i eseve akademike, diskutimi dhe zgjidhja e kazuseve të ndryshme, realizimi i projekteve kërkimore-studimore e detyrave të kursit e deri të punimi i diplomës.

- Përshkallëzimi dhe gradualiteti në marrjen e dijeve për të rritur masën e përvetësimit të tyre, sipas kohëzgjatjes së studimeve. Gjatë vitit të parë akademik Programi u ofron studentëve njohuri të përgjithshme me anë të lëndëve të formimit bazë të karakterit sociologjik, psikologjik, juridik, etj. Ndërkohë, gjatë viteve të tjera të studimeve akademike realizohet thellimi në njohuritë që përkojnë me profilin e diplomës për siguri publike, me objektiva specifike për përgatitjen e ekspertëve të rendit, sigurisë e luftës ndaj krimit.

- Është pjesë e programit dhe e gjithë kurrikulës t'u ofrojë studentëve njohuritë e nevojshme për të zgjidhur problematikat profesionale me të cilat do të përballen gjatë ushtrimit të detyrave dhe profesionit të tyre, duke përmbushur në kohë nevojat e punonjësve të policisë për kualifikim të mëtejshëm dhe ecuri në karrierë, si formë e të mësuarit gjatë gjithë jetës.

- Me shlyerjen e detyrimeve të parashikuara, në përfundim të këtij programi studentët do të zotërojnë kapacitetet analitike dhe konceptet e nevojshme për të trajtuar problematikat teorike dhe praktike të fushës së rendit e të sigurisë, duke krijuar në këtë mënyrë asetet e nevojshme akademike për të ndjekur ciklet e tjera të njëpasnjëshme të studimit.

TAÇI, P.
« Programi i studimeve "Bachelor" për rendin dhe sigurinë publike dhe reformimi i institucioneve të arsimit policor »

Policimi dhe Siguria
nr.1, 2015

3. Respektimi i parimeve të zhvillimit të arsimit dhe kërkimit shkencor

E quaj të nevojshme të theksohet se procesi i hartimit të dokumenteve e akteve ligjore e nënligjore dhe më tej veprimtaria për implementimin e tyre, i u përmbajt dhe respektoi parimet universale e rekomandimet ndërkombëtare të zhvillimit të arsimit e kërkimit shkencor në institucionet akademike publike, të cilat për shkak të rëndësisë se tyre u risillen në vëmendje të stafeve vendimmarrëse dhe personelit akademik, nëpërmjet dokumentit përfundimtar të reformës së IAL-ve.

Për rrjedhojë, si pjesë e arsimit të lartë publik, Arsimi Policor duhet vlerësuar si: *“shërbim dhe e mirë publike”*, gjithëpërfshirës dhe jo si e drejtë e atribut i njerëzve apo subjekteve të veçantë; krijon e duhet të ofrojë *“mundësi të barabarta dhe shanse të njëjta, jo vetëm konkurrimi, por edhe shkollimi”*, pa përjashtuar askënd që plotëson kriteret; duhet të mundësojë që programet e të gjitha niveleve të studimit të sigurojnë *“integrimin e mësimdhënies me kërkimin shkencor”*; siguron kushtet që *“studentët të mësohen nga staf akademik me tituj e grada shkencore, me performancë të lartë në mësimdhënie, në kërkim shkencor dhe në inovacion”*; ofron kushte e mundësi që *“stafi dhe studentët të gëzojnë liri të plota akademike dhe pavarësi organizative në aktivitetin mësimdhënës, në kërkimin shkencor dhe në zgjedhjen dhe promovimin akademik”*;

Gjykova t'i parashtrij në këtë mënyrë duke arsyetuar se momenti i hartimit të dokumenteve themelore të programit është pikërisht koha për t'i dhënë karakter objektiv gjithë procesit reformues dhe për të evituar kostot e panevojshme për veprimtarinë në vijim. Sepse, s'mund të pretendohet për ofrim të mundësive dhe shanseve të barabarta aplikantëve, nëse gjatë hartimit të rregullores së konkurrimit dhe pranimit të studenteve, do të vendoseshin barriera ndaluuese për motive sociale, ekonomike, politike, të racës, etnisë, besimit, etj., dhe, në vend që të sigurohet përfshirja e të gjithëve në proces, bëhen përjashtime të padrejta. Rrjedhimisht, arsimi policor, nga shërbim dhe e mirë publike, fare lehtë mund të kthehej në një lloj privilegji i njerëzve apo subjekteve të veçantë. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për konsiderimin e lirive akademike e organizative gjatë hartimit të statutit dhe rregullores së Akademisë, për kurrikulën, fushat e kërkimit, metodat e mësimdhënies, programet lëndore, si dhe për gjithë dokumentacionin shkollor që përcakton kriteret dhe norma sjelljeje afatgjata, të përshtatura me natyrën dhe veçoritë e këtij institucioni.

Shfrytëzimi i përvojës në arsimimin dhe kualifikimin policor. Gjatë procesit të hartimit të programit dhe dokumenteve të tjera, njohja dhe rivlerësimi i përvojës dhe eksperiencave tona, afërsisht njëqind vjeçare, në arsimin dhe kualifikimin policor, përbënte dhe përben një rezervë të konsiderueshme në ndihmë të reformës-eksperiencia të cilat grupet përkatëse të punës i njohën dhe konsideruan gjatë hartimit të akteve zyrtare. Fillimet e kësaj veprimtarie datojnë herët, pas pavarësisë dhe krijimit të shtetit të parë shqiptar, deri në fillimvitet '70. Edhe pse eksperiencat që përcillen janë modeste, për shkak të gjendjes së vendit dhe niveleve të zhvillimit, gjithsesi vlerësohen relativisht pozitive.

Vlera të referueshme shënohen me krijimin e Shkollës së Lartë e Policisë, si institucioni i parë i këtij lloji në vendin tonë, pas vitit 1971. Kjo është koha në të cilën

TAÇI, P.
« Programi
i studimeve
“Bachelor” për
rendin dhe
sigurinë publike
dhe reformimi i
institucioneve
të arsimit
policor »

Policimi
dhe
Siguria
nr.1, 2015

proceset e formimit bazë dhe kualifikimit policor u vunë në rrugën e zhvillimit dhe modernizimit. Nëse mbajmë në konsideratë kushtet politike, nivelin ekonomik, ritmet e zhvillimit, por dhe shndërrimet e mëdha social-ekonomike e politike të këtyre viteve, del se arsimimi policor është zhvilluar cilësisht, në mënyrë të vazhdueshme.

Ndër momentet më të rëndësishme të zhvillimit institucional e akademik, në këto 45 vjet zhvillimi, të cilat i studiuam dhe mund t'u referohemi, përveç planit dhe programeve mësimore të fillimit të studimeve të larta policore, përmendim reformat përmbajtjesore të viteve 1984 dhe 2000. Në vitin 1984, reforma u përqendrua në kurrikulën dhe programet universitare, çka ndryshe cilësohet dhe si "reforma për forcimin e karakterit juridik e profesional". Thelbi i ndryshimeve të planit mësimor ishin: shtimi i numrit të lëndëve profesionale, i numrit të lëndëve juridike e sociologjike, hartimi i një programi të integruar të përgatitjes fizike, si dhe zgjatja e kohës së studimeve nga 3 në 4 vjet. Veçor se, në lëndët profesionale të shtuara spikatin ato për teknikat informative, për metodat e përgjimit e investigimit kriminal dhe njohuritë për përgatitjen tekniko-speciale, të diktuar nga rritja e kriminalitetit dhe shtimi i krimeve të rënda.

Ndryshimi i sistemit politik në fillim të viteve '90, hapja e me botën, format e reja të kriminalitetit, etj, diktuan nevojën e rikonceptimit të programeve, ripunimit të teksteve, etj, pra të një reformë tërësore për ringritjen dhe riorganizimin e strukturave arsimore të formimit dhe kualifikimit policor. Kështu, në zbatim të planit të veprimit për strategjinë e zhvillimit të arsimit policor, në vitin 2000 u formua Akademia e Policisë, me statusin e shkollës së lartë policore, me kohëzgjatje të studimeve tre vite akademike, me shkëputje nga puna. Në prill të vitit 2001, për herë të parë në historinë e Policisë Shqiptare, u organizua konferenca "Për Strategjinë e Zhvillimit të Arsimit dhe Kualifikimit Policor", çka shënon një fazë të re më të lartë të zhvillimit institucional, akademik e shkencor të policisë.

4. "Programi" dhe grupet e interesit

Departamentet e Fakultetit të Sigurisë, krahas punës për organizimin dhe ringritjen e strukturave akademike e shkencore, u përfshinë në një veprimtari të gjere e intensive, në atë për hartimin e planeve, programeve dhe kurrikulës universitare. Veçanërisht i kushtuan vëmendje e kujdes të posaçëm kontakteve me grupet e interesit dhe faktorët institucionale për marrjen e mendimeve, vlerësimeve, opinioneve dhe sugjerimeve të tyre, për disa nga çështjet me themelore si: drejtimit ku duhet të thellohet veprimtaria e arsimit të lartë profesional për të evituar hendekun midis teorisë e praktikës dhe rritur integrimin mes tyre; në cilat aspekte mendohet se duhet përmirësuar profili i specialistit të rendit, sigurisë dhe luftës ndaj krimit; është e mjaftueshme përgatitja e tyre për tu përballur me tendencat e zhvillimeve në fushën e rendit dhe krimit; përfaqëson specialisti i policisë ekspertin e çështjeve të sigurisë, të parandalimit dhe policimit në komunitet; sensi i ndryshimeve të programit mësimor për të përcjelle kulturën qytetare dhe dijet, aftësitë e kompetencat profesionale që duhet të ketë specialisti i policisë i ditëve tona, etj.

Ndër veprimtaritë konsultative për hartimin e programit të studimit "Bachelor" për rendin dhe sigurinë publike, përmendim:

- Dërgimi zyrtarisht i projekt/programit drejtorive të përgjithshme të Policisë se Shtetit (Hetimit të Krimeve, Rendit e Sigurisë, Kufirit & Migracionit dhe

TAÇI, P.
« Programi i studimeve "Bachelor" për rendin dhe sigurinë publike dhe reformimi i institucioneve të arsimit policor »

Policimi dhe Siguria
nr.1, 2015

Shërbimet Mbështetëse), për të marrë mendimin e specialistëve të strukturave operuese lidhur me drejtimet ku duhet përqendrohet më mirë vëmendja e sektorëve dhe strukturave akademike e të kualifikimit.

- Organizimi i ballafaqimeve dhe konsultave me specialistët e Drejtorisë së Kufirit & Migracionit dhe Rendit e Sigurisë Publike dhe administrimi e pasqyrimi i vërejtjeve dhe sugjerimeve të tyre për Programin.

- Kontaktet dhe shkëmbimi i ideve dhe mendimeve me specialistët, pedagogët dhe drejtuesit e Fakultetit të Hetimit të Krimit.


- Takimi dhe bashkëbisedimet me specialistë të spikatur të fushave konkretë si informatike, të gjuhëve të huaja, juristë etj.

- Konsulta me personelin mësimdhënës e administrativ të Shkollës së Formimit Bazë prej nga vijjnë studentët tanë.

- Bashkëbisedimi dhe shkëmbimi i mendimeve me specialistët e Sektorit të Zhvillimit dhe Kurrikulave.

5. Struktura e studimeve, viti akademik dhe ndarja e krediteve

Studimet “Bachelor” për rendin e sigurinë publike janë studime universitare, me kohë të plotë, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas “Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve” (ECTS) dhe që realizohen me një kohëzgjatje normale në 3 (tri) vite akademike. Për çdo vit akademik, studenti ndjek rregullisht studimet dhe fiton deri 60 kredite, ndërsa në fund të studimeve trevjeçare studenti mund e duhet të fitojë 180 kredite ECTS. Procesi mësimor është i organizuar në vite akademike, me dy semestra për çdo vit studimesh (gjashtë semestra për tre vjet) dhe me tri sezona provimesh në vit. Në planin mësimor parashikohet një periudhe prej tetë javësh praktikë profesionale dhe dy periudha dyjavore, (një në vit të parë dhe tjetra në vitin e dytë) për kryerjen e stërvitjeve të grupuara në bazë kursi, etj. Po ashtu parashikohet që, gjatë vitit të fundit të studimeve, studenti mund të përgatisë një punim apo temë diplome, për të cilën edhe vlerësohet me notë për punën e bërë. Disiplinat mësimore, veprimtaritë dhe detyrimet e tjera akademike vlerësohen me kredite ECTS. Viti akademik është



TAÇI, P.
« Programi i studimeve “Bachelor” për rendin dhe sigurinë publike dhe reformimi i institucioneve të arsimit policor »

Policimi dhe Siguria nr.1, 2015


planifikuar të zgjasë 30 deri 32 javë mësimore, i ndare në dy semestra, të cilët zgjasin nga 15-16 jave mësimore. Ndërkohë, jave mësimore është pesë ditë, nga e hëna në të premte mësim dhe çdo ditë mund të zhvillohen deri 5 orë mësim. Në këtë mënyrë, studenti zhvillon jo më shumë se 25 orë mësimore në javë, në auditor.

Koha e fillimit dhe e mbarimit të vitit mësimor, sesionet e provimeve, pushimet e dimrit e të festave zyrtare, etj., përcaktohen në plan-kalendarin akademik, i cili del çdo fillim viti. Bazë për hartimin e plan-kalendarit janë udhëzimet e ministrit të Arsimit dhe vendimi përkatës i “Senatit akademik” të AS-së.

Ndër veprimtaritë formuese që parashikohen në Programin e Studimit “Bachelor” për Rendin dhe Sigurinë Publike veçohen: mësimi në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratorë); studimi individual (hulumtim, kërkim, studim, punim relacionesh, detyrash apo projektesh, përgatitje provimesh, përgatitje e tezës së diplomës etj.) dhe veprimtari të tjera, si praktika profesionale dhe vendosja në rol pranë strukturave vendore të policisë.

Ndarja e krediteve sipas kategorisë së lëndëve. Në tërësinë e krediteve që do të marrë studenti që ndjek këtë program studimi, së paku:

- Deri 36 kredite ECTS, janë për kategorinë e disiplinave të formimit të përgjithshëm;
- 90 kredite ECTS, për disiplinat e formimit karakterizues (profesional) të programit;
- Deri 18 kredite ECTS, për disiplinat e ngjashme me ato profesionale dhe/ose integruese;
- 14 kredite ECTS në kategorinë e disiplinave formuese të zgjedhura nga studenti;
- 18 kredite ECTS në kategorinë e veprimtarive formuese për njohje të gjuhës së huaj, aftësime informatike, (8 kredite ECTS vlerësohet praktika profesionale);
- 6 kredite ECTS për punimin e diplomës.



6. Aftësitë e fituara dhe profili i diplomës

Kompetencat që fitohen nga realizimi i objektivave. Nga zhvillimi i disiplinave dhe veprimtarive akademike që përshkruhen në programin e studimeve për Rendin dhe Sigurinë Publike, mundësohet realizimi i objektivave të formimit tërësor të

TAÇI, P.
« Programi i studimeve “Bachelor” për rendin dhe sigurinë publike dhe reformimi i institucioneve të arsimit policor »

Policimi dhe Siguria
nr.1, 2015

studentëve dhe fitohen dije, aftësi e shprehi profesionale që do të përbejnë profilin kulturor e profesional të studentit.

Realizohen dijeve të karakterit të universitar dhe formimit të përgjithshëm (bazë), ç'ka do të vijë nga zhvillimi i një grupi disiplinash dhe veprimtarish formuese nga fusha e psikologjisë, sociologjisë, drejtësisë, lëndë të veçanta, etj. Realizimi i këtij objektivi do të rrisë kapacitetet e studentëve për analizë dhe sintezë, për organizim dhe planifikim, njohuritë themelore të përgjithshme dhe mbështetjen për njohuritë bazë të profesionit.

Do të përvetësohen dije të formimit të posaçëm ç'ka lidhet me përkatësinë dhe të veçantën që përcjell program i studimit dhe që realizohen me anë të grupit të disiplinave dhe veprimtarive formuese ngushtësisht profesionale. Këto krijojnë aftësitë organizative, të planifikimit e kontrollit, aftësitë për t'u përshtatur në situata të reja dhe për të zbatuar njohuritë në praktikë, për të krijuar ide të reja, për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për të udhëhequr, hartuar e menaxhuar projekte, për të pasur iniciativë dhe frymë sipërmarrëse dhe vullnet për të lakmuar suksesin, etj.

Përftimi dhe marrja e njohurive e dijeve që lidhen e zgjerojnë formimin ndërdisiplinor me anë të veprimtarive dhe disiplinave të ngjashme, të afërta dhe integruese me disiplinat dhe veprimtaritë profesionale si, njohuri juridike, ekonomike, etj. Në këtë mënyrë shtohen aftësitë për gjykime kritike dhe arsyetime të drejta rreth veprimeve të kryera e vendimeve të mara, aftësi për të punuar në ekip, aftësi ndërpersonale, për të komunikuar me ekspertë të fushave të tjera, vlerësim të zgjidhjeve alternative, respektimit të mendimit ndryshe, etj.

Nëpërmjet disiplinave dhe veprimtarive formuese të fokusuar drejt përvetësimit të gjuhëve të huaja, njohurive informatike, etj. përftohen aftësitë njohëse e prezantuese, ose aftësitë komunikuese që lehtësojnë kryerjen e detyrave të përbashkëta me partnerët e huaj. Kështu shtohen aftësitë e komunikimit me gojë e shkrim, njohjet për një gjuhë të huaj, aftësi për menaxhim e informatikë, vlerësim të larmisë shumë-kulturore, aftësi për të bashkëpunuar në kontekst/me partnerë ndërkombëtarë, aftësi për të zgjidhur problemet dhe për vendimmarrje, etj.

Profili i diplomës "Specialist për Rendin dhe Sigurinë Publike". Siç u theksua, Programi synon të krijojë profilin e specialistit të policisë nëpërmjet njohurive bazë mbi parimet e përgjithshme të operimit policor dhe format e metodat e menaxhimit, aftësi specifike për organizimin e drejtimin e tërësisë së shërbimeve dhe specialiteteve që përfshihen në Policinë e Shtetit, si dhe për të trajtuar problematikat teorike e praktike të fushës së rendit, sigurisë e të luftës ndaj krimit, etj. Me shlyerjen e të gjitha detyrimeve dhe realizimit të 180 krediteve, pasi ka shlyer edhe provimin e mbrojtjes së diplomës, studenti shpallet se ka përfunduar me sukses ciklin e parë të studimeve "Bachelor" për rendin dhe sigurinë publike, me kohë të plotë. Ai pajiset me diplomën: "Specialist për Rendin dhe Sigurinë Publike", e cila është dokument zyrtar dhe përmban të dhënat e sakta të studentit.

Diploma për ciklin e parë të studimeve "Bachelor" për Rendin dhe Sigurinë Publike, shoqërohet me "Suplementin e Diplomës" – dokument ky që është hartuar në përputhje me kërkesat e hapësirës evropiane të arsimit të lartë. Në suplement përshkruhen në veçanti, natyra, niveli, përmbajtja, rezultatet e studimeve që janë kryer dhe përfundimi me sukses i të gjitha detyrimeve akademike e administrative nga mbajtësi i diplomës.

TAÇI, P.

« Programi i studimeve "Bachelor" për rendin dhe sigurinë publike dhe reformimi i institucioneve të arsimit policor »

Policimi dhe Siguria nr.1, 2015

7. Vështrim analitik i raporteve brenda planit mësimor - në vend të përfundimeve

a. *Përkatësia e lëndëve.* Një vështrim i përgjithshëm analitik e krahasimor mbi planin mësimor, për përkatësinë e lëndëve të karakterit formues, për raportet teori-praktikë, ndarjen e orëve dhe krediteve ECTS, evidenton se:

- Në grupin e lëndëve dhe moduleve profesionale, të kategorisë “B” janë 14 lëndë dhe kanë 91 kredite ECTS, të cilat zënë rreth 50.55 % të orëve të Programit (2275 nga 4500 orë gjithsej).

- Pjesa tjetër, e lëndëve i përkasin formimit të përgjithshëm universitar të kategorizuara në grupin “A”, “C”, “D” dhe “E” të cilat kanë 89 kredite ECTS, dhe zënë rreth 49.44 % të orëve (2225 nga 4500 orë gjithsej).

b. *Raportet teori-praktikë (orë leksioni me orë seminari, punë praktike, etj.)* Studimi i raporteve midis orëve të lëndëve të formimit profesional dhe orëve të lëndëve të formimit të përgjithshëm evidenton se:

- Nga orët e mësimi në auditor, 1085 orë, ose rreth 49.2% janë leksione dhe rreth 1120 orë, ose rreth 50.8% janë seminare e punë praktike; ndërkohë që brenda zërit mësim praktikë, seminarët janë 550 orë dhe zënë rreth 49.1% të tyre dhe mësimet praktike janë 570 orë ose 50.9%.

- 53.5% e orëve të seminareve dhe p/p dhe 51.6% e orëve të leksioneve i përkasin disiplinave profesionale, ndërkohë që këtij grupimi lëndësh i përket edhe 51.8% orëve të studimit individual. Pjesa tjetër janë për disiplinat e formimit të përgjithshëm.

c. *Studimi individual dhe studimi në auditor.* Po ashtu, nga vështrimi i tërësisë së veprimtarive dhe disiplinave formuese të planit mësimor, veçanërisht për raportin midis mësimëve apo shpjegimeve teorike (leksioneve) dhe seminareve, punës praktike dhe kontrollit të dijeve në auditor, përftohet konkretisht kjo ndarje:

- Nga 4500 orë mësimi në total, rreth 2205 orë, afërsisht 44.55% e totalit, janë orë mësimi në auditor (leksione, seminare, punë praktike, etj.),

- Brenda zërit mësim praktikë, seminarët janë 550 orë dhe zënë rreth 49.1% të tyre dhe orët e punëve apo mësim praktikë janë 570 ose 50.9%.

- Pjesa tjetër, rreth 2295 orë, ose 48.9% e gjithë orëve të studimeve, është studim individual i pavarur dhe kanë të bëjë kryesisht me studim të literaturës së rekomanduar, punim relacionesh, detyrash apo projektesh, përgatitje provimesh, etj. Sqarojmë se, në këtë grup orësh, përfshihen edhe veprimtari të tilla si praktika profesionale apo stazhi pranë strukturave vendore e rajonale të policisë dhe përgatitja e tezës së diplomës.

d. *Impakti në formimin e studentëve.* Nga ballafaqimi i shifrave të sipërpërmendura, raportet në përqindje 51 ÷ 49, (të kohës se studimit në auditor dhe studimit individual), i gjejmë me vend e të rregullt. Shkuarja, pothuajse deri të barazimi i orëve të mësimi në auditor dhe studimit të pavarur apo individual, do të bëjë që, te studenti të kultivohet e rritet përgjegjshmëria personale, ndjenja për të punuar në mënyrë të pavarur, për t’u përshtatur me situatat dhe për të zbatuar njohuritë në praktikë. Sikurse do të krijohen e zhvillohen tek ai aftësitë organizative të planifikimit e kontrollit, do të rritet iniciativa dhe fryma sipërmarrëse, aftësitë e komunikimit e bashkëpunimit me ekspertë të fushave të tjera, të vlerësimit të zgjidhjeve alternative dhe respektimit të mendimit ndryshe, etj.

TAÇI, P.
« Programi i studimeve “Bachelor” për rendin dhe sigurinë publike dhe reformimi i institucioneve të arsimit policor »

Policimi dhe Siguria
nr.1, 2015

Shoqëria civile dhe Policia e Shtetit



■ Prof. Asc. **Qetësor ORHANI**
Akademia e Sigurisë

Abstrakt

Policia e Shtetit gjatë gjithë kësaj periudhe tranzicioni, gati 25 vjeçare, si rezultat i bashkëpunimit dhe asistimit nga partnerët tanë, ka bërë dhe vazhdon të bëjë përparime të dukshme dhe cilësore në përmbushjen e misionit të saj.

Përparime të dukshme janë bërë në aspektin ligjor dhe atë funksional të saj. Në aspektin e bashkëpunimit me shoqërinë civile ka gjithashtu përmirësime të dukshme, pavarësisht se ky partneritet është akoma jo funksional, d.m.th. nuk i përgjigjet standardeve të kërkuara, pasi policimi në komunitet është policimi që përfshin qytetarët në mënyrë aktive për të zvogëluar, parandaluar dhe zbuluar krimet.

Me fjalë të tjera partneriteti ndërmjet policisë dhe qytetarëve nënkupton që policia, në aspektin e sigurisë, t'u ofrojë vazhdimisht qytetarëve një shërbim cilësor. Nga ana tjetër edhe qytetarët apo komuniteti duhet të jenë aktivë për ta ndihmuar ose ushqyer policinë me informacionin e domosdoshëm. Vetëm kështu ky partneritet do të ndihmojë në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve që përbëjnë shqetësim për qytetarët.

Ndihma e pakusyer e dhënë nga partnerët në drejtim të "Policimit në komunitet", ka bërë të mundur përvetësimin e kësaj filozofie të re, por ka ardhur koha që kjo filozofi e suksesshme të bëhet motoja e punës së policisë, pasi pa një bashkëpunim të suksesshëm me qytetarët nuk mund të pretendohet asnjëherë për funksionimin e këtij binomi jetik për sigurinë.

Aplikimi dhe përshtatja në kushtet e vendit tonë, e policimit në komunitet si filozofi dhe praktikë pune për ruajtjen e rendit dhe qetësisë, përbën pa dyshim një qasje të re e më të efektshme për arritjen e objektivave të policimit. Vendosja dhe krijimi i një marrëdhënieje partneriteti midis policisë dhe shoqërisë civile, të cilës ajo i shërben, është në themel të kësaj mënyre policimi. Kjo gjë e ka bazën e vet në hartimin e dokumenteve bazë të punës së policisë në këtë rrafsh¹, si dhe në urdhrat dhe udhëzimet e shumta të nxjerra nga përfaqësues të policisë të së gjitha niveleve.

Fjalëkyçe:

Idlership policor, lider, policia shqiptare, historik i lidershpit policor, lidershpi strategjik, menaxhimi policor, planifikim

ORHANI, Q.
« Shoqëria civile dhe Policia e Shtetit »

Policimi dhe Siguria
nr.1, 2015

¹ Bëhet fjalë për Strategjinë e Policisë së Shtetit, Plani i Veprimit Operacional, për Implementimin e Policimit në Komunitet, Urdhrat e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit etj. (Shënimi i autorit)

Hyrje

Partneriteti mes policisë dhe shoqërisë civile ofron vazhdimisht shërbime cilësore ndaj qytetarëve. Ky partneritet e ndihmon policinë në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve që përbëjnë shqetësim për qytetarët. *Vetëm kur shoqëria civile dhe policia punojnë për të mirën e përbashkët, qytetarët do të besojnë tek policia.* Ky besim ndihmon policinë që ti shërbejë më mirë komunitetit, që të përmbushë detyrat e “mbrojtjes dhe shërbimit” dhe të fitojë besimin në sytë e qytetarëve.

1. Si ta kuptojmë “policimin në komunitet”?

Tashmë vendi ynë i është bashkuar prirjes ndërkombëtare për adaptimin e policimit në komunitet si një filozofi dhe metodë pune që do të thotë se kjo qasje e re në veprimtarinë policore plotëson mënyrën tradicionale të policimit ku policia është tipikisht në pozita pritëse dhe reaguese, pra ai konsiderohet si një mënyrë që policia të bëjë më mirë detyrën e saj parësore për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike.

Me të drejtë sot policimi në komunitet konsiderohet si policimi më efikas, por për të kuptuar nëse ai praktikohet apo jo si metodë pune nga Policia e Shtetit nuk është aspak e nevojshme të analizosh efikasitetin e policimit në tërësi, por mjafton të analizojmë gjendjen e partneritetit apo nivelin e bashkëpunimit të policisë me shoqërinë civile.

Nga ana tjetër, mund të argumentohet se prania e marrëdhënieve të mira midis policisë dhe qytetarëve nuk është domosdoshmërisht e barasvlershme me policim më cilësor. Natyrisht që përmirësimi i aspekteve të tjera të punës së policisë si p.sh. trajnimi i vazhdueshëm, mirëfinancimi, motivimi etj., ndikojnë ndjeshëm në cilësinë e policimit.


Të përpiqesh të kuptosh nëse policimi tek ne bëhet në mënyrë tradicionale e reaguese, apo në të kundërt, në mënyrë parandaluese dhe komunitare, është njëlloj si të kuptosh nëse policohet mirë apo keq.

Në një anketim të zhvilluar nga ISPL në lidhje me dhënien e informacionit policisë nga komuniteti rezultoi se qytetarët janë të interesuar të bashkëpunojnë me policinë madje: *“rreth 70% e OJF-ve dhe gati 80% e qytetarëve të anketuar shprehën se: bashkëpunimi me policinë është i një rëndësie të veçantë për ta,*

ORHANI, Q.
« Shoqëria
civile dhe
Policia
e Shtetit »

Policimi
dhe
Siguria
nr.1, 2015

pavarësisht kësaj, vetëm rreth 20% e të gjithë të anketuarve pohojnë se kanë bërë një kallëzim në polici dhe se përgjigja e policisë ka qenë e pranueshme”².



Mungesa e gatishmërisë së qytetarëve për të dhënë informacion policisë mendoj se i ka rrënjët tek *mentaliteti i vjetër*, i krijuar gjatë sistemit të kaluar ku qytetarët vazhdon akoma t’i mendojë hija e ish-Sigurimit të Shtetit, i cili në atë periudhë relativisht të gjatë, kish depërtuar thellë në brendësi të shoqërisë sonë dhe si rezultat i saj njerëzit kishin frikë edhe nga njerëzit e shtëpisë e jo më nga punonjësit e Sigurimit të Shtetit, ky mentalitet pavarësisht se kanë kaluar dhjetëra vjet vazhdon akoma të përjetohet nga qytetarët sidomos nga brezi i vjetër.

Po kështu lëvizjet e shumta që kanë ndodhur këto vite si rezultat i ndikimeve partiake, kanë bërë që policia të mos shfaqë në të vërtetë profesionalizmin e saj, gjë e cila ka ndikuar tek qytetarët që të vazhdojnë akoma të mendojnë vetëm negativisht për policinë. Madje edhe fëmijët e shkollave vazhdojnë ta shikojnë policin si një figurë të frikshme pasi, që kur lindin edukohen me ndjenjën se “i thashë xhaxhi policit”. Kjo do të thotë që policia duhet të zbrësë deri në shkollat e ciklit të ulët, me qëllim që fëmijët të shikojnë tek policia figurën që do t’i ndihmojë dhe jo të kenë frikë dhe t’i shmangen asaj.

Tranzicioni i gjatë që po kalon vendi ynë dhe policimi drejt metodave moderne të punës që filloi mbas vitit 1990, deri në shpërthimin e trazirave shoqërore të vitit 1997 nuk flasin për ndonjë përqendrim të punës së policisë tek policimi në komunitet, por “*përpyekja më serioze për të instaluar policimin në komunitet në Shqipëri si një filozofi dhe praktikë pune është pa dyshim programi i UNDP në mbështetje të reformave në sektorin e sigurisë i zhvilluar në harkun kohor 2004 – 2007*”³. Ky program shërbeu si fillesa e policimit në komunitet i cili më pas është vazhduar me një sërë aktivitetesh të tjera të ndërmarra nga Policia e Shtetit dhe partnerët që e asistojnë atë.

Filozofia e re që aplikohet sot për policimin në komunitet është një produkt i një rëndësie të veçantë i cili është aplikuar dhe vazhdon të aplikohet sot nga shumica e shteteve të qytetëruara dhe të emancipuara. Pavarësisht trajnimeve të vazhdueshme dhe asistencës teknike që vazhdohet t’i jepet policisë sonë, ky proces është në hapat e parë të tij dhe shumë shpejt ka për t’i dhënë rezultatet e kërkuara.

Krahas ndihmës së dhënë nga partnerët, ka ardhur koha që kjo filozofi e


² ISPL, *Studim, Partneritetet në kontekstin e Policimit në Komunitet*. Tiranë: Ministria e Punëve të Brendshme, 2013. Faqe 48.

³ INLSH, *Policia, rendi siguria dhe marrëdhëniet me komunitetin*. Tiranë: Ministria e Punëve të Brendshme, 2014. Faqe 18

suksesshme të bëhet motoja e punës së policisë për të kërkuar vazhdimisht që bashkëpunimi me qytetarët duhet të jetë në qendër të vëmendjes së policisë së shtetit pasi pa një bashkëpunim të suksesshëm me ta nuk mund të pretendohet asnjëherë për funksionimin e këtij binomi jetik për sigurinë e qytetarëve.

Në përfundimet e anketimit të kryer nga ISPL në vitin 2013, shqetësues është fakti për përgjigjen e pyetjes: *A keni kërkuar ndonjëherë ndihmën e policisë?* Rreth 70% e të anketuarve janë përgjigjur me “Jo”, që do të thotë se qytetarët nuk e kanë krijuar akoma bindjen se policia do ti ndihmojë ata në zgjidhjen e problemeve që ata i kanë shqetësuar.

Aq më e rrezikshme bëhet kjo përgjigje po ti referohemi fenomenit shqiptar të vetëgjyqësisë, që për fat të keq vazhdon edhe sot dhe që aktualisht mban të ngjuar, kryesisht në zonat veriore të vendit, mbi 1000 fëmijë, nxënës shkollash të privuar nga liria, si provë e vazhimit të gjakmarrjes, një fenomen i vjetër ky për të cilin duhet të gjenden rrugë të reja, në radhë të parë nga shoqëria civile por edhe nga policia, për të eliminuar apo minimizuar këtë fenomen të papranueshëm për vendet e emancipuar ku ne kërkojmë të integrohemi.



Në mënyrë që policimi në komunitet të bëhet realitet, domethënë praktikë pune e zakonshme për policinë e shtetit, është e domosdoshme që midis policisë dhe partnerëve të saj të ekzistojnë linja të qarta dhe të hapura komunikimi. Vetëm kështu mund të bëhet realitet objektivi kryesor i këtij lloji policimi që është identifikimi i problemeve, i shkaqeve që qëndrojnë në themel të këtyre problemeve dhe, çka është më e rëndësishme, parandalimi i tyre.

2. Ku duhet të synojë ky partneritet

Një nga parimet kryesore të policimit në komunitet është ai i përkushtimit të policisë ndaj qytetarëve. Pavarësisht se ky ndërveprim është i dyanshëm unë mendoj se rolin primar në këtë bashkëpunim padyshim që duhet ta luajë policia për ta vendosur atë në pozicionin e dëshiruar.

Policia e Shtetit duhet të tregojë se ajo është e përkushtuar për përmirësimin e sigurisë së jetesës së qytetarëve duke i ndihmuar dhe duke i dëgjuar ata, si dhe duhet t’ju përgjigjet për zgjidhjen e problemeve që kërkojnë prej tyre, nga ana tjetër, edhe qytetarët duhet të jenë të gatshëm të ndihmojnë punonjësit e policisë

ORHANI, Q.
« Shoqëria
civile dhe
Policia
e Shtetit »

Policimi
dhe
Siguria
nr.1, 2015

në identifikimin dhe zgjidhjen e detyrave të tyre.

Përkushtimi është një koncept shumë i gjerë dhe që vazhdimisht evoluon në përputhje me kërkesat e kohës, disa nga aspektet më të rëndësishme mendoj se janë:

1. *Trajtimi i njëjtë i paanshëm dhe me respekt për të gjithë qytetarët*, mbetet si gjithmonë motivi kryesor që duhet të përfshijë gjithë sferën e punonjësve të policisë pasi duke zbatuar me rreptësi dhe pa dallim të gjitha kërkesat e policimit në komunitet indirekt ne kemi arritur të rikthejmë besimin e qytetarëve tek policia.

Një trajtim i njëjtë dhe i pa diferencuar për të gjithë do të çojë pa tjetër në rritjen e vlerave të policisë pasi qytetarët kur shohin se një pjesë përpiqen të zbatojnë me rigorozitet ligjet e miratuara dhe nga ana tjetër vetë ata që i vendosin apo aq më keq vetë punonjësit e policisë i shkelin ato me të drejtë qytetarët do të mendojnë se përse duhet të ankohen tek policia?! Është pikërisht kjo që i pengon qytetarët për t'ju drejtuar policisë po ti shtosh kësaj dhe imazhin e vjetër për policinë e dikurshme, gjërat përkeqësohen akoma më shumë.

Muajin e kaluar u publikua një video në internet, që një polic (në SHBA) i kishte vënë gjobë vetvetes, mbasi pa e ditur kishte parkuar gabim në vendin e invalidëve, të cilën e konstatoi pasi u kthye për të marrë makinën, kjo gjë për qytetarin tonë duket si një çudi e paprekshme për të, por në fakt në perëndim këto fenomene tashmë janë të shpeshta dhe kjo ka bërë atë që ata të ndihmojnë policinë me informacionet e tyre pasi duke ndihmuar policinë ata ndihmojnë vetveten.

2. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është edhe ai i *përfshirjes së qytetarëve në zgjidhjen e përbashkët të problemeve* që shqetësojnë si qytetarët ashtu dhe policinë. Bashkëpunimi i qytetarëve me policinë ashtu siç tregohet dhe nga anketimet e bërë nga ISPL vazhdon të ngelet në nivele shumë të ulëta, kjo do të thotë se duhet akoma shumë punë për ta rikthyer besimin e qytetarëve.

Bashkëpunimi me qytetarët arrihet kur punonjësi i policisë tregon interesim për t'i ndihmuar ata. Është me rëndësi që oficerët e policisë t'i qëndrojnë afër komunitetit, në mënyrë që të forcojnë lidhjet me ta për të minimizuar problemet që kanë të bëjnë me kriminalitetin dhe me shqetësimet e qytetarëve.

3. *Ndjeshmëria kulturore*, është përsëri një faktor tjetër që duhet pasur në konsideratë gjatë punës me qytetarët pasi në qytetet e mëdha sidomos në Tiranë përbërja e popullsisë mbas viteve 90 është shumë homogjene në këto kushte është detyra e policisë që të dijë ti dallojë ato dhe të njohë specifikat e çdo grupi shoqëror për të ndërtuar me sukses punën e vet.

4. Qytetarët tek policia duhet të ndjejnë sigurinë e tyre, në këtë aspekt *rritja e efektivitetit të sigurisë publike* do të çojë në rritjen e bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve nga njëra anë dhe policisë nga ana tjetër. Pavarësisht se në pamjen e parë të duket sikur gjatë gjithë këtyre viteve të tranzicionit gjërat kanë shkuar më keq madje duke bërë krahasime me të kaluarën duket sikur kemi qenë më mirë dhe tani gjërat po shkojnë më keq. Në fakt gama e problemeve që mbulon sot policia as që mund të krahasohet me ato të ish sistemit të kaluar pasi, sot jo vetëm vendi ynë por madje edhe vende shumë më të zhvilluara se ne po ndeshen me fenomene të pa dëgjua më parë,

Le të shikojmë se ç'ndodhi së fundi në Francë, ç'po ndodh aktualisht me dyndjet

e refugjatëve nga Siria e shumë e shumë probleme të tjera të ngjashme ose edhe më të vështira padyshim që rëndojnë mbi punën e policisë nga e cila qytetarët kërkojnë zgjidhje të menjëhershme. Pra mund të themi se ndërsa komuniteti ka ngritur në një shkallë më të lartë qytetërimin e tij nga ana tjetër krimi po merr përmasa gjithnjë e më të mëdha me të cilat policia duhet të ndeshet në çdo kohë dhe jo vetëm kaq por edhe duhet të fitojë, A mund të mendohet sot se në ish sistemin e kaluar njerëzit të kultivonin lëndët narkotike?! Po sa e ka ndryshuar përqendrimin e vëmendjes ky aspekt tek policia?!

5. *Komunikimi i hapur dhe i sinqertë*, duhet të përfshijë sot vëmendjen e gjithë drejtuesve të policisë së shtetit në të gjitha nivelet, pasi shumë pak madje edhe kur bëhet ai zhvillohet me shumë të meta, kjo kërkon një përgatitje më serioze duke përfshirë edhe arsimimin policor që këtë vit me të drejtë u rihap arsimiti i lartë policor si një aspekt shumë i rëndësishëm i cili do të ndihmojë në ngritjen e efektivitetit të komunikimit të policisë me qytetarët. Shikojmë shpesh filma policorë dhe me të drejtë ndjejmë një kënaqësi kur shohim që drejtuesit e policisë paraqiten me një nivel shumë të lartë komunikimi me publikun, madje në shumë raste ata thirren me tituj të lartë akademikë si doktorë, profesorë etj. Kjo do të thotë se aktualisht policitë e vendeve ku ne kërkojmë të aderojmë, i kanë tashmë këta drejtues që e meritojnë të quhen të tillë. A nuk mund t'i kemi edhe ne, apo përse nuk i kemi edhe ne?!

Po t'i rikthehemi përsëri studimit të ISPL-së na rezulton se rreth 40% e gazetarëve të intervistuar kërkojnë që shprehinë komunikuese të punonjësve të Policisë së Shtetit të jenë më të mira. Të njëjtën gjë kërkojnë edhe gazetarët në pyetjen mbi karakteristikat kryesore që do përkufizonin një polici ideale ata theksin kryesor e vënë mbi cilësitë e komunikimit dhe besimit, duke nënvizuar komunikimin qytetar.

Sipas tyre “komunikimi me qytetarët duhet të jetë i mirë dhe i përhershëm. Qytetari duhet të dijë ku të drejtohet kur ka nevojë dhe inspektori i zonës duhet të njohë çështjet problematike që ka komuniteti ku ai punon. Sipas anketimit të kryer po nga ISPL rezulton se 30% e gazetarëve shprehen se; “policia duhet të japë më shumë informacion, të jetë transparente në marrëdhëniet që krijon, më e hapur, kontaktet me komunitetin t'i ketë më të shpeshta, të bashkëpunojë me qytetarët dhe duhet të ketë persona më të përgatitur dhe të posaçëm për të komunikuar me median dhe qytetarët”.⁴

Reformat e shpeshta të ndërmarra dhe ndryshimet e fundit e kanë fuqizuar faktorin që lidhet me komunikimin e brendshëm të Policisë së Shtetit si shumë të rëndësishëm për suksesin e këtij procesi. “Megjithatë ky komunikim duket se vuan një “sëmundje” të vjetër kronike në punën e përditshme të Policisë”⁵

3. Roli i qytetarëve në aktivitetet policore

Studimet e zhvilluara në shoqërinë amerikane tregojnë se problemet e policimit po pësojnë ndryshime të shpejta ashtu sikurse dhe çështjet publike po bëhen edhe

⁴ INLSH, *Policia, rendi siguria dhe marrëdhëniet me komunitetin*. Tiranë: Ministria e Punëve të Brendshme, 2014. Faqe 18.

⁵ COMPOR, *Strategjia e Integruar e Komunikimit dhe Plani i Komunikimit për Fushatën Sensibilizuese në pesë Sektorë të Policisë së Shtetit Shqiptar*. Tiranë: Ministria e Punëve të Brendshme, 2014. Faqe 81.

më komplekse, zgjidhjes së problemeve me mënyrën tradicionale të komunitetit po i vjen fundi. *“Të punosh bashkërisht në mënyrë të suksesshme sot, kërkon një ndryshim të thellë në lidhje me konceptimin tonë se si është i krijuar ndryshimi dhe, një ndryshim po aq të thellë në konceptimin tonë mbi leadershipin. Leadershipi bashkëpunues është projektuar për të ndihmuar qytetarët dhe liderët e shoqërisë civile për të bërë bashkë anëtarët e komuniteteve të ndryshëm në përpjekjet që i çojnë drejt ndryshimeve reale, të matshme në jetën e këtyre komuniteteve”*⁶.

Duke u mbështetur në hulumtimet e tyre të gjera, ata tregojnë se si trajtohen çështjet komplekse; si të trajtohen qytetarët e frustruar dhe të zemëruar dhe se si zyrtarët e zgjedhur dhe udhëheqës të tjerë të shoqërisë civile të mund të gjenerojnë vullnetin qytetar, për rrëzimin e bllokimit legjislativ dhe burokratik. Autorët përshkruajnë se si të hartohet, si të fillojë, dhe si të mbështetet një proces konstruktiv dhe bashkëpunues.

Përfundimi i mësipërm përkon me vizionin e ndërtimit të një lideri strategjik policor për të ardhmen, i cili e sheh veten vazhdimisht në kontakt me shoqërinë civile dhe komunitetin, për shkak të natyrës së ekspozuar që ka posti i tij. Në këtë mënyrë leadershipi bashkëpunues policor është vërtet një udhë e saktë për tu ndjekur edhe në kushtet e vendit tonë.

Në shoqëritë demokratike qytetarët kanë të drejtë dhe detyrim të marrin pjesë në aktivitetet e policisë ata kanë të drejtën e fjalës së tyre lidhur me mënyrën se si qeveriset me ta, duke e parë problemin në këtë kënd vështrimi, Policia e Shtetit duhet të reagojë shpejt dhe të jetë plotësisht e përgjegjshme ndaj sigurisë së tyre, luftës kundër kriminalitetit dhe për mbështetjen e kërkesave dhe nevojave në rritje të komunitetit. Vendosja e kontakteve transparente pozitive duke u sjellë në mënyrë miqësore, të hapur dhe institucionale me qytetarët do të çojë në forcimin e besimit tek publikut të cilit i shërbejmë.


Nëse komuniteti është i lidhur me policinë, ai fillon të shfaqë interesa të përbashkëta dhe të përkrahë policinë në përmbushjen e misionit dhe detyrave të saj funksionale. Kur qytetarët të ndiejnë se ata kanë kontroll mbi fatin e tyre, mund të ndodhin ndryshimet pozitive.

Aktivitetet policore në komunitet inkurajojnë qytetarët që të punojnë së bashku në rritjen e sigurisë së tyre. Po kështu, marrëdhëniet dhe kontaktet me të rinjtë, qytetarët e moshuar, organizatat e ndryshme kulturore, fetare dhe organet shtetërore forcohen më shumë.

Dhënia e informacionit Policisë për veprime të paligjshme, nga qytetarët, është akoma e një niveli shumë të ulët e pa përfillshme, madje edhe përpjekjet e policisë për të mbledhur informacion nga qytetarët janë shumë të dobëta. Ky fakt tregon se qytetarët vetëm kërkojnë nga ana e policisë dhe *nuk e shohin si obligim kushtetues dhënien e informacionit*, madje jo vetëm kaq por edhe bashkëpunimin me policinë për parandalimin e një veprimtarie antiligjore.

Që të arrihet ky bashkëpunim apo ndërveprim është përsëri policia ajo që duhet të paraprijë këtë proces që sapo ka filluar. Duhet të rritet pjesëmarrja e qytetarëve në aktivitetet tona dhe të bëjmë që ata ta ndiejnë veten pjesë e këtij bashkëpunimi, ndoshta ka ardhur koha që edhe në kurset e ndryshme që zhvillohen në Akademinë

⁶ Chrislip, D., Carl L. (1994). *Collaborative Leadership: How Citizens and Civic Leaders Can Make a Difference*, Jossey-Bass, 1st edition, pp.15-23.



e Sigurisë duhet të përfshihen anëtarë të komunitetit apo shoqërisë civile pjesëtarë të OJF-ve medieve, institucioneve etj. të cilët do ta prekin dhe do të ndjejnë drejtpërsëdrejti atë që policia bën për t’ju shërbyer qytetarëve.

Ky fakt duket shumë qartë në faktin se:

“Rreth 55% e të anketuarve nga komuniteti i biznesit pranuan se do të merrnin pjesë me dëshirë në takime ose konsultime periodike me policinë për të diskutuar mbi çështje dhe shqetësime mbi rendin publik. Ndërkohë që vetëm 30% e OJF-ve të intervistuar kanë komunikime të përhershme me departamentin e policisë që mbulon fushën e veprimtarisë së tyre”⁷.

Nga ky fakt dallojmë dy qëndrime të kundërta të shoqërisë civile nga njëra anë kanë dëshirë për të bashkëpunuar me policinë e cila është shumë pozitive, pasi ata nuk duan të qëndrojnë indiferentë dhe nga ana tjetër gatishmëria për të vepruar është e pakënaqshme pasi një përqindje e vogël tashmë e kanë bërë realitet një gjë të tillë, pavarësisht prej kësaj shifrat flasin për një tendencë rënieje të indiferentizmit nga ana e qytetarëve, pra komuniteti po lëviz pozitivisht në drejtimin e duhur, gjë që është pozitive dhe në interes të policimit në komunitet.

Bashkëpunimi i policisë me qytetarët nëpërmjet një komunikimi të vazhdueshëm me ta është një aspekt shumë i rëndësishëm, pasi krijon një përfytyrim tjetër tek qytetarët, të cilët në përgjithësi mundohen të shmangin kontaktin me policinë. Hapja e zyrave publike të informacionit të policisë sa më afër komunitetit, do të krijonte një lehtësi tek qytetarët për ta ndërjerë sa më pranë ndihmën e policisë, kjo do të ndihmonte si qytetarët ashtu dhe policinë për tu bërë pjesë e një qëllimi të përbashkët i cili ka të bëjë me sigurinë publike.

Autorët Sam Torres dhe Ronald E. Vogel, profesorë në departamentin e të Drejtës penale, Universiteti i Kalifornisë, SHBA, si pjesë e studimit të tyre mbi policimin në komunitet, kryen një eksperiment i cili kishte në fokus emigrantët latinë dhe ata vietnamezë dhe marrëdhënien e tyre me policinë. Duke kryer një mënyrë komunikimi nëpërmjet zyrave publike me sportele të hapura, ata arritën që të kishin impakt në perceptimin që komuniteti kishte ndaj policisë. U shpërndanë edhe pyetësorë në fillim dhe në fund të projektit të hapjes së këtyre zyrave kaq pranë komunitetit dhe u vu re se ishte fuqizuar pritshmëria dhe besimi ndaj policisë dhe ishte ulur frika ndaj krimit⁸.

ORHANI, Q.
« Shoqëria civile dhe Policia e Shtetit »

⁷ ISPL, *Studim, Partneritetet në kontekstin e Policimit në Komunitet*. Tiranë 2013. faqe 48.

⁸ Torres, S., Vogel, R., (2001). "Pre and post?test differences between Vietnamese and Latino residents involved in a community policing experiment - Reducing fear of crime and improving attitudes towards the police", in: *Policing: An International Journal of Police Strategies & Management*, Vol. 24 Iss: 1, pp.40 - 55

Ngritja e këtyre zyrave edhe për kushtet e vendit tonë do të ndihmonte në rritjen e besimit dhe e qëllimit që policia të konsultohet dhe të marrë parasysh kërkesat e qytetarëve në përcaktimin e praktikave dhe parimeve të kryerjes së detyrave operative si dhe të bashkëpunojë me qytetarët kurdoherë në zgjidhjen e problemeve. Në këtë mënyrë, qytetarët janë “klientë” të policisë.

4. Përfundime dhe rekomandime

Qytetarët mbeten përfituesit kryesorë të shërbimeve të policisë për garantimin e rendit dhe sigurisë publike, pasi këto shërbime synojnë mbrojtjen e jetës dhe pasurisë së qytetarëve, mbrojtjen e të drejtave të tjera të tyre si dhe zbulimin dhe parandalimin e krimit që i kërcënon ata. Është e rëndësishme që aktualisht duhet të ngrihet në një nivel më të lartë partneriteti i policisë së shtetit me partnerët e saj shtetërorë, pasi ky bashkëpunim duhet të funksionojë në nivelin e zbatimit në praktikë të detyrave të përbashkëta në fushën e rendit dhe të sigurisë, i cili aktualisht është inekzistent në nivelin e planifikimit strategjik.

Aktualisht interesi dhe gatishmëria e qytetarëve për bashkëpunim me policinë rezulton në nivele të larta dhe të kënaqshme, nga ana tjetër shkalla e përfshirjes së qytetarëve në çështjet e policimit mbetet e tepër e ulët. Ky është një defekt serioz që duhet ndryshuar sa më shpejt.

Ka ardhur koha që për policimin në komunitet nga ana e Policisë së Shtetit dhe nga gjithë komisaritet të hartohen strategji dhe plane afatgjata duke përfshirë në to forma dhe programe sa më të larmishme të bashkëpunimit, sidomos në aspektin e nxitjes së vullnetarizmit të publikut për të ndihmuar policinë.

Në hartimin e strategjive të suksesshme i rëndësishëm është identifikimi i shqetësimeve të komunitetit e cila mund të arrihet nëpërmjet organizimit ose pjesëmarrjes së policisë në aktivitetet e komunitetit dhe nga ana tjetër përfshirjen e qytetarëve në aktivitetet e saj, për çështje të ndryshme, të cilat kanë të bëjnë me problemet e sigurisë publike.

Puna me medien dhe transparenca e policisë lidhur me çështjet që shqetësojnë komunitetin është një tjetër problema i cili jo vetëm që nuk duhet neglizhuar, por përkundrazi duhet përdorur gjerësisht dhe me profesionalizëm nga ana e policisë. Nga Akademia e Sigurisë mund të organizohen edhe kurse të përbashkëta të policisë me përfaqësues të OJF-ve, medieve etj, pasi kjo do të çojë në familjarizimin e të dy palëve në lidhje me çështjet e shoqërisë civile.

Përfshirja e qytetarëve në çështjet e rendit dhe të sigurisë është një detyrim ligjor për Policinë e Shtetit prandaj kërkohet një planifikim i studiuar dhe jo spontan. Për më tepër, siç u përmend edhe më lart, Policia e Shtetit ka adoptuar tashmë procedura standarde dhe plane rajonale veprimi të cilat synojnë, midis të tjerash, të bëjnë të mundur përfshirjen reale të qytetarëve në çështjet e ruajtjes së rendit dhe sigurisë.

Ka ardhur koha ashtu sikurse rekomandojnë edhe partnerët tanë që asistojnë PSH, për hartimin e një strategjie kombëtare komunikimi me publikun dhe medien e cila të përpunojë më tej dhe të kodifikojë të gjitha format tradicionale të komunikimit të njëanshëm midis policisë dhe qytetarëve, ashtu sikurse hartimi i programeve të veçanta nga Akademia e Sigurisë, për trajnimin e punonjësve të PSH të cilët do të merren me çështjet e policimit në komunitet.

Literatura

1. Strategjia e Policisë së Shtetit.
2. INLSH (Instituti për Ndryshim dhe Lidhshmëri në Shqipëri), "Policia, rendi, siguria dhe marrëdhëniet me komunitetin - Gjetje dhe rekomandime për politika që përmirësojnë punën e Policisë së Shtetit Shqiptar në lidhje me policimin në komunitet "(studim). Tiranë: Ministria e Punëve të Brendshme, 2014.
3. ISPL (Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore), "Partneritetet në kontekstin e policimit në komunitet", (raport studimor i përgatitur për Programin "Mbështetja e Qeverisë Suedeze ndaj Ministrisë së Brendshme/Policisë së Shtetit Shqiptar për Policimin në Komunitet"). Tiranë: Ministria e Punëve të Brendshme, 2013.
4. COMPOR, Strategjia e Integruar e Komunikimit dhe Plani i Komunikimit për Fushatën sensibilizuese në pesë sektorë të Policisë së Shtetit Shqiptar. Tiranë: Ministria e Punëve të Brendshme, 2014.
5. Torres, S., Vogel, R. (2001). "Pre and post test differences between Vietnamese and Latino residents involved in a community policing experiment - Reducing fear of crime and improving attitudes towards the police", in: *Policing: An International Journal of Police Strategies & Management*, Vol. 24 Iss: 1, pp.40 - 55.
6. Chrislip, D., Larson, C., (1994). *Collaborative Leadership: How Citizens and Civic Leaders Can Make a Difference*. Jossey-Bass; 1st edition, pp.15-23.

Çështja shqiptare dhe kompleksi ballkanik i sigurisë



■ **Dr. Xhavit SHALA**

Drejtori i Qendrës Kërkimore Shkencore, Akademia e Sigurisë

Abstrakt

Objekti i studimit dhe hulumtimit në këtë punim është çështja shqiptare dhe kompleksi ballkanik i sigurisë. Studimi dhe hulumtimi i ndikimi të çështjes shqiptare në kompleksin ballkanik të sigurisë paraqet interes në planin kombëtar dhe rajonal. Ky punim ka për qëllim që të provojë lidhjen e ndërsjellët mes shkallës së zgjidhjes së çështjes shqiptare me sigurinë rajonale. Për të provuar këtë lidhje, do të përdorim ndërmjet të tjerave teorinë dhe analizën e kompleksit rajonal të sigurisë të Shkollës së Kopenhagës. Në përfundim të punimit konkludohet se çështja shqiptare në rajon dhe shkalla e zgjidhjes së saj ka ndikuar në vazhdimësi dhe vazhdon të ndikojë në sigurinë rajonale e me gjerë.

Fjalëkyçe:

Siguria, Ballkani, Çështja shqiptare, Perandoria Osmane, siguria rajonale, kompleksi i sigurisë

Hyrje

Ballkani ka qenë dhe mbetet një rajon jo vetëm në aspektin gjeografik. Popujt e këtij rajoni, përveç afërsisë gjeografike, i kanë bashkuar shqetësimet e përbashkëta në fushën e sigurisë. Gjatë historisë ata shpesh janë përbashkuar me të njëjtin pushtues dhe kanë përjetuar të njëjtat rreziqe në fushën e sigurisë. Për këtë ata shpesh ata janë rreshtuar nëpër aleanca dhe kanë bashkëpunuar mes veti për t'i bërë ballë kërcënimeve të njëjta në fushën e sigurisë. Të tilla janë koalicioni i krishterë i princave ballkanas në betejën e Fushë Kosovës në vitin 1389,¹ dhe shekuj më vonë aleancat që çuan në Luftën e I Ballkanike,² pjesëmarrja në koalicionin antifashist

Shala, Xh.
« Çështja shqiptare dhe kompleksi ballkanik i sigurisë »

Policimi dhe Siguria nr.1, 2015

¹ Beteja e Fushë-Kosovës e 15 qershorit 1389 u zhvillua midis koalicionit të krishterë të princave ballkanas dhe ushtrisë osmane.

² Traktati i Miqësisë dhe i Aleancës ndërmjet Bullgarisë dhe Serbisë, 13 Mars 1912; Traktati i Aleancës Ndërmjet Bullgarisë dhe Greqisë, 29 Maj 1912.

gjatë Luftës II Botërore apo dhe pjesëmarrja sot në NATO e pjesës më të madhe të shteteve ballkanike si dhe rruga e përbashkët e tyre drejt Bashkimit Evropian. Pra, marrëdhëniet dhe bashkëveprimi mes tyre, përveç afërsisë geografike, ka qenë i përcaktuar edhe nga perceptime e shqetësime të përbashkëta në fushën e sigurisë, ndonëse shpesh në raporte armiqësie, duke krijuar kështu “një grup aktorësh në nivel më të lartë se kombëtar, por më i ulët se ai i global”.³

Berri Buzan, një nga themeluesit e Shkollës së Kopenhagës, e shpjegon sigurinë si një çështje që vjen nga ndërveprimet midis kombeve.⁴

Ndërsa kompleksin rajonal të sigurisë si një grup të kombeve që nuk mund të ndahet, sepse siguria dhe shqetësimet e tyre janë të përbashkëta.⁵ Sipas tij, këto kombe mund të ishin në marrëdhënie miqësore, por dhe kundërshtuese dhe të ballafaquara me kërcënime për njëri-tjetrin, siç është rajoni i Ballkanit, i cili përbën një kompleks rajonal sigurie më vete, me të katër elementët e tij strukturor: kufijtë, strukturën anarkike, polaritetin si dhe ndërtimin social.

Nga Kongresi i Vjenës i vitit 1815, Fuqitë e Mëdha të kohës, pas marrëveshjes për të respektuar reciprokisht interesat dhe ekuilibrin e forcave, arritën të mënjanonin luftërat e përgjithshme dhe të ruajnë paqen dhe sigurinë e përgjithshme në Evropë për gati 100 vjet. Por, nëse patën sukses në nivel të përgjithshëm, Fuqitë e Mëdha dështuan në arritjen e paqes dhe sigurisë në Ballkan, në nivel rajonal. Kjo sepse, vetë Fuqitë e Mëdha, por edhe aktorë të tjerë shtetërorë ballkanikë, nuk i vlerësuan marrëdhëniet midis kombeve si dhe fqinjësinë e mirë mes tyre, përfshirjen e të gjithë aktorëve në vendosjen e ekuilibrit të fuqisë si dhe shpërndarjen e drejtë të kësaj fuqie në nivel rajonal si përcaktuese për paqen dhe sigurinë në rajon.

Në llogaritjen, vendosjen e ekuilibrit dhe shpërndarjen e fuqisë në Ballkan, aktorët rajonalë dhe ndërkombëtarë që në fillim përjashtuan faktorin shqiptar dhe interesat e tyre kombëtare. Kjo u bë sidomos nga Konferenca e Ambasadorëve të Londrës në vitet 1912-1913, gjatë procesit të konfigurimit të ekuilibrave rajonalë pas përmbysjes së Perandorisë Osmane. Mos zgjidhja në kohë e çështjes shqiptare dhe përjashtimi i tyre gjatë procesit të konfigurimit të ekuilibrave rajonalë ka bërë që ekuilibrat e vendosura në rajon të ishin të brishta dhe siguria e kërcënuar.

Në këtë punim, për të provuar lidhjen e ndërsjellë mes shkallës së zgjidhjes së çështjes shqiptare (siç e përcaktoi Konferenca e Ambasadorëve në Londër) me sigurinë rajonale, përveç teorisë së ekuilibrit të fuqisë, do të përdorim dhe teorinë e kompleksit rajonal të sigurisë të Shkollës së Kopenhagës. Analiza e kompleksit rajonal të sigurisë na jep çelësin për shpjegimin e çështjeve të sigurisë në rajonin e Ballkanit dhe të raporteve të ndërsjella të çështjes shqiptare me të. Kjo analizë, sipas B. Buzan dhe O. Wæver⁶ përfshin katër nivelet (elementet konstitutiv) të lidhur mes tyre. Në kontekstin ballkanik këto janë: rendi, stabiliteti dhe siguria e brendshme e shteteve ballkanike (niveli brenda shtetit); marrëdhëniet midis shteteve të rajonit të Ballkanit (niveli rajonal); bashkëveprimi e rajonit të Ballkanit me rajonet fqinje (niveli ndër rajonal) si dhe roli i fuqive botërore në rajon (niveli global) të cilat, të ndërlidhura së bashku, përbëjnë kostelacionin ballkanik të sigurisë

Shala, Xh.
« Çështja shqiptare dhe kompleksi ballkanik i sigurisë »

³ Sugio Takahashi: “Redefinition of Cooperative Security and Regional Security...”. Po aty.

⁴ Barry Buzan, People, States and Fear, second edition (Colorado: Lynne Rinner Publishers, 1991), pp. 187.

⁵ Po aty, faqe 190.

⁶ Barry Buzan and Ole Wæver: “Regions and Powers, The Structure of International Security”. P.52-53. Burim i cituar.

Politicimi dhe Siguria nr.1, 2015

(modelin e formuar nga bashkëveprimi i katër elementeve konstitutiv).

Nga ana tjetër katër elementet konstitutivë (katër nivelet) e një kompleksi rajonal sigurie përcaktojnë strukturën thelbësore të atij kompleksi. Kjo strukturë thelbësore përbëhet nga katër variabël të cilat janë: kufijtë e kompleksit, struktura anarkike, polariteti dhe ndërtimi social.⁷ Ndërveprimi mes katër niveleve (elementeve konstitutiv) të kompleksit rajonal të sigurisë përcaktojnë ndryshimet në strukturën thelbësore të kompleksit. Dhe ndryshimet në strukturën thelbësore i krijojnë kompleksit rajonal tre mundësi zhvillimi. Këto janë, së pari: ruajtja e *status quo*-së, që do të thotë se nuk ka ndryshime të rëndësishëm në strukturën e tij thelbësore; së dyti janë transformimet e brendshme të rajonit, që do të thotë ndryshime në strukturën anarkike, të polaritetit, (për shkak të shpërbërjes, bashkimit, pushtimit, niveleve të ndryshme të zhvillimit), ose për shkak të ndryshimeve në modelin dominues e miqësi/armiqësi, (për shkak të ndryshimeve ideologjike, të ndryshimeve të lidhshpimit) si dhe së treti transformime të jashtme, që ndodhin kur kufijtë e kompleksit rajonal të sigurisë ndryshojnë⁸ nga kurrje ose zgjerimi.

Pavarësisht se siguria është një konstruktion shoqëror që merr një kuptim të caktuar brenda një konteksti të caktuar shoqëror, teoria e Buzanit për sigurinë dhe kompleksin rajonal të sigurisë mund të përdoret me sukses për të shpjeguar zhvillimet në Ballkan në këto njëqind vitet e fundit dhe sidomos lidhjen e ndërsjellët mes shkallës së zgjidhjes së çështjes shqiptare me sigurinë rajonale.

Për këtë le ta studiojmë dhe analizojmë fillimisht lidhjen e ndërsjellë mes shkallës së zgjidhjes së çështjes shqiptare me katër nivelet (elementet konstitutivë) të kompleksit ballkanik të sigurisë.

1. Ndikimi i çështjes shqiptare në rendin, stabilitetin e sigurinë në nivel shtetëror të aktorëve rajonalë

Kongresi i Berlinit, që u mbledh për të revizionuar vendimet e Shën Stefanit e la gjeohapësirën shqiptare të ndarë mes katër shteteve pushtuese: Turqisë, Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë. Shqiptarët vazhduan luftën për të siguruar të drejtat e tyre kombëtare duke tronditur kështu në vazhdimësi sigurinë e këtyre shteteve.

Elita politike shqiptare, që në fillimet e çështjes shqiptare dhe në vazhdimësi, e ka parë paqen dhe sigurinë në rajon si një çështje që vjen nga ndërveprimet midis kombeve që jetojnë aty, ndryshe nga elitat e vendeve fqinjë, të cilat synonin vetëm zgjerimin e territoreve të tyre, kryesisht në drejtim të gjeohapësirës shqiptare. Por, fqinjët nënvleftësonin faktin se bashkë me pjesë të gjeohapësirës shqiptare po i shtonin vendit të tyre, por edhe rajonit, një kërcënim permanent për sigurinë, stabilitetin dhe paqen. Pa një zgjidhje të drejtë të çështjes shqiptare as këto vende që po rrëmbenin pjesë të gjeohapësirës shqiptare, por as dhe rajoni nuk do të kishin më paqe dhe siguri.

1.1. Çështja shqiptare dhe siguria e Perandorisë Osmane

Moszgjidhja e çështjes shqiptare ka pasur ndikim vendimtar në çështje të sigurisë

⁷ Michaela Cruden, *Regional Security Complex Theory: Southeast Asia and the South Pacific*, The University of Waikato, p.15, 2011.

⁸ Barry Buzan and Ole Wæver, *op. cit.*, faqe 381.

dhe ka minuar vetë Perandorinë Osmane. Kjo ishte paralajmëruar më herët nga shkrintari dhe studiuesi i njohur Ami Boue, i cili pasi u kthye nga udhëtimet që bëri në vitet 1836-1838 në territoret shqiptare dhe territoret e tjera evropiane të Perandorisë Osmane, paralajmëroi se “mund të jemi të sigurt se sapo të kërcasë një zjarr në perandorinë turke, shqiptarët do të revoltohen dhe mund të para vështrihen ndryshime të mëdha... Shqipëria mund të formojë fort mirë një shtet të pavarur ndërmjet Serbisë dhe Greqisë”.⁹ Ndikimi i çështjes shqiptare në sigurinë e Perandorisë Osmane u bë më evident jo vetëm pas krijimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit por edhe në rezistencën antiosmane në vitet 1901-1908, në lëvizjen xhonturke,¹⁰ e deri në shpërbërjen e asaj perandorie. Kryengritjet shqiptare në planin e brendshëm, dobësuan pozitën e Turqisë në Ballkan, ndikuan në ndryshimin e raportit të forcave në rajon dhe e bënë Perandorinë Osmane një target të lehtë përballë aleancës së shteteve ballkanike, duke ndikuar kështu në zhvillimet në vijim në kompleksin rajonal të sigurisë së Ballkanit.

1.2. Çështja shqiptare dhe siguria e Serbisë

Konferenca e Ambasadorëve të Londrës lejoi përfshirjen brenda kufijve të Serbisë pjesë të gjeohapësirës shqiptare nga Shqipëria e Veriut, gjithë Kosovën si dhe pjesë të Shqipërisë Lindore. Këto u legalizuan përfundimisht në Konferencën e Versajës, në Memorandumin e 9 Dhjetorit 1919 të Fuqive të Mëdha¹¹. Serbia dhe Fuqitë e Mëdha nuk vlerësuan paralajmërimet e shqiptarëve¹² se, pa zgjidhjen e drejtë të çështjes së tyre, paqja dhe siguria në rajon do të ishin në vazhdimësi të kërcënuara. Kështu, bashkë me pjesën e gjeohapësirës shqiptare që përfitoi, Serbia “importoi” dhe një kërcënim ekzistencial për sigurinë e vet. Jo më kot kryeministrin serb Nikolla Pashiq e vlerësonte Shqipërinë si “Thembra e Akilit e Serbisë”, domethënë krahu i dobët i Serbisë, mjaft i rrezikshëm për sigurinë e saj,¹³ prandaj ata e kanë mbajtur në vazhdimësi të sigurizuar Shqipërinë. Në strategjinë e saj, pas sigurizimit të këtij kërcënimi dhe për ta minimizuar sa të jetë e mundur më shumë atë, Serbia taktikisht planifikoi dhe investoi në tre drejtime kryesore. E para të gjente një pretekst dhe të realizonte pushtimin e Shqipërisë. Për këtë ajo e dinte se do të kishte një reagim të fuqishëm ndërkombëtar. Nëse dështonte varianti i pare, do të kalonte në variantin e dytë, duke punuar për të realizuar një bashkim të butë të Shqipërisë me Serbinë. Paralelisht do të punohej edhe për një variant të tretë, duke investuar për të mbajtur në vazhdimësi një Shqipëri të dobët që të mos kishte mundësi të ngrinte zërin për çështjen shqiptare në Serbi.

Le të shqyrtojmë një nga një këto variante. Pas Konferencës së Londrës, në

⁹ “La Turquie d’Europe”. Vëllimi IV. Paris 1840. Marrë citimi nga Lumo Skëndo “Udhëtarët e huaj në Shqipëri gjer në fund të Shekullit XIX” Faqe 134-135. Tiranë 2012.

¹⁰ Prof. Dr. Zekeria Cana: Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kosovë 1908- 1912. Faqe 259. Botuar “8 Nëntori” Tiranë 1982.

¹¹ Pika Nr.2 e Promemorjes së Qeverivë të SHBA, Britanisë së madhe dhe Francës mbi Çështjen Shqiptare. Pjesë e Memorandumit Anglo-Franko-amerikan lidhur me Çështjen e Adriatikut. Adriaticus, “La Question Adriatique Receuil de documents officiels”. Paris, 1920, f.57-58,65-67. Përkthyer në shqip në “Lufta e popullit shqiptar për çlirimin kombëtar” Vëllimi I. F.490-492. Tiranë 1975.

¹² Memorandum i Delegacionit të Qeverisë së Përkohshme të Durrësit, paraqitur në Konferencën e Paqes. Paris 12 Shkurt 1919. Burim i cituar.

¹³ Për më tepër shih: Vështrim i shkurtër mbi politikën që Nikolla Pashiq ka zhvilluar ndaj Shqipërisë, si kryeministër i qeverisë së Serbisë dhe Ministër i Punëve të Jashtme në fillim të shekullit XX. Sreten Draskic “Evropa dhe Çështja Shqiptare (1830-1921)”. Beograd 2000.

fillim të tetorit 1913, me pretekstin e sulmit kundër kryengritësve shqiptarë, ushtria serbe hyri në territorin shqiptar duke dalë përsëri në bregdet në Durrës. Austro-Hungaria i kërkoi në mënyrë ultimative largimin e trupave serbe përndryshe “qeveria perandorake dhe mbretërore, ... do ta shihte veten të detyruar që të përdorte mjetet e nevojshme për të siguruar plotësimin e kërkesës së saj”¹⁴ Pas këtij kërcënimi Serbia tërhoqi trupat e saj nga Shqipëria. Pra përplasja për çështjen shqiptare po rrezikonte sigurinë e Serbisë me një sulm të mundshëm nga Austro-Hungaria. Kjo rrezikonte të destabilizonte më tepër kompleksin ballkanik të sigurisë.

Pasi dështuan në variantin e pushtimit të përhershëm të Shqipërisë, serbët kaluan në opsionin e dytë, mundësinë për bashkimin e butë me Shqipërinë. Për ta arritur këtë, fillimisht Serbisë i duhej të poziciononte njeriun e saj në krye të pushtetit në Shqipëri. Dhe ky personi i zgjedhur prej saj ishte Esat Toptani. Kështu ushtria serbe pushtoi dy herë Shqipërinë vetëm për të mbështetur Esat Toptanin, në tetor të vitit 1914 për të mbështetur ardhjen e tij në pushtet dhe në qershor 1915 për ta shpëtuar Esatin nga kryengritësit e Haxhi Qamilit. Me Esatin serbët nënshkruan dy marrëveshje të cilat po të zbatoheshin, e bënin Shqipërinë pjesë të Serbisë.¹⁵ Por as Esati, as Zogu i cili nuk i qëndroi marrëveshjes dhe angazhimeve që kishte marrë në Beograd për “lidhje të privileguara me Jugosllavinë”,¹⁶ as përpjekjet e Titos gjatë periudhës së komunizmit për trajtimin e çështjes kombëtare në Kosovë edhe Maqedoni sipas këtij stili komunist¹⁷ dhe as spastrimi i hapur etnik i shqiptarëve nga Milosheviçi nuk ja eliminuan dot kërcënimin që përbënte për sigurinë e Serbisë çështja e pa zgjidhur shqiptare.

Në të vërtetë kriza e federatës jugosllave në fund të viteve ‘80 dhe në fillim të viteve 90, ka qenë fokusuar në çështjen e Kosovës. Bile në opinionin kosovar dhe në analizat e kohës “pritej që lufta në Jugosllavi do të fillonte në Kosovë”¹⁸. Vetë autorë serbë janë të bindur se “Jugosllavia në të vërtetë është shkatërruar në Kosovë”¹⁹. Bashkë me territoret shqiptare që përfitoi nga Konferenca e Ambasadorëve të vitit 1912-1913, Serbia “importoi” dhe një kërcënim të përhershëm për sigurinë e vet.

1.3. Çështja shqiptare dhe siguria e Greqisë

Çështjen shqiptare në Greqi, të njohur dhe si çështja çame, zyrtarisht e krijoi Konferenca e Londrës të vitit 1913. Në datat 1 dhe 11 Gusht 1913, Konferenca vendosi që në jug kufiri të përfshinte Korçën brenda Shqipërisë dhe të dilte në bregdet në Kepin e Stillos²⁰. Para mbylljes së saj më 12 Gusht 1913, Konferenca ngriti dhe komisionin për caktimin në terren të kufirit me Greqinë. Mbetja e

¹⁴ Documents Diplomatiques Francais, 3 eme serie, t. VIII, D.Nr.341, pp.429-431.

¹⁵ Për më tepër shih: Dispozita kryesore të Marrëveshjes së Nishit mes Esat Pashës e Nikolla Pashiqit, më 4 shtator 1914 si dhe Protokollin e Tiranës, datë 28 qershorit 1915, mes Ljube Jovanoviqit e Esat Pashës. Sreten Draskic, burim i cituar, faqe 257-259 dhe 266-270.

¹⁵ DDI, VII serie, vol VII, p.223. Cituar nga Prof. Dr. Arben Puto. Po aty faqe 380.

¹⁶ Viktor Meier: “Yugoslavia A History of its Demise”, Published in the Taylor & Francis e-Library, 2005. p.181.

¹⁷ The Kosovo Report, p.42-43.

¹⁸ Vesna Pestic, “Rat za nacionalne drzave”, in Srpska strana rata: trauma i katarza u istorijskom pamcenju / edited by N. Popov, Beograd 1996. f.35.

¹⁹ Procesverbal mbi kufirin jugor të Shqipërisë dhe çështjen e ishujve. Londër 1 Gusht 1913. Botuar i përkthyer nga Prof. Dr. Arben Puto: “Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit” Vëllimi II. Dok. Nr.40, f. 282.

Çamërisë brenda kufijve të shtetit grek u konfirmua dhe legalizua përfundimisht edhe nga Konferenca e Paqes e Parisit e vitit 1919. Çështja shqiptare në Greqi, është pjesë e rëndësishme e çështjes shqiptare në rajon, e cila nuk ka gjetur akoma zgjidhje. Si e tillë ajo ka qenë në vazhdimësi e sigurizuar nga shqiptarët. Historikisht, deri në një zgjidhje optimale të saj, kjo çështje do të vazhdojë të ndikojë në çështjet e sigurisë së shtetit helen dhe do të mbahet e sigurizuar prej tyre.

Në zbatim të “Megali Idheas”, programit të tyre politik ekspansionist, shteti grek, që në Kongresin e Berlinit ishte përpjekur që të përfitonte sa më shumë nga territoret shqiptare në kufijtë e tij veriorë. Këtë tendencë të shtetit helen për të përfshirë sa më shumë territore shqiptare nga Kongresi i Berlinit, Fuqitë e Mëdha po e shihnin si një investim të keq që Greqia po bënte kundër sigurisë së vet. I pari që e shfaqti hapur këtë shqetësim ishte Princi Bismark i Gjermanisë. Ne mendojmë, shprehej ai se “ruajtja e paqes dhe e ardhmja e Greqisë do të përfitonin në rast se Greqia do të përfshinte në gjirin e saj sa më pak elementë shqiptarë që të jetë e mundur. Greqia nuk do të ishte në gjendje as t’i sundonte e as t’i asimilonte këta elementë. Qetësia e saj do të kërcënohej në qoftë se aneksonte një pjesë të madhe të kësaj race/kombësie luftarake dhe pak të nënshtrueshme”²¹. Bile Bismarku propozonte që në vend të territoreve shqiptare, grekeve t’i jepej ishulli i Kretës. “Ishulli i Kretës ... ka jo vetëm një sipërfaqe pothuajse të barabartë me pjesën shqiptare të Epirit, por si për nga popullsia me shumicë dërmuese greke, ashtu edhe për nga pozita gjeografike, ai paraqet përfitime thelbësore sa që nuk mund të krahasohen kurrsesi me Shqipërinë”²².

Shteti grek e vlerësonte si kërcënim për sigurinë e tij faktin që tokat pranë kufirit më Shqipërinë nuk ishin greke. Për këtë ata duheshin bërë greke me të gjitha format dhe mundësitë. Që nga kjo kohë, qeveritë greke ndërhyjnë dhunshëm në këtë pjesë të hapësirës gjeopolitike shqiptare dhe nëpërmjet spastrimit etnik të shqiptarëve, kryesisht të besimit mysliman²³, arritën ndryshimin e raporteve demografike.²⁴

Ndonëse qeveria greke nuk e pranonte ekzistencën e çështjes çame,²⁵ krizat e shpeshta në marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Greqisë janë nxitur jo rrallë nga moszgjidhja e problemit të pronave të komunitetit çam, larguar si pasojë e spastrimit etnik grek. Pas përmbysjes së komunizmit çështja çame ka përjetuar një ringjallje të menjëhershme. Çështja çame përbën sfidën e radhës së çështjes shqiptare dhe “ka gjasa që të ndiqet me energji nga çamët dhe përkrahësit e tyre të shumtë nga i gjithë spektri politik shqiptar”²⁶.

Ky rigjallërim i çështjes çame dhe përfshirja e saj në axhendat politike në Shqipëri dhe Buksel është perceptuar nga ana e Greqisë si një kërcënim për sigurinë e saj dhe se “Greqia ndjeu një kërcënim të mundshëm nga kufijtë e saj veriore, në

²¹ Shtojcë e letrës së departamentit datë 18 shkurt 1881. Legatës së Francës në Athinë. Paris 11 Shkurt 1881. Botuar në dokumentin Nr. 227 të librit “Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit” Pjesa II. Faqe 436-438. Botim i Institutit të Historisë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Tiranë 1986.

²² Po aty.

²³ Dr. Lambros Baltsiotis: The Muslim Chams of Northwestern Greece. European Journal of Turkish Studies, 12 | 2011, p.7.

²⁴ Raport i ICG-së për Evropë N° 153, 25 Shkurt, 2004. Faqe 27.

²⁵ Athinë - “Çështja çame nuk ekziston”. Shekulli 28/06/2006

²⁶ International Crisis Group: “Albania, State of the Nation”. Europe Report nr. 871. Tirana/ London/ Brussels, 1 March 2000.

krahasim me kërcënimin tradicional nga ana e Turqisë në lindje”.²⁷ Sa më sipër konkludojmë se çështja çame, si pjesë e rëndësishme e çështjes shqiptare, e ngjizur nga Konferenca e Ambasadorëve të Londrës, do të vazhdojë të ndikojë në çështjet e sigurisë së shtetit helen deri në një zgjidhje optimale të saj. Është në interes të Greqisë dhe sigurisë së saj njohja dhe pranimi i çështjes çame “para se kjo çështje të ketë marrë hov dhe ... kur ankesat legjitime të çamëve do shndërroheshin në çështje më të thella kombëtare.”²⁸

1.4. Çështja shqiptare dhe siguria e Malit të Zi

Çështja shqiptare në Malin e Zi është pjesë e rëndësishme e çështjes shqiptare në rajon dhe në vazhdimësi ka ndikuar në çështjet e sigurisë së Malit të Zi. Konferenca e Ambasadorëve të Londrës në vitin 1913 i dha Malit të Zi edhe Hotin e Grudën dhe Plavën e Gucinë,²⁹ pjesë të hapësirës gjeopolitike shqiptare. Konferenca e Paqes e Parisit e vitit 1919, i dha përfundimisht “tapinë” e këtyre territoreve Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene, në të cilën ishte shkruar Mali Zi.

Mbreti Nikolla i Malit të Zi e lidhi vetë vazhdimësinë e kurorës dhe qeverisjes së tij me çështjen shqiptare. Ai kishte planifikuar që Shkodrën ta bënte si kryeqytetin e Malit të Zi³⁰ dhe betejën për Shkodrën e mori si sfidë personale. Ai mendonte se dështimi në marrjen e saj rrezikonte vetë dinastinë malazeze dhe kishte deklaruar mundësinë se, nëse nuk pushtonte Shkodrën, do të tërhiqej dhe do të ikte në Amerikë³¹. Në rrethimin e Shkodrës Mali i Zi vetëm në sulmet e datave 25, 26 dhe 27 janar 1913 la rreth pesëmijë të vrarë dhe të plagosur, ose 40% e të gjithë trupave të tyre. Lufta për Shkodrën ishte një humbje e madhe materiale e njerëzore, me ndikime në sigurinë e mbretërisë së vogël malazeze. Por atë që nuk e arritën me luftë, malazetët e arritën në bisedime me Esat Pashën, i cili më 9 prill 1913, nënshkroi marrëveshjen për dorëzimin e Shkodrës princit Danilo të Malit të Zi.

Synimi për të mbajtur me çdo kusht Shkodrën, edhe pas vendimit që mori Konferenca e Ambasadorëve për ta lënë atë brenda kufijve të shtetit shqiptar, rrezikoi seriozisht vetë sigurinë e shtetit malazez. Duke mbajtur Shkodrën, Mali Zi ishte futur në zonën e interesave italiane e austro-hungareze, çka rrezikonte dhe një reagim të armatosur nga ana e tyre.

Edhe pas përmbyesjes së komunizmit udhëheqësit e shqiptarëve në Malin e Zi asnjëherë nuk e sfiduan ekzistencën e shtetit të Malit të Zi me kërkesa të shprehura për ndarje³². Shqiptarët kanë luajtur një rol të rëndësishëm në pavarësimin e Malit të Zi në vitin 2006. Në konsultim dhe me Tiranën zyrtare³³, në referendumin e vitit 2006, shqiptarët morën pjesë masivisht në votime dhe mbështetën pavarësinë e Malit të Zi nga Unioni Serbi-Mali Zi³⁴. Ky ishte një investim i rëndësishëm i

²⁷ Miranda Vickers: The Cham Issue – Where to Now? p.8, Published By: Defence Academy of the United Kingdom, Conflict Studies Research Centre, London 2007.

²⁸ Raport i ICG-së për Evropën N° 153, 25 Shkurt, 2004. Faqe 4Po aty.

²⁹ Raport i Pol Kambonit, datë 14 Prill 1913 “ Mbi përcaktimin e kufijve të Shqipërisë në Veri dhe Verilindje”, Documents Diplomatiques, 3-eme serie, t. VI, D.Nr. 301,pp347-358. Botuar e përkthyer ne shqip në “Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare” Dok. Nr. 19. Vëllimi II. Faqe 243-244.

³⁰ Sreten Draskic, Faqe 182.Burim i cituar.

³¹ Po aty.

³² Keneth Morrison: “ Montenegro, A Modern History”,P.126.Burim i cituar.

³³ Berisha mbështet pavarësinë e Malit të Zi. Takimi Ferhat Dinosa Sali Berisha, 5 Prill 2006. Lajmet.com,06.04.2006.

³⁴ Emri e ri "Unioni Serbi-Mali Zi" u miratuan zyrtarisht më 4 shkurt, 2003. Shih Michael A. Schuman: "Nations in Transition: Serbia and Montenegro", p.75.

shqiptarëve në krijimin dhe sigurinë e shtetit të pavarur të Malit të Zi. Pavarësisht se nuk kanë kërkuar ndarjen e Malit të Zi, shqiptarët nuk i kanë ndërprerë asnjëherë përpjekjet për t'i dhënë një zgjidhje të pranueshme çështjes së tyre kombëtare në Malin e Zi.

Mosplotësimi dhe injorimi i kërkesave të shqiptarëve etnikë në Malin e Zi, mund të radikalizojë pozicionin e tyre, mund t'i krijojë probleme republikës së vogël malazeze lidhur me çështjet e sigurisë dhe mund të implikojë në këtë çështje edhe Shqipërinë, Kosovën e Maqedoninë, me pasoja kjo edhe për paqen dhe sigurinë në kompleksin ballkanik të sigurisë. Si më sipër konkludojmë se çështja e pa zgjidhur shqiptare ka ndikuar negativisht në rendin, stabilitetin dhe sigurinë e shteteve fqinjë të cilëve Konferenca e Ambasadorëve të Londrës ju dha pjesë nga gjeohapsira shqiptare, duke krijuar kështu probleme jo vetëm për sigurinë e këtyre shteteve, por edhe me gjërë për kompleksin ballkanik të sigurisë.

2. Marrëdhëniet mes shteteve në rajon, çështja shqiptare dhe kompleksi rajonal i sigurisë

Le të studiojmë dhe analizojmë tani, për të njëjtën periudhë kohore, ndikimin e marrëdhënieve midis shteteve në Ballkan në kompleksin rajonal të sigurisë si dhe lidhjen e ndërsjellë të tyre me çështjen shqiptare në rajon.

Greqia, Serbia, Mali i Zi dhe Bullgaria, secila më vete, por edhe së bashku, të suportuara edhe nga Rusia, janë përpjekur që të përfitojnë sa më shumë nga territoret osmane. Por një pjesë e territoreve osmane në Ballkan dhe konkretisht Vilajetet e Shkodrës, Shkupit, Manastirit dhe Janinës, ishin pjesë e gjeohapësirës shqiptare. Në këtë mënyrë synimet dhe veprimet e tyre për t'u zgjeruar në territoret osmane ishin në të vërtetë synime dhe veprime kundër interesave dhe çështjes shqiptare në rajon. Prandaj raportet armiqsore të këtyre shteteve me Perandorinë Osmane, mos pranimit prej tyre të shqiptarëve si aleat të barabartë në aleancën ballkanike antiosmane, mbajtja e raporteve armiqsore dhe përjashtimi i shqiptarëve si dhe interesave të tyre kombëtare nga ekuilibrat e projektuar rajonale, do të mbanin për shumë kohë Ballkanin në gjendje lufte më një kompleks rajonal sigurie të mbizotëruar më tepër nga modeli social i armiqësisë midis kombeve.

Në prag të shpërbërjes së Perandorisë Osmane shtet ballkanike kishin nënshkruar mes tyre një seri marrëveshesh e traktatesh dy paleshe. I tillë ishte traktati mes Serbisë e Bullgarisë në Mars 1912,³⁵ mes Bullgarisë dhe Greqisë më 29 Maj 1912,³⁶ marrëveshja mes Bullgarisë, Serbisë dhe Malit të Zi në Gusht 1912 si marrëveshja mes Greqisë dhe Serbisë më 19 Maj 1913. Serbia, Bullgaria, Greqia si dhe Mali i Zi, nënshkruajnë mes tyre aleanca jo për paqe, por për luftë në Ballkan, jo për mbrojtje, por për të pushtuar territore, duke përfshirë dhe ato shqiptare, duke kërcënuar kështu paqen dhe sigurinë në kompleksin ballkanik.

Pas kësaj, në tetor 1912, shtetet ballkanike, pasi përmbyllën përgatitjet ushtarake, njëri pas tjetrit i shpallën luftë Turqisë, filluan operacionet ushtarake

Shala, Xh.
« Çështja shqiptare dhe kompleksi ballkanik i sigurisë »

³⁵ Traktati i Miqësisë dhe Aleancës ndërmjet Bullgarisë dhe Serbisë. Nënshkruar në Sofje më 13 Mars 1912. Përkthyer në shqip nga Prof. Dr. Arben Puto në "Çështja Shqiptare në aktet ndërkombëtare ..." Vëllimi I, faqe 370-376. Dokumenti Nr. 48.

³⁶ Traktati i Aleancës mes Bullgarisë dhe Greqisë si dhe dhe Konventa Ushtarake në zbatim të Traktatit

kundër saj dhe pushtuan pjesën më të madhe të gjeohapësirës shqiptare në Ballkan. Për këtë Fuqitë e Mëdha organizuan Konferencën e Ambasadorëve në Londër. Përfitimi prej fqinjëve ballkanikë më shumë se gjysmës së gjeohapësirës shqiptare do të bënte që, edhe në të ardhmen, në kompleksin ballkanik të sigurisë të mbizotëronte modeli social i armiqësisë midis kombeve.

Fuqitë e Mëdha, pothuajse për më shumë se një shekull, kishin vlerësuar si burim për sigurinë e Ballkanit vetëm ekuilibrin mes Fuqive të Mëdha dhe nuk ishin të interesuara për një klimë besimi reciprok në rajon. Gjithashtu shtetarët ballkanas, në kulturën e tyre strategjike, e kuptonin sigurinë si një aleancë më njëjërën nga Fuqitë e Mëdha të kohës. Për ta ishte më mirë të sigurosh përkrahjen e një shteti të fuqishëm se sa të shkosh mirë me fqinjët. Politikat qeverisëse të mbështetura në përfundime të tilla, për shumë kohë do të ushqenin armiqësinë në marrëdhëniet mes shteteve në rajon, do të minonin bashkëpunimin rajonal dhe do të prodhonin pasiguri të vazhdueshme për paqen në Ballkan. Të dy palët, Fuqitë e Mëdha dhe ato rajonale, në vazhdimësi kishin injoruar peshën që luan në sigurinë rajonale bashkëpunimi dhe fqinjësia e mirë mes shteteve të rajonit, kishin injoruar faktin se “siguria është një çështje që vjen nga ndërveprimet midis kombeve”.³⁷

Zgjidhja gjysmake e çështjes shqiptare në vitet 1912-1913, duke lënë më shumë se gjysmën e gjeohapësirës shqiptare së bashku me tre nga katër qendrat e vilajeteve shqiptare jashtë kufijve të shtetit të cunguar shqiptar, ndikoi negativisht në polaritetin e kompleksit ballkanik të sigurisë, në shpërndarjen e padrejtë të fuqisë në disfavor të shqiptarëve, në shkëlqen sistematike deri në ditët e sotme të së drejtave kombëtare të shqiptarëve në rajon, në marrëdhëniet mes vetë shteteve fqinjë, si dhe pengoi zhvillimin dhe prosperitetin e kombit dhe shtetit shqiptar, duke ndikuar kështu negativisht dhe në konstelcionin e sigurisë të kompleksit ballkanik.

3. Bashkëveprimi i Ballkanit me rajonet fqinje, çështja shqiptare dhe kompleksi rajonal i sigurisë

Në kompleksin rajonal të sigurisë, është i rëndësishëm dhe ndërveprimi me rajonet fqinjë³⁸. Historikisht, Ballkani, sidomos ai i Jugut, ka luajtur një rol të madh në zhvillimet evropiane. Nga viti 1700 në vazhdim, Evropa konsolidohet jo vetëm si kompleks rajonal sigurie e cila kishte filluar zgjerimin drejt kompleksit tjetër fqinjë, Ballkanit, por shumë shpejt arriti të bëhet qendra e politikës botërore. Më pas, deri në Konferencën e Ambasadorëve të Londrës dhe shpërbërjen e Perandorisë Osmane në vitin 1913, kompleksi ballkanik sigurizohet dhe mbulohet në aspektet e sigurisë nga fuqitë e kompleksit evropian, por edhe nga Rusia³⁹. Fuqitë evropiane luajtën rol kryesor në ruajtjen e *status quos* së Perandorisë osmane në kompleksin ballkanik, pasi i frikoheshin depërtimit sllav dhe synimeve të Rusisë⁴⁰ për sllavizimin e tij. Në këtë kohë, me pretekstin e vendosjes së paqes mes fuqive,⁴¹ të cilat e kishin sigurizuar Ballkanin, si dhe të aleatëve të tyre të kompleksit

³⁷ Barry Buzan, *People, States and Fear*, second edition (Colorado: Lynne Rinner Publishers, 1991), pp. 187.

³⁸ Barry Buzan and Ole Wæver: “Regions and Powers, The Structure of International Security”. P.50.

³⁹ Për më tepër shih: “Marrëveshja e arritur ndërmjet Austro-Hungarisë dhe Rusisë në lidhje me Ballkanin”, Përkthyer në shqip nga Prof.Dr. Arben Puto në “Çështja Shqiptare në Aktet Ndërkombëtare të Periudhës së Imperializmit”. Vëllimi I.Faqe 322; Marrëveshja e Rakonixhit, nënshkruar më 24 tetor 1909, Viktor Emanueli III, Mbreti i Italisë dhe Nikolaj II, Mbreti i Rusisë.

⁴⁰ Prof.Dr.Arben Puto: “Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit” Vëllimi I.f.12.

⁴¹ Deklaratë e Eduart Grey mbi caktimin e kufijve të Shqipërisë. Botuar e përkthyer në “Çështja Shqiptare në Aktet Ndërkombëtare” V.II. Dokumenti Nr. 44.Faqe 292-293.

ballkanik, u sakrifikua çështja shqiptare në rajon, duke ndikuar kështu negativisht në kompleksin rajonal të sigurisë.

4. Roli i fuqive botërore në rajon, çështja shqiptare dhe kompleksi rajonal i sigurisë

Një nga rastet tipike ku Fuqitë botërore kanë ndërhyrë ose ndikuar së bashku në kompleksin ballkanik të sigurisë me organizimet dhe aktet juridike ndërkombëtare është Konferenca e Londrës, e ambasadorëve të Fuqive të Mëdha e vitit 1912-1913 me vendimet e protokollet e saj⁴². Në prag dhe pas kësaj konferenca një rëndësi të madhe ka luajtur për çështjen shqiptare por edhe për kompleksin ballkanik të sigurisë, bashkëpunimi, rivaliteti dhe më pas armiqësia austro-italiane.

Këto dy Fuqi të e Mëdha të kohës, pavarësisht kundërshtive mes tyre për supremaci në çështjen shqiptare, bënë aleancë mes veti dhe për të larguar Serbinë nga bregdeti Adriatik, mbështetën çështjen shqiptare duke propozuar krijimin e një shteti shqiptar në Ballkan. Propozimi i tyre më 17 dhjetor 1912 u kthye në vendim nga Konferenca e Ambasadorëve të Fuqive të Mëdha të Londrës⁴³. Por kjo konferencë, duke iu dhënë fqinjëve ballkanikë më shumë gjysmën e gjeohapësirës shqiptare gjoja në emër të vendosjes së paqes dhe ekuilibrit në Ballkan,⁴⁴ cenoi rëndë interesat kombëtare të shqiptarëve dhe bëri investimin më të keq ndërkombëtar për paqen në kompleksin ballkanik të sigurisë.

Rreth dy vite më vonë, pasi Austro-Hungaria sulmoi Serbinë, Italia kërkoi kompensim në bazë të nenit 7 të Traktatit të Tretë të Aleancës Trepalëshe ⁴⁵ dhe konkretisht që Austro-Hungaria të ndërpriste interesimin për Shqipërinë. Pasi Austro-Hungaria refuzoi kërkesën e Italisë lidhur me Shqipërinë, qeveria italiane refuzoi pjesëmarrjen e mëtejshme në Aleancën Treshe (Fuqitë Qendrore). Italia krahas bisedimeve me Austro-Hungarinë rreth çështjes shqiptare, kishte zhvilluar bisedime edhe me fuqitë e Marrëveshjes Trefishe (Antanta), rreth kalimit nga Aleanca Treshe në Marrëveshjen Trefishe. Këto bisedime përfunduan me marrëveshjen mjaft të favorshme për Italinë, atë të Londrës të 13 prillit 1915, ku asaj iu pranuan pretendimet për Shqipërinë⁴⁶. Kështu këmbëngulja italiane për të pasur kontrollin mbi territorin dhe bregdetin shqiptar është një nga shkaqet kryesore të largimit të Italisë nga koalicioni me Austro-Hungarinë dhe Gjermaninë.

Por me kalimin e Italisë tek Antanta, u prish ekuilibri i forcave në Evropë mes

⁴² Shih raportin e ambasadorit Pol Kambon, përfaqësues i Francës në konferencë, datë 17.12.1912. Dokuments Diplomatiques Francais, 3-eme serie, te,t. V. D. n°, 78, pp .94-96. Përkthyer në shqip në "Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare ..." V.II, Faqe 187-190. Burim i cituar; Illyrisch-Albanische Forschungen, Ludwig von Thalloozy, II band, Munchen und Leipzig 1916, p.173. Përkthyer në shqip në "Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare" V.II, Faqe 187-190. Dokumenti Nr.38; Si dhe Procesverbali i Konferencës Londrës në vazhdim të vendimit të saj përfundimtar të datës 29 Korrik 1913. Përkthyer në shqip në "Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare..." V.II, Faqe 280-281.

⁴³ Pjesë nga raporti i ambasadorit të Francës, Pol Kambon, datë 17.12.1912. Dokuments Diplomatiques Francais, 3 eme serie, te,t. V. D. n°, 78, pp .94-96. Përkthyer në shqip në "Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare....." V.II, faqe 187-190.

⁴⁴ Deklaratë e Eduart Grey mbi caktimin e kufijve të Shqipërisë. Botuar e përkthyer në "Çështja Shqiptare në Aktet Ndërkombëtare" V.II. Dokumenti Nr. 44. Faqe 292-293.

⁴⁵ Shih neni 7, Trakta i Tretë i Aleancës Tripalëshe ndërmjet Austro-Hungarisë, Gjermanisë dhe Italisë. A.F. Pribram, Les traites politiques secrets de l'Austrie-Hongrie, t. I, Paris 1923, pp.60-62. Përkthyer në shqip në "Çështja Shqiptare në aktet ndërkombëtare ..." Vëllimi I, faqe 307-308. Dokumenti Nr.35.

⁴⁶ Shih Traktati i Fshehtë i midis Fuqive të Antantës dhe Italisë. Londër 26 Prill 1915. Botuar i përkthyer në shqip nga Prof. Dr. Arben Puto në "Çështja Shqiptare në aktet ndërkombëtare ..." Vëllimi II, faqe 634-622. Dokumenti Nr.161.

dy aleancave, përkatësisht Aleancës Treshë (Fuqitë Qendrore) dhe Marrëveshjes Trefishe (Antanta). Kështu u bë një rigrupim i fuqive në Evropë. Marrëveshja Trefishe tashmë u bë Katërfishe dhe peshorja anoi në dobi të fuqive të Antantës, duke i ndryshuar kështu rrjedhat e Luftës I-Botërore. Pra çështja shqiptare ishte njeri ndër faktorët që çoi në thellimin e përplasjes mes dy aleancave më të mëdha të kohës, duke mundësuar kështu daljen e konfliktit të armatosur jashtë kompleksit ballkanik të sigurisë, në kompleksin rajonal të sigurisë fqinjë, në atë të Evropës.

Pas përmbyesjes së komunizmit, kur fuqitë botërore, kryesisht ato perëndimore, filluan të kenë një qasje tjetër për sigurinë në rajon, duke e trajtuar atë si një çështje që vjen nga ndërveprimi mes kombeve, kur Ballkanin filluan të mos e trajtojnë thjesht si një rajon gjeografik që prodhon vazhdimisht pasiguri, por si një grup të kombeve që nuk mund të ndahet për shkak se proceset e sigurizimit dhe desigurizimit i kanë të lidhura mes tyre aq shumë sa problemet e tyre të sigurisë nuk mund t'i zgjidhin veç e veç, kur krijuan bindjen se pa zgjidhjen e çështjeve nacionale dhe të çështjes shqiptare nuk mund të ketë paqe e siguri në Ballkan, vetëm atëherë ndërhyrjet e tyre filluan të ndikojnë pozitivisht në kompleksin ballkanik të sigurisë. Ndikimi dhe mbështetja që fuqitë kryesore botërore i dhanë procesit të zgjidhjes së çështjes shqiptare në rajon, nëpërmjet krijimit dhe njohjes së shtetit të pavarur të Kosovës ka ndikuar pozitivisht në kompleksin ballkanik të sigurisë.

5. Çështja shqiptare dhe transformimet e kompleksit ballkanik të sigurisë

Sikurse e theksuam në fillim të këtij punimi, ndërveprimi mes katër elementet konstitutivë (katër nivelet) e një kompleksi rajonal sigurie përcaktojnë ndryshimet në katër variabëlitet e strukturës thelbësore të atij kompleksi të cilat janë: kufijtë e kompleksit, struktura anarkike, polariteti dhe ndërtimi social.⁴⁷ Dhe ndryshimet në strukturën thelbësore i krijojnë kompleksit rajonal tre mundësi zhvillimi të cilat janë ruajtja e status quo-së, transformimet e brendshme të kompleksit si dhe transformime të jashtme të tij⁴⁸.

Siç provuam më lart, çështja shqiptare ka ndikuar e vazhdon të ndikojë në katër nivelet (elementet konstitutivë) e kompleksit rajonal të sigurisë e, për rrjedhojë, në konstelacionin (modelin) e kompleksit ballkanik e në strukturën thelbësore të këtij kompleksi, duke mundësuar dhe duke i bërë njëkohësisht të domosdoshme transformimet e brendshme të kompleksit ballkanik të sigurisë. Kjo do të thotë se çështja shqiptare në rajon ka ndikuar dhe në ndryshimin e strukturës anarkike, të polaritetit dhe të modelit social dominues miqësi / armiqësi, dhe potencialisht do të vazhdojë të ndikojë deri në një zgjidhje optimale të saj, të pranueshme nga shqiptarët.

Lënia jashtë kufijve të shtetit shqiptar nga Konferenca e Londrës e më shumë se gjysmës së gjeohapësirës shqiptare së bashku me tre nga katër qendrat e vilajeteve

⁴⁷ Barry Buzan and Ole Wæver: "Regions and Powers, The Structure of International Security". P.53. Burim i cituar; Michaela Cruden, Regional Security Complex Theory: Southeast Asia and the South Pacific, The University of Waikato, p.15, 2011.

⁴⁸ Barry Buzan and Ole Wæver, po aty, faqe 381.

shqiptare, ndikoi negativisht në polaritetin e kompleksit ballkanik të sigurisë, në shpërndarjen e padrejtë të fuqisë në disfavor të shqiptarëve, në marrëdhëniet mes shteteve në rajon dhe në vetë sigurinë rajonale, duke u kthyer kështu në një faktor që do të diktonte në vazhdimësi transformimet e brendshme në kompleksin rajonal të sigurisë, deri në gjetjen e një zgjidhjeje optimale për çështjen shqiptare në rajon.

Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë dhe shuarjes së konfliktit në nivel global, kompleksi ballkanik shoqërohet me transformime të vullshme të brendshme, por dhe të jashtme, pasojë kjo e ndryshimit të strukturës së tij thelbësore. Kështu filloi procesi i shpërbërjes së Jugosllavisë. Mos zgjidhja e çështjes shqiptare kërcënonte jo vetëm Ballkanin, por edhe kompleksin fqinjë, Bashkimin Evropian si dhe për interesat e aktorëve të tjerë të fuqishëm ndërkombëtarë shtetërorë e jo shtetërorë, si SHBA dhe NATO. Prandaj çështja shqiptare u sigurizua prej tyre. Përveç luftës dhe përpjekjeve të shqiptarëve, ishte ndërhyrja e fuqishme e këtyre aktorëve që bëri të mundur krijimin e shtetit të pavarur të Kosovës. Ishte gjithashtu ndërhyrja dhe presioni i tyre faktori kryesor që i bëri shqiptarët të nënshkruajnë Marrëveshjen e Ohrit dhe atë të Konculit.

Kjo shkallë e zgjidhjes së çështjes shqiptare në rajon, ndonëse jo përfundimtare, ka ndikuar pozitivisht në kostelacionin e sigurisë në Ballkan dhe më gjerë si dhe ndryshoi përsëri strukturën e nënkompleksit ballkanik të sigurisë, duke diktuar kështu transformime të brendshme në të. Kështu në strukturën anarkike të nënkompleksit është shtuar një shtet i ri, Kosova. Ka zhvillime në drejtim të polarizimit të fuqisë në rajon. Krijimi i shtetit të pavarur të Kosovës çoi në fillimin e procesit të korrigjimit dhe rishpërndarjes së fuqisë në rajon në dobi të shqiptarëve dhe në një rivendosje të ekuilibrave të fuqisë në Ballkanin Perëndimor si nënkompleks rajonal sigurie, mes sllavëve, shqiptarëve dhe grekëve. Grekët, sllavët dhe shqiptarët nuk janë vetëm tre popuj bashkë në zonat e veta, “por janë tri qytetërime, me tri kultura, me tri gjuhë. Ballkani nuk mund të përfytyrohet, qoftë dhe pa njërin prej këtyre përbërësve.⁴⁹ Boshti Beograd-Tiranë-Athinë duhet të jetë kyç në vendosjes e politikave në Ballkan, do të deklaronte në Tiranë më 10 qershor 2007, Presidenti amerikan Bush.⁵⁰

Si përfundim, pasi studiuam dhe analizuam për një periudhe më shumë se njëqindvjeçare, lidhjen e ndërsjellët mes shkallës së zgjidhjes së çështjes shqiptare me kompleksin ballkanik të sigurisë, konkludojmë se çështja shqiptare në rajon dhe shkalla e zgjidhjes së saj ka ndikuar në vazhdimësi dhe vazhdon të ndikojë në sigurinë rajonale dhe me gjerë.

Shala, Xh.
« Çështja shqiptare dhe kompleksi ballkanik i sigurisë »

Policimi dhe Siguria
nr.1, 2015

⁴⁹ Ismail Kadare, Intervistë për revistën NIN të Beogradit. Ribotuar në gazetën “Shqip”, 25 Prill 2012.

⁵⁰ Ridefinimi i kufijve me marrëveshje shtetërore. Telegrafi.com, 4.9.2010.

Referencat

I. Dokumente arkivore, traktate, raporte etj.

1. AQSH. Fondi Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Dosja Nr. 2. Dokumenti Nr. 5523.
2. Traktati i Berlinit, ndërmjet Gjermanisë, Austro-Hungarisë, Francës, Britanisë së Madhe, Italisë, Rusisë dhe Turqisë, nënshkruar në Berlin, më 13 korrik 1878. Botuar në "Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare...", vëll. I. Dokumenti Nr. 16.
3. "Traktatit Paraprak i Paqes ndërmjet Turqisë dhe Rusisë". Shën Stefan (Stamboll), 3 mars 1878. Nënshkruar nga Konti N.Ignatiev Nelidov dhe Safet Sadullah.
4. Marrëveshje mes Austro-Hungarisë dhe Italisë. Romë 8 maj 1913. "Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare...", vëll. II. Dokumenti Nr.27.
5. Traktati i Miqësisë dhe Aleancës ndërmjet Bullgarisë dhe Serbisë. Nënshkruar në Sofje, më 13 mars 1912. Botuar në Prof.dr. Arben Puto në "Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare...", vëll. I, Dok. Nr.48.
6. Marrëveshja sekrete midis Greqisë dhe Serbisë mbi ndarjen e sferave të influencës në Shqipëri, nënshkruar në Selanik, më 19 maj 1913. Documents Diplomatiques, Ministere des Affaires Etrangeres, oktobre 1915 - juin 1916, Athenes, 1921, pp. 19-20.
7. Traktati i fshehtë midis fuqive të Antantës dhe Italisë. Londër, 26 prill 1915. Botuar në "Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare...", vëll.II, Dok. Nr.161.
8. Traktati i Paqes midis Greqisë, Bullgarisë, Malit të Zi, Serbisë dhe Turqisë, nënshkruar në Londër më 30 maj 1913. Botuar në "Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare...", vëll. II. Dok. Nr. 45.
9. Ultimatum i Austro-Hungarisë drejtuar Serbisë në 18 tetor 1913, për terheqjen e trupave nga Shqipëria. Documents Diplomatiques Francais, 3eme serie, t. VIII, D.Nr.341, pp.429-431.
10. Procesverbal i Konferencës Londrës në vazhdim të vendimit të saj përfundimtar të datës 29 korrik 1913. Botuar në "Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare...", vëll. II.
11. Memorandum drejtuar lordit Bikonsfild, përfaqësues i Anglisë në Kongresin e Berlinit. Botuar nga prof. Arben Puto në "Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit", vëll. I, f. 140. Dokumenti Nr.6.
12. Memorandum i Anglo-Franko-amerikan lidhur me Çështjen e Adriatikut. Adriaticus, "La Question Adriatique Receuil de documents officiels", Paris, 1920, f. 57-58, 65-67. Botuar në "Lufta e popullit shqiptar për çlirimin kombëtar", vëll. I, f. 490-492, Tiranë 1975.
13. Adriaticus. La Question Adriatique Receuil de documents officiels. Paris, 1920, f. 109-110. Botuar në "Lufta e popullit shqiptar për çlirimin kombëtar", vëll. II, f. 34-35.
14. Memorandum i Qeverisë Serbe drejtuar Konferencës së Ambasadorëve në Londër, Janar 1913. Botuar në "Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare...", vëll. II.
15. Memorandum i qeverisë greke, datë 3 janar 1913, drejtuar Konferencës së Ambasadorëve në Londër. Botuar në "Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare...", vëll. II, Dok. Nr. 4.
16. Letër e Sen Kanten, i ngarkuar me punë i Francës në Cetinë, dërguar ministrit të Jashtëm të Francës Dë Frejsines, në Janar 1880. "Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit" II. Botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë 1986.
17. Memorandum i Delegacionit të Qeverisë së Përkohshme të Durrësit, paraqitur në Konferencën e Paqes.Paris 12 Shkurt 1919
18. Notë e presidentit Willson, datë 6 mars 1920, në përgjigje të notës së aleatëve të datës 26 shkurt 1920, te "Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare...", vëll. II.
19. Dokumente të përkthyer dhe të botuara në "Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit", vëll. II, f.37-41, Tiranë 1986. Botim i Akademisë së Shkencave të RPSSH
20. Documents Diplomatiques Francais, 3 eme serie, t. VIII, D.Nr.341, pp.429-431.
21. Raport i Pol Kambonit, datë 14 Prill 1913 " Mbi përcaktimin e kufijve të Shqipërisë në Veri dhe Verilindje", Documents Diplomatiques, 3-eme serie, t. VI, D.Nr. 301,pp347-358. Botuar e përkthyer ne shqip në "Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare" Dok. Nr. 19. Vëllimi II. Faqe 243-244.
22. Vendim i Konferencës së Ambasadorëve për Kufijtë e Shqipërisë. Pika 1. Paris 9 nëntor 1921
23. Raport i ICG-së për Evropë N° 153, 25 Shkurt, 2004.Faqe 27.International Crisis Group:"Albania, State of the Nation". Europe Report nr. 871. Tirana/ London/ Brussels, 1 March 2000.

II. Botime, studime e artikuj

1. Buzan, B. "People, States & Fear: The National Security Problem in International Relations", 1983.
2. Buzan, B. and Wæver O: "Regions and Powers; The Structure of International Security", Cambridge

- University Press, Cambridge, 2003.
3. Collins, Alan: "Studimet bashkëkohorë të sigurisë", Tiranë 2009.
 4. Sarah Terry, University of Calgary: Defining Security: Normative Assumptions and Methodological Shortcomings.
 5. Stolberg, Alan G.: Sistemi Ndërkombëtar në Shekullin e 21-të. Botuar në "Guidë për politikën dhe strategjinë e sigurisë kombëtare", vëll. II. Botim i Akademisë së Mbrojtjes "Spiro Moisiu".
 6. Wolfers, Arnold: "National Security as an Ambiguous Symbol", Political Science Quarterly, Vol.67, No.4, December 1962.
 7. Emmers, Ralf. Sigurizimi, "Studime bashkëkohore të sigurisë". Tiranë 2009.
 8. Grizold, Anton: "Paradigma e sigurisë pas Luftës së Ftohtë. Parandalimi dhe menaxhimi i konflikteve - rasti i Maqedonisë", Shkup 2009.
 9. Takahashi, Sugio: Redefinition of Cooperative Security and "Regional" Security in the Asia-Pacific. The National Institute for Defense Studies (NIDS), Security Reports, No.1 (March 2000).
 10. Fürstenberg, Michael: "Conflict Beyond Borders", Conceptualizing Transnational Armed Conflict, Nr. 97, September 2010, ISSN-Nr. 1614-7898.
 11. Wallensteen, Peter and Sollenberg, Margareta: Armed Conflict and Regional Conflict Complexes, 1989-97. Journal of Peace Research, Vol. 35, No. 5.
 12. Cruden, Michaela: Regional Security Complex Theory, Southeast Asia and the South Pacific, The University of Waikato, 2011.
 13. Meta, Beqir: Tensioni greko-shqiptar 1939, Tirane 2007.
 14. Meta, Beqir: Shqipëria dhe Greqia 1949-1990, Paqja e veshitire.Tirane 2007
 15. Frashëri, Kristo: "Shqiptarët dhe Kriza Lindore" në "Lidhja Shqiptare e Prizrenit", Tiranë 1989
 16. Hoti, Ukshin: "Filozofia politike e Çështjes Shqiptare", "Rozafa",Tiranë 1995.
 17. Qosja, Rexhep: "Çështja shqiptare. Historia dhe politika", "Toena" 1998.
 18. Stavaleci, Esat: "Statusi i kombit shqiptar dhe sfidat e tij", Prishtinë 13 gusht 2007.
 19. Puto, Arben: "Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit" Vëll. I.
 20. Draskic, Sreten: "Europa i Allbansko Pitanje 1830-1921". Beograd 2000.
 21. Miliëvië, Milië: Pat za Mope. Medija Centar "Odbrana". Beograd 2011.
 22. Pesic, Vesna, "Rat za nacionalne drzave", in Srpska strana rata: trauma i katarza u istorijskom pamcenju / edited by N. Popov, Beograd 1996.
 23. Belegu, Xhafer: "Lidhja e Prizrenit", Tiranë 1939.
 24. Petifer, Xhejms: "Southern Balkans 2009- Stability and Stasis", Published By: Defence Academy of the UK. ISBN 978-1-905962-71-6.
 25. Shala, Xhavit: "Ballkani, gjeopolitika dhe siguria", vëll. I dhe II, Tiranë 2009.
 26. Boriçi, Gjon: "Marrëdhëniet ndërkombëtare në vorbullën e diplomacisë", "UFO", Tiranë 2009
 27. Nathalie, Clayer: "Në fillimet e nacionalizmit shqiptar", Tiranë 2009.
 28. Skëndo, Lumo: "Udhëtarët e huaj në Shqipëri gjër në fund të shekullit XIX", Tiranë 2012.
 29. Jablonsky, David & Craig, R. Nation: "Fuqia kombëtare dhe siguria". Botuar në "Guidë për politikën dhe strategjinë e sigurisë kombëtare", vëll. II. Botim i Akademisë Ushtarake "Spiro Moisiu", Tiranë 2009.
 30. Cana, Zekeria: "Lëvizja Kombëtare Shqiptare në Kosovë 1908-1912", "8 Nëntori", Tiranë 1982.
 31. "Ismail Qemali, përmbledhje dokumentesh", "8 Nëntori, 1982.
 32. "Hasan Prishtina, Dokumente", Tiranë 1983.
 33. Baltisiotis, Lambros: The Muslim Chams of Northwestern Greece. European Journal of Turkish Studies, 12 / 2011.
 34. Rich, Norman: "Diplomacia e Fuqive të Mëdha 1814-1914", "Toena" 2006.
 35. Nye Jr, Joseph S.: "Soft Power: The Means To Success In World Politics", 2004.
 36. Kisinger, Henri: "Diplomacia", Tiranë 1999.
 37. Kadare, Ismail: Intervistë për revistën NIN të Beogradit. Ribotuar në gazetën "Shqip", 25 prill 2012.
 38. Viktor Meier: "Yugoslavia A History of its Demise", Published in the Taylor & Francis e-Library, 2005,p.181
 39. The Kosovo Report, p.42-43.
 40. Vesna Pesic, "Rat za nacionalne drzave", in Srpska strana rata: trauma i katarza u istorijskom pamcenju / edited by N. Popov, Beograd 1996.f.35.
 41. Morrison, Keneth: " Montenegro, A Modern History".

Shala, Xh.
 « Çështja shqiptare dhe kompleksi ballkanik i sigurisë »

Policimi dhe Siguria
 nr.1, 2015

Ekstremizmi i dhunshëm kërcënim potencial afatgjatë



■ **Dr. Mimoza XHARO**
Akademia e Sigurisë

Abstrakt

Deri para 3-4 vjetësh shteti islamik nuk ekzistonte ndërkohë që tashmë kontrollojnë një gjerësi të madhe territori të Irakut dhe Sirisë. Dukë parë nivelin e makabriteteve dhe fushatës së paparë propagandistike në rjetet sociale dhe jo vetëm, ISIS-i ka demonstruar vazhdimisht se është më shumë se një organizatë ndërkombëtare terroriste, për me tepër është tashmë një entitet me kapacitete komandim kontrolli dhe logjistike të sofistikuar, e aftë për të mbajtur nën kontrollin e tij territor kritik strategjik në zemër të Lindjes së Mesme. Aktualisht ISIS përbën një kërcënim real edhe për sigurinë globale. Territorët nën zotërimin e tij mund të shndërrohen në një port të sigurt për grupet terroriste duke ofruar kështu një “safe even” apo një “inkubator” terroristësh për të planifikuar sulme terroriste në vendet perëndimore. Konflikti i zgjatur sirian, vala e refugjatëve nga rajonet e konfliktit mund të shfrytëzohet nga ISIS për të eksportuar militantë me synim kryerje aktesh terroriste apo ngritje celulash për të ardhmen, një sfidë për agjencitë e inteligjencës dhe zbatimin të ligjit.

Rreziku që paraqesin luftëtarët e huaj pas kthimit në vendet e origjinës përbën një kërcënim real afatgjatë që ka gjetur një vëmendje të madhe ndërkombëtare. Edhe pse një vend tashmë simbol i harmonisë fetare dhe i rreshtuar bindshëm qysh në krye të herës në anën e koalicioneve kundër terrorizmit nuk është imun ndaj këtij kërcënimi. Është tashmë fakt që shumë vullnetarë nga Ballkani i janë bashkuar ISIS-it, përfshi vendin tonë. Kërcënimet nga xhihadistë ballkanas nuk kanë munguar në videot e shpëmdara si pjesë e fushatës propagandistike të organizatës dhe xhihadi ka filluar “të flasë” edhe shqip. Nuk kanë munguar kërcënimet direkt për akte terroriste edhe ndaj vendit tonë, Kosovës dhe vendeve të tjera të Ballkanit, ç’ka do të thotë se vëmendja e ISIS-it për Ballkanin është shtuar.

Aktet terroriste në Paris “11 shtatori evropian”, dëshmojnë se është koha “që duhet të flasim të gjithë” dhe perceptojmë nivelin real të kërcënimit, pjesë e një strategjie, e cila nuk është vetëm ekskluzivitet i strukturave përgjegjëse të shtetit por më gjithëpërfshirëse.

Fjalëkyçe:

ISIS - shteti islamik, Al-Qaeda, xhihadistë, Ballkan, luftëtarët e huaj të ISIS, kërcënim terrorist, radikalizëm fetar, inteligjenca

Hyrje

*“Nëse ka pasur ndonjëherë një sfidë në botën e sotme të ndërvarur që nuk mund të përballet nga një vend i vetëm është ky: terroristë që kalojnë kufij dhe kërcënojnë të ndërmarrin dhunë”
Presidenti Obama ¹.*

Radikalizmi terrorist apo ekstremizmi i dhunshëm është një proces dinamik, sipas të cilit individit nis ta pranojë dhunën terroriste si një rrugë të mundshme, madje edhe legjitime të veprimit. Radikalizmi terrorist dhe rekrutimi nuk ndodhin në vakum. Kushtet që favorizojnë terrorizmin, të njohura dhe të pranua nga OKB-ja përfshijnë: “Konfliktet e zgjatura, të pazgjidhura, zhveshja e viktimave të terrorizmit nga aspektet njerëzore në të gjitha format dhe mënyrat që ai shpallet, mungesa e rendit, shkelja e të drejtave të njeriut, diskriminimi mbi baza etnike, kombëtare dhe fetare, përjashtimi politik, marginalizimi me karakter ekonomik-shoqëror dhe keqqueverisja”.² Përdorimi i termit ekstremizëm i dhunshëm dhe trajtimi si shqetësim global gjeti përdorim të gjerë pas shpalljes së shteti islamik nga krahu më radikal i Al-Qaedës, ISIS.

1. Vështrim i shkurtër historik

Pas bashkimit me Al-Qaedën (2003), grupi El-Tewhid Wel-Jihadi u bë i njohur si Al-Qaeda në Irak. Në 2006, pasardhësi i Ebu Mus’ab el-Zarqawit, Ebu Ejub el-Masri, vendosi si qëllim të grupit krijimin e një kalifati në rajon, duke deklaruar se luftonte për “Shtetin Islamik të Irakut” (ISI), emër me të cilin më pas do të identifikohet me vetë Al-Qaeda në Irak. Në 2011, ISI u shndërrua në grupin më të madh e më të fuqishëm ekstremist suni në Irak. Në prill 2013, ISI u transformua në Shteti Islamik i Irakut dhe Levantes (ISIL) ose ndryshe shteti Islamik i Irakut dhe al-Sham (ISIS).³

Me krijimin e ISIS/ISIL, fragmentarizmin e Al-Nusras dhe me tentativën e ISIL për të bashkuar nën një komandë të gjitha grupet xhihadiste në rajon, nisën

¹ Presidenti Obama, shtator 2014, i cituar në: *Final report of the task force on combating terrorists and foreign fighters travels*, shtator 2015.

² UN, “The United Nations Global Counter Terrorism Strategy” (Strategjia e OKB-së në luftën kundër terrorizmit), op. cit., shënimi 8; OSBE, *Ministerial Statement on Supporting the United Nations Global Counterterrorism Strategy* (Deklarata Ministrore në Mbështetje të Strategjisë Globale të OKB-së në luftën kundër terrorizmit), op. cit., shënimi 20.

³ Levant është term gjeografik dhe i referohet një zone në jug-perëndim të Azisë, e cila kufizohet me Detin Mesdhe, me Shkretëtirën Arabe, Mesopotaminë dhe nga Mali Taurus. Kjo zonë përfshin shtetet: Qipro, Izrael, Palestinë, Jordani, Liban, Siri dhe Hatay (provincë në jug të Turqisë). Në periudha të ndryshme historike ka përfshirë rajone edhe të tjera. Kështu, pjesë e kësaj zone ndonjëherë janë përfshirë, Iraku dhe Gadishulli Sinai.

Xhara, M.
«Ekstremizmi i dhunshëm kërcënim potencial afatgjatë»

Policimi dhe Siguria
nr.1, 2015

dhe përplasjet e para për pushtet mes grupeve xhihadiste. Duke përfitur nga konflikti në Siri, ISIS shtoi radhët e militantëve të tij. Në 29 qershor 2014, udhëheqësit e ISIS-it shpallën krijimin e Shtetit Islamik, me kufi nga qyteti Dayala në lindje të Irakut deri në qytetin Aleppo në veri të Sirisë. Gjithashtu, ata ndryshuan edhe emrin e grupit nga ISIS në “Shteti Islamik”, me lider Abu Bakar Al Baghdadi-drejtuuesin aktual të këtij grupi, të vetë quajtur tashmë *Kalifi Ibrahim*. Në deklaratën e shpalljes së Shtetit Islamik iu kërkohet të gjithë myslimanëve të betohen për besnikëri ndaj kalifit të tyre. Al Baghdadi kërkoi gjithashtu shkrirjen e grupimeve dhe bashkimin nën shtetin islamik.⁴ ISIL ka nën urdhrat e tij një vëllim të burimeve dhe një hapësirë territori të pashoqe në historinë e organizatave ekstremiste⁵. Shpejtësia dhe shkalla e përparimit të tij kanë qenë shumë të larta, ndërkohë që pasuria e grupit xhihadist llogaritet në miliarda dollarë duke grumbulluar para përmes teknikave që janë më të njohura nga organizata mafioze, se sa nga grupe revolucionare apo xhihadiste.⁶

Në fakt situata u përshkallëzua në këtë pikë nga dështimi total i shtetit irakian për të funksionuar si shtet unitar që ofron shërbime pa diferenca sektare në gjithë territorin. Kriza u shkaktua nga shumë faktorë por në veçanti nga rënia e moralit, ligjit, dinjitetit të shtetit, niveli i lartë i korrupsionit dhe së fundi rënia e ushtrisë irakiane. Grupi nuk do të kishte qenë në gjendje të realizonte një shtrirje kaq të madhe, të funksionojë si një entitet shtetëror, i aftë për të kontrolluar territore dhe ushtruar pushtet mbi një popullsi prej miliona, në qoftë se ai nuk do kishte qenë i armatosur plotësisht si një ushtri konvencionale, pjesërisht prej konfiskimit të pajisjeve ushtarake nga të larguarit nga ushtria irakiane dhe plaçkitja e bazave ushtarake siriane. Shtimi i radhëve të grupimit me luftëtarë nga e gjitha bota, gjerësia e territoreve nën kontroll, makabritetet e kryera ndaj pengjeve perëndimore (ekzekutimi monstruoz i tyre) dhe fiseve kundërshtarë, përdorimi i gjerë i rrjeteve dhe medieve sociale, propaganda mediatike, kryerja/kërcënimet/marrja përsipër e akteve terroriste, kanë vënë grupimin nën një vëmendje të paparë ndërkombëtare si një kërcënim global në rritje.

2. Miti i kalifatit dhe Shteti Islamik

Sipas sektit suni të islamit profeti kishte katër kalifë⁷. Një mit u zhvillua me shkatërrimin e perandorisë otomane në 1924, i cili mbronte se të restaurohej fuqia islame ishte e nevojshme të mblidheshin të gjithë myslimanët nën një pushtet të vetëm.⁸ Ideja e vënies nën një territor të një autoriteti të vetëm Islam është e

⁴ Al-Bagdadi, "Give good news to the believers: The declaration of the Islamic State in Iraq and Al-Sham", [www.OpenSource.gov/Analysis on ISIS](http://www.OpenSource.gov/Analysis%20on%20ISIS). (Një deklaratë audio nga Amir Al-Muminin Abu Bakr Al-Hussaini Al-Quraishi Al-Bagdadi.) Përveç shpalljes së shtetit islamik, kufijve dhe objektivave të tij, me këtë deklaratë, thuhet se: "Nën emrin e Shtetit Islamik të Irakut edhe emri i Jabhat Al Nusra do të venitet me dëshirën e Allahut dhe ata do mbeten pjesë e historisë së xhihadit tonë të bekuar si të parët para kësaj, dhe në të njëjtën kohë i shtrijmë krahët dhe hapim zemrat ndaj fraksioneve duke bërë xhihad për hir të Allahut të plotfuqishëm dhe fiset krenar në vendin e bekuar të Al-Shamit, për të bërë fjalën e Allahut më të lartë dhe populli dhe toka të drejtohet nga ligjet e Allahut ...")

⁵ Janine Davidson dhe Emerson Brookings në "Counsel for Foreign Relations", gjendet në: www.cfr.org

⁶ Stuart Gottlieb, "Four reasons ISIS is a threat to US homeland", në: *The national interest Magazine*, 20 shtator 2014.

⁷ Kalif i referohet në teologjinë islame pasardhësit e Profetit.

⁸ Vetë Bin Ladeni e pat thënë dikur në një deklaratë të tijën se bota islame është privuar nga një kalifat që prej rënies së perandorisë otomane. Bashkëpatriotët e tij uahabistë sauditë ishin revoltuar kundër kësaj dhe këtij lloji kalifati.

bazuar edhe në një mit më të hershëm. Abdullah Azzam, një ish anëtar i lëvizjes *Muslim Brotherhood*, ka shprehur në shkrimet e tij idenë se xihadi në Islam ishte një obligim individual për të rivendosur e rikrijuar territore të pastra islame. Kjo ide gati detyzëqëare është koncepti kryesor i përdorur nga ideologë të ndryshëm për të radikalizuar rekrutë që të luftojnë për shtetin islamik.⁹

Shteti islamik pretendon se ka rivendosur një *kalifat* në përputhje me “metodën profetike”. Sipas historianit Edward Luttwak shteti islamik vetëm kërkoi frymëzimin e tij nga katër kalifët e parë që pasuan profetin Muhamed. As kalifi më i fuqishëm, kalifi Abbasit, nuk është model i këtij shteti islamik. Po të shihet propaganda e shtetit islamik do kuptohet që qysh nga themelimi, grupi ka kërkuar të risjellë ditët e lavdishme të kalifit Abbasid në Bagdad, kryesisht në kohën e Harun al-Rashid të 1001 netëve të famshme.¹⁰

“*E di, se Bagdadi i al-Rashidit është shtëpia e kalifatit, që paraardhësit tanë ndërtauan*”, deklaroi një zëdhënës i Shtetit Islamik. “*Kjo nuk do të shfaqet nga duart tona, por me anë të trupave tona dhe kokave të prera. Ne edhe një herë do të mbjellim flamurin e monoteizmit, flamurin e shtetit islam në të.*”¹¹

Në të njëjtin vit, al-Bagdadi njoftoi: “*Sot, ne jemi në shtëpinë e kalifatit, Bagdadin e al-Rashidit*”.¹² Sipas studiuesve, plani i Shtetit Islamik për të ringjallur kalifin Abbasit në Bagdad ka dy probleme: *E para* është ideologjike: Harun al-Rashid nuk njihej si ideologjikisht i devotshëm, atij i pëlqente poezia, dhe ata që e rrethonin vlerësonin debatin intelektual dhe kulturën e tij pagane, të cilat janë në fakt anateme e salafistëve ultrakonservativë, si këta që “qeverisin” sot shtetin e vetëshpallur islamik. Por duket se ata duan t’i ngjajnë pushtetit të al-Rashidit dhe jo ideologjisë së tij profetike. *Problemi i dytë* është i karakterit demografik: Shumica e banorëve të Bagdadit janë të sektit shiit. Ata nuk do heqin dorë pa luftë, nuk do dorëzohen kaq kollaj as vetë padronët e tyre në Iran. Është në fakt çmenduri të pretendosh të marrësh Bagdadin përveç se të konsolidojë atë pushtet që ka në rajonet me shumicë sunite.¹³

Me shpalljen e *Kalifatit Islamik*, Abu Bakr al-Bagdadi, ka bërë një reklamim të tij si lidhësi i lëvizjes globale xihadiste. Ai nuk ka kërkuar vetëm që çdo mysliman t’i pretojë besnikëri atij si *kalifi* i ri, por ka asnjansuar gjithashtu legjitimitetin e çdo grupi apo aleance tjetër islamiste, duke përfshirë edhe vetë Al-Qaeda.¹⁴ “I vetë deklaruar *Kalif* i ri i paraqit myslimanëve me një zgjedhje ose të pranonin atë si kalifin e tyre ose do të vriteshin. Kjo mënyrë ka precedentë në Europën e Mesjetës më shumë se në historinë myslimane. Kalifi Ibrahim (*emrin e të cilit lideri pretendon të njihet*) zeron aleancat aktuale dhe të ardhme të grupit. Komuniteti suni që mbështet shtetin islamik ose duhet të bjerë nën autoritetin e kalifit ose rrezikon të vritet. Fakti që grupi me shpalljen e shtetit islamik la jashtë

⁹ Afzal Ashraf, “The myth of the caliphate and the Islamic State”, gjendet elektronikisht në: www.aljazeera.com/.../myth-caliphate-islamic-state-2014, 10 korrik 2014.

¹⁰ Frazja “*al-Rashid*” nuk është një epitimi i zakonshëm për t’iu referuar Bagdadit, gjendet vetëm në librat e mesjetës. Në diskutimet moderne fraza “*Bagdadi i al-Rashid-it*” është kontrast i “*Damascus of al-walid*”, një nga kalifët Umayyad të asaj kohe.

¹¹ Muharib al-Jaburi, “al-`Ilan `an qiyam dawlat al-`Iraq al-Islamiyya,” 15 janar 2007.

¹² Abu Umar al-Bagdadi, “wa-yamkurun wa-yamkur Allah,” 15 shtator 2007.

¹³ Haylamaz, Resit. *Abu Bakr: The Pinnacle of Truthfulness* (Paperback), 2013, f. 147.

¹⁴ Vetëshpallja e al-Bagdadi si *kalif*, është shumë e debatuar në komunitetin e gjerë islam, pasi në botën islame nuk ka pasur një *kalif* që kur Perandoria Osmane doli jashtë sektit Ahmadiya, ku figura e kalifit është përcaktuar si i vetmi pasardhës legjitim i profetit Muhamed. Fakti që ISIS e bëri këtë, solli ndërlikime të mëdha ideologjike dhe teologjike dhe përbën një sfidë ideologjike të madhe edhe për vetë Al-Qaeda.

Xhara, M.
«Ekstremizmi
i dhunshëm
kërcënim
potencial
afatgjatë»

Policimi
dhe
Siguria
nr.1, 2015

fjalën Irak, dëshmon shfrytëzimin e situatës së krijuar për objektiva të vetat¹⁵.

3. Shteti Islamik versus Al-Qaeda dhe një rivalitet i mundshëm mes tyre

Dihet tashmë që pas 11 shtatorit, lëvizja globale xhihadiste është ndarë në dy grupime të mëdha: Al-Qaida dhe grupet e lidhura me të, nën lidhësinë e ri Zawahri (post Bin Laden) dhe gjithë të tjerët (grupe kryengritëse dhe terroriste që kanë mbajtur pavarësinë e tyre nga Al-Qaeda). Me shpalljen e shtetit islamik, duket se ISIS është shndërruar grupimi i dytë xhihadist i fuqishëm dhe dominues në botë, i cili ka shprehur hapur synimet e tij: do atë që ka Al-Qaeda, kredibilitet global dhe respekt, mbështetje dhe besnikëri nga organizatat xhihadiste në botë. Me evoluimin e konfliktit sirian dhe avancimin në territore të shtetit islamik, një pjesë e grupimeve i janë bashkuar ISIS-it përfshi grupe të Magrebit islamik, grupi kryesor i al-Qaeda në rajonin Afganistan-Pakistan, Al-Nusrah, grupi i Boko Haram etj.¹⁶

Pavarësisht profilit të ulët të liderëve të tyre, grupime të tilla vazhdojnë të deklarojnë besnikërinë shtetit islamik si kohët e fundit grupi Afgan Hezb-e-Islami, e ndërkohë që edhe grupi xhihadist egjiptian Ansar Bayt al-Maqdis mendohet se ka lidhje të forta me shtetin islamik pavarësisht mungesës së deklarimit hapur. Shteti islamik ka gjithashtu mbështetje në Gaza përfshi një brigadë të armatosur me deri operativë teknologjikë që mbështetin aktivitetin “on-line” të tij dhe duket se janë vënë nën komandimin e tij. Ndërkohë që edhe Ansar al-Sharia në Tunizi dhe Ansar al-Sharia në Libi mund të bien nën këtë autoritet.¹⁷

Një nga pikat e forta të shtetit islamik është mbështetja që ai po merr në komunitet radikale anglishtfolëse. Kjo dinamikë ka potencialin të dëmtojë seriozisht lëvizjen globale xhihadiste, duke e copëzuar atë në fraksione që luftojnë për resurse dhe mbështetje dhe ndoshta do të përfundojnë të vrasin njëri tjetrin.¹⁸

Me krijimin e shtetit islamik Al-Qaeda fillimisht u dëmtua rëndë ideologjikisht. Ideologjia e saj ishte të luftohej armiku i largët perëndimor dhe jo armiku i afërm regjimet myslimane “apostate”.¹⁹ Por Al-Bagdadit injoroi instruksionet e Zawahrit. Ai zgjodhi aktet e dhunshme për t’u konfirmuar dhe i konsideronte të pavlefshme organizatat e tjera jashtë Kalifatit. Ndërkohë ISIS edhe pse lindi nga të qenit fraksion i Al-Qaeda dallon nga ajo pasi qëllimet e tij janë të lokalizuara gjeografikisht. Ata ndahen jo vetëm nga objektivat por edhe nga taktikat.²⁰

Ndërsa Al-Qaeda aspiron për xhihad global, ISIS i ka të përcaktuar dhe shpallur tashmë kufijtë e shtetit islamik. Shpallja e Shtetit Islamik konsiderohet edhe si një tentativë e Abu Bakar Al-Baghdadit për të futur nën ombrellën e tij të gjitha grupet

Xharo, M.
«Ekstremizmi
i dhunshëm
kërcënim
potencial
afatgjatë»

Policimi
dhe
Siguria
nr.1, 2015

¹⁵ Afzal Ashraf, “The myth of the caliphate and the Islamic State”, gjendet në: www.aljazeera.com/.../myth-caliphate-islamic-state-2014, 10 korrik 2014.

¹⁶ Grupi xhihadist i Boko Haram njihet si grup xhihadist i linjës së ashpër në Nigeri, i cili ka deklaruar që një pjesë e vendit bie nën autoritetin e kalifatit në Afrikë. Mediet kanë raportuar masakra në fshatra të tëra. Shih www.aljazeera.com/.../nigeria-struck-wave-boko-haram.

¹⁷ J.M. Berger, “Who’s winning the war to become a jihadi superpower?”, në: foreignpolicy.com, 2 shtator, 2014.

¹⁸ Po aty

¹⁹ Afzal Ashraf (këshilltar në “Institutin për studime mbi mbrojtjen dhe sigurinë britanike” (RUSI) dhe ka shërbyer ndërkohë në ushtrinë britanike. Ka qenë pjesë e hartimit të strategjive kundër kryengritjes dhe një sërë vlerësimesh mbi çështje të policisë dhe drejtësisë në Irak.

²⁰ STRATFOR, “Stratfor Global Intelligence: Analyzing Differences between al Qaeda and The Islamic State”, gjendet në: <https://www.stratfor.com/.../conversation-analyzing-diff>.

e tjera në Lindjen e Mesme deri tejkalimin e Al-Kaidës. Nga ana tjetër vetë Zawahri është shprehur në mesazh video se “shteti islamik është ilegjitim dhe i bëri thirrje mbështetësve të tij t’i bashkoheshin Al-Qaedës në luftën kundër koalicionit perëndimor”.²¹

“Vëllezërit e mi muxhajdinë në të gjitha vendet dhe nga të gjitha grupet, ne po përballemi me agresion nga Amerika, Europa dhe Rusia, kështu që varet nga ne se sa do jemi të bashkuar” është shprehur Zawahri sipas një raportimi të Reuters. Në mesazh videot e mëparshme vetë lideri aktual i Al Qaedës kishte theksuar se asnjë mysliman nuk është i obliguar të dëshmojë besnikëri ndaj Bagdad-it dhe shtetit të tij. I ashtuquajtur i kalifat nuk ishte themeluar bazuar në “metoda profetike” dhe nuk kishte dakordësinë e autoriteteve të njohura xhihadiste.²²

Por nisur nga frika e dominimit dhe shtimit të radhëve të shtetit islamik nga grupimet që më parë ishin nën Al-Qaedën dhe pas një angazhimi të paparë ndërkombëtar mbi koordinimin e përpjekjeve globale në luftën kundër ISIS, duket se ka dalë në pah indicia e parë e liderit të Al-Qaedës ku kërkon unitet ndër grupet xhihadiste, duke konfirmuar kështu përçarjen dhe divergjencat që egzistojnë mes grupimeve kur i referohet “ngritjes së një *sharia (grykate)* të pavarur për të zgjidhur mosmarrëveshjet mes tyre.”²³

“Amerikanët, rusët, iranianët, alautitë dhe hezbollahu po koordinojnë luftën e tyre kundër nesh dhe ne nuk jemi të aftë të ndërpresim luftën mes nesh në mënyrë që të bashkojmë përpjekjet dhe forcat tona kundër tyre, jo kundër vetes. Rusia dhe SHBA janë në krye të dy koalicioneve të mëdha të angazhuar në sulme ajrore ndaj targeteve tona në Siri”²⁴ është shprehur Zawahri në një postim video të publikuar në internet në 1 nëntor 2015.

Ky rivalitet në propagandë është reflektuar edhe në një rivalitet në terren. Në janar 2015 një grup xhihadis i profilit të ulët, në Jemen, deklaroi hapur kalimin e tij nga al-Qaeda tek ISIS. Dihet tashmë se al-Qaeda e Gadishullit Arabik (AQAP) është dominuese në Jemen. Pak më vonë, në mars 2015, shteti islamik i quajtur “Sana’a Province” mori përsipër katër sulme terroriste në dy xhami të kryeqytetit të Jemenit, ku pati 142 viktima dhe 351 të plagosur. AL-Qaeda (AQAP) e distancoi veten nga sulmet, duke theksuar në mesazhet në video se ajo “nuk sulmon xhamitë” dhe menjëherë rimori kontrollin në qytetin al-Houta. ISIS-i ndoshta u mundua të shfrytëzonte përçarjen që ekziston prej kohësh aty mes sunnive dhe shiitëve. Të njëjtin muaj, grupi islamik i Boko Haram-it, në Nigeri, deklaroi hapur kalimin nga al-Qaeda tek shteti islamik. Aktet terroriste në Paris (7 janar 2015 dhe 13 nëntor 2015) janë një shembull domethënës i këtij rivalitetit të ethshëm. Aktet terroriste në Charlie Hebdo i mori përsipër Al-Qaeda, ndërkohë që për nga simbolika (liria e medias) dhe impakti i gjerë ishte tipik akt i Al-Qaedës.

ISIS i dha jehonë dhe mbështetje në fakt aktit, në revistën e tij online Dabiq²⁵

²¹ Demyan Kudryavtsev, The Moscow Times Online in English, (ueb-faqe në gjuhën angleze): <http://www.themoscowtimes.com/>.

²² Thomas Jocelyn, “Zawahri argues Islamic state’s caliphate is illegitimate in newly released message”, The long war, journal online, 9 shtator, 2015.

²³ Reuters, “Al Qaeda chief urges lone wolf attacks, militant unity”, 13 shtator, 2015.

²⁴ Vasudevan Sridharan, “Al-Qaeda: Ayman al-Zawahiri urges jihadis to unite against Russia and West”, International Business times, online, 2 nëntor, 2015. (Videoja është publikuar nëpërmjet kanaleve xhihadiste në 1 nëntor 2015, një ditë pasi aeroplani i linjës ajrore ruse 7K9268 u rrëzua dhe shkaktoi vdekjen e 224 pasagjerëve).

²⁵ Dabiq online, Nr. 7, 2015.

Xhara, M.
«Ekstremizmi
i dhunshëm
kërcënim
potencial
afatgjatë»

Policimi
dhe
Siguria
nr.1, 2015

duke e konsideruar “*Coulibaly-n si shembull i një xhihadisti të mirë që duhej ndjekur.*” Në 13 nëntor 2015 një seri aktesh të koordinuara në Paris me 130 viktime, nga të cilat 89 në teatrin Bataclan dhe 368 të plagosur.²⁶ Kësaj radhe ISIS merr përsipër aktin. Në fakt akte terroriste të krahasueshme me ato të al-Qaedës për nga impakti dhe simbolika. ISIS kësaj radhe zgjodhi simbolin e jetës së lirë (stadium futbollit, kafene, bar kafe, kohë e lirë për të dëgjuar muzikë në Bataclan - vende të frekuentuara si nga parisianët dhe nga turistët e shumtë). Pas akteve të Parisit, në 21 nëntor 2015, një akt tjetër terrorist në Mali, me 21 viktime dhe 170 pengje në hotel Radisson Blue, në Bamako. Sipas raportimeve në media militanti i armatosur lironte pengjet pasi u kërkonte të recitonin nga Kurani. Një grup afrikan i al-Qaedës mori përsipër aktin në Twitter. Mesazhi ishte se: “Ne (d.m.th. Al-Qaeda) nuk sulmojmë myslimanët dhe xhamitë.”²⁷

Në 26 nëntor 2015, një akt tjetër terrorist në Tunizi, ISIS mori përsipër aktin. Kërcënime për akte të tjera terroriste janë prezent. Franca, Belgjika, Londra, Italia janë vënë në masa të përforcuara sigurie nga indikacionet për akte të mundshme. Në 19 nëntor 2015, ISIS publikoi në revistën e saj online Dabiq foto të bombës së improvizuar të përdorur për të rrëzuar avionin e linjës ajrore ruse (Metro jet flight 9268) ku humbën jetën 224 persona. Pavarësisht hetimeve që vazhdojnë, nëse është e vërtetë që ISIS rrëzoi avionin rus, atëherë kjo dëshmon ambicien reale të tij për të konkurruar realisht me Al-Qaedën (aktet e rrëmbimit të avionëve apo rrëzimit të tyre më së shumti të marra përsipër nga al-Qaeda). Pavarësisht ndryshimeve në taktika, teknika, metoda, gjenerata target (ISIS targeton gjenerata më të reja në moshë, Lideri i Al-Qadës rreth 61 vjeç ndërkohë që Al Bagdadi 41 vjeç, i fuqizuar në kohën e teknologjive të reja si I-phone, duke dëshmuar një adoptueshmëri “perfekte” me rrjete sociale etj.) të dyja grupet përdorin ideologjinë për të rritur mbështetjen.

4. Masterplani i Shtetit Islamik: “Dhjetë shtetet e dekadës tjetër”

Në deklaratat dhe ueb-faqet e ISIS kohë më parë u publikua edhe një masterplan i shtetit islamik, i quajtur “*the ten state solution*” që grafikisht jepet në figurën e mëposhtme.²⁸

Harta ka ngjallur diskutime midis teologëve islamë. Walid Shoebat, një ish anëtar i ish-organizatës për çlirimin e Palestinës (PLO), i kthyer tashmë në një teolog islam, e ka përkthyer në këtë mënyrë hartën “Dhjetë shtetet e dekadës tjetër”²⁹:

Në hartën e mësipërme, shteti islamik ka objektiva afatgjatë shtrirjeje deri në Ballkan, Spanjë, Portugali. Ballkani pretendohet të jetë nën “Orobpa” dhe Portugalia dhe Spanja nën “Andalus”; Kurdistan, Iraku dhe Siria do të jenë shtetet e para objektive të kalifatit, së bashku me Libanin, nën emërtimin Sham; shtete të tjera që do mund të vihen nën kalifat në fazën e dytë do të jenë Turqia ose (Anadulli) dhe

²⁶ CNN, 13 nëntor, 2015.

²⁷ Daily mail online, 21 nëntor, 2015.

²⁸ Walid Shoebat, referuar nga Jack Moore, “Ten state solution” (shënim M.XH: nënkupton dhjetë shtetet e dekadës tjetër), në: *International Business Time*, 2 shtator 2014.

²⁹ Jack Moore, referuar Walid Shoebat, në: *International Business Time*, 2 shtator 2014.



shtetet e quajtura Gogaz që përfshijnë Azerbaixhanin, Kazakistanin, Kyrgyzstanin, Turkmenistanin, Takhikistanin dhe Uzbekistanin; nën Khurasan do të bjenë Irani, Afghanistani, Pakistani dhe potencialisht Indonezia, ndërsa Hijaz do përfshijë shtetet e gjirit dhe Yemeni; nën Qinanana do jetë Egjipti, Sudani dhe Somalia, ndërsa nën Magreb do jenë shtete e Afrikës së Veriut, si Libia, Tunizia, Algeri, Maroku dhe Mauritania.³⁰

Harta e shpallur nga shteti islamik shtrihet edhe në gadishullin e Ballkanit. Sa mistike dhe reale mund të jetë ajo?! Harta sipas studiuesve të sigurisë ka probleme dhe duket më tepër një hartë propagandistike për të nxitur besimtarët e këtyre vendeve dhe shtuar radhët e rekrutëve militantë. Ballkani njihet si vend i diversitetit të kulturave, etnive, kombësive dhe në komunitetet myslimane feja myslimane tradicionale e shkollës *medhebi hanefi* është ajo mbizotëruese. Por rajoni ka pasur here pas here problematika që lidhen me rryma radikale si *wahabizmi* dhe *salafizmi*, tentativa për krijim partish politike, influenca të jashtme radikale, përplasje të rrymave here pas here kryesisht në periudha zgjedhjes të drejtuesve të bashkësive islame, një pjesë e prestarëve të shoqatave bamirëse pas mbylljes nuk janë larguar për shkak të krijimit të lidhjeve familjare, marrjes së nënshtetësive, tentativa për t'i dhënë karakter fetar lëvizjeve politike etj.

Ka aktualisht vatra të nxehta ku predikohet rryma wahabiste si në Bosnjë, Sanxhak e jetkë. Pavarësisht efektit propagandistik dhe fantazisë që ky masterplan mund të ketë, nuk duhet të ngelet jashtë vëmendjes së analistëve të çështjeve të sigurisë dhe për parashikime afatgjata për të parandaluar radikalizimin dhe krijimin e vatrave të veçuara eksportuese terroristësh. Në fakt është hera e parë në historinë e grupimeve të tilla terroriste që japin një hartë të cunguar jo globale siç pretendon në strategjitë e saj Al-Qaeda. Përveç përfshirjes në këtë hartë të Ballkanit, është

Xhara, M.
«Ekstremizmi i dhunshëm kërcënim potencial afatgjatë»

Policimi dhe Siguria
nr.1, 2015

³³ Po aty.

tashmë fakt që shumë vullnetarë nga Ballkani i janë bashkuar ISIS-it. A është kjo një taktikë e grupimit për të nxitur më shumë militantë nga ky rajon për t'iu bashkuar grupimit, pra një taktikë propagandistike për efekte rekrutimi apo një strategji reale i mbetet objekt studimeve dhe vlerësimeve afatgjatë të kërcënimit.

5. Shteti Islamik kërcënim jo vetëm për rajonin e Lindjes së Mesme, por global

ISIS përbën tashmë një rrezik potencial për sigurinë në nivel lokal, rajonal deri dhe global. Sipas teoricienëve ushtarakë *armiku vendos kur një luftë mbaron*. ISIS do të ketë humbur kur të mos ketë më strehë të sigurt, kur nuk do mund të sigurojë më financa, kur nuk do mund të realizojë rekrutime të reja dhe kur të rinjtë ekstremistë apo të zhgënjyer të largohen dhe kthehen në shtëpi. Por edhe atëherë lufta me siguri nuk do të konsiderohet e mbaruar. Industria terroriste ende do të përfitojë nga të rinjtë siç degët e Al-Qaedës kanë bërë në të gjithë Lindjen e Mesme dhe Afrikë, dhe madje edhe në Indi, duke themeluar kështu një cikim xhihadistësh. Shkatërrimi i ISIS-it nuk është i mjaftueshëm dhe ai është vetëm manifestim i radhës i kërcënimit.³¹

Shteti islamik e demonstroi se është kërcënim real për rajonin e Lindjes së Mesme, dhe nën këtë këndvështrim pa një Lindje të Mesme stabël, paqja globale mbetet e rrezikuar. Grupet terroriste do vazhdojnë të gjejnë copëza “safe havens” apo të krijojnë të tilla, në Afganistan, më pas në Yemen, Somali, Nigeri etj. Ka qenë pjesë e debatit politik e akademik të cilët kanë bërë thirrje për Shtetet e Bashkuara për rikthim me trupa në Irak pas tërheqjes në 2011 “për të vënë çizme në terren”. Duke marrë në konsideratë zhvillimet e fundit, nivelin e kërcënimit dhe përmasat e shtrirjes së shtetit islamik, SHBA ndërmoi iniciativën e dërgimit të forcave speciale në Siri. Sekretari i Mbrojtjes Robert Work u shpreh në Samitin e “Defense One”, 2015 se “Shekulli i të gjithave është koha e strategjisë së madhe, ku padyshim një vend të rëndësishëm zënë fushata globale kundërterrorizmit, e shënjuar nga lufta kundër ISIS. Forca speciale amerikane do të dislokohen në terren në pjesën verilindore të Sirisë së bashku me grupe të tjera përfshi turkmenë, kurdë etj. Përveç pajisjes së tyre me mjete mbrojtjeje misioni i tyre do të jetë strikt këshillim dhe asistencë, mision i ndryshëm nga ai në Irak si fillim. Ata janë në kuadër të fillimit të një strategjie të re në luftën kundër grupeve terroriste, të cilat do fokusohen në Irak me ndihmën e forcave irakiane të rimarrin Ramadin, de Bayji dhe më tej Mosulin. Në Siri objektivi imediat është to merret dhe mbahet kryeqyteti i vetë deklaruar i ISIL-it, Raqqa.”³²

Në nivelin global, ISIS tashmë paraqet një rrezik për sigurinë ndërkombëtare. “Konflikti sirian e ka shndërruar atë rajon në një terren të ekstremizmit të dhunshëm. Kjo është një krizë globale dhe kërkon një zgjidhje globale.”³³ Në deklaratat e herëpashershme të bërë nga krerët e ISIS, janë bërë kërcënime të drejtpërdrejta ndaj

Xharo, M.
«Ekstremizmi
i dhunshëm
kërcënim
potencial
afatgjatë»

Policimi
dhe
Siguria
nr.1, 2015

³¹ Stuart Gottlieb, “Four reasons ISIS is a threat to America homeland”, në: *The national Interest magazine*, 20 shtator, 2014. (Autori konkludon se “Fakti që grupe si ISIS mendojnë dhe veprojnë gjithmonë në terma synimesh sa lokale aq edhe globale e bën atë kërcënim potencial”).

³² Defense One, Samiti “Koha e të gjithave” organizuar nga Revista online “Defense One” me pjesëmarrje nga të gjitha institucionet e sigurisë së SHBA, gjendet në: www.defenseone.com/feature/defense-one-summit-2015/ Defense one Summit, “The age of everything” in Washington D.C. 2 nëntor, 2015- Setting National Security Priorities in an Era of Evolving Threats.

³³ Former attorney general Eric Holder, korrik 2014.

vendete perëndimore, të konkretizuara tashmë edhe me akte terroriste.. Një kërcënim real të konsiderohet i tillë duhet të ketë tre elementë: synim, kapacitete dhe mundësi. Qartësisht ISIS ka synim të shprehur, deri edhe kanë deklaruar në videot e prodhuara si pjesë e fushatës së tyre propaganduese që “*flamuri i zi do të fluturojë i lirë mbi shtëpinë e bardhë*”.³⁴ ISIS ka kapacitete financiare për të mbuluar blerjet e armatimeve, financuar rekrutimet dhe deri thithjen e mercenarëve me pagesë, ka arritur të zotërojë sasi shumë të madhe territori nga ku mund të shndërrohet në inkubator për terroristët. “Fushata e sulmeve ajrore duket se nuk ka ndaluar frymëzimin e luftëtarëve të huaj për t’u bashkuar ISIS-it. Kur filluan sulmet ajrore radhët e militantëve islamistë ishin rreth 15.000, sot deri 25.000 luftëtarë të huaj, të tjerë vazhdojnë të hyjnë në Siri mesatarisht 1000 në muaj. Ata kanë bërë të mundur që ISIS të mbetet i fuqishëm, edhe pse deri 10.000 luftëtarë janë vrarë nga fushata ajrore, ata janë zëvendësuar shumë shpejt nga luftëtarë të rinj, ç’ka ka bërë që numri ka mbetur pothuaj i njëjtë.”³⁵

Shteti islamik mund të shndërrohet edhe si kauzë frymëzimi për individë të veçuar në vendet perëndimore, të cilët mund të ndër marrin akte të veçuar terroriste kundër targeteve që mund t’u japin atyre përparësi mbulimi mediatik për rrjedhojë impakt të gjerë. Faktori ndërkombëtar ka vënë theksin në rëndësinë e kalimit nga faza e vendimmarrjes dhe kuptimit të fenomenit në inicimin e procedurave dhe planeve praktike dhe shkëmbimit të informacionit dhe inteligjencës, duke e ditur tashmë që ka me qindra e mijëra terroristë të ardhur nga vendet evropiane dhe ka me mijëra të tjerë që kanë shkuar atje nga më shumë se njëqind vende të tjera të botës. Tërheqja, rekrutimi, financimi i tyre po kryhen nëpërmjet rrjeteve dhe komunikimeve sociale dhe ndërmerren nga celula të vogla në shumë vende të Evropës perëndimore..³⁶

ISIS paraqet një kërcënim për të gjithë shtetet moderne, ai nuk është vetëm një kërcënim në kontekst rajonal, pasi ka sfiduar kufijtë e sistemit shtet modern. ISIS është tashmë një kërcënim real për shtetet fqinje në Lindjen e Mesme, po zgjeron rrezën e kërcënimit ndaj Arabisë Saudite, Izraelit dhe perëndimit. Përballja me këtë kërcënim është shumë e vështirë dhe arritja e strategjive ndërkombëtare për t’a luftuar gjithashtu.³⁷

Bazuar në një letër nga një nga nipat fiktivë të Bin Ladenit dërguar një familjari të tij në 2020 (*nga materialet e kapura pas vrasjes së Bin Ladenit*), Raporti i Këshillit të Inteligjencës Kombëtare “*Mapping the global future*” 2020, parashikonte se “Islami radikal do të ketë një impakt global domethënës bazuar në grupime etnike, fetare deri në krijimin e një autoriteti që sfidon kufijtë shtetërorë... Diferencat mes fesë dhe etnive do të kontribuojnë në konfliktet e ardhshme dhe nëse mbeten të pa zgjidhura do të jenë shkak i krizave rajonale e më gjerë”³⁸ Nga analiza dhe zhvillimi

³⁴ www.washingtontimes.com, 4 tetor, 2010.

³⁵ Laura Smith-Spark and Noisette Martel, “U.S. Official: 10,000 ISIS, Fighters Killed in 9 Months,” CNN, 3 qershor, 2015, <http://www.cnn.com>.

³⁶ Al-Ghabban: “There are thousands of ISIS elements from than 100 countries enter Iraq and Syria by fac. Shafaq”, gjendet në: <http://www.shafaq.com/sh2/>. [Specifika e faqes: Të reja në gjuhë angleze mbi kurdët dhe situatën e Irakut. “News website run by Shafaq Culture and Media Foundation for Fayli Kurds, covering Iraqi issues, with special focus on Fayli Kurds’ issues;]

³⁷ Chanchal Kumar, “Islamic state of Iraq and Syria a global threat: international strategy to counter the threat”: Journal of social sciences and humanity, vol nr 1, No4, 2015, pp 345.

³⁸ National Intelligence Council, “Mapping the global future, Report of the National Intelligence Council’s 2020” - Projekt i bazuar edhe në konsultime me ekspertë joqeveritarë botërore, dhjetor 2004.

Xhara, M.
«Ekstremizmi
i dhunshëm
kërcënim
potencial
afatgjatë»

Policimi
dhe
Siguria
nr.1, 2015

i skenarëve të ndryshme për kërcënimet e ardhshme, parashikimet përfshinin një terrorizëm ndërkombëtar të decentralizuar, me trajnime, financime, furnizime me armë me mjete virtuale; Iraku dhe konflikte të tjera të mundshme do të mund të krijonin terren për rekrutime, trajnime për një klasë të re terroristësh, të cilët do të jenë të *profesionalizuar* dhe për të cilët dhuna politike do të jetë qëllim në vetvete. Shtetet që mund të jenë në harkun e dhunës dhe destabilitetit do jenë nga Afrika Subsahariane, nëpërmjet Afrikës së Veriut deri në Lindjen e Mesme, Ballkani, Kaukazit dhe Azia jugore dhe qendrore dhe pjesë të Azisë juglindore. Përpjekjet kundërterrorizëm në vitet e ardhshme do drejtohen kundër një seti terroristësh që janë të lidhur më shumë ideologjikisht dhe teknologjikisht se gjeografikisht dhe kjo do jetë sfida më e mundshme e fokusit se ndaj një organizate të centralizuar siç është Al-Qaeda. Rekomandohej një strategji e gjerë ndërkombëtare kundërterrorizmi që i qasej problemit në shumë fronte.³⁹ Dhe sot në 2015 gjetjet e raportit janë mëse reale. Aktet terroriste në Paris⁴⁰ dëshmojnë për dimensionin e ri të kërcënimit në nivel global.

6. Çështja e luftëtarëve të huaj dhe rreziku që mbart kthimi i tyre në vendet e origjinës

Që me fillimin e konfliktit në Siri një numër i madh vullnetarësh iu bashkuan grupeve radikale aty. Pjesa më e madhe e tyre i janë bashkuar tashmë Shtetit Islamik, jo vetëm që luftojnë përkrah tij por janë angazhuar në akte terroriste, fushatë propagandistike dhe kërcënime ndaj vendeve të tyre të origjinës. Disa nga karakteristikat që konstatohen ndër ta, pavarësisht vendeve nga janë larguar:

1. Mosha më e ndeshur e vullnetarëve është 18-29 vjeç edhe pse ka shumë raste të moshës 15-17 vjeç, apo edhe tek të 30-ta. Sipas studiuesve të sigurisë kjo moshë është më e re se ajo e vullnetarëve të “xhihadit” në Afganistan, ku më e ndeshura ishte 25-30 vjeç.

2. Shumica e luftëtarëve ishin pa përgatitje ushtarake dhe pa ndonjë eksperiencë të mëparshme luftimi edhe pse ka një bërthamë me luftëtarë të vjetër, që kanë luftuar në fronte të tjera të cilët kanë formuar tashmë njësitë e tyre.

3. Një numër i konsiderueshëm i rekrutëve nga vendet perëndimore janë të rinj të fesë islame. Mesatarisht 6% e vullnetarëve nga vendet e BE-së, janë të konvertuar.⁴¹ Shumë vullnetarë nga vendet perëndimore janë brezi i dytë dhe i tretë i emigrantëve të ardhur në këto vende.

4. Pamjet e përgjithshme të ofruara nga luftëtarët për jetën e tyre në shtetin islamik flasin për aktivitete të motivuara, të përziera me një ndjenjë heroizmi, për të tërhequr bashkëkombësit e tyre dhe për t'i dhënë kuptim imazhit të tyre.

5. Motivimet janë të shumta, duke filluar nga nevoja ekonomike, papunësia, injoranca e kulturës së shëndoshë fetare. Media sociale gjithashtu ka luajtur rol domethënës. Mundësia dhe dëshira për të marrë pjesë në *një betejë të profetizuar, si 1.400 vjet më parë*, për disa prej tyre ishte një motiv. Për të tjerë “*Të jesh “xhihadist”, do të thotë të jesh i obliguar për të ndihmuar komunitetin mysliman*

Xharo, M.
«Ekstremizmi
i dhunshëm
kërcënim
potencial
afatgjatë»

Policimi
dhe
Siguria
nr.1, 2015

³⁹ Po aty

⁴⁰ CNN, “Akte të koordinuara terroriste në Paris në 13 nëntor 2015 ku u vranë 130 persona dhe plagosën më shumë se 350”.

që është aktualisht “i sulmuar”. Ky është motivi qendror i ekstremizmit islamik, që nga koha e Al-Qaeda në vitet 1990.

6. Barbarizmat ndaj popullsisë civile në Siri mund të kenë ndikuar edhe në ngjalljen e ndjenjës së solidaritetit.

7. Një tërheqje tjetër është mundësia për të jetuar në një vend ku rregullat dhe sjellja janë *vetëm në përputhje me mësimet e Islamit*. Njohuritë e tyre për fenë janë rudimentare dhe kështu ata nuk e vënë në dyshim autoritetin e udhëheqësve të tyre dhe i besojnë verbërisht për ato që thonë.

8. Disa e shohin luftën si një mundësi për aventurë, për arratisje nga vendi ku janë, apo për përfitime financiare. Shumë të tjerë, mund të mos jenë në gjendje të thonë se përse ata kanë vendosur të marrin pjesë në luftë. Ka edhe të gënjyer që janë ndeshur me realitet krejt tjetër atje, që janë kthyer dhe vazhdojnë jetën normale.

Është shqetësues fakti që kësaj radhe teatri i konfliktit sirian përfshiu një numër më të madh se çdo herë tjetër vullnetarësh/luftëtarësh shqipfolës. Një pjesë e tyre nga zonat rurale, të varfra dhe me nivel arsimor të ulët. Shumica kanë udhëtuar edhe me familjet, ka pasur raste edhe të marrjes edhe të fëmijëve pa dijeninë e nënave si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë.⁴² Shumica nuk kanë pasur mbështetjen e familjes dhe në shumë raste familja nuk ka ditur për largimin e tyre drejt luftës. Nga të larguarit kosovarë ka edhe ish luftëtarë të UÇK që i janë bashkuar ISIS-it si dhe imamë që kanë predikuar, rekrutuar, financuar vajtjen në Siri. Është në fakt hera e parë që ueb-faqet apo videot e shpërndarë nga xhihadistët japin mesazhe kërcënuese nga shqiptarë në gjuhën shqipe. Predikimet janë kryer kryesisht në objekte të shndërruara në xhami apo xhami jashtë juridiksionit të komuniteteve zyrtare myslimane. Është po ashtu hera e parë në historinë e xhihadizmit që thirrjet e liderit të ISIS-it u përkthyen edhe në gjuhën shqipe⁴³. Burimet e hapura të informacionit flisnin edhe për një “brigadë të Ballkanit”⁴⁴ që është më shumë mediatike dhe ka efekt propagandues apo synim ambiciesh të disa prej luftëtarëve shqipfolës, liderëve të tyre të vetëshpallur si të tillë, për të zënë dhe fituar influencë në radhët e grupimit. Në disa raste rrjetet sociale u përdorën për të udhëzuar të rinjtë që do ishin të gatshëm t’iu bashkoheshin duke treguar itinerare, lajmëruar për mbërritjen mirë të dikujt apo për rrugë të zëna e të rrezikshme që nuk duheshin përdorur. Sipas vlerësimit të ICSR mbi 650 individë kanë udhëtuar drejt rajoneve të konfliktit nga Ballkani perëndimor (Shqipëria 90; Bosnja 330; Kosova, 100 deri 150; Maqedonia 12; Serbia, 50 deri 70. Numri i luftëtarëve të vrarë rreth 40 deri

⁴² Joseph A. Carter; Shiraz Maher; Peter R. Neumann. “Measuring Importance and Influence in Syrian Foreign Fighter Networks”, *The international center for the study of radicalization and political violence (ICSR) report*, f.13

⁴³ *www.reporter.al*, “Dhjetëra fëmijë shqiptarë pengje të xhihadistëve në Siri”, 16 dhjetor, 2014.

⁴⁴ *www.shekulli online*, “Xhihadistët e ISIS-it, mesazh edhe në gjuhën shqipe: Kërkoni vdekjen në çdo vend. Një mesazh drejtuar muxhahidave dhe umetit musliman në muajin e ramazanit”, 6 korrik 2014. Në këtë mesazh theksohet: “Nuk ka punë më të mirë në këtë muaj të ndershëm ose në ndonjë muaj tjetër sesa xhihadi në rrugë të allahut, kështu që përfitonit prej kësaj mundësie dhe ecni në rrugën e të parëve tuaj. Ndihejoni fenë e allahut nëpërmjet xhihadit në rrugën e allahut. Shkoni përpara, o muxhahadë në rrugë të allahut. Terrorizoni armiqtë e allahut dhe kërkoni vdekjen në çdo vend që mund ta gjeni atë, sepse dynjasë do t’i vijë fundi, kurse ahireti është i përjetshëm. Dhe i bekuar është ai i cili largohet nga kjo dynja në Ramazan dhe e takon zotin e tij në një prej këtyre ditëve të mëshirës. Kështu që kapni armët, kapni armët, o ushtarët e shtetit islamik! Dhe luftoni, luftoni”.

⁴⁴ *Shqiptarja.com*, “ISIS formon “brigadën e Ballkanit” 20 luftëtarë të gatshëm për luftë”, 31 gusht 2014; po ashtu edhe në: *www.shekulli.com*; *www.bota sot*, 31 gusht 2014.

50, dhe i të kthyerve nga 70 në 90).⁴⁵

Shifrat kanë ndryshuar që pas këtij referimi të 2014 (me *llogaritjen e të kthyerve*). Ka ndër ata që janë kthyer të zhgënjyer dhe i janë rikthyer jetës normale në vend, ndërkohë që pjesa tjetër deklarorin se nuk kishin ndërmend të ktheheshin. Video në internet i tregojnë ata duke djegur pasaportat në shenjë refuzimi simbolik të njohjes së shtetit nga ata vijnë, pati video ku edhe vullnetarë nga Kosova dogjën pasaportën kosovare.⁴⁶

Ndërsa në fillimet flitej për vullnetarë dhe motivet ishin nga më të ndryshmet tashmë bëhet fjalë për luftëtarë të huaj, të cilët shkojnë në Siri/Irak të vetëdijshëm për çfarë po shkojnë dhe kujt do t'i bashkohen. Rreziku më i madh qëndron pikërisht në këtë kategori.”Tashmë situata ka evoluar, ISIS është shndëruar pika fundore e përfundimit të vullnetarëve që janë aktualisht pjesë e terrenit të konfliktit”.⁴⁷

Pavarësisht adresimeve ligjore, përforcimit të masave të sigurisë, kontrolleve kufitare, kufizimeve të tjera, thirrjet për rekrutime (*në rrjete sociale*) kanë vazhduar. Në gusht 2014, shteti islamik publikoi një thirrje për rekrutime potenciale në gjuhën angleze në revistën Dabiq online. Thirrja përshkruante udhëtimin drejt Irakut dhe Sirisë si analog me *hijrah*, duke revokuar një pjesë të historisë së islamit në të cilën profeti dhe mbështetësit e tij të hershëm ndjenë persekutimin në Mekë për sigurinë e Yathrib (Medina) dhe përdorën më vonë Yathrib si një bazë për fushatat e tjera të mëpasshme në gadishullin arabik. Në thirrje thuhej: çdo profesionist mysliman që ka vonuar këtë xhihad në të kaluarën duhet tani ta verë atë prioritet numër një t'i përgjigjet kësaj *hixhrajë* sidomos pas krijimit të shtetit islamik Ky kalifat ka nevojë më tepër se kurrë për ekspertë, profesionistë dhe specialist që mund të kontribuojnë në forcimin e strukturave të tij dhe të vijnë në ndihmë vëllezërve të tyre myslimanë⁴⁸. ISIS vazhdon të jetë “i suksesshëm” në përdorimin e mediave sociale për rekrutime. “Ka një thirrje realisht globale nga ISIS. Ata janë aq të adaptueshëm me medien sociale sa që nëpërmjet kësaj po arrijnë të infektojnë individë në shkallë të parapë globale”⁴⁹.

7. E ardhmja e kërcënimit

“Ecuria nga vullnetar në terrorist nuk është lineare, as dhe e pashmangshme dhe shumica e njerëzve që kthehen nga lufta në Siri mund të mos jenë kërcënim terrorist, vështirësia është se si mund të dallohen ato.”⁵⁰ . . .”Pothuajse të gjithë ata

⁴⁵ Timothy Holman, “Foreign Fighters from the Western Balkans in Syria”, *CTC Sentinel*, 30 qershor, 2014. (Shih edhe hulumtimin e kryer nga “Qendra Ndërkombëtare për Studimin e Radikalizmit” në Kolegjin Mbretëror në Londër, në territorin e kontrolluar nga Shteti Islamik ndodhen 150 luftëtarë nga Kosova, 90 nga Shqipëria, 70 nga Serbia, 330 nga Bosnje-Hercegovina, 12 nga Maqedonia).

⁴⁶ Pamje video, 24 maj 2014: “Shqiptarët e Sirisë djegin pasaportat”; gjendet në: <https://www.youtube.com/watch?v=523mBk9S1fY>,

⁴⁷ Mark Wiggins, “Analysis: ISIS domestic threat foreign solutions”, *KVUE*, 2014.

⁴⁸ *Islamic State's, Dabiq magazine*, mars-prill 2015.

⁴⁹ Erin Banco, “Why Do People Join ISIS? The Psychology Of A Terrorist”, *International Business Times*, 13 nëntor, 2015. (Nisur nga kjo masë përdorimi dhe propagandë, “Qendra Strategjike e Kundërterrorizmit për Komunikimet” ka përgatitur dhe publikuar në internet në gjuhën angleze dhe arabe një video kundër-propagandë me synime edukative dhe reflektuese për të kontrastuar retorikën e ISIS me realitetin; shih “US Mocks ISIS with Propaganda Video to Fight Militants In ‘Welcome To ISIS Land’”. Materialet në video janë marrë edhe nga vetë propaganda në videot e shtetit islamik, aktet terroriste, mizoritë, duke synuar të demonstrojë hipokrizinë e një organizate.)

⁵⁰ Pamje video: “Foreign fighters in Iraq and Syria: Where do they come from”; gjendet në: <https://www.ctc.usma.edu/.../foreign-fighters-from-the>.

që luftuan kundër Bashkimit Sovjetik në Afganistan u bënë terroristë më pas, megjithëse rrethanat ishin të ndryshme.”⁵¹

Sipas disa studiuesve ekziston rreziku i organizmit të selektuar të kthimit të vullnetarëve dhe përdorimit të tyre për akte terroriste në vendet e origjinës ndoshta deri selektive për në vendet e koalicionit ndërkombëtar kundër ISIS.⁵²

Kërcënimet nga xhihadistë ballkanas nuk kanë munguar në videot e shpërndara si pjesë edhe e fushatës propagandistike të organizatës. Ishim mësuar disi të shikonim kërcënime ndaj targeteve perëndimore kryesisht SHBA. Por nuk kanë munguar kërcënimet direkt për akte terroriste edhe ndaj vendit tonë, Kosovës dhe vendeve të tjera të Ballkanit, ç’ka do të thotë se vëmendja e ISIS karshi Ballkanit është shtuar.⁵³

Në mars 2014, 13 individë u arrestuan për lidhje me terrorizmin, me akuza për rekrutim të rreth 70 individëve për t’iu bashkuar al Nusras në fillimet e konfliktit dhe më pas shtetit islamik. Nëntë prej tyre po përballen me gjykimin në Tiranë. E njëjta gjë ka ndodhur edhe në Kosovë ku janë arrestuar deri tani rreth 100 individë, përfshi edhe një numër drejtuesish komuniteti fetar apo figura të lidhura me Bashkësinë islame të Kosovës, dhe një pjesë e tyre janë liruar për mungesë provash për lidhje të tyre direkt me terrorizmin.⁵⁴

“Ne nuk e dimë se ata do veprojnë sot apo nesër, por çfarë ne dimë është që në 10-15 vjet, jo thjesht muajin e ardhshëm, do të përbëjnë një kërcënim. Ata kanë marrë trajnim ushtarak, kanë krijuar rrjetet e tyre, e kemi parë këtë me luftëtarët që luftuan ish-sovjetikët në Afganistan në vitet 1990. Të tjerë u kthyen në shtëpitë e tyre në Libi, Pakistan, dhe atje ashtu si shokët e tyre në Afganistan u shndërruan në elitë lidhësi të xhihadit të ri...”⁵⁵

“Nëse ka pasur ndonjëherë një sfidë në botën e sotme të ndërvarur që nuk mund të përballen nga një vend i vetëm është ky: terroristë që kalojnë kufij dhe kërcënojnë të ndërmarrin dhunë”⁵⁶.

Në kundërpërgjigje të përforsimit të masave të sigurisë, adresimeve ligjore, fokusit nga agjencitë e zbatimit të ligjit dhe inteligjencës, rekrutuesit po përdorin përherë e më shumë komunikime më të sofistikuar, duke e bërë kapjen e tyre më të vështirë nga agjencitë e inteligjencës dhe ato të zbatimit të ligjit. Një sfidë tjetër që vështirëson punën e tyre është edhe mungesa e një bazë të dhënash globalisht me identitetet dhe karakteristikat e luftëtarëve të huaj. Përdorimi i shumë transiteve apo kombinimi ajër-tokë, tokë-ajër, ajër-ajër-tokë-ajër, e ka bërë më të vështirë identifikimin e motivit të udhëtimit. Ka edhe raste ku edhe pas largimit në vendet e origjinës, vazhdojnë të mbajnë kontakte në rrjete sociale dhe mbeten kështu të

⁵¹ Hayrudin Somun, Today’s Zaman, “Mujahideen’ from Balkans in Syria”; gjendet në: www.todayszaman.com/op-ed_mujahideen-from-balkan.

⁵² Sheldon Filger “Does the islamic state pose a threat to coalition partners against ISIS” available at www.opensource.gov.

⁵³ www.telegafi.com/lajme/isis-kercenon-serish-ballkanin-2-66995.html: “ISIS kërcënon sërish Ballkanin: Gëzohuni Ballkan! Jeni afër ditëve më të mira. Po ju vijjnë myslimanët! Ne jemi një kalifat islamik.”, thuhet ndër të tjera në video-mesazhin që brenda pak orësh u fshi nga kanali “Youtube”, shih edhe “indeks online”, 9 gusht 2014: “Lajmërohet edhe një xhihadist shqiptar në Siri; thotë se do kthehet me koka të prera: Pas Lavdrim Muhaxherit, edhe një xhihadist nga Kosova është lajmëruar në Siri. Në një video të publikuar në internet, ai këndon në arabisht dhe betohet se do të kthehet në Kosovë me koka të prera.”

⁵⁴ Gazeta Express, 22 janar 2014; Balkan insight, 3 mars 2014

⁵⁵ Peter Keumann, ekspert, 14 prill, 2015.

⁵⁶ Presidenti Obama, shtator 2014, cituar në “Final report of the task force on combating terrorists and foreign fighters travels”, shtator 2015.

radikalizuar gjithë kohën edhe pse e kanë lënë fushën e betejës. Luftëtarët e huaj janë motiv i fuqisë së ISIS. Ata arrijnë të zëvendësojnë luftëtarët e vrarë menjëherë.

“Ne mendojmë se çështja më e vështirë qëndron te lufta kundër luftëtarëve të huaj. Kërcënimi mbetet eminent pasi kthimi i atyre për kanë luftuar përkrah shtetit islamik, mund të ndërmarrin akte terroriste kur të kthehen në vendet e tyre. Një nga nëntë xhihadistë perëndimore kanë ndërmarrë sulme kur janë kthyer nga rajoni i konfliktit në vendet e tyre. Edhe pse rreth 10 përqind, është gjithsesi një shifër shqetësuese duke u nisur nga fakti që 25.000 ekstremistë kanë shkuar me dëshirën e tyre atje. Aktet e kryera nga të kthyerit janë më vdekjeprurëse edhe nga përmasat.⁵⁷

8. Përballja me kërcënimin

Çështja e luftëtarëve të huaj dhe rrezikut afatgjatë që ata paraqesin pas kthimit të tyre në vendet e origjinës ka gjetur një vëmendje të madhe ndërkombëtare. Në të gjitha dokumentet, vlerësimet apo raportet si ndërkombëtare, amerikane, evropiane, organizma, institute etj nënvizohet fort rreziku në terma afatgjatë që përbën kthimi i luftëtarëve të huaj në vendet e origjinës. Fokusi vihet në koordinimin e përpjekjeve për t’u përballur me fenomenin si shkëmbimi i informacionit, bashkëpunimi dhe koordinimi midis agjencive të inteligjencës me ato të zbatimit të ligjit; ngritja e kapaciteteve të duhura, monitorimi dhe ndërprerja e financimeve; menaxhimi dhe kontrolli kufitar etj.⁵⁸

Në 24 shtator 2014, Presidenti Obama drejtoi një sesion në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara me fokus përforcimin e përpjekjeve për një përgjigje ndërkombëtare kërcënimit që paraqesin luftëtarët e huaj. Sesioni konkludoi me adoptimin e një rezolute⁵⁹, e cila u kërkon shteteve anëtare sigurojnë me ligjet e tyre të brendshme penalizmin e shtetasve të tyre apo të tjerëve që kalojnë nga territori i tyre për krime që lidhen me luftëtarë të huaj, kufizime mbi tregti armësh, ndalim të tregtisë me pasuri kulturore të Sirisë dhe Irakut si dhe vendosi një mekanizëm raportimi për implementimin ndërkombëtarisht të rezolutave që kanë lidhje me këtë çështje. Edhe në nivel të Bashkimit Evropian, 28 vendet anëtare i kanë dhënë një vëmendje të veçantë kësaj çështjeje në një sërë takimesh në nivel ministrash. Në shkurt 2015 Parlamenti European kaloi një rezolutë për masat kundërterrorizëm. Aktet terroriste në Paris dhe Kopenhagën në fillimet e 2015 injektuan urgjencë dhe një moment të ri në iniciativat evropiane në luftën kundër fenomenit duke rritur shkëmbimin e informacionit nëpërmjet organizmave si EUROPOL⁶⁰ dhe EUROJUST⁶¹; u finalizua një sistem i gjerë rekordi të dhënash për grumbullimin e të dhënave mbi pasagjerët e linjave ajrore, përforcimi i kontrolleve kufitare, parandalimi i radikalizimit të mëtejshëm nëpërmjet gjurmimit

Xharo, M.
«Ekstremizmi
i dhunshëm
kërcënim
potencial
afatgjatë»

Policimi
dhe
Siguria
nr.1, 2015

⁵⁷ Homeland Security Committee, *Final report of the Task Force on combating terrorists and foreign fighter taravel*; shih edhe, Thomas Hegghammer, “Should I Stay or Should I Go? Explaining Variation in Western Jihadists Choice between Domestic and Foreign fighting”, *American Political Science Review*, shkurt 2013, doi: 10.1017/S0003055412000615.

⁵⁸ The United States Congress, “European Fighters in Syria and Iraq: Assessments, Responses, and Issues for the United States, paper”, *US Congressional Report*, 27 prill, 2015.

⁵⁹ *U.N. Security Council Resolution 2178*, miratuar në 12 shkurt, 2015

⁶⁰ Agjenci e BE-së përgjegjëse për inteligjencën kriminale.

⁶¹ Agjenci e BE-së përgjegjëse për koordinimin hetimor për krimet ndërkufitare.

dhe heqjes nga interneti të përmbajtjeve që promovojnë terrorizmin etj⁶².

Përveç rolit të agjencive të inteligjencës në grumbullimin e informacionit në funksion të monitorimit parandalimit të kërcënimit, edhe roli i agjencive të zbatimit të ligjit, strukturat e policisë mbetet thelbësor në përballjen me këtë kërcënim. Në kohën kur fenomeni i luftëtarëve të huaj që kalojnë kufij vazhdon, sfida prioritare mbetet që informacioni dhe të dhënat e agjencive të zbatimit të ligjit të jenë të aksesueshme në kohë në pikat kufitare sidomos në ato rajone dhe pika kufitare të identifikuar tashmë si rrugë kalimi të luftëtarëve të huaj. Për këtë INTERPOL ka dhënë një kontribut të qenësishëm⁶³ duke zhvilluar programe shkëmbimi efikase për të dhënat në kohë reale për të ndihmuar autoritetet e zbatimit të ligjit për të marrë masa dhe koordinuar ato si baza e të dhënave nominale me të dhëna personale të individëve të dyshuara për aktivitet kriminal që kërkohen nga çdo vend, baza e të dhënave të dokumenteve të udhëtimit të vjedhura apo të humbura, grupe pune mbi çështjen e luftëtarëve të huaj që përfshijnë vend anëtarë nga të gjitha rajonet dhe organizata ndërkombëtare të cilat mbledhen rregullisht.⁶⁴ Sekretari i Përgjithshëm i Interpolit, Jürgen Stock, theksoi rëndësinë e madhe që ka shkëmbimi i informacionit mbi luftëtarët e huaj në samitin e liderëve në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. Një ndërveprim dhe fleksibilitet më i madh për të autorizuar agjencitë e zbatimit të ligjit të ndërveprojnë me Interpolin në kohë reale pasi çdo e dhënë ndihmon të gjithë.⁶⁵

Në këtë kuadër edhe vendi unë jep/merr kontribut të rëndësishëm në këtë drejtim. Politikat e vendit tonë në luftën kundër terrorizmit në përgjithësi dhe ekstremizmit të dhunshëm në veçanti janë të bazuara në respektimin e të drejtave të njeriut, zbatim të ligjit dhe bashkëpunim ndërkombëtar i suksesshëm. Shqipëria është nga vendet e para që iu përgjigj kësaj sfide globale, duke marrë masat e duhura ligjore në nivel kombëtar.⁶⁶ Shqipëria ka ratifikuar të gjitha konventat kundër terrorizmit të OKB dhe KE dhe protokollat e lidhura me to; është tashmë vend anëtar i NATO-s dhe kontribuues me kontingjente të FA qysh në krye të herës nga "Iraqi Freedom", Afganistan deri në koalicionin ndërkombëtar kundër ISIS, si dhe iniciativa rajonale si SECI⁶⁷, BSEC⁶⁸ AII⁶⁹, CEI⁷⁰, SECEP⁷¹; ka një

⁶² Në mars 2015 ministrat e brendshëm të BE orientuan EUROPOLIN të ngrinte një njësi referuese interneti (Internet Referral Unit) në ndihmë të luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm. Njësia monitoron përmbajtjet terroriste në internet dhe platformat e medieve sociale dhe punon me dhënësin e shërbimit për ta hequr këtë përmbajtje.)

⁶³ INTERPOL, www.interpol.int/.../Terrorism/Counter-Terrorism-Fusio...; INTERPOL ka ngritur edhe një qendër globale për shkëmbim inteligjence për kundërterrorizmin (Counter terrorism fusion center) e cila investigon hierarkitë organizative, trajnimet, financimi, metodat dhe motivet e grupeve terroriste dhe një projekt konkret për çështjen e luftëtarëve të huaj "Foreign Terrorist Fighters FTF" (https://www.thegctf.org/.../14Sept19_The+Hague-Marr). Një projekt ambicioz dedikuar luftëtarëve të huaj në rajonet e konfliktit, e krijuar në korrik 2013, me synimin e adresimit të shkëmbimit të informacionit dhe të dhënave kyçe për identifikimin e luftëtarëve të huaj. Konsideron shkëmbimin e informacionit si thelbësor në identifikimin e luftëtarëve të huaj dhe ndalimin e tyre të kalojnë kufijtë. Interpoli inkurajon aktivisht vendet të shkëmbejnë të dhëna dhe informacion nëpërmjet sistemeve të sigurta të shkëmbimit.

⁶⁴ INTERPOL, www.interpol.int/home page

⁶⁵ INTERPOL, "INTERPOL's activities against the foreign terrorist fighter threat", (publikuar me rastin e Samitit të liderëve për luftën kundër ISIS dhe ekstremizmit të dhunshëm), UN, New York: 29 shtator 2015.

⁶⁶ Committee of experts on terrorism (codexter) profiles on counter-terrorist capacity- Albania, nëntor 2014

⁶⁷ Procesi i bashkëpunimit të Evropës Juglindore.

⁶⁸ Organizata e bashkëpunimit të Detit të Zi.

⁶⁹ Iniciativa adriatiko-joniane.

⁷⁰ Iniciativa europiano-qendrore.

⁷¹ South-Eastern European Cooperation Process.

Xharo, M.
«Ekstremizmi i dhunshëm kërcënim potencial afatgjatë»

Policimi dhe Siguria
nr.1, 2015

legjislacion të pasur dhe të plotë kombëtar që adreson çështjen e financimit të terrorizmit, pastrimit të parave, rekrutimeve, luftëtarëve të huaj; janë bërë amendamentet e nevojshme në reflektim të Konventës Evropiane për parandalimin e terrorizmit, etj.⁷²

Këshilli i Ministrave ka aprovuar kontributin për qeverinë e Republikës së Irakut në kuadër të koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit.⁷³ Ministria e Brendshme krijoi Drejtorinë e Antiterrorit në Policinë e Shtetit,⁷⁴ me shtrirje në rrethe, e cila po luan një rol të rëndësishëm në përpjekjet e vendit kundër terrorizmit. Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave⁷⁵ është përgjegjëse për koordinimin me institucionet financiare në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Agjencitë e inteligjencës në vend (SHISH,⁷⁶ AISM⁷⁷) kanë përfunduar strukturat e tyre kundërterrorizëm dhe kanë partneritete të vlerësueshme me shërbimet homologe partnere, duke dhënë kështu një kontribut thelbësor në luftën kundër këtij kërcënimi.

9. Rekomandime

1. Edhe pse një vend simbol i harmonisë fetare me faktor politik e social mbështetës të kontributit domethënës që jep vendi në luftën kundër terrorizmit në kuadër të sigurisë kolektive e globale, numri i luftëtarëve shqipfolës në rajonin e konfliktit (*përfshi edhe nga diaspora*) nuk e bëjnë vendin tonë imun ndaj këtij kërcënimi. Progres Raporti 2015 rekomandonte ngritje kapacitetesh për të parandaluar radikalizimin, përfshi masa adekuate për të adresuar fenomenin e luftëtarëve të huaj.⁷⁸

2. Ndërsa konflikti sirian vazhdon, një valë e madhe refugjatësh sirianë ka gjetur të papërgatitur Evropën në menaxhimin efikas të situatës. Përveç çështjes humanitare trajtimit, strehimit, regjistrimit të refugjatëve, respektimit të së drejtave të njeriut, kjo valë mund të përdoret nga ISIS si mundësi për të dërguar xhihadistë për të kryer akte terroriste e zënë rrënjë për formim celulash në këto vende. Aktet terroriste në Paris, 13 nëntor 2015⁷⁹, dëshmojnë se ISIS tashmë po e bën këtë. Edhe pse i pakonfirmuar ende, ndërrimi i itinerarit të mundshëm drejt rrugëve ballkanike mund të vendosë agjencitë e inteligjencës dhe ato të zbatimit të ligjit para sfidave të mungesës së kapaciteteve profesionale njerëzore/infrastrukturore për identifikimin, monitorimin, parandalimin.

4. Përçarjet dhe ambiciet mes grupimeve për sferë influence mund të çojnë luftëtarët shqipfolës në ndërmarrje aktesh terroriste edhe në vendet e tyre të

⁷² Ka përmirësuar dhe adresuar edhe çështjen e vullnetarëve të huaj duke bërë ndryshime esenciale në kodin penal, neni 265/a, “pjesëmarrja në formacione ushtarake, organizata ushtarake ose paraushtarake në një konflikt të armatosur që zhvillohet në një vend të huaj apo pjesëmarrja në ndonjë tip trajnimi të ndërmarrë nga këto struktura pa qenë shtetas në një vend të huaj apo anëtar i forcave të armatosura i njëjës prej palëve në konflikt është e dënueshme me burgim nga tre deri tetë vjet”.

⁷³ VKM nr. 543, datë 19.08.2014.

⁷⁴ Urdhër i MB nr. 548/7, 17.10.2014.

⁷⁵ E njohur si Intelligence Financial Unit, partnere dhe kontribuuese e njëjësive homologe, me kontribute të rëndësishme në luftën për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

⁷⁶ Shërbimi Informativ Shtetëror www.shish.gov.al/.

⁷⁷ Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes. www.mod.gov.al/.

⁷⁸ EU Progres Report 2015 for Albania, pp 49.

⁷⁹ Të paktën njëri nga terroristët ishte i infiltuar në radhët e refugjatëve sirianë, deri me pasaportë siriane.

originës si mjet “për t’u bërë prezent dhe krijuar identitet në radhët e ISIS-it”.

5. Kthimi i luftëtarëve në vend përbën një sfidë të shumëfishtë: për institucionet e inteligjencës dhe agjencive të zbatimit të ligjit për të monitoruar aktivitetin e tyre në kthim, bërë diferencimin midis atyre që kthehen të zhgënjyer, të mashtruar dhe të bindur për t’u kthyer jetës normale me ata që janë radikalizuar tashmë dhe kanë synime e plane konkrete; për institucionet e shtetit për të hartuar plane gjithëpërfshirëse për integrimin në jetën ekonomike dhe sociale të vendit, për komunitetin mysliman shqiptar për të për të mos lënë shteg rrymave radikale. Mënyra e trajtimit nga autoritetet shtetërore të vullnetarëve të kthyer (*problem ky jo vetëm i yni*), do të ketë një ndikim të rëndësishëm në sjelljen e tyre në të ardhmen.

6. Vizita e Papës së Shenjtë në vendin tonë, tregoi se institucionet e inteligjencës dhe sigurisë koordinuan dhe ofruan kushte sigurie maksimale për një vizitë tejet të suksesshme që do mbetet gjatë në memorien tonë historike. Institucionet e inteligjencës, sigurisë dhe strukturat e policisë u angazhuan në një koordinim të paparë, shkëmbim informacioni në kohë dhe *pa asnjë xhelozie institucionale*. Mësimi i nxjerrë përtej një vizite, do ishte koordinim, bashkëpunim i vazhdueshëm dhe shkëmbim informacioni në kohë e vijimësi. Një copëz informacioni që nuk duket domethënëse për një institucion mund të jetë thelbësor për institucionin tjetër.

7. Krimi dhe terroristët i kanë sofistikuar mënyrat e veprimit, komunikimit, hapësira dixhitale, rrjetet sociale ua kanë “*mundësuar*” këtë.⁸⁰Përdorimi i gjerë i rrjeteve sociale për propagandë, rekrutime, financime, radikalizim imponon ngritjen e kapaciteteve infrastrukturore e njerëzore të afta për monitorim të fenomenit. Prioritet u duhet dhënë edhe krijimit/përforcimit të njësive analitike në strukturat përgjegjëse për kundërterrorizmin të agjencive të inteligjencës dhe zbatimit të ligjit, trajnime të vazhdueshme, përforcim kapacitetesh analitike profesionale njerëzore (*asnjë mjet shkencor nuk e ka zëvendësuar deri më sot gjykimin e analistit*).

8. Ndërkohë që në strukturat tona të inteligjencës/ sigurisë/ zbatimit të ligjit janë ndërtuar partneritete të qëndrueshme e lavdërueshme me homologë e partnerë, ka mangësi në bashkëpunim të tillë në nivel ekspertësh në plan kombëtar. Një rëndësi e veçantë i duhet kushtuar takimeve, paneleve analitike, përtej *mureve të sekretit institucional* për hartim të integruar vlerësimesh afatshkurtra, afatmesme, afatgjata të kërcënimit terrorist që do ndihmonte vendimmarrjen strategjike në adresim me politika efikase të luftës kundër këtij fenomeni. Panele të tilla mund të organizohen edhe nga studiues të fushës së sigurisë me akademikë e përfaqësues të shoqërisë civile.

9. Aktet terroriste në Paris, “një 11 shtator evropian”, dëshmim i intensitetit të kësaj vale terrorizmi, tregon më së miri se është koha “që duhet të flasim të gjithë” dhe perceptojmë nivelin real të kërcënimit, pjesë e një strategjie, e cila nuk është vetëm ekskluziviteti i strukturave përgjegjëse të shtetit por më gjithëpërfshirëse. Vetëm një qasje gjithëpërfshirëse ndaj këtij fenomeni do mund të ndihmonte në parandalimin

Xharo, M.
«Ekstremizmi i dhunshëm kërcënim potencial afatgjatë»

⁸⁰ The Brookings Project, “The ISIS tweter census-Definining and describing the population of ISIS supporters on Tweter”, mars 2015

⁸¹ OSCE, *Parandalimi i terrorizmit dhe lufta kundër ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm që favorizojnë terrorizmin: qasja e policimit në komunitet*, gjendet: www.osce.org/sq/secretariat/123186?download=true

⁸² Po aty

e radikalizmit dhe monitorimin/neutralizimin e ekstremizmit të dhunshëm.

10. Mbrojtja e publikut të gjerë nga terrorizmi është shndërruar në një detyrë madhore dhe me shumë sfida për policinë.⁸¹ Më shumë duhet bërë në drejtim të komunikimit me publikun. Publiku i gjerë duhet të kuptojë natyrën e kërcënimit, mënyrën sesi duhet të reagojë në rast emergjence, cilat janë të drejtat që ai gëzon, ku ta raportojë informacionin, rolin e policisë dhe publikut në luftën kundër terrorizmit. Duhet rritur edhe ndërveprimi institucional ku edhe inspektori i thjeshtë i policisë të jetë në gjendje të njohë dhe t'u përçojë në kohë oficerëve të antiterrorit informacionin që është relevant.

11. Është shumë e rëndësishme që përpjekjet në luftën kundër terrorizmit të mos jenë diskriminuese apo që ato pa dashje të jenë stigmatizuese ndaj ndonjë feje apo besimi fetar në veçanti.⁸²

Dhe së fundmi do të ritheksoja fjalët e Presidentit Obama në samitin e liderëve për luftën kundër ISIS dhe ekstremizmit të dhunshëm “Varfëria nuk shkakton terrorizëm, por siç kemi parë në Lindjen e Mesme, Afrikën e Veriut kur njerëzit, kryesisht të rinjtë, janë të varfër dhe të pa shpresë apo të poshtëruar nga padrejtësia, korrupsioni, kjo mund të mbjellë pakënaqësi që terroristët mund t'i shfrytëzojnë që tregojnë se pse zhvillimi i qëndrueshëm, krijimi i oportuniteteve dhe dinjiteti kryesisht për të rinjtë është pjesë e luftës kundër terrorizmit të dhunshëm. Pra rruga reale drejt një stabiliteti të qëndrueshëm dhe progresi nuk është më pak demokraci, por besoj është më shumë demokraci në termat e lirisë së fjalës, lirisë së besimit, shtetit ligjor, shoqëri civile të forta.”

Referenca

1. Presidenti Obama, 2014, “Final report of the task force on combating terrorists and foreign fighters travels”, shtator 2015.
2. UN, “The United Nations Global Counter Terrorism Strategy” (Strategjia e OKB-së në luftën kundër terrorizmit).
3. Al-Baghdadi, “Give good news to the believers: The declaration of the Islamic State in Iraq and Al-Sham”, [www.Opensource.gov/Analysis on ISIS](http://www.Opensource.gov/Analysis%20on%20ISIS).
4. Janine Davidson dhe Emerson Brookings në “Counsel for Foreign Relations”, gjendet në: www.cfr.org.
5. Stuart Gottlieb, “Four reasons ISIS is a threat to US homeland”, gjendet në: “The national interest Magazine” 20 shtator 2014.
6. Afzal Ashraf, “The myth of the caliphate and the Islamic State”, gjendet elektronikisht në: www.aljazeera.com/.../myth-caliphate-islamic-state-2014, 10 korrik 2014.
7. Muharib al-Jaburi, “al-`Ilan `an qiyam dawlat al-`Iraq al-Islamiyya,” 15 janar 2007.
8. Abu Umar al-Baghdadi, “wa-yamkurun wa-yamkur Allah,” 15 shtator 2007.
9. Haylamaz, Resit, “Abu Bakr: The Pinnacle of Truthfulness (Paperback)”, 2013.
10. Afzal Ashraf, “The myth of the caliphate and the Islamic State”, gjendet në: www.aljazeera.com/.../myth-caliphate-islamic-state-2014, 10 korrik 2014.
11. J.M Berger, “Who’s winning the war to become a jihadi superpower?”, foreignpolicy.com, 2 shtator, 2014.
12. STRATFOR, “Stratfor Global Intelligence: Analyzing Differences between al Qaeda and The Islamic State”, gjendet në: <https://www.stratfor.com/.../conversation-analyzing-diff>.
13. Demyan Kudryavtsev, The Moscow Times Online in English, (ueb-faqe në gjuhën angleze): <http://www.themoscowtimes.com/>.
14. Thomas Jocelyn, “Zawahiri argues Islamic state’s caliphate is illegitimate in newly released message”, The long war, journal online, 9 shtator, 2015.

15. Reuters, "Al Qaeda chief urges lone wolf attacks, militant unity", 13 shtator, 2015.
16. Vasudevan Sridharan, "Al-Qaeda: Ayman al-Zawahiri urges jihadis to unite against Russia and West", International Business times, online, 2 nëntor, 2015.
17. Dabiq online, Nr. 7, 2015.
18. CNN, 13 nëntor, 2015.
19. Daily mail online , 21 nëntor, 2015.
20. Walid Shoebat, referuar nga Jack Moore, "Ten state solution", International business time, 2 shtator 2014.
21. Jack Moore, referuar Walid Shoebat, International business time, 2 shtator 2014.
22. Stuart Gottlieb, "Four reasons ISIS is a threat to America homeland", The national Interest magazine, 20 shtator, 2014. 32 Defense One, Samiti "Koha e të gjithave" organizuar nga Revista online "Defense One" me pjesëmarrje nga të gjitha institucionet e sigurisë së SHBA, gjendet në: www.defenseone.com/feature/defense-one-summit-2015/ Defense one Summit. www.washingtontimes.com, 4 tetor, 2010.
23. Laura Smith-Spark and Noisette Martel, "U.S. Official: 10,000 ISIS, Fighters Killed in 9 Months," CNN, 3 qershor, 2015, <http://www.cnn.com>.
24. Al-Ghabban, "There are thousands of ISIS elements from than 100 countries enter Iraq and Syria by fac. Shafaq", gjendet në: <http://www.shafaaq.com/sh2>.
25. Chanchal Kumar, "Islamic state of Iraq and Syria a global threat: international strategy to counter the threat". Në: Journal of social sciences and humanity, vol nr 1, No4, 2015, pp 345.
26. National Intelligence Council, "Mapping the global future, Report of the National Intelligence Council's 2020" - Projekt i bazuar edhe në konsultime me ekspertë joqeveritarë botërore, dhjetor 2004.
27. CNN, "Akte të koordinuara terroriste në Paris në 13 nëntor 2015 ku u vranë 130 persona dhe plagosën më shumë se 350".
28. Joseph A. Carter; Shiraz Maher; Peter R. Neumann. "Measuring Importance and Influence in Syrian Foreign Fighter Networks", The international center for the study of radicalization and political violence (ICSR) report, f.13
29. www.reporter.al, "Dhjetëra fëmijë shqiptarë pengje të xhihadistëve në Siri", 16 dhjetor, 2014.
30. www.shekulli.com online, "Xhihadistët e ISIS-it, mesazh edhe në gjuhën shqipe: Kërkoni vdekjen në çdo vend.
31. Timothy Holman, "Foreign Fighters from the Western Balkans in Syria", CTC Sentinel, 30 qershor, 2014.
32. Mark Wiggins, "Analysis: ISIS domestic threat foreign solutions", KVUE, 2014.
33. "Islamic State's Dabiq magazine", mars-prill 2015.
34. Erin Banco, "Why Do People Join ISIS? The Psychology Of A Terrorist", International Business Times, 13 nëntor, 2015. 50 Pamje video: "Foreign fighters in Iraq and Syria: Where do they come from"; gjendet në: <https://www.ctc.usma.edu/.../foreign-fighters-from-the>.
35. Hayrudin Somun, Today's Zaman, "Mujahideen' from Balkans in Syria"; gjendet në: www.todayszaman.com/op-ed-mujahideen-from-balkan.
36. Sheldon Filger, "Does the islamic state pose a threat to coalition partners against ISIS", www.opensource.gov.
37. www.telegrafi.com/lajme/isis-kercenon-serish-ballkanin-2-66995.html: "ISIS kërcënon sërish Ballkanin"
38. Gazeta Express , 22 janar 2014; Balkan insight, 3 mars 2014.
39. Peter Keumann, ekspert, 14 prill, 2015.
40. Presidenti Obama, shtator 2014, "Final report of the task force on combating terrorists and foreign fighters travels", shtator 2015.
41. Homeland Security Committee, "Final report of the Task Force on combating terrorists and foreign fighter travel", American Political Science Review, shkurt 2013.
42. The United States Congress, "European Fighters in Syria and Iraq: Assessments, Responses, and Issues for the United States, paper", US Congressional report, 27 prill, 2015.
43. U.N. Security Council Resolution 2178, miratuar në 12 shkurt, 2015.
44. INTERPOL, "INTERPOL's activities against the foreign terrorist fighter threat", UN, New York: 29 shtator 2015.
45. Committee of experts on terrorism (codexter) profiles on counter-terrorist capacity- Albania, nëntor 2014.
46. VKM nr. 543, datë 19.08.2014.
47. Urdhër i MB nr. 548/7, 17.10.2014.
48. Shërbimi Informativ Shtetëror www.shish.gov.al/.
49. Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes. www.mod.gov.al/.
50. EU Progres Report 2015 for Albania.
51. The Brookings Project, "The ISIS tweter census-Definining and describing the population of ISIS supporters on Tweter", mars 2015.
52. OSCE, "Parandalimi i terrorizmit dhe lufta kundër ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm që favorizojnë terrorizmin: qasja e policimit në komunitet", gjendet: www.osce.org/sq/secretariat/123186?download=true.

Xhara, M.
«Ekstremizmi i dhunshëm kërcënim potencial afatgjatë»

Policimi dhe Siguria
nr.1, 2015

Hetimi i vetëvrasjes



■ **Dr. Sofokli DUKA**
Akademia e Sigurisë



■ **Dr. Stavri SINJARI**
Akademia e Sigurisë

Abstrakt

Vetëvrasja ngërthen në vetvete dukuri dhe fenomene sociale, kriminologjike, kriminale, humane etj. Vetëvrasja si dukuri humane, aktualisht në shumicën e legjislacioneve penale botërore nuk përbën vepër penale, por mund të lidhet direkt ose indirekt me një veprimtari kriminale. Është pikërisht hetimi i veprës të vetëvrasjes ajo veprimtari, e cila sqaron dhe dokumenton elementët e mësipërm dhe vërteton plotësisht nëse ndodhemi përpara një vepre vetëvrasje të thjeshtë apo ajo është pasojë, rrjedhojë apo simulim i një vepre tjetër penale.

Vetëvrasja në përgjithësi, edhe pse karakterizohet nga një trend rritje nga viti në vit, është një fenomen i injoruar dhe i pa vlerësuar si duhet nga shoqëria, shteti dhe institucionet, gjë që argumentohet me mungesën e institucioneve, bazës ligjore dhe instrumenteve për parandalimin e saj dhe rehabilitimin e viktimave të saj. Por të njëjtin vlerësim pasqyron edhe niveli i hetimit të vetëvrasjes, i krahasuar me hetimin e veprave të tjera penale.

Për një hetim sa më të plotë, objektiv dhe profesional të vetëvrasjes, duhet të njihen mirë mekanizmi i kryerjes së vetëvrasjes: krijimi i kushteve dhe mjeteve të vetëvrasjes, tentativa për vetëvrasje, paravetëvrasja, vetëdëmtimi, dallimi i vetëvrasjes nga vrasja, vdekja natyrale, vdekja aksidentale, vetëvrasja nga pakujdesia; bashkëpunimi në vetëvrasje, shtytja në vetëvrasje, shkaktimi i vetëvrasjes, vetëvrasja si pasojë e një veprimtarie kriminale, si dhe shenjat kryesore që duhet të gjenden tek viktima dhe vendi i ngjarjes, sipas mënyrave të realizimit të vetëvrasjes.

Ndër objektivat kryesore të hetimit të vetëvrasjes, parësore duhet të jenë ato të vërtetimit apo përfjashimit të ekzistencës së elementëve të një vepre penale që paraprin, shoqëron apo realizon vetëvrasjen. Në përgjithësi hetimet e deritanishme të vetëvrasjes në praktikën shqiptare, shoqërohen me veprime të thjeshta dhe të lehta hetimore, duke evituar hetimin proaktiv dhe karakterin zbulues të hetimit.

Fjalëkyçe:

vetëvrasje; kushte dhe mjete të vetëvrasjes, tentativa për vetëvrasje, paravetëvrasja, vetëdëmtimi, vrasja, simulimi i vrasjes si vetëvrasje, vdekja natyrale, vdekja aksidentale, vetëvrasja nga pakujdesia; bashkëpunimi në vetëvrasje, shtytja në vetëvrasje, shkaktimi i vetëvrasjes.

HYRJE

Vetëvrasja ka qenë dhe është një problem shqetësues mbarëbotëror për të gjitha shoqëritë dhe epokat. Ky fenomen është bërë objekt studimi i një sërë shkencash: filozofike, mjekësore, psikologjike, sociologjike, kriminologjike etj. Mjaft filozofë, shkencëtarë e sociologë si Emil Dyrheim, kanë shkruar volume të tëra për fenomenin e vetëvrasjes, por në Shqipëri, ku numri i vetëvrasjeve ka shënuar rritje nga viti në vit, kjo fushë ende nuk njihet sa duhet teorikisht. Përpjekjet shqiptare, për t'i dhënë vlerësimin e duhur këtij problemi dhe për ta trajtuar e parandaluar shkencërisht, kanë qenë sporadike.

Përveç humbjeve të mjaft jetëve njerëzore, fenomeni i vetëvrasjes ka edhe kosto sociale, psikologjike dhe financiare për shoqërinë dhe shtetin. Kushdo mund të jetë një viktimë e mundshme e vetëvrasjes dhe kushdo mund të jetë person i prekur nga kjo vepër. Prandaj është e domosdoshme që cilido të ketë njohuritë e zakonshme mbi veçoritë e lindjes, zhvillimit, realizimit dhe parandalimit të këtij fenomeni, për ta evituar atë nga vetvetja dhe nga të tjerët.

Akti i vetëvrasjes është një veprim, i cili ka një sërë veçorish në aspektin e shkaqeve, rrethanave dhe faktorëve që e lindin dhe e favorizojnë; të lindjes së mendimit, shfaqjes së tij, përgatitjes, tentativës për ta realizuar dhe realizimin; format, metodat dhe mjetet që përdoren për këtë qëllim, si dhe format e metodat e parandalimit.¹

Gjithashtu, vetëvrasja si dukuri ka karakter historik. Qëndrimi ndaj saj ka evoluar dhe ndryshuar në etapa të ndryshme historike. Pro dhe kundër saj, ka koncepte dhe teori të ndryshme filozofike dhe fetare. Në këtë këndvështrim, parandalimi i vetëvrasjeve merr një rëndësi të veçantë, në kuadër të së cilit rol kryesor lot edhe procesi i hetimit të vetëvrasjes.

1. Vlerësimi i fenomenit të vetëvrasjes

Vetëvrasja është objekt pune për një sërë institucionesh shtetërore dhe shoqërore, por për Policinë e shtetit, ajo është një objekt pune i veçantë.

Jo vetëm kur tentohet apo kryhet, por edhe kur shfaq shenjat e saj, vetëvrasja është dhe duhet të jetë objekt pune i policisë. Është pikërisht ajo që e administron këtë vepër dhe realizon hetimin e saj. Gjatë këtij procesi, Policia e Shtetit, ka një sërë detyrimesh ligjore, për të sqaruar shkaqet dhe rrethanat e kryerjes në kuadër

¹ Van Heeringen, K.dhe Hawton, K. "Suicide", në: Lancet, vol. 373, no 9672, prill 2009, f. 1372-81

të parandalimit të këtij fenomeni, si dhe për të përjashtuar mundësinë e simulimit të një vrasjeje si vetëvrasje, për të vërtetuar ose përjashtuar pasojën e vetëvrasjes si rezultat i krimeve të tjera në përgjithësi dhe krimeve seksuale në veçanti, për të zbuluar mjetet kriminale të kryerjes së aktit, mbajtja e të cilave përbën vepër penale, për të diferencuar autorët e shkaktimit të vetëvrasjes etj. Policia, si strukture e specializuar, kur vihet në dijeni për mundësinë e kryerjes së një vetëvrasjeje, ndërhyr me mjetet dhe metodat e saj për ta parandaluar atë, ku edhe në këtë rrafsh nuk kanë munguar rastet. Është detyrë e policisë që, nëpërmjet analizave dhe studimeve, t'iu japë rekomandimet e nevojshme strukturave të tjera të shoqërisë dhe shtetit, për parandalimin e këtij fenomeni.

Në kuadër të parandalimit, kërkohet që veprimtaria në funksion të tij, të institucionalizohet. Disa nga elementet fillestarë të këtij procesi mund të jenë: aktet normative për evidentimin, ezaurimin dhe parandalimin e vetëvrasjeve, rehabilitimin e viktimave, shtimi i funksioneve organike për vetëvrasjet, përmirësimi dhe pasurimi i sistemit statistikor, shtimi i njohurive teorike dhe profesionale për këtë fenomen në programin mësimor të Akademisë së Sigurisë dhe fondin e strukturave të hetimit të krimit. Për një hetim gjithëpërfshirës, objektiv dhe profesional të vetëvrasjes, është e domosdoshme të njihen veçoritë e shfaqjes, lindjes, përgatitjes dhe realizimit të kësaj vepre, të ngjashmërisë, dallimeve dhe lidhjeve me vepra të tjera penale, me qëllim që të vërtetohen plotësisht ose të përjashtohen ekzistenca e elementëve të kësaj vepre.

2. Dallimet e vetëvrasjes me vepra të tjera penale dhe jo penale

Gjatë procesit të hetimit është e domosdoshme të bëhet dallimi midis vetëvrasjes dhe veprave të tjera të ngjashme si dhe lidhja e saj me vepra të tjera penale, të cilat kanë sjellë si pasojë vetëvrasjen, apo e kanë simuluar atë si të tillë.

2.1 Paravetëvrasja

Ndodh që një person të ndërmarrë një aksion që i ngjan tentativës së vetëvrasjes. Nëpërmjet saj, ai mund të dëshirojë të japë një mesazh ose të realizojë një qëllim konkret, më së shumti, të tërheqë vëmendjen e të tjerëve, apo të bëjë një thirrje për ndihmë. Në këto raste nuk kemi të bëjmë me akt vetëvrasës, apo tentativë të saj. Një nga veçoritë e aktit paravetëvrasës, është përsëritja e veprimeve të këtij karakteri nga i njëjti individ. Pavarësisht qëllimit gjatë dhe pas kryerjes së këtyre akteve, tek të dëmtuarit ndodhin reaksione të forta psikike, të cilat, në të ardhmen, mund të motivojnë një tentativë të vërtetë vetëvrasjeje. Gjeste vetëvrasjeje, më tepër ndërmarrin adoleshentët dhe të rinjtë, të cilët përjetojnë probleme psikosociale dhe paraqesin shenja ankthi e shqetësimi.²

Por raste të tilla gjenden edhe në mosha më të rritura. Nëpërmjet këtyre veprimeve, ata nuk duan të vdesin, por të realizojnë qëllime të tjera. Disa prej këtyre qëllimeve, mund të jenë përpjekjet për të shpëtuar nga dhimbjet shpirtërore, për të tërhequr vëmendjen nga një veprim i rëndë dhe i gabuar, për të mënjeluar

² Miller, David. *Child and Adolescent Suicidal Behavior: School-Based Prevention, Assessment, and Intervention*. Guilford Press, 2011, p. 46.

një ndëshkim të mundshëm, për të transmetuar një mesazh, për të tërhequr vëmendjen e mjedisit përreth për përmirësimin e kushteve sociale e shpirtërore etj. Pikërisht për këtë arsye, personat në fjalë nuk përzgjedhin metoda shumë të dhunshme dhe me pasojë të menjëhershme, apo mjete të rrezikshme, ndërsa tentativa është gjithmonë e metë.³

Në fakt, ajo nuk është një tentativë vetëvrasjeje, por një provë e përmasave të lehta. Kjo kategori personash, nuk vuan nga sëmundje të rënda psikike dhe gjithashtu nuk shquhet për depresion të një shkalle të lartë, ndërkohë që rol të rëndësishëm në ndërmarrjen e këtyre akteve marrin faktorët psikologjikë dhe ata socialë, të mpleksur me rrethana të tilla si konfliktet familjare, ndikimi i alkooli, drogës, botës së krimit, bixhozit, mosmarrëveshjeve ndërpersonale etj. Një akt paravetëvrasjeje, mund të mund të luhet në të njëjtën skenë si ajo e një tentative vetëvrasjeje, gjë që hetimi duhet ta ketë parasysh në dallimin midis tyre.

2.2 Vetëdëmtimi

Vetëdëmtimi dhe vetëvrasja, janë dy nocione të ndryshme. Veprimet vetëdëmtuese edhe pse ngjajnë, nuk konsiderohen tentativë vetëvrasjeje. Individit që ka një mendim të konsoliduar vetëvrasës, me përjashtim kur synon simulimin, nuk ndërmerr aktin e vetëdëmtimit, por drejtpërdrejt atë të vetëvrasjes. Vetëdëmtimi kryhet nga një person mbi trupin e tij, me ose pa ndërgjegje. Ky dëmtim mund të ketë si shkak emocionet e papërbalueshme, ngjarjet e jashtëzakonshme apo arsye të tjera. Individët vetëdëmtues, përdorin shpesh praktikën e vetëvrasjes, prerjen e organeve jetike, helmim, overdoza, djegie apo plagosje, por gjithmonë pa dëshiruar të vdesin.⁴

Në përgjithësi, këta persona nuk janë psikikisht të sëmurë, rrallë mund të vuajnë nga sëmundje të tjera, si dhe nuk shquhen për depresion të përparuar. Më të prekura nga ky fenomen janë femrat e moshës mbi 35 vjeç, me probleme dhe konflikte sociale. Shkalla e personave vetëdëmtues për personat mbi 15 vjeç në Evropë është 0.14 për qind për meshkujt dhe 0.193 për qind për femrat. Mjaft prej tyre nuk kanë nevojë për trajtim spitalor. Këta individë, në kushtet e një gjendjeje të rënduar, në reaktionin e një krize, dëshirojnë të dënojnë dhe dëmtojnë vetveten. Qëllimi i tyre ndoshta është lehtësimi i dhimbjeve, ose transmetimi i ndjenjave të tyre në mjedisin e jashtëm, megjithëse shpesh herë këto motive janë komplekse dhe të turbullta. Vetëdëmtimi, është një metodë në përgjithësi jo vdekjeprurëse, me të cilin individit vetëdëmtues përplas pjesë të trupit në mur, pemë, shtyllë dhe vende të tjera të forta, godet trupin me sende të forta, si dru, gur, hekur etj., dëmton fytyrën ose pjesë të tjera të trupit, duke grisur, shqyer, gjakosur etj. Gjendje të tilla mund të ndodhin si rezultat i një lajmi të padëshiruar e të papritur, nga vdekja e një të afërmi, për humbje, dështime, dëshpërim të çastit, ndëshkim, dënim, arrestim etj. Në rastet e vdekjeve, shkulja e flokëve, goditja e kokës, e gjoksit, apo e zemrës, me grushte, një zakon edhe i ditëve të sotme, është i trashëguar nga ritet pagane. Kur tejkalohej intensiteti i goditjeve dhe shkalla e dëmtimeve trupore, mund të vijë si pasojë edhe vdekja e individit. Raporti midis tentativave për vetëvrasjeve dhe vetëdëmtimit është 6:1.⁵

³ Wilмотte, J. *Le suicide, psychothérapies et conduites suicidaires*. Mardaga, 1986, f. 10

⁴ O'Connor, Rory dhe Noel Sheehy. *Understanding suicidal behaviour*. Leicester: BPS Books, f. 33-37

⁵ McDougall, Tim; Armstrong, Marie; Trainor, Gemma. *Helping children and young people who self-harm: an introduction to self-harming and suicidal behaviours for health professionals*. Abingdon, Oxon: Routledge, 2010, f. 23.

2.3 Vrasja me dashje dhe nga pakujdesia

Vrasja, pavarësisht se jep të njëjtat pasoja si vetëvrasja - vdekjen e personit, ndryshe nga ajo, konsiderohet vepër penale. Në kuptimin juridik, vrasje konsiderohet vdekja e shkaktuar ndaj një njeriu, në mënyrë të kundërligjshme, me dashje ose nga pakujdesia. Meqenëse si vrasja edhe vetëvrasja sjellin të njëjtën pasojë - vdekjen, është e nevojshme që, qysh në fillim të hetimit, të përcaktohet mënyra e vdekjes. Një veprim i tillë, është i domosdoshëm për këto arsye:

a. Viktimat e vrasjes dhe vetëvrasjes, si dhe vendet e ngjarjes, shpesh herë kanë të njëjtën pamje. Në disa raste, ato janë identike, si, për shembull, në vdekjet me helmim, hedhjet nga lartësitë, mbytjet, varjet, shpimet me mjete të mprehta etj. Në shikimin e parë, është e pamundur të arrihet në një përfundim të saktë mbi natyrën e vdekjes. Versioni i parë që ngrihet në këto skena, është ai i vetëvrasjes, por s'përrjashtohen mundësitë që të ndodhemi edhe përpara krimit të vrasjes, gjë që duhet të shoqërohet me ngritjen dhe vërtetimin e një versioni të tillë.

b. Vrasja dhe vetëvrasja kryhen përafërsisht me të njëjtat metoda dhe mjete.

c. Autori, në mjaft raste, vrasjen e simulon⁶ si vetëvrasje, duke ndërtuar skenën e ngjarjes, duke zgjedhur dhe përdorur mjetet e krimit, duke krijuar prova shtesë dhe duke zhdukur gjurmët e krimit, për të krijuar alibi që vdekja të konsiderohet si vetëvrasje.

d. Edhe një vetëvrasje për qëllime hakmarrjeje apo interesa të tjera, mund të simulohet si vrasje, duke vepruar pak a shumë si më lart.

e. Nga vetë ngjashmëria e madhe e skenave midis vrasjes dhe vetëvrasjes, ekziston mundësia që edhe hetimi të gabojë, kur një gjë e tillë bëhet jo me qëllim, në përcaktimin e natyrës së vdekjes.

Dallimet midis vrasjes dhe vetëvrasjes janë të qarta, si në kuptimin teoriko-juridik edhe në atë praktik. Dallimet më thelbësore janë këto:

a. Tek krimi i vrasjes, metoda e veprimit nuk zgjidhet nga viktimat e po kështu edhe mjetet e krimit nuk përdoren nga ai, por nga autori.

b. Vrasja kryhet nga një person tjetër, ndërsa vetëvrasja realizohet kryesisht nga vetë viktimat.

c. Vrasja mund të kryhet me dashje ose nga pakujdesia, ndërsa vetëvrasja realizohet gjithmonë me dashje.

d. Qëllimi i vrasjes është vdekja e një personi tjetër, i cili nuk e dëshiron atë, ndërsa tek vetëvrasja është vdekja e e vetë autorit.

e. Tek vetëvrasja ekzistojnë në përgjithësi faktorët plotësues, të cilët gjenden tek viktimat ose vendi i ngjarjes.⁷

Në aspektin praktik, dallimi midis vrasjes dhe vetëvrasjes realizohet nëpërmjet aplikimit të metodikave të hetimit, përdorimit të mjeteve dhe teknikave shkencore, veprimeve të ndryshme hetimore, kërkimit, gjetjes, administrimit dhe vlerësimit të provave. Pa hyrë në këto imtësi, duhet theksuar se problemi më thelbësor në përcaktimin e natyrës së vdekjes është dallimi i simulimit të vrasjes si vetëvrasje.

⁶ University of Manchester Centre for Mental Health and Risk, *The National Confidential Inquiry into Suicide and Homicide by People with Mental Illness*.

Raport vjetor që jendet elektronike në:

http://www.medicinemanchester.ac.uk/cmhr/centreforsuicideprevention/nci/reports/annual_report_2012.pdf

Faqe e vizituar për herë të fundit në dhjetor 2015.

⁷ Maris, Ronald. *Comprehensive textbook of suicidology*. New York: Guilford Press, 2000, p. 540.

Këto raste iu përkasin më tepër vrasjeve në familje Por mund të ndeshemi përpara simulimit edhe në vrasje të natyrave të tjera.⁸

Tek vetëvrasja, të gjitha gjurmët e krimit duhet t'i përkasin viktimës dhe, çdo shmangie nga ky rregull, duhet të krijojë dyshime serioze për ekzistencën e vrasjes ose të vdekjeve aksidentale. Çdo vetëvrasje, ka veçoritë e saj të identifikimit. Rëndësi marrin gjurmët dhe provat suplementare, si mbetjet e barutit në dorën e viktimës, shenjat e dhunës, shenja të tjera që tregojnë rezistencë, pozicioni i viktimës dhe i mjeteve të krimit, letra të lëna nga viktimat etj., etj. E njëjta metodike ndiqet edhe në dallimin e simulimit të një vetëvrasjeje si vrasje. Si autorë të vrasjeve që simulohen si vetëvrasje, në përgjithësi janë personat më të afërt të viktimave, të cilët tregojnë kujdes të veçantë në simulimin e skenës së vetëvrasjes, prandaj është e vështirë që, në këto rrethana, të ketë dëshmi, apo edhe sinjale nga të afërmit, të cilat duhet të sigurohen në rrugë informative, duke ngritur dhe përjashtuar pas çdo vetëvrasjeje edhe versionin e vrasjes.⁹

Personat që realizojnë simulime të tilla, zakonisht mundohen të krijojnë një skenë sa më afër realitetit të vetëvrasjes. Por praktika hetimore ka treguar edhe të kundërtën, atë të prishjes së vendit të ngjarjes.

Vrasje 1993-2014

1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005
268	265	210	248	1542	573	496	275	208	179	144	119	131

2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	Shuma
87	105	88	89	124	135	130	5395

Shkalla:17.9; 269 në vit.

Vetëvrasje 2000-2014

Nr. 2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
1. 99	146	144	144	173	219	208	225	161	150	132	225	225	274	318

Shkalla:9.47, 189 në vit

Burimi: Drejtoria e Policisë së Shtetit:
Fondi i vrasjeve dhe vetëvrasjeve.

2.4 Vetëvrasja (vdekja) nga pakujdesia

Janë ato vetëvrasje ku tek viktimat mungon qëllimi, apo dëshira për të vdekur. Edhe pse janë vetëvrasje, ato kanë më tepër natyrën e vdekjeve aksidentale. Ndryshe nga vetëvrasjet në këtë rast ajo kryhet nga pakujdesia e viktimës. Personi, në këto raste, e parashikon se veprimi i tij mund të sjellë si pasojë vdekjen, por me mendjehetësi shpreson se do ta kapërcejë apo mënjanojë atë. Në vetëvrasjet nga pakujdesia në formën e besimit të tepruar, personi nuk e dëshiron vdekjen, por, megjithëse e ka parashikuar pasojën e mundshme, me ndërgjegje e lejon ardhjen e

Duka, S.
dhe
Sinjari, S.
«Hetimi
i vetëvrasjes»

Policimi
dhe
Siguria
nr.1, 2015

⁸ Shelly M, Moreau M. dhe Tubert-Bitter P. *Abus sexuel dans l'enfance et conduites à risque chez les gays.* AREMEDIA, 2006

⁹ Ladame, François. *Adolescence et suicide.* EME Éditions Sociales Françaises (ESF), 1980

saj. Personi nuk lejon me ndërgjegje ardhjen e pasojës, por lejon veprimet që sjellin këtë pasojë. Kështu, për shembull, një person duke luajtur me pistoletën e mbushur pa siguresë, ia drejton zemrës dhe e shkreh, duke shkaktuar vdekjen e menjëhershme të tij.

Vetëvrasjet nga pakujdesia

Nr	2001	2002	2003	2004	2005
1	18	2	7	6	3

*Burimi: Drejtoria e Policisë së Shtetit:
Fondi i vrasjeve dhe vetëvrasjeve.*

Numri i vetëvrasjeve nga pakujdesia, i krahasuar me vetëvrasjet, është shumë herë më i vogël, pasi mjaft prej tyre janë mundur të parandalohen. Viktima, në këto raste, ndryshe nga vetëvrasja, kërkon ndihmë e shpëtim. Vetëvrasje nga pakujdesia kanë ndodhur edhe nëpërmjet rënieve nga ballkonet, nga dritaret, lartësitë etj.

Vetëvrasja nga pakujdesia mund të kryhet në formën e neglizhencës, atëherë kur viktima edhe pse i ka të gjitha mundësitë dhe është i detyruar të parashikojë pasojat e veprimeve të tij që mund t'i sjellin vdekjen, nuk e bën një gjë të tillë. Lënia e helmeve në sirtarët e ilaçeve dhe pranë fëmijëve, mbajtja e armëve të gjahut dhe atyre pa leje në vende të pasigurta dhe të shoqëruara me municion, pusët e pambyllura, dritaret dhe ballkonet e pasiguruara, prizat e korrentit të paizoluara, mjetet zjarrvënëse në duart e fëmijëve dhe mjete e rrethana të tjera të kësaj natyre, kanë shkaktuar një sërë vdekjesh aksidentale apo vetëvrasje nga pakujdesia, sidomos nga radhët e të miturve, personave të pazotë për të vepruar dhe të moshuarve.

Nga ana e familjarëve, ekziston tendenca që vetëvrasjet t'i paraqesin si vdekje aksidentale, ose si vetëvrasje nga pakujdesia. Hetimi objektiv presupozon të vërtetojë natyrën e vdekjes, si dhe shkakun e saj.¹⁰

Vdekjet aksidentale mund të shkaktohen edhe nga lojëra të ndryshme. Por, kur si elemente të tyre shërbejnë mjete të njëjta me ato të vetëvrasjes, është vështirë të dallohen nëse janë vdekje aksidentale, apo vetëvrasje. Si të tilla, mund të konsiderohen loja me shall, lojë me shilarës (litar), loja e luftës, etj.

2.5 Vdekjet aksidentale

Vdekje aksidentale konsiderohen ato raste kur personi që ka shkaktuar vdekjen e tjetrit, ose viktima që e shkakton vetë atë, nuk ka pasur mundësi të parashikonte se veprimet apo mosveprimet e tij do të sillnin si pasojë vdekjen. Konstatimi nëse vdekja është vrasje, vetëvrasje apo vdekje aksidentale, bëhet në çdo rast konkret, nëpërmjet hetimit. Në mjaft raste, vdekjet aksidentale shkaktohen edhe si rezultat i veprimeve shoqërisht të rrezikshme dhe të kundërligjshme, si shkelja e rregullave të sigurimit në punë, shkelja e disiplinës në transport, shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, të mbrojtjes nga zjarri, të punimeve nën tokë e në lartësi, të përdorimit pa kriter dhe pa dijenitë e nevojshme për to të lëndëve plasëse e ndezëse, të objekteve nën presion etj. Vdekjet aksidentale dallohen nga vrasjet dhe vetëvrasjet

Duka, S.
dhe
Sinjari, S.
«Hetimi
i vetëvrasjes»

Policimi
dhe
Siguria
nr.1, 2015

¹⁰ Ajdacic-Gross V, Weiss MG, Ring M. "Methods of suicide: international suicide patterns derived from the WHO mortality database", në: *Bull. World Health Organ.*, vol. 86, no 9, shtator 2008, f. 726-32

në bazë të veçorive që paraqet realizimi i secilës formë të këtyre veprave.

Nr		2001	2002	2003	2004	2005
1	Vdekje aksidentale	104	167	167	135	161
2	Mbytje aksidentale	24	38	38	39	41

Burimi: Drejtoria e Policisë së Shtetit:
Fondi i vrasjeve dhe vetëvrasjeve.

Numri i vdekjeve aksidentale është 10 më i lartë se ai i vrasjeve dhe 123 me i ulët se ai i vetëvrasjeve. Vdekjet aksidentale më të shumta janë shënuar në sektorin e ndërtimit, gjatë punimeve nën tokë, nga korrenti dhe nga rrufeja. Rastet më të shumta të mbytjeve aksidentale, kanë ndodhur në sezonet e pushimeve nëpër plazhe, në stinën e verës dhe viktimat kanë qenë kryesisht gra dhe fëmijë. Nisur nga fakti se vdekjet dhe mbytjet aksidentale ndodhin në mjedise të hapura dhe në mënyrë publike, është vështirë simulimi i vrasjeve apo vetëvrasjeve si të tilla, megjithëse mundësitë ekzistojnë dhe tentativa të tilla ka pasur.

2.6 Vetëvrasjet me aksident automobilistik

Kuptimi i vdekjes nga aksidentet automobilistike, është i qartë. Mjeti automobilistik mund të përdoret edhe si mjet vrasës apo vetëvrasës. Pronarë mjetesh të tilla kanë preferuar të vetëvriten në automjetin e tyre me armë zjarri. Në vitet e mëparshme, ka pasur vetëvrasje që janë kryer duke u hedhur përpara mjeteve të qarkullimit. Vdekjet automobilistike kanë shkallën më të lartë të vdekjeve në grupin e vrasjeve, vetëvrasjeve dhe vdekjeve aksidentale, 12.1.

Praktika botërore ka mjaft raste të vetëvrasjes më mjete qarkullimi, si dhe të simulimit të vrasjes si aksident automobilistik, qoftë si drejtues mjeti ose si kalimtar. Në hetimin e aksidenteve automobilistike, kur ka dyshime apo prova, duhen ngritur edhe versionet e simulimit të vrasjes apo vetëvrasjes si aksident automobilistik.¹¹

2.7. Shkaktimi i vetëvrasjes

Shkaktimi i vetëvrasjes konsiderohet si veprimtari kriminale. Legjislacioni penal botëror mban të njëjtin qëndrim ndaj kësaj veprimtarie. Në legjislacionin penal shqiptar ekzistojnë dy nene të drejtpërdrejtë, ku parashikohet kjo vepër penale, si dhe disa nene të tjera, ku shkaktimi i vetëvrasjes është rrethanë cilësuese. Shkaktimi i vetëvrasjes është parashikuar si vepër penale në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë edhe në Kodin Penal Ushtarak. Kjo vepër penale ka dy momente kryesore: trajtimin e keq sistematik, si dhe sjelljet e tjera sistematike që prekin rëndë dinjitetin e personit, i cili, si pasojë e këtyre veprimeve, bëhet viktimë e vetëvrasjes apo tentativës për vetëvrasje. Trajtimi i keq sistematik, presupozon dhunën e vazhdueshme, dëbimin nga shtëpia të bashkëshortes shtatzënë apo personit të pazotë për të vepruar, lënien pa mjetet e domosdoshme të jetesës, si ushqimi, veshja, medikamentet mjekësore; rëndimin e tejskajshëm në punë, tej mundësive dhe aftësive, privimin e lirisë dhe të drejtave themelore njerëzore, si mbyllja në banesë apo bodrum, dhuna për të mos lejuar vazhdimin e shkollës,

Duka, S.
dhe
Sinjari, S.
«Hetimi
i vetëvrasjes»

Policimi
dhe
Siguria
nr.1, 2015

¹¹ O'Connor, Rory C.; Platt, Stephen; Gordon, Jacki., *International Handbook of Suicide Prevention: Research, Policy and Practice*. John Wiley and Sons, 2011, p. 34.

lidhjet intime; kryerja e akteve të turpshme etj. Ndërsa si sjellje sistematike që prekin rëndë dinjitetin e personit, mund të përmendim fyerjet sistematike, shpifjet, publikimin në opinion ose në media të dobësive të jetës intime vetjake, nëpërkëmbjen, talljet etj. Lidhja shkakësore kërkon që këto sjellje poshtëruese të jenë sistematike, të përsëritura disa herë, të kenë ndikuar në uljen e dinjitetit të personit, si pasojë e të cilave ai ndërmerret aktin e vetëvrasjes apo tenton të vetëvritet. Praktika shqiptare ka pasur disa raste kur vetëvrasja, në mënyrën më paradoksale, është ndikuar edhe nga veprime të ligjshme të personit materialisht përgjegjës ndaj viktimës, si kërkesë llogarie, vërejtje apo kritika të rënda, kufizime të lejueshme etj. Në këto raste, pavarësisht nëse ka ose jo lidhje shkakësore, nuk ekzistojnë elementet e veprës penale të shkakimit të vetëvrasjes.¹²

Pas simulimit të vrasjes si vetëvrasje, kjo veprë penale është dukuria e dytë që ndeshet më shpesh në fenomenin e vetëvrasjes. Subjekti i kësaj vepre mund të jetë personi që e ka viktimën në vartësi materiale apo çfarëdolloj vartësie tjetër Por subjekti i tillë mund të jetë kushdo që, nëpërmjet sjelljeve sistematike, ul dinjitetin e një individi: një lidhje e afërt, një i njohur, i panjohur, punëdhënës etj. Ky krim kryhet me dashje, drejtpërdrejt, përsa iu përket veprimeve që kanë të bëjnë me trajtimin dhe sjelljet, si dhe me dashje jo drejtpërdrejt apo nga pakujdesia, përsa i përket ardhjes së pasojave kriminale. Pretendimet për shkakim të vetëvrasjes nga të afërmit e viktimave janë gjithmonë më të larta se sa çështjet penale të filluara. E rëndësishme është që këto pretendime të vlerësohen në të gjitha rastet, ndërkohë që është hetimi ai që vërteton apo rrëzon bazueshmërinë e tyre.

2.8. Vetëvrasja si pasojë e një veprimtarie kriminale

Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, parashikohen katër vepra penale, (nenet 100-103) kur vetëvrasja konsiderohet si pasojë e një veprimtarie tjetër kriminale dhe konkretisht e krimeve të marrëdhënies seksuale. Në këto raste, kjo pasojë, vetëvrasja, vlerësohet si rrethanë cilësuese e sanksionit penal. Ky cilësim është parashikuar për veprat penale të marrëdhënies seksuale me: të mitura, me dhunë me të mitura të moshës 14-18 vjeç, me dhunë me të rritura, homoseksuale me dhunë me të rritur, dhe marrëdhënie seksuale me persona të pazotë për t'u mbrojtur. Sanksionet ndryshojnë raportet, në varësi me pazotësinë e viktimave për t'u mbrojtur ndaj këtyre akteve. Konstatimi i këtij fakti është problem i hetimit, gjë që zgjidhet rast pas rasti. Por, gjatë hetimit të çështjeve të vetëvrasjeve, sa herë që viktimat janë persona të kategorive të mësipërme, të mitura, adoleshentë të moshës 14-18 vjeç, femra të rritura, homoseksuale, si dhe persona të pazotë për t'u mbrojtur, si një nga versionet e ngritura për shkakun e vetëvrasjes/vdekjes, duhet të jetë edhe ai i kryerjes së marrëdhënies seksuale me dhunë apo në kushtet e pamundësisë për t'u mbrojtur.

Duka, S.
dhe
Sinjari, S.
«Hetimi
i vetëvrasjes»

Nr	G. Moshë	10-15	16-25	26-35	36-45	46-55	56-65	Mbi 66
1	%	56	64	36	36	35	32	27

Vetëvrasjet e femrave 2000-2006

Burimi: Drejtoria e Policisë së Shtetit:
Fondi i vrasjeve dhe vetëvrasjeve.

Tabela e mësipërme tregon numrin e vetëvrasjeve të femrave sipas grupmoshave.

¹² Gunnell D., Eddleston M., Phillips M.R., Konradsen F. "The global distribution of fatal pesticide self-poisoning: systematic review". *BMC Public Health* 7, 2007, f. 357.

Në përgjithësi, viktimat e krimeve të marrëdhënieve seksuale janë kryesisht nga këto grupmosha, pa përjashtuar edhe ato me moshë më të madhe. Gjatë hetimeve të vetëvrasjeve që iu përkasin këtyre femrave, nuk është vërtetuar ndonjë rast që ato të kenë qenë pasojë e krimeve në fushën e marrëdhënieve seksuale. Por ky version nuk është ngritur në të gjitha rastet, për të mos thënë që ai është ngritur shumë rrallë. Praktika shqiptare ka treguar se krimet në fushën e marrëdhënieve seksuale kanë dhënë si pasojë vetëvrasjen apo tentativën për vetëvrasje edhe në grupmoshat mbi 56 vjeç, gjë që argumenton se në grupmoshat më të reja prania e kësaj pasoje është më e mundshme. Rasti më tipik është ndoshta ai i zbuluar në muajin shkurt 2008, në Laknas të Tiranës, ku një baba-monstër, me ndërjegje dhe me qetësinë më të madhe, kishte plot njëmbëdhjetë vjet rresht që përdhunonte seksualisht të bijën. Kjo e fundit, një vajzë e zakonshme, me një formim të rëndomtë kulturor e social, në kushtet e një depresioni të thellë, duke mos pasur e gjetur asnjë rrugëdalje tjetër, kur edhe pasi kërkoi ndihmë nga nëna, vëllai më i madh dhe të afërmit, u këshillua të mos hapte gojë, se ishte turp i madh dhe çnderohej tërë familja dhe fisi, të paktën dy herë kishte tentuar të vetëvritej.

Legjislacioni penal shqiptar, për cilësimin e krimeve të marrëdhënieve seksuale, kërkon si pasojë aktin e realizuar të vetëvrasjes, duke e nënvleftësuar tentativën për vetëvrasje, problem ky që kërkon diskutim. Viktimat e krimeve seksuale, kur ndërmarrin aktin e vetëvrasjes, ndodhen në kushtet e ndikimit të faktorëve që krijohen gjatë dhe pas kryerjes së veprës kriminale ndaj tyre, kryesorët e të cilave mund të jenë stresi i lartë, depresioni i thellë, tronditja e shkallës së lartë psikike etj. Si pasojë e kësaj trysnie, ato kryejnë tentativën për vetëvrasje, e cila është një nga fazat e domosdoshme të realizimit të vetëvrasjes.¹³

Qëllimi i një tentative të tillë është vdekja. Duke përjashtuar rastet kur nga ky qëllim viktimat heq dorë në mënyrë vullnetare, në të gjitha rastet e tjera, ardhja e pasojës, shkaktimi ose jo i vdekjes nuk është më një çështje subjektive e viktimës, por e faktorëve dhe rrethanave të tjera. Në këtë këndvështrim, ka rëndësi vlerësimi i veprimeve dhe synimeve të viktimës në aspektin e anës objektive dhe anës subjektive të kryerjes së tentativës për vetëvrasje, ndërsa ardhja ose jo e pasojës është një akt formal. Vetë viktimat e dëshiron vdekjen, gjë për të cilën ka kryer të gjitha veprimet që ajo i ka quajtur të domosdoshme për ardhjen e saj. Dhe, ekzistojnë të gjitha mundësitë që ajo ta ndër marrë përsëri tentativën e dështuar të vetëvrasjes, në kushte dhe rrethana të tjera. Sondazhet tregojnë se mbi 50 për qind e personave që kanë një tentativë të dështuar vetëvrasjeje, e tentojnë përsëri këtë akt.¹⁴

Por, në mjaft raste, pasojat e tentativës së dështuar për vetëvrasje mund të jenë po aq të rënda sa edhe ato të vetëvrasjes dhe, konkretisht, kjo ndodh kur viktimat mund të pësojnë gjymtime të rënda dhe të përjetshme, paaftësi të plotë për punë, sëmundje të pashërueshme psikike etj., të cilat ligji aktual penal nuk i merr në konsideratë. Pa vazhduar më gjatë me trajtimin teorik të këtij problemi, mendoj se, si rrethanë cilësuese në sanksionet e neneve 100-103 të Kodit Penal, krahas vetëvrasjes, duhet shtuar edhe tentativa për vetëvrasje.

3. Shenjat dalluese të vetëvrasjes

Vetëvrasjet lënë shenjat e tyre të veçanta sipas formës së realizimit, të cilat

¹³ Geddes, John; Price, Jonathan; Gelder, Rebecca McKnight; me Michael; Mayou, Richard. *Psychiatry* (botimi i 4-t). Oxford: Oxford University Press, 2012, f. 62

¹⁴ Dwivedi, Yogesh. *The neurobiological basis of suicide*. Boca Raton, FL: Taylor & Francis/CRC Press, 2012, f. 166

janë të domosdoshme dhe kërkohen gjatë procesit të hetimit, për të dokumentuar se ndodhemi pikërisht përpara një veprë të tillë. Ky hetim ka si objektiv kryesor edhe vërtetimin apo përjashtimin e mundësisë së simulimit të një veprë tjetër penale që sjell si pasojë vdekjen, me vetëvrasje. Gjatë këtij hetimi merr rëndësi dokumentimi i faktorëve plotësues, të cilat nuk ekzistojnë në veprat e tjera penale.

Vetëvrasja me armë zjarri. Në përgjithësi personat që vetëvriten me armë zjarri, shënjojnë në organet më jetike, si në kokë, zemër e më rrallë në gjoks ose në fyt, duke e puqur armën me organin e trupit, në një kontakt të drejtpërdrejtë me të, duke mënjanuar veshjet. Kur organi jetik llogaritet mirë vdekja është e shpejtë, por jo e menjëhershme, kohë kjo e mjaftueshme për të kryer edhe ndonjë veprim të thjeshtë, pa mundur të prishë skenën e veprës.

Kufoma qëndron në pozicionin që është kryer vetëvrasja; arma e zjarrit, si rregull gjendet në dorën e viktimës, e shtrënguar fort dhe rrallë e lëshuar në afërsi të dorës. Në të gjitha rastet në dorën me të cilën është kryer shkrepja gjenden mbetjet e djegies së barutit.¹⁵

Vetëvrasja me armë zjarri, në përgjithësi rezulton të kryhet vetëm me një goditje, por praktika kriminalistike ka treguar se ajo mund të realizohet edhe me dy e më shumë goditje. Raste të tilla mund të ndodhin kur ajo kryhet me armë automatike dhe pozicioni i qitjes automatike është i qartë, si dhe në rastet kur goditja e parë bëhet në një organ jo jetik. Por tek vetëvrasjet me armë zjarri nuk mund të hasen plagë provuese, sikurse ndodh të vetëvrasjet me shpim.

Vetëvrasjet me armë zjarri mund të kombinohen edhe me djegie të trupit, ku si rregull vënia e flakës realizohet para qitjes. Në këto raste janë të pranishme ena e mbajtjes së lëndës djegëse, mjeti ndezës, si dhe pengesa t për të penguar kundërveprimin.

Vetëvrasja me armë zjarri, mund të shoqërohet edhe me mbetje trupore të shpërndara në vendin e ngjarjes, gjë që ndodh kur ajo kryhet me armë zjarri të gjatë, me rreze të gjerë veprimi, jo me puqje, por me një kënd qoftë edhe me pak gradë.

Vetëvrasja me varje. Në këto raste gjenden të gjitha shenjat që krijohen nga kjo lloj vdekje: gjurma e lakut në qafë, brazdë në formë patkoi, njollat kufomore të lokalizuara në pjesët e poshtme të trupit, dukja e majës së gjuhës, pranin e spermës dhe urinës në organin gjenital dhe në mbathje, pika hemorragjike në sy, në fytyrë, në qafë, në shpatulla etj, të cilat krijohen nga ndërprerja e qarkullimit të gjakut në tru. Si faktorë plotësues mund të llogarisim: vendosjen e pengesave për të ruajtur intimitetin e aktit dhe parandalimin e reagimit, mungesa e shenjave të dhunës, si dhe e rezistencës. Por, mund të ndodh që të ketë edhe ndonjë shenjë dhune apo rezistence, kur ky akt parashoqërohet me vetëdëmtim, apo kur rezistenca apo reagimi kryhet në mënyrë instiktive, apo për arsye të tjera që lidhen me anën subjektive të viktimës.

Vetëvrasja me helmim. Janë të pranishme simptomat e përgjithshme të vdekjeve me helmim: vjellja, shtangimi, paraliza, dëliri, ndryshimet në bebëzën e syrit, cianoza, aroma ose kundërmimi, shkuma e gojës, ndryshimet në lëkurë dhe

¹⁵ White, Tony. *Working with suicidal individuals: a guide to providing understanding, assessment and support.* London: Jessica Kingsley Publishers, 2010, f. 12

¹⁶ Quill, Constance E. Putnam; parathënie nga Timothy E. *Hospice or hemlock?: searching for heroic compassion.* Westport, Conn.: Praeger, 2002, f. 143

rraskapitja, ku ekspertiza ka mundësi të bëjë dallimin në se bëhet fjalë për sëmundje natyrore apo për vetëvrasje. Si faktorë plotësues mund të përmendim ato që janë tipike për skenën e vetëvrasjes me anë të varjes.

Vetëvrasja me mbytje në ujë. Jo të gjitha këto vetëvrasje lënë shenja dhe krijojnë faktorë plotësues. Të tilla gjenden në rastet kur viktimat lidh duart e këmbët, si dhe pesha të ndryshme, për të penguar kundërveprimin, si dhe realizuar zhytjen në fund të ujit. Por edhe këto shenja konsiderohen faktorë plotësues, kur në trup nuk gjenden shenja që vërtetojnë përdorimin e dhunës ndaj tij, por duke marrë në konsideratë gjithmonë edhe mundësinë e parashoqërimit të kësaj lloji vetëvrasjeje me vetëdëmtim. Si rregull, kjo vetëvrasje realizohet në vende ku ka thellësi uji, shumë rrallë në thellësi të cekëta, në brigje pa prani të personave të tjerë. Viktima zhytet ose shkon drejt thellësisë i veshur, duke lënë në breg veshjet e jashtme dhe të rënda si dhe sende të tjera personale. Për të vërtetuar në se ndodhemi përpara një skene vetëvrasjeje, mbytje aksidentale, apo vrasje të simuluar si mbytje në ujë, hetimi e ka të domosdoshme të kryej edhe një sërë veprimesh të tjera, jashtë vendit të ngjarjes. Për të dalluar një vetëmbytje reale apo të simuluar, kërkohet ekzistenca elementëve të domosdoshëm të kësaj lloji vdekjeje.¹⁷

Vetëvrasje me energji elektrike: Edhe në këto skena hetimi ndodhet përpara vështirësish reale për të vërtetuar në se ndodhemi përpara veprave të vetëvrasjes, vdekjes aksidentale, apo simulimit të vrasjes si vetëvrasje, pasi kjo lloji vetëvrasje mund të realizohet si në mënyrë fare të thjeshtë, ashtu edhe të komplikuar, ku në këto të fundit gjenden edhe faktorë plotësues. Si të tillë mund të evidencojmë krijimin e pengesave, për mos ndërhyrje në realizimin e veprës, lidhjen e trupit pranë sendeve të rënda apo të palëvizshme, për të evituar reagimin personal, mungesën e shenjave të përdorimit të dhunës etj.

Vetëvrasjet me prerje, shpim (therje): Forma më e përhapur është ajo e prerjes së damarëve, si dhe e prerjes apo depërtimit në organet më jetike të mjeteve të shpimit në organet më jetike, sidomos në zemër, apo gurmaz. Shenjat e veçanta të kësaj vepre janë: prania e mjetit shpues në ose pranë organit jetik, e gjakut në duart e viktimës, pozicioni i kufomës për afërsisht në ato rrethana që është kryer vepra, mungesa e reagimit dhe elementeve të përdorimit të dhunës.¹⁸

Vetëvrasja nëpërmjet hedhjes nga lartësitë: Në këto skena pothuajse mungojnë faktorët plotësues apo shenjat e veçanta të realizimit të kësaj vepre. Hetimi ndodhet përpara versionit të trefishtë: vdekje aksidentale, vetëvrasje, vrasje, për zgjidhjen e tyre pak gjasa ka të të orientojë vendngjarja.

Vetëvrasja nëpërmjet hedhjes përpara mjeteve të lëvizshme, kafshëve, sendeve apo mjediseve të dëmshme dhe të rrezikshme: kjo metodë parakupton hedhjen apo shkuarjen drejt mjeteve automobilistike apo të lëvizshme, kafshëve të egra mishngrënëse, gropave të shkrirjes së gëlqeres apo bitumit, si dhe mjediseve të tjera të ngjashme. Edhe në këto raste, hetimi ndodhet përpara versionit të trefishtë: vdekje aksidentale, vetëvrasje, vrasje, versione të cilat zgjidhen nëpërmjet veprimeve të ndryshme hetimore, ku si objektiv kryesor është verifikimi i jetës sociale të viktimës.

¹⁷ Robinson, (red) David Picard, Mike. *Emotion in motion: tourism, affect and transformation*. Farnham, Surrey: Ashgate, 2012, f. 176

¹⁸ Toland, John. *The Rising Sun: The Decline and Fall of the Japanese Empire 1936–1945*, Random House: 1970, f. 519

4. Përfundime

1. Gjatë hetimit të një vetëvrasje, në të gjitha rastet, pavarësisht se në pamje të parë mund të duket një situatë e thjeshtë, duhet të ngrihen të paktën tre versione: vetëvrasje, vdekje aksidentale/natyrale, vrasje.

2. Në të gjitha skenat e vetëvrasjes duhet të kërkohen dhe të gjenden faktorët e mundshëm plotësues, të cilat janë prova të pa kontestueshme të ekzistencës së kësaj vepre.

3. Objektivi kryesor në hetimin e vetëvrasjes është vërtetimi ose përjashtimi i simulimit të vrasjes apo një vepre tjetër penale që sjell si pasojë vdekjen, si vetëvrasje.

4. Por edhe në hetimin e vrasjes, kur ka dyshime të pranueshme, , duhet të ngrihet edhe versioni i simulimit të vetëvrasjes si vrasje.

5. Gjatë hetimit të vetëvrasjeve të femrave, sidomos minoreneve dhe adoleshenteve, apo personave të pazotë për të vepruar, duhet të ngrihet edhe versioni i realizimit të kësaj vepre, si pasoje, rrjedhojë apo lidhje me një veprimtari tjetër kriminale, sidomos në fushën e krimeve seksuale, shtytjes apo shkaktimit të vetëvrasjes.

6. Edhe gjatë hetimit të vdekjeve aksidentale, duhet të ngrihet versioni i vetëvrasjes apo vrasjes.

7. Gjatë sqarimit të procesit të simulimit, duhet të vlerësohen atë elementë, veprime, prova dhe fakte që devijojnë nga realizimi real dhe llogjik i kësaj vepre, paqartësitë, mangësitë dhe kundërshtitë.

Literaturë

1. Van Heeringen, K.dhe Hawton, K. "Suicide", në: *Lancet*, vol. 373, no 9672, prill 2009.
2. Miller, David. *Child and Adolescent Suicidal Behavior: School-Based Prevention, Assessment, and Intervention*. Guilford Press, 2011.
3. Wilmotte, J. *Le suicide, psychothérapies et conduites suicidaires*. Mardaga, 1986.
4. O'Connor, Rory dhe Noel Sheehy. *Understanding suicidal behaviour*. Leicester: BPS Books.
5. McDougall, Tim; Armstrong, Marie; Trainor, Gemma. *Helping children and young people who self-harm: an introduction to self-harming and suicidal behaviours for health professionals*. Abingdon, Oxon: Routledge, 2010.
6. University of Manchester Centre for Mental Health and Risk, *The National Confidential Inquiry into Suicide and Homicide by People with Mental Illness*, 2012.
7. Raport vjetor që jendet elektronike në:
8. http://www.medicine.manchester.ac.uk/cmhr/centreforsuicideprevention/nci/reports/annual_report_2012.pdf
9. Faqe e vizituar për herë të fundit në dhjetor 2015.
10. Maris, Ronald. *Comprehensive textbook of suicidology*. New York: Guilford Press, 2000.
11. Shelly M, Moreau M. Dhe Tubert-Bitter P. *Abus sexuel dans l'enfance et conduites à risque chez les gays*. AREMEDIA, 2006
12. Ladame, François. *Adolescence et suicide*. EME Éditions Sociales Françaises (ESF), 1980.
13. Ajdacic-Gross V, Weiss MG, Ring M. "Methods of suicide: international suicide patterns derived from the WHO mortality database", në: *Bull. World Health Organ.*, vol. 86, no 9, shtator 2008.
14. O'Connor, Rory C.; Platt, Stephen; Gordon, Jacki.. *International Handbook of Suicide Prevention: Research, Policy and Practice*. John Wiley and Sons, 2011.
15. Gunnell D., Eddleston M., Phillips M.R., Konradsen F. "The global distribution of fatal pesticide self-poisoning: systematic review". *BMC Public Health* 7, 2007.
16. Geddes, John; Price, Jonathan; Gelder, Rebecca McKnight; me Michael; Mayou, Richard. *Psychiatry (botimi i 4-t)*. Oxford: Oxford University Press, 2012.
17. Dwivedi, Yogesh. *The neurobiological basis of suicide*. Boca Raton, FL: Taylor & Francis/CRC Press, 2012.
18. White, Tony. *Working with suicidal individuals: a guide to providing understanding, assessment and support*. London: Jessica Kingsley Publishers, 2010.
19. Quill, Constance E. Putnam; parathënie nga Timothy E. *Hospice or hemlock?: searching for heroic compassion*. Westport, Conn.: Praeger, 2002.
20. Robinson, (red) David Picard, Mike. *Emotion in motion: tourism, affect and transformation*. Farnham, Surrey: Ashgate, 2012.
21. Toland, John. *The Rising Sun: The Decline and Fall of the Japanese Empire 1936-1945*, Random House: 1970.
22. Begeja, Skënder. *Kriminalistika I*. Tiranë: Erik, 2001.
23. Duka, Sofokli. *Vetëvrasjet, motivet për të jetuar*. Tiranë: Geer, 2008.
24. Durkheim, Emile. *Le suicide, etude de sociologie*. Paris: Quadrige/PUF, 1991.
25. Halili, Ragip. *Kriminologjia*. Prishtinë: 2008
26. Hysi, Vasilika. *Vetëvrasja, si mund ta frenojmë këtë krim*. Tiranë: 2008.
27. Uka, Emin. *Hakmarrja-autoriteti i egër njerëzor*. Prishtinë: 2008.
28. Uka, Emin. *Vetëvrasja, problem shoqëror*. Prishtinë: 2010.
29. Drejtoria e Policisë së Shtetit. *Fondi i vrasjeve dhe vetëvrasjeve*. Tiranë.
30. Arkiva e Akademisë së Sigurisë. *Historia e Policisë*. Tiranë.
31. Akademia e Sigurisë. *Fondi i Hetimit të Krimit*. Tiranë.

Duka, S.
dhe
Sinjari, S.
«Hetimi
i vetëvrasjes»

Policimi
dhe
Siguria
nr.1, 2015

Rëndësia e bashkëpunimit policor me organizatat partnere për efikasitet në luftën kundër krimit



■ **Dr. Myzafer ELEZI**
Akademia e Sigurisë

Abstrakt

Në kohën në të cilën po jetojmë krimi ka marrë përmasa të mëdha. Bëhet fjalë për ato lloje veprash penale të cilat prekin dy a më shumë shtete dhe që ndikojnë ndjeshëm në sigurinë e vendit dhe atë globale. Përmendim këtu krimet me natyrë terroriste të cilat kanë përballë të gjitha strukturat ligj zbatuese në fushën e sigurisë dhe drejtësisë, krimin e organizuar, veçanërisht trafikimin e njerëzve, kryesisht trafikimin e fëmijëve, të femrave për prostitucion, të organeve; trafikimin e lëndëve narkotike etj. Bashkëpunimi policor ndërkombëtar është një temë jo fort e trajtuar nga studiuesit e fushës. Gjenden literatura që trajtojnë këtë bashkëpunim, por jo posaçërisht të fokusuar tek nivelet dhe format e bashkëpunimit policor në nivel evropian apo më gjerë.

Në përgjithësi nuk ka një përkufizim standard që etiketon bashkëpunimin policor, por duke u nisur nga praktikat e veprimtarisë procedurale për kryerjen e shkëmbimit dhe koordinimit ndërmjet organizatave policore, si dhe nga përvoja personale, bashkëpunimi policor mund të përkufizohet si një aktivitet i ndërsjellë midis organizatave, agjencive të zbatimit të ligjit, që bazohet në parimet kryesore të fiksuar në dokumente të rëndësishme ndërkombëtare, me qëllim shkëmbimin e informacioneve, kryerjen e operacioneve të përbashkëta proaktive si dhe planifikimin e veprimeve të koordinuara midis tyre. Parë në këtë këndvështrim, duhet pranuar se hartimi dhe zbatimi në praktikë i një legjislacioni që ndihmon institucionet përkatëse në veprimtarinë e tyre, për parandalimin dhe luftën kundër krimit, shpeshherë është jo i plotë, dhe jo i zbatueshëm. Për këtë arsye bëhet i nevojshëm një studim më i plotë për të analizuar e pasqyruar situatën aktuale, si dhe për të dhënë disa rekomandime të cilat mund të sjellin ndryshim pozitiv në aspektin ligjor, institucional dhe operacional.

Fjalëkyçe:

bashkëpunim policor, marrëveshje, konventë, hetime të përbashkëta, krim i organizuar, ekstradim etj.

Elezi, M.
«Rëndësia e bashkëpunimit policor me organizatat partnere për efikasitet në luftën kundër krimit»

Policimi dhe Siguria
nr.1, 2015

Hyrje

Bashkëpunimi policor ndërmjet shteteve të ndryshme është një nga format e bashkëpunimit ndërkombëtar, i cili përfshin shkëmbimin e informacionit ndërmjet agjencive kombëtare e lokale të zbatimit të ligjit, por edhe operacione dhe hetime të përbashkëta kundër aktiviteteve kriminale. Objekti i punimit është bashkëpunimi policor ndërkombëtar kundër krimit. Nëpërmjet kësaj teme synohet pasqyrimi i rëndësisë së bashkëpunimi policor ndërkombëtar kundër krimit dhe aspekte të trajtimit ligjor dhe efektshmërisë, parë në këndvështrimin ligjor, institucional dhe operacional. Bashkëpunimi nënkupton koordinimin e masave dhe të veprimeve të palëve pjesëmarrëse për arritjen e një qëllimi të caktuar, i cili bazohet në marrëveshje dhe akte të tjera ndërkombëtare në të cilat Shqipëria është palë.

Bashkëpunimi policor ndërkombëtar s'është gjë tjetër, veçse "një aktivitet i ndërsjellë midis organizatave, agjencive të zbatimit të ligjit që bazohet në parimet kryesore të fiksuar në dokumente të rëndësishme ndërkombëtare me qëllim shkëmbimin e informacioneve, kryerjen e operacioneve të përbashkëta pro-aktive si dhe planifikimin e veprimeve të koordinuara midis tyre"¹. Ai bazohet në disa traktate të Këshillit të Evropës dhe Kombeve të Bashkuara (marrëveshje shumëpalëshe) dhe në marrëveshjet ndërmjet shteteve (marrëveshje dypalëshe).

1. Rëndësia e bashkëpunimit policor ndërkombëtar

Krimi i organizuar mund të ndodh brenda kufijve kombëtarë apo në dy e më shumë vende, gjë që mund të çojë në zhvillimin e hetimeve në disa juridiksione. Kështu që, në funksion të hetimeve është i domosdoshëm bashkëpunimi ndërmjet policive respektive. Bashkëpunimi policor ndërkombëtar është i rëndësishëm dhe ja vlen të studiohet për dy arsye kryesore:

Së pari, sepse aktivitetet e paligjshme, si krimi i organizuar, trafiket e të gjitha llojeve, terrorizmi etj, mund të shtrihen në disa shtete, pra, prekin disa juridiksione kombëtare, rrezikojnë sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e popullsisë. Këto aktivitete kriminale përballen suksesshëm vetëm përmes bashkëpunimit ndërkombëtar policor, si dhe agjencive ligjzbatuese.

Së dyti, sepse shkalla dhe efikasiteti i bashkëpunimi policor ndikon mbi ndjeshëm në sigurinë e çdo vendi përfshirë Shqipërinë, në marrëdhëniet mes

Elezi, M.
«Rëndësia e bashkëpunimit policor me organizatat partnere për efikasitet në luftën kundër krimit»

Policimi dhe Siguria
nr.1, 2015

¹ Shkëmbi, Hasan. *Tipologjitë e policimit të vendeve të Bashkimit Evropian*. Tiranë: shtëpia botuese GEER 2006, faqe 204.

shteteve (përfshi ato të Shqipërisë me shtete të tjera), si dhe në mirëqenien e çdo individi, grupi, shoqërie, shteti (përfshi ato shqiptare).

2. Baza ligjore për bashkëpunimin ndërkombëtar

Baza ligjore është thelbësore për bashkëpunimin ndërkombëtar. Përmes përcaktimit të saj, nëpunësi i drejtësisë penale duhet të jetë i sigurt se kompetenca po ushtrohet drejtë dhe rezultatet e bashkëpunimit do të përdoren sipas mënyrës së parashikuar në ligj. Verifikimi i bazës ligjore zakonisht siguron edhe informacion të rëndësishëm për objektin dhe natyrën e instrumentit përkatës të bashkëpunimit. Gjithashtu, si bazë ligjore për bashkëpunimin policor me vendet partnere shërben Kushtetuta e Shqipërisë dhe legjislacioni kombëtar penal e procedural, si dhe ligji organik i policisë. Konkretisht, neni 84 i ligjit për Policinë e Shtetit, citon: *“Policia bashkëpunon me polici të shteteve të tjera ose me organizata ndërkombëtare policore, bazuar në marrëveshjet ndërkombëtare dy ose shumëpalëshe”*.² Po kështu, si bazë ligjore shërbejnë edhe dokumentet e tjera ndërkombëtare, si; konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare, Traktati i Mastrichtit, 1992, (nenet 29 dhe 30 “Bashkëpunimi Policor”), Traktati i Lisbonës, (neni 69/F/G “Bashkëpunimi Policor”), Konventa Shengen, e vitit 1990, Konventa Europol, e vitit 1995, Traktati i Amsterdamit, i vitit 1997, Traktati Nicës, i vitit 2003, etj.

Më poshtë po citojmë disa dokumente ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, të cilat kanë në fokus bashkëpunimin ndërkombëtar kundër krimit:

- Synim parësor i Konventës së OKB-së kundër krimit të organizuar ndërkombëtar është: *“bashkëpunimi ndërkombëtar për parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar”*.³

- Qëllimi bazë i Protokollit të OKB-së për parandalimin, ndalimin dhe ndëshkimin e trafikimit të qenieve njerëzore, sidomos të grave dhe fëmijëve, i cili plotëson Konventën e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar është: *“nxitja e bashkëpunimit ndërkombëtar për parandalimin, ndalimin dhe ndëshkimin e trafikimit të qenieve njerëzore”*.⁴

- Qëllimi bazë i “Protokollit kundër kalimit kontrabandë të migruesve me tokë, det dhe ajër, i cili plotëson Konventën e OKB-së kundër krimit të organizuar ndërkombëtar” është: *“parandalimi dhe lufta kundër kalimit kontrabandë të migruesve, si edhe nxitja e bashkëpunimit midis Shteteve Palë për këtë qëllim, duke mbrojtur, në të njëjtën kohë, të drejtat e migruesve të kaluar kontrabandë”*.⁵ Në Konventë është përfshirë një deklaratë e cila thotë se veprimi i efektshëm për të parandaluar dhe luftuar kalimin kontrabandë të migruesve kërkon një qasje të plotë ndërkombëtare, përfshirë edhe bashkëpunimin, shkëmbimin e informacionit dhe masa të tjera të duhura.

- “Konventa Kuadër e OKB-së kundër korrupsionit”⁶ (UNCAC), theksojnë

² Ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, neni 84 “Bashkëpunimi ndërkombëtar”.

³ UNTOC - “Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar” është ratifikuar nga parlamenti shqiptar me Ligjin nr. 8920, datë 11.07.2002 “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar dhe dy Protokolleve Shtesë të saj”. Konventa u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në muajin nëntor të vitit 2000 dhe ka hyr në fuqi në muajin dhjetor të vitit 2003.

⁴ Protokollit i Palermos, 2000.

⁵ Protokollit i OKB për kontrabandën, miratuar në dhjetor 2000.

⁶ UNCAC - “Konventa Kuadër e OKB-së kundër Korrupsionit” e cila hyri në fuqi në vitin 2005.

rëndësinë qendrore të bashkëpunimit ndërkombëtar si një mjet me rëndësi kritike për eliminimin e bazave të kriminelëve.

- “Konventat Evropiane për ndihmën reciproke në çështjet penale dhe ekstradimin” dhe Protokollat e tyre i detyrojnë shtetet nënshkruese të miratojnë ligje të përbashkëta në fushat e ndihmës së ndërsjellët juridike dhe ekstradimit.

- “Konventa për bashkëpunimin policor për Evropën Juglindore” thekson: *“palët duhet ta forcojnë bashkëpunimin e Palëve të Kontraktuara në lidhje me luftën kundër rreziqeve që i kanosen sigurisë publike dhe/ose rendit publik si edhe në lidhje me parandalimin, zbulimin dhe hetimit policor të veprave penale”*.⁷

- “Marrëveshja ndërmjet qeverive të vendeve pjesëmarrëse në Bashkëpunimin Ekonomik të Detit të Zi, për bashkëpunimin në luftën kundër krimit, në mënyrë të veçantë, format e tij të organizuara”⁸ përcakton fushat dhe format⁹ e bashkëpunimit të ndërsjellët. Sipas marrëveshjes fusha e bashkëpunimit përfshin: parandalimin, shtypjen, zbulimin, mbylljen dhe investigimin e krimeve dhe në veçanti të:

“Akteve të terrorizmit, krimit të organizuar, trafikeve të qenieve njerëzore; aktiviteteve ndërkombëtare ilegale ekonomike dhe legalizimit të aktiviteteve (pastrimi i parasë) që rrjedhin nga aktivitetet kriminale; kontrabandës, aktiviteteve kriminale të lidhura me migracionin, kalimin ilegal të kufirit; falsifikimit të kartëmonedhave, kartave të kreditit, dokumenteve, sigurimeve dhe vlerave të tjera, si dhe çdo lloj dokumenti identiteti; krimet e dhunshme kundër jetës dhe pronës së njerëzve; korrupsionit, krimit ekologjik, krimit teknologjik, duke përfshirë krimin kompjuterik, etj”¹⁰.

3. Si realizohet bashkëpunimi me organizatat policore ndërkombëtare?

3.1 Bashkëpunimi policor përmes Interpolit

Një nga mënyrat e bashkëpunimit policor në nivel global realizohet nëpërmjet organizatës policore ndërkombëtare Interpol. Në vitin 1998 Shqipëria ka miratuar ligjin¹¹ për aderimin në këtë organizatë. Në nenin 1 të këtij ligji është parashikuar se: *“Republika e Shqipërisë aderon në Organizatën Ndërkombëtare të Policisë Kriminale - INTERPOL me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi në këtë organizatë, parashikuar në Kushtetutën e Interpolit”*. Në mënyrë që të arrijë qëllimet e saj me vendet anëtare, organizata Interpol mban lidhje dhe shkëmben informacion dhe të dhëna me ZQK-të e vendeve anëtare, në

⁷ Shih: Neni 1 i Konventës së Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore (PCC SEE), miratuar më datë 05.05.2006.

⁸ Ratifikuar me ligjin nr. 8512, datë 15.7.1999, Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet qeverive të vendeve pjesëmarrëse në Bashkëpunimin Ekonomik të Detit të Zi, për bashkëpunimin në luftën kundër krimit, në mënyrë të veçantë, format e tij të organizuara”, Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 23, faqe 809. Qeveritë e vendeve pjesëmarrëse të Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (BSEC) nënshkruese të Marrëveshjes janë: Republika e Shqipërisë, Republika e Armenisë, Republika e Azerbajxhanit, Republika e Bullgarisë, Gjeorgjia, Republika Helenike, Republika e Moldavisë, Rumania, Federata Ruse, Republika e Turqisë, Ukraina, në cilat më pas do të quhen “Palë”.

⁹ Format e bashkëpunimit i paraqet Neni 2 i kësaj Marrëveshjeje.

¹⁰ Shih: Neni 1 i Marrëveshjes ndërmjet qeverive të vendeve pjesëmarrëse në Bashkëpunimin Ekonomik të Detit të Zi, për bashkëpunimin në luftën kundër krimit, në mënyrë të veçantë, format e tij të organizuara”.

¹¹ Ligji nr. 8427 datë 14.12.1998, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Organizatën Ndërkombëtare të Policisë Kriminale - Interpol”. Fletore Zyrtare nr. 30, datë 23.12.1998, faqe 1157.

Elezi, M.
«Rëndësia e bashkëpunimit policor me organizatat partnere për efikasitet në luftën kundër krimit»

Policimi dhe Siguria
nr.1, 2015

funksion të misionit dhe vizionit të saj. Vizioni i organizatës është: “Ndërlidhje policore për një botë më të sigurt”, ndërsa misioni i saj: “Parandalimi dhe lufta kundër krimit nëpërmjet një bashkëpunimi policor ndërkombëtar të lartë”¹². Rëndësia qëndron në ndërlidhjen që siguron për çdo agjenci të zbatimit të ligjit në vendet anëtare, për të bërë të mundur përmirësimin e sigurisë publike. Misioni arrihet nëpërmjet katër funksione primare të organizatës, të cilat janë:

- a) Komunikim i sigurt dhe global policor (sistemi I24/7 i sigurt, i disponueshëm për të gjitha ZQK);
- b) Shërbime dhe arshiva globale për policinë (databas-e nominale, automjetesh, gjurmë gishtash, AND, vepra arti etj);
- c) Ndihmë shërbimeve policore (nëpërmjet zyrave specifike në Sekretariatit e Përgjithshëm);
- d) Trajnim policor dhe zhvillimi (nëpërmjet Sekretariatit të Përgjithshëm)¹³.

Interpoli u jep ndihmë vendeve anëtare nëpërmjet *Sistemit e ASF* dhe *database*-ve policore që ai ka, të cilat kontrollohen nëpërmjet sistemit I-24/7 nga çdo ZQK. *Sistemi e ASF* është një sistem që praktikisht lidh *database*-t e Interpolit me sistemin kombëtar të vendeve. Shqipëria është një nga vendet që e ka instaluar këtë sistem, ndërsa *database*-t ruajnë të dhëna të: gjurmëve të gishtave, dokumenteve të vjedhur ose të humbur, automjeteve të vjedhur, personave në kërkim ndërkombëtar, ADN, veprave të artit të vjedhura, si dhe imazhe të abuzimeve seksuale ndaj të miturve. Një ndër mënyrat më të rëndësishme të shkëmbimit të informacionit nëpërmjet kanalit të Interpolit janë kartelat e saj. Kartelat e Interpolit janë alerte ndërkombëtare që bëjnë të mundur shkëmbim të rëndësishëm informacioni kriminal në gjithë vendet anëtare. Ato publikohen nga Sekretariati i Përgjithshëm me kërkesë të ZQK-ve ose organizmave të autorizuar, mundësisht në të katër gjuhët zyrtare të organizatës: Anglisht, Frëngjisht, Spanjisht dhe Arabisht. Kartelat përmbajnë informacion të detajuar mbi identitetin e personit që është objekt i saj, mundësisht foto, gjurmë gishtash, profil AND, etj, si dhe një përmbledhje të shkurtër faktesh, informacion mbi dispozitat ligjore dhe mbi vendndodhjen e personit (në rastin e kartelës së kuqe)¹⁴.

Më poshtë po paraqesim disa tregues të bashkëpunimit policor ndërkombëtar përmes Interpol, lidhur me ekstradimin e personave.

Nga statistikat e mësipërme, arrihet në konkluzion se, nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale në fushën e ekstradimit reflekton angazhim dhe rezultate konkrete të strukturave të zbatimit të ligjit. Marrëveshjet dypalëshe të ekstradimit të tilla si, ajo me SHBA-në, Italinë, dhe Kosovën paraqesin rëndësi të veçantë si të vetmet marrëveshje nëpërmjet të cilave Shqipëria ka pranuar ekstradimin në kushte reciprociteti të shtetasve shqiptarë për jashtë shtetit. Duhet thënë se legjislacioni në fuqi parashikon mundësinë e ekstradimit të shtetasve shqiptarë, vetëm kur kjo disponohet me marrëveshje dypalëshe. Prej hyrjes në fuqi të marrëveshjes bilaterale me Italinë, deri në fund të vitit 2012 në Shqipëri janë arrestuar me qëllim ekstradimi

¹² Kushtetuta e Interpolit.


¹³ Shkëmbi, Hasan. *Tipologjitë e policimit të vendeve të Bashkimit Europian*. Tiranë: Shtëpia Botuese “GEER”, 2006, faqe 207.

¹⁴ Rregullore “Për funksionimin e ZQK Interpol-Tirana”, kapitulli mbi tipet e paralajmërimeve, miratuar me Urdhër nr. 759, datë 21.05.2008 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

¹⁵ Sipas statistikave të Zyrës Qendrore Kombëtare të Interpol-Tirana, raporti i Drejtorisë së Bashkëpunimit dhe Koordinimit Ndërkombëtar në analizën vjetore të Policisë së Shtetit, Tiranë, Janar 2013.

Viti	Persona të ekstraduar nga jashtë-brenda	Persona të ekstraduar nga brenda-jashtë
2000	21	-
2001	15	1
2002	19	-
2003	31	-
2004	39	-
2005	50	-
2006	70	-
2007	82	7
2008	87	5
2009	91	6
2010	52	9
2011	58	29
2012	71	48
2013	49	73
2014	58	67
SHUMA	831	262

Tabela 1:
Statistika lidhur me ekstradimin e personave për periudhën kohore 2000 - 2014



Burimi:
ZQK Interpol -Tirana.

drejt Italisë 152 shtetas shqiptarë nga të cilët 82 janë ekstraduar brenda vitit 2013.¹⁵ Ndërsa për vitin 2014 evidentohen këto statistika të detajuara si më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Të dhëna për personat		Gjithsej
		Shqiptarë	Shtetas të huaj	
1	Shpallur në kërkim ndërkombëtar	262		262
2	Rishpallur në kërkim ndërkombëtar			
3	Shpallur në kërkim ndërkombëtar nga ZQK homologe	98	13	111
4	Arrestuar me qëllim ekstradimi drejt vendit tonë	59	6	65
5	Arrestuar me qëllim ekstradimi drejt vendeve të tjera	71	21	92
6	Ekstraduar drejt vendit tonë	56	2	58
7	Ekstraduar drejt vendeve të tjera	52	15	67
8	Transferim persona te dënuar	8	10	18
9	Deportime	1		1
	SHUMA	607	67	674

Burimi:
ZQK Interpol -Tirana.

Elezi, M.
«Rëndësia e bashkëpunimit policor me organizatat partnere për efikasitet në luftën kundër krimit»

Policimi dhe Siguria
nr.1, 2015

3.2 Bashkëpunimi policor përmes Europol

Europol është agjencia e zbatimit të ligjit në BE, me qendër në Hagë,¹⁶ që ka për mision të asistojë autoritetet e agjencive të zbatimit të ligjit në vendet anëtare në luftën e përbashkët kundër krimit të organizuar dhe formave të tjera të krimeve të rënda. Europol-i si organizatë e BE-së për zbatimin e ligjit që trajton informacionin sekret kriminal, synon të përmirësojë efektivitetin dhe bashkëpunimin midis autoriteteve kompetente të shteteve anëtare, për parandalimin dhe luftën kundër krimit të rëndë të organizuar ndërkombëtar dhe terrorizmit. Objektivi i tij, sipas nenit 2 të Konventës Europol¹⁷, është përmirësimi i efektivitetit dhe bashkëpunimit të autoriteteve kompetente¹⁸ në shtetet anëtare për të parandaluar dhe luftuar krimin e rëndë ndërkombëtar, nëse ka të dhëna ose arsye për të besuar që:

- është e përfshirë një strukturë e organizuar kriminale; dhe
- preken dy ose më shumë shtete anëtare dhe kërkohet përjasje e përbashkët nga shtetet anëtare.

Europoli u jep mbështetje vendeve anëtare për problemet në fushën e sigurisë, lidhur me parandalimin e kriminalitetit në vende, dhe konkretisht për:

- *Lehtësimin e shkëmbimit të informacionit midis shteteve anëtare nëpërmjet oficerëve të tyre të ndërlidhjes të emëruar nga Europol si përfaqësues të agjencive të tyre kombëtare të zbatimit të ligjit;*

- *Për kryerjen e analizave operacionale në mbështetje të operacioneve;*

- *Gjenerimin e raporteve strategjike (p.sh. vlerësimet e kërcënimit) dhe analizën e krimit mbi bazën e informacionit dhe informacionit sekret të dhënë nga shtetet anëtare dhe palët e treta;*

- *Për kryerjen e ekspertizës dhe mbështetjes teknike për hetime dhe operacione të kryera brenda BE-së, nën mbikëqyrjen dhe përgjegjësinë ligjore të shteteve anëtare të interesuara.*¹⁹

Europol është aktiv për promovimin e analizës së krimit dhe harmonizimin e teknikave hetimore brenda shteteve anëtare²⁰. Gjithashtu, bashkëpunon si mes shteteve anëtare edhe për njësitë e emëruara në çdo palë të tretë si pikë kontakti me Europol për shkëmbimin e informacionit brenda kuadrit të marrëveshjes së bashkëpunimit. Këto njësi quhen Pika Kombëtare të Kontaktit dhe operojnë si njësi kombëtare të Europolit me përjashtimin që ato nuk kanë akses në sistemin e Europolit. Ato mund të lidhen me Europolin me linja elektronike të dedikuara të pajisura me pajisje kriptuese për mbrojtje të sigurt. Në Shqipëri funksionon një zyrë kombëtare për komunikimin me Europolin,²¹ e cila shkëmben informacion të klasifikuar

Elezi, M.

«Rëndësia e bashkëpunimit policor me organizatat partnere për efikasitet në luftën kundër krimit»

Policimi dhe Siguria nr.1, 2015

¹⁶ Shtabi i EUROPOL e ka vendndodhjen në Hagë, Holandë.

¹⁷ Shkëmbi, Hasan. *Tipologjitë e policimit të vendeve të Bashkimit Europian*. Tiranë: Shtëpia botuese "GEER", 2006, faqe 215.

¹⁸ Për qëllim të kësaj Konvente "autoritete kompetente" do të thotë të gjitha organet publike që ekzistojnë në Shtetet Anëtare të cilat janë përgjegjëse sipas legjislacionit të brendshëm për të parandaluar dhe luftuar veprat penale. Neni 2 i zëvendësuar nga Akti i Këshillit që miraton në bazë të nenit 43 (1) të Konventës për Krijimin e EUROPOL-it, një Protokoll që ndryshon atë Konventë (2004/C 2/01), Akt i Këshillit i 27 nëntorit 2003 (Fletore Zyrtare nr. 2, 06.01.2004, fq. 3).

¹⁹ Deflem, Mathieu. "Europol and the Policing of International Terrorism: Counter-Terrorism in a Global Perspective", në: *Justice Quarterly*, Volume 23 nr 3, shtator 2006, fq. 342.

²⁰ Shkëmbi, Hasan. *Tipologjitë e policimit të vendeve të Bashkimit Europian*. Tiranë: Shtëpia botuese "GEER", 2006, faqe 221.

²¹ ZKE - Zyra Kombëtare EUROPOL në Shqipëri, strukturë në Drejtorinë e Bashkëpunimit dhe Koordinimit Ndërkombëtar, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Tiranë. Ngritur me Urdhër të ministrit të Brendshëm në dhjetor 2010.

nëpërmjet kanalit të sigurt SIENA²². Në zbatim të Nenit 4 të Konventës së Europol, çdo shtet anëtar krijon një njësi ose zyrë kombëtare për komunikimin me shërbimin policor europian në dy mënyra: drejtpërdrejt, nëpërmjet linjave të sigurta të komunikimit elektronik dhe nëpërmjet Zyrës Ndërlidhëse në Europol (ZNE).

Bashkëpunimi midis Europol dhe ZKE mbahet nëpërmjet shkëmbimit të informacionit në nivel strategjik dhe operacional, që kryhet në tre forma:

a. kërkesat për kontrollet nga Europol ose nga zyrat ndërlidhëse të vendeve të BE-së, vendeve të treta dhe institucioneve të tjera që kanë marrëveshje me Europol;

b. kërkesat për kontrole operative nga autoritetet kompetente kombëtare në Sistemin e Informacionit të Europol dhe/ose kontrollet në disa vende të BE-së ose vendeve të treta nëpërmjet zyrave ndërlidhëse në Europol;

c. dërgimi i informacionit operativ në sistemin operacional të Europol.²³

Në rastet kur kërkesat paraqiten nga Europoli, në përputhje me llojin e veprës penale, kompetencat e autoriteteve kompetente kombëtare, si dhe përmbajtjen e vetë kërkesës, ZKE përcakton mënyrën e veprimit të mëtejshëm dhe shpërndarjen tek autoritetet kompetente kombëtare. Në rastin kur informacionet teknike dhe strategjike ose raportet janë subjekt i kërkesës së Europol dhe të paraqitura prej tij, që kanë për objekt propagandimin e inteligjencës për format e reja të krimit ose analizën analitike për situatën kriminale, ZKE i përcjell ato në strukturat përkatëse organizative strategjike dhe analitike, brenda autoriteteve kompetente kombëtare, për informimin e tyre dhe për të vepruar mbi to.

4. Konkluzione

Në një botë globale, krimi, trafiket, terrorizmi, kontrollohen dhe luftohen më mirë përmes bashkëpunimit midis shteteve dhe agjencive të zbatimit të ligjit.

“Bashkëpunimi policor ndërkombëtar” dallon nga “bashkëpunimi ndërkombëtar” për nga fokusi, baza ligjore, institucione, aktorët veprues, format e realizimit. Ai gjen shprehje në tre nivele, global, rajonal, bilateral dhe shtrihet në fusha të ndryshme, si: krim i organizuar, trafikë ilegale, terrorizëm, menaxhim i kufijve, ekstradim të personave etj.

Bashkëpunimin policor reflekton interesat e shteteve dhe të agjencive të zbatimit të ligjit, d.m.th. ato angazhohen në bashkëpunim policor për shkak të përputhjes së interesave, në funksion të rritjes së nivelit të tyre të sigurisë. Baza e bashkëpunimit mes shteteve dhe agjencive të tyre të ligjit është kriminaliteti i dyanshëm dhe reciprociteti.

Bashkëpunimi policor është i suksesshëm ku ai realizohet nëpërmjet kombinimit të instrumenteve ligjore dhe kuadrit operationale. Legjitimiteti dhe juridiksioni i instrumenteve ligjore që mbulojnë bashkëpunimin policor buron nga pranimi i tyre prej shteteve dhe agjencive të ligjit, mbi bazën e vullnetit të lirë dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Standardet dhe autoriteti i instrumenteve ligjore ndërkombëtare që mbulojnë bashkëpunimin policor, marrin përparësi mbi ato kombëtare, vetëm kur shtetet dhe agjencitë e tyre të ligjit i pranojnë ato me vullnet të lirë, përmes përqafimit të tyre dhe kryerjes së ndryshimeve në legjislacionin kombëtar.

Elezi, M.
«Rëndësia e bashkëpunimit policor me organizatat partnere për efikasitet në luftën kundër krimit»

Policimi
dhe
Siguria
nr.1, 2015

²² EUROPOL REVIEW: General Report on Europol Activities, Hague 2012, p.7.

²³ Shih: Rregullore e Zyrës Kombëtare të Europolit.

Instrumentet ligjore të bashkëpunimit ndërkombëtar ekzistojnë dhe përdoren në tipa të ndryshëm, si: marrëveshje, konventa, protokolle, traktate, memorandume, karta, deklarata, pakte, statute, rezoluta, akte, ligje, vendime, rregullore, rekomandime, etj. Ato e kanë origjinën nga iniciativa ndërkombëtare (marrëveshjet shumëpalëshe/dypalëshe mes shteteve) ose kombëtare (akte ligjore, vendime të ekzekutivit, etj). Këto instrumente aplikohen nga shtetet në nivel bilateral, rajonal, global, dhe dallojnë nga njeri-tjetri nga këto elemente: parimet mbi të cilat ngrihen fokusi dhe orientimi i tyre; marrëdhëniet dhe detyrimet që krijojnë me shtetin nënshkrues; hapësirën që i lënë shtetit nënshkrues për të refuzuar elemente të veçantë, etj. Kuadri operacional i bashkëpunimit policor reflekton kapacitetin teknologjik dhe investimin konkret të një shteti në funksion të parandalimit dhe goditjen e kriminalitetit në vend dhe atij transnacional.

Shqipëria është anëtarësuar në organizatat policore ndërkombëtare, rajonale, por ka edhe bashkëpunime dypalëshe me vendet fqinje duke nënshkruar marrëveshje dhe protokolle bilaterale bashkëpunimi. Falë këtij angazhimi konstatohet rritje e besimit të organizatave policore të vendeve partnere, e për rrjedhojë rritje të nivelit të bashkëpunimit. Por, duke parë numrin e veprave penale me kapërcim të kufijve nacionalë, si dhe dinamikën në rritje të kriminalitetit në nivel global, mbetet ende shumë punë për të bërë për parandalimin, dokumentimin, zbulimin e krimeve dhe bashkëpunimin policor me vendet e tjera të rajonit, në funksion të këtij fenomeni. Në përgjithësi, Shqipëria ka treguar frymë pozitive për të bashkëpunuar me organizatat dhe vendet partnere në luftën kundër kriminalitetit. Aktualisht ky bashkëpunim karakterizohet nga tendenca në rritje e tij.

5. Rekomandime

Me qëllim përmirësimit dhe rritjen e efikasitetit të bashkëpunimit policor ndërkombëtar në vijimësi, në luftën kundër krimit transnacional, parashtrijmë disa rekomandime, të cilat mendojmë se duhet të marrin në konsideratë:

a. *Akses në database-n e dokumenteve biometrike.* Duke qenë se databas-i policisë shkencore përgjithësisht ka të evidentuar vetëm ata persona të cilët më parë kanë qenë të shoqëruar në organet e policisë, nevojitet që nga kompania Aleat të vihen në dispozicion të strukturave përkatëse të policisë, database të gjurmëve të gishtave të dokumenteve biometrike, me qëllim identifikimin e personave të kërkuar, mundësisht në një kohë sa më të shkurtër. Deri tani Policia e Shtetit nuk ka akses të marrë të dhëna nga database të kompanisë Aleat. Rekomandojmë nënshkrimin e një marrëveshjeje të përbashkët ndërmjet kësaj kompanie dhe Policisë së Shtetit apo Prokurorisë së Përgjithshme për këtë qëllim. Nju gjë e tillë mund të bëhet edhe me ligj, duke parashikuar që, për nevoja hetimi, struktura të posaçme të policisë të kenë akses në marrjen dhe përpunimin e të dhënave personale nga kompania Aleat.

b. *Akses në database-n elektronik të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile.* Rekomandohet, gjithashtu akses i plotë i strukturave hetimore të policisë në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile, për të bërë të mundur jo vetëm identifikimin e personit i cili kërkohet për tu arrestuar me qëllim ekstradimi, por edhe i lidhjeve të tij familjare, gjë që mendoj se do të ndihmonte në identifikimin e vendndodhjes etj.

c. *Akses në database elektronik të Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor.* Gjithashtu, në këtë kuadër bashkëpunimit ndërinstitucional rekomandojmë akses të plotë të strukturave përkatëse të policisë në database të Drejtorisë së

Përgjithshme të Transportit Rrugor, për identifikimin e automjeteve të cilat përdoren nga personat në kërkim, targave, apo ndryshimet lidhur me kalimin në pronësi të tyre, etj.

d. ritje të bashkëpunimit ndërinstitucional lidhur me shpalljen/anulimin e kërkimit të personave. Nisur nga problematika të ndryshme të hasura nga strukturat policore, në lidhje me statusin e personit në kërkim, për evidentimin ose jo të tij në sistem, rekomandojmë bashkëpunim më të ngushtë të disa institucioneve, si: Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë në ministrinë e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, etj, për të rakorduar periodikisht ndryshimet e gjeneraliteteve apo të gjendjes gjyqësore. Kryesisht ky shkëmbim informacioni duhet të fokusohet tek personat e shpallur në kërkim, të arrestuar, të dënuar, të falur apo ata të cilët kanë përfituar nga amnistia.

e. Nënshkrimi i marrëveshjeve bilaterale për ekstradimin e personave. Referuar Kushtetutës së Shqipërisë, e cila në nenin 39 parashikon se ekstradimi mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht në marrëveshjet ndërkombëtare, të gjenden modalitete për të shmangur këtë kufizim - p.sh. rekomandojmë përmirësim të marrëveshjeve ekzistuese dhe nënshkrim të marrëveshjeve të reja dypalëshe ekstradimi me shtetet në të cilat jetojnë një numër i konsiderueshëm i shtetasve shqiptarë, kryesisht me vendet fqinje si Greqia, Maqedonia, Mali i Zi, por edhe me vende të tjera si Britania e Madhe, Belgjika etj. Këto marrëveshje bilaterale ekstradimi, do të kapërcejnë pengesën e shtetësisë së personit, sikundër është vepruar me Republikën e Italisë dhe Republikën e Kosovës.

f. Rishikimi i strategjisë kundër drogës, në përshtatje me situatën aktuale në vend. Duke parë statistikat zyrtare lidhur me numrin e bimëve të mbjella, të shkatërruara apo dhe rastet e trafikimit të lëndës narkotike drejt vendeve fqinjë, rekomandohet rishikimi i strategjisë kundër drogës dhe hartimi i një tjetër strategjie kombëtare kundër drogës, dhe të përcaktohet një plan eficient veprimi, në përputhje me kushtet aktuale të kriminalitetit. Kjo strategji pavarësisht nga kostoja që ajo ka, të synoj kontrollin e plotë të të gjithë territorit dhe rritjen e forcës goditëse ndaj kultivuesve, përpunuesve dhe trafikuesve të lëndës narkotike.

Referenca

1. Parlamenti Shqiptar. *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*. Tiranë: OSCE, 1998
2. Kushtetuta e Interpolit.
3. Shkëmbi, Hasan. *Tipologjitë e policimit të vendeve të Bashkimit Evropian*. GEER, Tiranë, 2006.
4. Ligji nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit".
5. Ligji nr. 8427 datë 14.12.1998, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Organizatën Ndërkombëtare të Policisë Kriminale - Interpol". Fletore Zyrtare nr. 30, viti 1998. "Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar" ratifikuar me Ligjin nr. 8920, datë 11.07.2002.
6. Protokollin i OKB për kontrabandën, miratuar në dhjetor 2000.
7. UNCAC - "Konventa Kuadër e OKB-së kundër Korrupsionit", 2005.
8. Ligji nr. 8512, datë 15.07.1999, Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet qeverive të vendeve pjesëmarrëse në Bashkëpunimin Ekonomik të Detit të Zi, për bashkëpunimin në luftën kundër krimit, në mënyrë të veçantë, format e tij të organizuara". Fletore Zyrtare nr. 23, viti 1999.
9. Rregullore "Për funksionimin e ZQK Interpol-Tirana", miratuar me Urdhër nr. 759, datë 21.05.2008 të 10. Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
11. Rregullore e Zyrës Kombëtare të Europolit.
12. Konventa për Krijimin e EUROPOL-it, Protokollin që ndryshon atë Konventë (2004/C 2/01), Akt i Këshillit i 27 nëntorit 2003 (Fletore Zyrtare nr. 2, viti 2004).
13. Deflem, Mathieu. "Europol and the Policing of International Terrorism: Counter-Terrorism in a Global Perspective", *Justice Quarterly*, Volume 23, nr. 3, shtator 2006.
14. EUROPOL REVIEW: General Report on Europol Activities, Hague 2012.

Elezi, M.

«Rëndësia e bashkëpunimit policor me organizatat partnere për efikasitet në luftën kundër krimit»

Policimi dhe Siguria
nr.1, 2015

Migracioni i parregullt si sfidë ndërmjet humanizmit dhe sigurisë kombëtare



■ **Drejtues Pëllumb NAKO**
Akademia e Sigurisë

Abstrakt

Prej shumë vitesh, por sidomos vitin e fundit, deti Mesdhe dhe vendet e Ballkanit, në mënyrë të veçantë ato të Ballkanit Perëndimor, janë prekur nga një migracion ilegal, që shfaqet përmes zhvendosjeve masive të popullsisë aziatike e afrikano-arabe në drejtim të vendeve të zhvilluara të Bashkimit Europian. Ky migracion i ka vënë vendet ballkanike (mes tyre edhe Shqipërinë) përballë sfidave të shumta; në linja më të përgjithshme, këto sfida luhaten ndërmjet detyrimit të këtyre shteteve për të trajtuar problemet migratore në respekt të plotë të së drejtave të njeriut e njëkohësisht, garantimit të sigurisë së tyre kombëtare.

Migracioni i tanishëm i popullsisë aziatike e afrikano-arabe, i mbështetur paraprakisht nga grupe kriminale në det, dhe nga rrjete trafikantësh në tokë, u transformua në një dyndje masive drejt disa vendeve të Bashkimit Europian. Përgjigjja ndaj tij ishte larg të qenurit e njësuar. Vende të ndryshme europiane, me profile të ndryshme demokracie, dhanë përgjigje nga më të ndryshmet, që kulmuan me rrethimin e kufijve shtetërore me tela me gjemba. E thënë ndryshe, kufijtë Shengen filluan të rrethohen me tela me gjemba, disa vende rikthyen kontrollet në kufi, në disa të tjera, kjo dukuri ka shume kohë që ekziston heshturazi (portet italiane ku mbërrijnë mjetet e lundrimit nga Greqia).

Fjalëkyçe:

politika europiane, siguri kombëtare, migracioni ilegal, trysni migratore, Mesdhe, rruga ballkanike e migracionit

Nako, P.
«Migracioni
i parregullt
si sfidë
ndërmjet
humanizmit dhe
sigurisë»

Policimi
dhe
Siguria
nr.1, 2015

* Kjo ekspertizë, në një formë më të zgjeruar është botuar nga autori, edhe në Qendrën e Studimeve të Larta të Ministrisë së Brendshme franceze, ku ai morri pjesë për studime të fushës së sigurisë gjatë vitit 2014-2015:

“NAKO, Pëllumb. L’immigration irrégulière qui transite à travers les Balkans vers l’Europe occidentale. CHEMI – Juin 2015. Paris: Ministère de l’Intérieur, République Française.”

Versioni që po botohet në revistën “Policimi dhe Siguria” përmban të dhëna të rifeskuara dhe një analizë të mbështetur në të rejtat më të fundit, duke trajtonuar të njëjtën problematikë kaq aktuale.

1. Konsiderata të përgjithshme

Prej shumë vitesh, por sidomos vitin e fundit, deti Mesdhe dhe vendet e Ballkanit, në mënyrë të veçantë ato të Ballkanit Perëndimor, janë prekur nga një migracion ilegal, që shfaqet përmes zhvendosjeve masive të popullive aziatike e afrikano-arabe në drejtim të vendeve të zhvilluara të Bashkimit Europian. Ky migracion i ka vënë vendet ballkanike (mes tyre edhe Shqipërinë) përballë sfidave të shumta; në linja më të përgjithshme, këto sfida luhaten ndërmjet detyrimit të këtyre shteteve për të trajtuar problemet migratore në respekt të plotë të së drejtave të njeriut e njëkohësisht, garantimit të sigurisë së tyre kombëtare.

Migracioni i tanishëm i popullive aziatike e afrikano-arabe, i mbështetur paraprakisht nga grupe kriminale në det, dhe nga rrjete trafikantësh në tokë, u transformua në një dyndje masive drejt disa vendeve të Bashkimit Europian. Përgjigjja ndaj tij ishte larg të qenurit e njësuar. Vende të ndryshme europiane, me profile të ndryshme demokracie, dhanë përgjigje nga më të ndryshmet, që kulmuan me rrethimin e kufijve shtetërore me tela me gjemba. E thënë ndryshe, kufijtë Shengen filluan të rrethohen me tela me gjemba, disa vende rikthyen kontrollin në kufi, në disa të tjera, kjo dukuri ka shume kohë që ekziston heshturazi (portet italiane ku mbërrijnë mjetet e lundrimit nga Greqia).

2. Koncepti aktual i sigurisë kombëtare

2.1 Koncepti bashkëkohor i sigurisë kombëtare

Aktualisht, koncepti i sigurisë kombëtare ka marrë përmasa shumë më të gjera se ai klasik. Ai nuk kufizohet vetëm në nocionin e thjeshtë të mbrojtjes së territorit dhe të popullsisë kundrejt një agresioni të jashtëm, që ka të bëjë përgjithësisht me aktorët shtetërorë, por nënkupton edhe nevojën për të menaxhuar rreziqet dhe kërcënimet, të drejtpërdrejta ose jo, që potencialisht mund të cenojnë jetën e një vendi. Kërcënimi nënkupton të gjitha situatat të cilave duhet t'u bëjë ballë një vend, përkundrejt qëllimeve të mundshme armiqësore. Me rrisht të rreziqit, nënkuptohen rreziqet e mundshme, të zhveshura nga qëllimet armiqësore, por që potencialisht mund të prekin sigurinë kombëtare; këto rreziqe mund të jenë qoftë ngjarje politike, po ashtu dhe katastrofa natyrore e sanitare.¹

¹ Përkufizim dhe koncepte të mara në formë të përmbledhur nga "Libri i Bardhë", 2013, i Republikës Franceze: *Ministère de la Défense. French White Paper*, Achevé d'imprimer en juillet 2013 par le Pôle graphique de Tulle, France (Ministère de la Défense / SGA / SPAC). Francë: Dépôt légal: juillet 2013. http://www.livreblancdefenseetsecurite.gouv.fr/pdf/the_white_paper_defence_2015.pdf

2.2 Disa lloje rreziqesh të lidhura me migracionin ilegal

Duke u bazuar në konceptin e mësipërm të sigurisë kombëtare, natyra e rreziqeve dhe kërcënimeve të sigurisë kombëtare të një vendi do të ishte shumë e gjerë dhe e ndarë në dy grupe të mëdha: Në rreziqe që vijnë nga brenda vendit dhe në rreziqe që vijnë nga jashtë vendit. Kërcënimi e ka burimin gjithmonë jashtë vendit, pasi ai nënkupton agresion.

a. Dobësia e një shteti, i cili kthehet në burim kërcënimi për një shtet tjetër, është bërë tashmë një fakt i ri strategjik me rëndësi të madhe. Përgjatë shekujve, shtetet më të fuqishme e shihnin dobësinë e një shteti si mundësi për të zgjeruar territorin e tyre, si dhe për të rritur mbizotërimet. Aktualisht nuk është më e njëjta gjë; gjithçka ka ndryshuar qysh nga koha kur progresi i të drejtës së popujve për vetëvendosje, si dhe sovraniteti i shteteve u bë parimi mbështetës i organizimit të rendit aktual botëror. Pra rrisqet ose rreziqet që këto shtete të dobëta i prekin brenda territorit të tyre, mundet që shumë shpejt të dalin jashtë kontrollit dhe të prekin edhe sigurinë e tjetrit. Një shtet që nuk kontrollon dot kufijtë dhe territorin e tij, mund të kthehet në një tempull për grupet kriminale, hapësirë kalimi për trafiket, prapavijë aktesh terroriste. Në një peizazh të ri strategjik, pra, është gjithmonë e më e rëndësishme të identifikohen rreziqet që përftohen prej dobësive shtetërore sa më shpejt të jetë e mundur. Rreziqet që vijnë nga vendet që karakterizohen prej dobësive të shumta shtetërore, por që zotërojnë njëherazi pajisje të sofistikuar ushtarake, janë më të rënda.

b. Në epokën që jetojmë, rreziqet dhe kërcënimet janë shumëfishuar edhe në sajë të natyrës globale të zhvillimeve. Globalizimi i bën më të prekshme kërcënimet e forcës dhe rreziqet e dobësisë. Pra, globalizimi ka sjellë si pasojë reduktimin maksimal në kohë dhe distancë të rrisqeve nga mund të vijnë nga vendet me shtet të dobët. Rreziku mund të vijë thuajse njëkohësisht si nga një vend fqinj, edhe nga një vend në një kontinent tjetër. Në këto kushte, vendet ku dobësitë shtetërore çojnë në shpërthimin e konflikteve të dhunshme brenda territorit të tyre, shkaktojnë rreziqe që prekin jo vetëm vendet fqinje, por edhe vende shumë larg tyre, në mënyrë të veçantë vendet që përzgjidhen si rrugë kalimi a transiti. Shembulli më klasik është Siria e këtyre viteve të fundit.

c. Rajoni ku ndodhet vendi ynë është i ekspozuar ndaj shumë rreziqeve, por, sipas vlerësimeve të vendeve perëndimore, edhe vetë vendet e Ballkanit përbëjnë nga ana e tyre një rrisik për vendet e Europës Perëndimore. Ballkani Perëndimor aktualisht është edhe i rriskuar, por është kthyer edhe vetë në një rrisik për vendet me shtet të konsoliduar. Ja se çfarë shkruhet në dokumentin strategjik francez të vitit 2013:

*“Fqinjësia lindore e Bashkimit European vazhdon të kërkojë një vigjilencë të veçantë. Dobësitë e shteteve të dala nga shpërbërja e Bashkimit Sovjetik dhe e Jugosllavisë, disa prej tyre edhe candidate për në Bashkimin European, vazhdojnë të jenë të dukshme”.*²

² Po aty

3. Trysnia migratore

3.1 Trysnia migratore në rrugë detare³

3.1.1 Karakteristikat e migracionit në rrugë detare

Migracioni i parregullt me rrugë detare ka specifika të ndryshme nga ai që zhvillohet në rrugë tokësore. Lëvizja e emigrantëve në rrugë detare karakterizohet, në radhë të parë, nga numri i madh dhe i përqendruar i personave në një mjet të vetëm lundrimi, pra, mjete të tejmbushura; në pjesën dërrmuese, ai është i organizuar nga grupet kriminale. Udhëtimi i përqendruar dhe në numër të lartë individësh emigrantë në këto mjete mundëson rritjen në maksimum të përfitimeve financiare të organizatorëve të tyre dhe, në të njëjtën kohë, mundëson kosto të përballeshme për çdo individ që paguan udhëtimin. Thuhet e përballeshme, jo se kushton pak, por çmimi i paguar nga emigrantët është shumë më i lartë se një udhëtim i zakonshëm. Pra, grupet kriminale luajnë gjithmonë me numrin dhe me çmimet e kripura të paguara nga çdo person.

Megjithatë, ata nuk mjaftohen me kaq. Me qëllim që të ulin sa më shumë koston, grupet kriminale vënë në dispozicion mjete lundrimi të amortizuara, me kushte teknike minimale, çka krijon kushtet për rreziqe nga më të ndryshmet, për incidente që shkaktojnë humbje jete të shumë emigrantëve fatkeq. Faktor tjetër që rrit rrezikun e shkakimit të incidenteve me pasojë vdekjen, janë edhe masat që marrin trafikantët, në rastet e ndjekjes nga forcat e policive të kufirit, duke braktisur mjetet e lundrimit, me qëllim që mos bien në dorën e organeve kompetente të vendeve të destinacionit. Pasojat e këtyre faktorëve tashmë janë të mirënjohura nga opinioni publik botëror dhe sidomos ai europian.

Këta faktorë kanë nxitur edhe ndjeshmërinë e organeve kompetente të vendeve të destinacionit për të marrë masa parandaluese, pasi incidentet me pasojë vdekjen kanë gjithmonë numër të madh fatkeqësh.

3.1.2 Përgjigjia e Europës ndaj trysnisë migratore në Mesdhe⁴

Rrugët e migracionit ilegal detar në Mesdhe, në masën më të madhe, kanë destinacion Italinë (Lampeduza, Sicili); ato që nisen nga Turqia kalojnë në ishujt grekë, e nga Greqia, në Itali (rruga famëkeqe e njohur Shqipëri-Itali nuk u rigjallërua). Në këtë kontekst, pas tragjedisë detare të 3 tetorit 2013, në të cilën humbën jetën rreth 366 emigrantë, çka provokoi emocione të thella në opinionin publik botëror dhe sidomos atë italian, qeveria italiane, më 15 tetor 2013, filloi "Operacionin Mare Nostrum", i cili ishte një operacion ushtarak dhe humanitar i

³ "European Agency for the Management of Operational Cooperation at the External Borders of the Member States of the European Union" (FRONTEX). *Annual Risk Analysis 2014, Printed version: OPOCE Catalogue number: TT-AC-14-001-EN-C, PDF: TT-AC-14-001-EN-N. Warsaw, April 2014.*

Referuar faqes zyrtare të FRONTEX:

http://frontex.europa.eu/assets/Publications/Risk_Analysis/Annual_Risk_Analysis_2014.pdf

⁴ "European Agency for the Management of Operational Cooperation at the External Borders of the Member States of the European Union" (FRONTEX). *Annual Risk Analysis 2013, Printed version: OPOCE Catalogue number: TT-AC-13-001-EN-C, PDF: TT-AC-13-001-EN-N. Warsaw, April 2013.*

Referuar faqes zyrtare të FRONTEX:

http://frontex.europa.eu/assets/Publications/Risk_Analysis/Annual_Risk_Analysis_2013.pdf

zhvilluar nga marina ushtarake italiane, me qëllim që të ndihmonte emigrantët në det. Opinioni publik botëror, organizmat e Bashkimit Europian (FRONTEX) me në krye organet kompetente të shtetit Italian organizuan shumë operacione për të parandaluar emigracionin në fjalë, si dhe për të asistuar emigrantët në rrezik jete. Këto operacione u zhvilluan (dhe vazhdojnë të zhvillohen nën drejtimin e FRONTEX-it, operacioni TRITON) si në ujërat ndërmjet Italisë dhe vendeve të Afrikës së Veriut, edhe në ujërat ndërmjet Greqisë dhe Italisë, duke u mbështetur me mjete nga ajri dhe deti.

Duhet të theksohet në këtë rast se masat në fjalë ishin në formën e një “përgjigjeje të bashkënduar nga të gjitha vendet europiane”. Pra, u vunë në dispozicion të autoriteteve italiane mjete detare dhe ajrore të vendeve europiane, si dhe burime të shumta financiare nga Bashkimi Europian. Megjithatë, masat më shumë u përqendruan në kërkimshpëtimin e emigrantëve në rrezik jete, pasi trysnia migratore nga vendet në fjalë vazhdoi dhe vazhdon.

Pra trysnisë migratore në Mesdhe iu dha përgjigje e unifikuar dhe e financuar nga Bashkimi Europian. Përveç kësaj, tregues tjetër i rëndësishëm në kontrollin e rrugëve detare në Mesdhe është edhe efikasiteti dhe përvoja e gjerë e shtetit Italian në menaxhimin e katastrofave njerëzore ose edhe të kontrollit të migracionit që, gjithsesi, nuk e shmangu përplasjen me Francën, e cila, për një çast, filloi të rivendosë kontrollin në kufijtë e saj me Italinë.

Përballë dislokimit të mjeteve të shumta detare të vendeve Europiane, të mbështetura financiarisht nga Bashkimi Europian, trysnia migratore në detin Mesdhe pësoi shfryrje, por nuk u zhduk, pasi faktorët që e shkaktojnë burimin e këtij migracioni ende janë aty e të pandryshuar. Si përfundim, nëse në Mesdhe trysnia migratore filloi të shfryhej, ajo filloi të rritej dramatikisht në krahun tjetër, këtë radhë në rrugë tokësore, ku Ballkani përbën pistën më të rëndësishme.

3.2 Migracioni i parregullt në rrugë tokësore⁵

3.2.1 Karakteristika të përgjithshme të migracionit në rrugë tokësore

Në rast se do të zgjidhnin, emigrantët nuk do të hezitonin që nga rrugët e mundshme, të privilegjonin atë tokësore. Duke bërë këtë zgjedhje, ata, në një farë mënyre, janë zotër të vetes (jo si në rastin e rrugës detare).

a. Rrugëtimin ata mund ta zgjedhin dhe organizojnë vetë, bazuar në njohjen e terrenit, të cilin e zotërojnë në bazë të kontakteve që kanë pasur me shtetasit e vendeve ku tranzitojnë (rasti tipik i kontakteve të tyre me shqiptarët në Greqi). Pra, rruga tokësore rezulton të jetë një sipërmarrje e vetë emigrantit, kurse ajo detare është sipërmarrje e trafikantëve.

b. Në rrugën tokësore, emigrantët kanë mundësinë që të shfrytëzojnë mjetet e transportit publik të vendit ku tranzitojnë dhe lëvizjen e bazojnë në grupe të vogla.

c. Në sajë të kontakteve me qytetarët e vendit ku tranzitojnë, emigrantët mund të

⁵ Të dhënat bazohen kryesisht në diskutimet e kryera nga deputetët italianë në lidhje me emigimin në rrugë tokësore në Ballkanin Perëndimor:

Rocco, Gianluca. Dabizzi, Andrea. Oropeza, José Angel. "Audizione di rappresentanti dell'Organizzazione Internazionale per le Migrazioni (OIM), competenti per l'area dei Balcani". *Atti Parlamentari, Camera Deputati - Senato Repubblica, xvii Legislatura, Discussioni, Accordo Schengen*, Seduta del 27 Maggio 2014
Transkriptim i diskutimeve të: "Comitato Parlamentare di Controllo sull'Attuazione dell'Accordo di Schengen, di Vigilanza sull'attività di Europol, di Controllo e Vigilanza in Materia di Immigrazione"; zhvilluar në 27 maj 2014.

gjejnë lehtësisht edhe persona për t'i ndihmuar në rrugëtimin e tyre me mjete transporti, kundrejt një pagesë të përballueshme prej tyre.

d. Në të njëjtin kontekst, rruga tokësore u krijon mundësinë emigrantëve që të ndryshojnë sipas rrethanave kohën dhe mënyrën e udhëtimit. Ata mund të përdorin në mënyrë të njëpasnjëshme mjete të ndryshme transporti apo të udhëtojnë në këmbë, natën apo ditën.

e. Kalimi e migracionit transballkanik nga një migracion i asistuar nga individë dhe grupe kriminale të organizuara në rrjet, drejt një zhvendosjeje masive tërësisht të pakontrolluar, sigurisht që ka vënë në rrezik sigurinë publike e kombëtare të këtyre vendeve.

Duhet theksuar se karakteristikat e mësipërme të migracionit të parregullt vëreheshin para se ky migracion të kthehej në një zhvendosje masive të tyre gjatë mesit të vitit të shkuar dhe këtij viti; çka detyroi shtete të ndryshme të Bashkimit Europian ose të tjera, që të kundërvepronin në mënyra tërësisht të ndryshme: që nga lehtësimi i tranzitimit të tyre me mjete të transportit publik, deri në bllokim kufijsh apo rrethim të tyre me tela me gjemba. Kjo lëvizje masive ka vënë në rrezik serioz Shengenin dhe provoi, në një farë mënyre, paradoksin europian ndërmjet inkoherencës së kufijve të përbashkët (Marrëveshja Shengen) dhe politikës migratore aspak të unifikuar të Bashkimit Europian.

3.2.2 Rruga ballkanike e migracionit në rrugë tokësore⁶

Rruga Ballkanike është tashmë rruga e njohur nga literatura kriminologjike europiane si rruga e trafikeve, e filluar në vitet 1990 me trafikun e heroinës afgane nga Turqia e Greqia, përmes ish- Jugosllavisë drejt vendeve të Europës Qendrore dhe Perëndimore.

Migracioni i parregullt nëpërmjet Ballkanit Perëndimor fillimisht u zhvillua në mënyrë më të kujdesshme dhe në linja të përgjithshme ai u mbështet nga grupe trafikantësh të lidhur në rrjet. Ky migracion ishte shumë i kujdesshëm; ai rridhte çdo ditë pa shumë zhurmë në rrugë e degëzime të shumta ballkanike drejt vendeve të BE-së. Opinioni publik europian nuk e njihnte problemin, pasi rruga tokësore nuk karakterizohej nga tragjedi masive që të tërhiqnin vëmendjen e opinionit publik, madje ai opinion mendonte se ky problem ishte shumë larg tyre, në Ballkan. Rruga ballkanike paraqet edhe paradokse, pasi ajo kalon nga një vend Shengen, i gjunjëzuar nga kriza ekonomike dhe me probleme të rënda si Greqia, nga e cila tranziton në vendet e Ballkanit Perëndimor e, më pas, sërish drejt vendeve Shengen.

Por kur Italia dhe gjithë Europa, nëpërmjet Frontex-it, minimizuan trysninë detare për shkaqet që përmendëm më sipër, dhe në kushtet kur burimet fillestare të kësaj trysnie migratore nuk u zhduken, atëherë kjo trysni filloi të shfryjë në rrugën e

⁶ Të dhënat bazohen kryesisht në diskutimet e kryera nga deputetët italianë në lidhje me emigimin në rrugë tokësore në Ballkanin Perëndimor:

De Bonis, Andrea. "Audizione di Andrea De Bonis, rappresentante dell'Alto Commissariato delle Nazioni Unite per i Rifugiati (UNHCR)". Atti Parlamentari, Camera Deputati - Senato Repubblica, xvii Legislatura, Discussioni, Accordo Schengen, Seduta del 25 marzo 2014.

Traskriptim i diskutimeve të: "Comitato Parlamentare di Controllo sull'Attuazione dell'Accordo di Schengen, di Vigilanza sull'attività di Europol, di Controllo e Vigilanza in Materia di Immigrazione": zhvilluar në 25 mars 2014.

Referuar burimit zyrtar: http://documenti.camera.it/leg17/resoconti/commissioni/stenografici/pdf/30/indag/c30_flussi/2014/03/25/leg.17.stencomm.data20140325.U1.com30.indag.c30_flussi.0002.pdf

vetme që kishte ngelur e hapur, në atë ballkanike, duke u kthyer në dyndje masive. Greqia, Maqedonia dhe Serbia nuk kishin dhe nuk kanë kapacitetet e Italisë për të menaxhuar këto situata. Hungaria tregoi të njëjtën gjë. Rreziku i mbylljes së kufijve nga ana e vendeve të Europës në kufi me Ballkanin do të shkaktonte më pas shpërthimin e trysnisë drejt Kroacisë. Aktualisht edhe Sllovenia po rrethon kufirin me tela me gjemba. Vendet ende të paprekura ngelen Shqipëria, Kosova, Mali i Zi dhe Bosnja. Mbyllja me tela me gjemba e shumë kufijve ndoshta do të çonte në shpërthimin e trysnisë dhe të kufijve të vendeve ende të paprekura.⁷

Ndërhyrja e Brukselit dhe vendimet e marra në nivele të larta nga ana e vendeve të BE-së kanë bërë që në këtë çast trysnia të ketë përmasa minimale.

4. Vendet afrikane e aziatike, burim emigracioni me destinacion Europën

4.1 Karakteristika të përgjithshme

Duhet theksuar që në fillim se në bazë të koncepteve për sigurinë kombëtare të shpjeguara më lart dhe rrisqeve që përcaktuara prej tyre, rezultojnë se shtetet burim migracioni klasifikohen pikërisht në kategorinë e vendeve me shtet të dobët, të cilët përbëjnë rrisht për vendet e tjera të së njëjtës kategori ose të vendeve të destinacionit të quajtur vend me shtet të konsoliduar.

- Gati të gjitha vendet në fjalë kanë qenë të kolonizuara dhe kanë fituar pavarësinë e plotë në fundin e shekullit të 19-të dhe gjatë gjithë shekullit të 20-të; territoret e tyre të tanishme janë vendosur në bazë të kompromiseve të ish vendeve koloniale.
- Kriteret e vendosjes së këtyre kufijve në përgjithësi kanë qenë më shumë reflektim i ekuilibrave ndërmjet vendeve kolonizatorë, sesa reflektim i realiteteve konkrete të popullatave të këtyre vendeve.

- Kufijtë e këtyre vendeve përmbledhin brenda tyre popullata të shumta me gjuhë e fe të ndryshme, për të cilat nocioni i atdheut nuk është i njëjtë me ato të një shteti me kufijtë e përcaktuar si anëtar i OKB-së, por përcaktohet sipas etnisë së cilës i përket. Për shembull, një anëtar i fiseve tuareg në Mali e ka të vështirë ta quajë veten malian.

- Në shumë raste, kufiri shtetëror kalon në mes të popullatave që u përkasin së njëjtës etni, me gjuhë dhe fe të njëjtë, çka bën që kufijtë të mos ruajnë simbolikën e tyre. Për shembull, fiset pashtun në Afganistan, nuk kanë ndryshim nga ata në Pakistan.

- Pas fitores së pavarësisë, këto vende kanë mundur të ruajnë unitetin e tyre vetëm në sajë të diktaturave të cilat i kanë sunduar me forcë, duke favorizuar disa etni dhe duke shtypur të tjera.

- Vendet që kanë rrëzuar diktaturat, kanë kaluar në kaos, ku pushteti qendror thuhet nuk njihet fare (Irak); në disa të tjera, janë krijuar disa pushtete qendrore me zona ndikimi të caktuara (Libia). Rivalitetet për pushtet, të ndërthurura me

Nako, P.
«Migracioni
i parregullt
si sfida
ndërmjet
humanizmit dhe
sigurisë»

Policimi
dhe
Siguria
nr.1, 2015

⁷European Agency for the Management of Operational Cooperation at the External Borders of the Member States of the European Union" (FRONTEX). *Western Balkans Annual Risk Analysis 2013*, Frontex reference number: 6476/2013. Warsaw, May 2013

Referuar faqes zyrtare të FRONTEX:

http://frontex.europa.eu/assets/Publications/Risk_Analysis/WB_ARA_2013.pdf

ndikimet fetare, etnike ose të fuqive të mëdha të rajonit, kanë bërë që të lindin lëvizje me karakter fundamentalist mysliman (Boko Haram në Nigeri, El Shebbab në Somali), që kulmoi me ISIS-in.

- Edhe vendet që nuk e kanë njohur diktaturën, kanë si karakteristikë kryesore faktin se pushteti qendror përgjithësisht është i dobët, në rastin më të mirë, dhe i kontestuar, në rastin më të keq. Në këto vende, një tribu apo një popullatë e një feje a etnie të caktuar zotëron pushtetin qendror dhe nuk u jep shumë akses ose nuk u jep aspak akses popullatave të etnive apo feve të tjera brenda të njëjtit shtet. Kjo dukuri çon në konflikte të natyrave të ndryshme, që nga luftërat civile, në konfliktet e armatosura të herëpashershme, që për një çast fashiten, më pas shfaqen prapë. Paqëndrueshmëria që reflektojnë këto shtete, çon në qëndrime të skajshme të natyrës ekonomike, në dhunë, në varfëri absolute.

- Radikalizmi dhe fanatizmi fetar gjithashtu vazhdon të mbetet një faktor destabiliteti, persekutimesh dhe, për rrjedhojë, edhe të emigracionit të shtetasve të këtyre vendeve.

- Rivalitetet e fuqive më të mëdha rajonale (Irani, India, Egjipti, Arabia Saudite) ka bërë që shumë nga këto vende të mos jenë të stabilizuara dhe të përfshihen nga dhuna e armatosur.

- Jo rrallë herë, vendet fqinje shfrytëzojnë afërsinë etnike, gjuhësore apo fetare të popullatave të një vendi fqinj, për të ndikuar në rritjen e tensioneve ndëretnike në këto të fundit.

4.2 Të dhëna rreth disa vendeve, shtetasit e të cilëve kanë tranzituar në Shqipëri⁸

Përshkrimi për këto shtete do të jetë shumë i shkurtër dhe vetëm ilustrativ. Ai do të përqendrohet vetëm në aspekte që japin njohuri mbi përbërjen e popullsisë dhe popullsitë me rrisht migrator, qytetarët e të cilëve kanë tranzituar tashmë në vendin tonë.

Afganistani

Popullsia e Afganistanit përbëhet nga këto kombësi kryesore:

Pashtunët, të cilët përbëjnë 44% të popullsisë totale dhe jetojnë në jug të vendit. Ky grup organizohet rreth një sistemi tribal kompleks, që lind shumë rivalitete ndërtribale. Pashtunët përdoren shpesh, nga ndikimi i Pakistanit, për të tensionuar vendin. Ata janë shkaktarët e lëvizjes talebane.

Taxhikët, përbëjnë 26% të popullsisë. Ata flasin në masë të madhe gjuhën perse dhe janë sunitë. Taxhikët përbëjnë elitën intelektuale dhe politike të Afganistanit. Ata kanë lidhje të forta me Iranin.

Hazarët, përbëjnë 9.3% të popullsisë, ata flasin gjuhën mongole dhe u përkasin si korent fetar shiitëve.

Në Afganistan ka edhe më shumë se tetë etni të tjera, në masë më të vogël.

Hazarët përbëjnë një popullatë të rrezikuar, pasi ajo është e fesë shiite. Edhe popullata me fe të ndryshme nga ajo sunitë që mbizotëron vendin, përbëjnë grupe të rrezikuara dhe shumë prej tyre janë larguar nga vendi.

Pakistan

Pakistan është një shtet federal, i cili “u krijua” në vitin 1947, pas ndarjes së

⁸ OCRIEST, Central Office for the Suppression of Irregular Migration and the Employment of Irregular Migrants, *Fiches analytiques*, janar-shkurt 2015.

Indive britanike. Ai ka këto etni kryesore:

Punxhabi, e cila përbën 52.6 % të popullsisë.

Pashtunët, të cilët përbëjnë 13.2% të popullsisë.

Sind'hi-të, të cilët përbëjnë 11.7 % të popullsisë.

Gjuha e folur është ajo urdu, e folur vetëm nga 8 % e popullsisë. Kjo gjuhë është zyrtare edhe në Indi. Tensionet ndërmjet komuniteteve hindo dhe myslimane janë përdorur nga të dyja vendet për të destabilizuar njëri- tjetrin.

Duhet theksuar se, që në kushtetutën e tij, Pakistani nuk i vë në pozita të barabarta popullatat me fe të ndryshme, duke sanksionuar që presidenti dhe kryeministri duhet të jenë myslimanë, kurse gjykata federale myslimane ka të drejtë të zhvlerësojë çdo ligj të konsideruar antiislam. Kodi penal pakistanez njeh "blasfeminë" si vepër penale. Të krishterët, të cilët përbëjnë rreth 3% të popullsisë, janë shtresa më e persekutuar.

Iraku

Iraku mishëron pa përjashtim të gjitha karakteristikat e vendeve me shtet të dobët që përshkruam pak më sipër dhe kompleksitetin e një zone që është burim eksodesh masive. Ky vend ka njohur diktaturën, konfliktin e armatosur me fqinjët, ndërhyrjen e huaj, post-diktaturën, kaosin, mungesën e autoritetit të një qeverie qendrore, rivalitetet dhe përleshjet ndërmjet etnive të shoqëruara me atentate të shumta (kurdët, shiitët, sunitët), konfliktet me tendencë separatiste (kurdët), konfliktet me karakter fetar dhe ekstremizmin fetar (shteti islamik), implikimin e fuqive rajonale (Irani). Në Irak mund të persekutohet dikush se është i krishterë, po aq lehtësisht sa një tjetër që i përket një rryme të caktuar myslimane (shiit).

Siria

Siria aktualisht është në një kaos total, por në ndryshim nga Iraku, diktatura është ende në fuqi. Konfliktet fillestare në Siri ndërmjet opozitës dhe regjimit janë kthyer në kauza të fuqive të mëdha botërore dhe rajonale, duke nisur nga vendet e NATO-s, Rusia, Irani, Turqia, me interesa të ndryshme, madje edhe të kundërta. Ashtu si edhe në Irak, në Siri, kaosi dhe kompleksiteti i natyrës së konflikteve i kanë lënë hapësirë krijimit të shtetit islamik. Në Siri aktualisht konfliktet janë të shumta dhe të natyrave të ndryshme, me aktorë po ashtu të ndryshëm. Në thelb, në njërën anë qëndron regjimi i Asadit, në anën tjetër opozita që e kundërshton atë. Kjo e fundit është e ndarë në shume fraksione, njëra prej të cilave edhe shteti islamik, i cili, me ekstremizmin dhe fanatizmin e tij përbën aktualisht një kërcënim me përmasa botërore. Siria është një mozaik kombësish: 5 kombësi të fesë myslimane, si dhe 12 kombësi të fesë së krishterë. Gjuha zyrtare është një dialekt arab që flitet në Siri, Palestinë e Liban; fliten gjithashtu edhe më shumë se pesë gjuhë minoritare.

Somalia

Edhe Somalia është një shtet i pastabilizuar, burim emigracioni masiv. Në Somali, feja islame është e sanksionuar në kushtetutë. Popullata në shumicë (97%) është myslimane sunitë dhe shiite. Ka një pakicë të krishterë që është tërësisht e persekutuar. Somalia përbëhet nga 11 etni kryesore, të cilat flasin dialekte të ndryshme, ku kryesori është dialekti somali, i cili, nga ana e tij, ndahet në disa nëndialekte. Pas pavarësisë, Somalia ka njohur luftën civile dhe aktualisht pushteti qendror është thuarjse joekzistues, pasi pjesa qendrore e vendit (Puntland-i) dhe ajo veriore (Somaliland-i) nuk i binden pushtetit qendror. Ato njihen si të pavarura

vetëm nga vendi fqinj, Etiopia, e cila shfrytëzon lidhjet e saj klanore për të copëzuar vendin dhe për të ushtruar ndikimin e saj. Rivalitetet ndërmjet tribuve të shumta e kanë transformuar vendin në kaos, duke zhytur popullatën në varfëri. Qeveria qendrore e Somalisë është cilësuar si më e korruptuara në botë (në vendin e 180-të), ku shteti është kthyer në një organizatë kriminale.

Eritrea

Ashtu si Somalia, Eritrea është një vend që shtrihet në të ashtuquajturin Briri i Afrikës. Popullsia e Eritresë përbëhet nga 9 etni, të cilat flasin gjuhë të ndryshme. Në Eritre popullsia myslimane përbën 45% të popullsisë dhe po aq (45%) është edhe popullsia e krishterë (ortodokse, katolike, protestante), kurse 10% janë të feve të tjera, që i nënshtrohen rregullisht persekutimit, megjithëse kushtetuta e vendit garanton lirinë fetare. Eritrea e fitoi pavarësinë nga Etiopia në vitin 1993 dhe në vitin 1998 hyri në luftë me të. Eritrea aktualisht është një shtet njëpartiak, partitë e tjera nuk lejohen me ligj. Që nga fitorja e pavarësisë, nuk janë zhvilluar asnjëherë zgjedhje politike. Diktatura në Eritre është sot një nga më të mbyllurat dhe më të ashprat në botë. Aktualisht 1/5 e popullsisë ka emigruar në vendet e tjera, kryesisht në Europë dhe Izrael.

Mali

Mali është një shtet afrikan ku ekzistojnë gjithsej 26 etni që flasin gjuhë të ndryshme, ku më kryesoret janë etnitë Tuareg, Malinke, Bambara, Mauret, Khassonke, Sarakolle, Peul, Dogon, Sonrai, Diaara e të tjerë. Karakteristike për Malin është se me nocionin etni, këto të fundit nënkuptojnë atdheun. Nëse flasim për etninë Dogon, kjo nënkupton atdheun Dogon. Pushteti qendror në Mali, i zotëruar nga etnia Malinke, bën pak ose aspak për integrimin ekonomik e politik të etnive të tjera, sidomos ato veriore, të populluara nga tuaregët, që disa vite më parë iu kundërvunë me forcë pushtetit qendror dhe vetëm ndërhyrja ushtarake e Francës rivendosi ekuilibrin. Autoritetet maliene thonë se jashtë territorit të vendit jetojnë rreth 4 milion malienë; për to, destinacioni kryesor ka qenë Franca.

5. Përfundime

Duke u bazuar në konceptin e përmendur më lart të sigurisë kombëtare dhe në llojet e rreziqeve që e prekin atë, del në pah se edhe Shqipëria mund të preket nga problematika që sjell migracioni i shtetasve të vendeve me shtet të dobët nga Azia, Afrika, apo edhe më afër, pavarësisht se ajo nuk është për momentin destinacion për këta shtetas. Por, ndërkohë, shumë shtetas të këtyre vendeve kanë kaluar tashmë transit nëpër vendin tonë, duke tentuar të kalojnë në vendet fqinje. Po ashtu, është fakt që kërkesa e shtetasve afrikanë e aziatikë për të tranzituar në Shqipëri gjeti oferta nga grupe kriminale shqiptare e të huaja për të bërë kontrabandimin e tyre. Megjithëse në përmasa të vogla, rritja e kriminalitetit në këtë fushë është shembulli më i qartë se si mund të rriten rreziqet që prekin drejtpërdrejt sigurinë kombëtare. Rreziku, që vendi ynë të kthehet në rrugëkalim për terroristët, për trafik armësh kimike e luftarake, është real. Po ashtu, edhe qëndrimi ilegal i të huajve mund ta kthejë vendin në një prapavijë për akte terroriste për vende të tjera. E thënë ndryshe, vendi ynë mund të jetë vetë i rrezikuar dhe njëkohësisht të rrezikojë vende të tjera.

Nako, P.
«Migracioni i parregullt si sfida ndërmjet humanizmit dhe sigurisë»

Policimi dhe Siguria
nr.1, 2015

Përsa i përket anës tjetër të medaljes, asaj humanitare, do të shohim se Shqipëria nuk ka marrëdhënie diplomatike e as konsullore me vendet për të cilat folëm më sipër. Pra, dialogu me autoritetet e këtyre vendeve është tërësisht i pamundur. Shqipëria e ka të vështirë të përputhë konventat ndërkombëtare të azilit dhe refugjatëve të përshtatura në legjislacionin e saj, me kërkesat për sigurinë kombëtare. Aktualisht nuk ka mekanizma për të përzgjedhur kërkesat për azil. Pak ose aspak njihet realiteti konkret gjeografik, politik, fetar, kulturor i shtetasve të vendeve që tranzitojnë në Shqipëri. Pra, ato pak kërkesa për azil që janë bërë, nuk kanë mundësi reale për të verifikuar nëse kërkuessit janë vërtet viktima apo jo. Pra, azili rrezikon t'i jepet edhe një terroristi dhe t'i refuzohet dikujt që mund të ketë vërtet nevojë.

Sigurisht, është e pamundur të sigurohet informacion për çdo individ, por nuk është e pamundur që institucionet shqiptare të fillojnë e të interesohen për të njohur në detaje karakteristikat gjuhësore, fetare, folklorike, kulturore, ekonomike dhe natyrën e konflikteve për çdo vendburim migracioni, në mënyrë që të jetë qartësisht e orientuar në drejtim të rreziqeve që mund të vijnë, por edhe për garantimin e të drejtave të atyre që do të kërkojnë azil.

Aktualisht vendet e Bashkimit Europian nëpërmjet FRONTEx-it përdorin shumë metodën CIRAM (Common Integrated Risk Analysis Model) të analizës së rrezikut lidhur me migracionin e parregullt. Kjo metodë, ndër të tjera, parashikon bashkëpunimin me autoritetet në burim të migracionit, detyrë që e kryejnë në forma të ndryshme (marrëveshje teknike të këtyre vendeve me FRONTEx-in apo me marrëveshje dypalëshe), si dhe duke dërguar oficerë kontakti me profil migracioni në vendet në fjalë. Shqipëria nuk i ka këto mundësi, pasi kanë fatura financiare, ndoshta të pamundshme. Megjithatë, vendi ynë i ka mundësitë të krijojë në kuadrin e sigurisë kombëtare, institucione fare të kufizuara në personel, ku ndër të tjera të studiohen me imtësi profilet e këtyre vendeve. Në vendet e Bashkimit Europian, organet e specializuara kanë në dispozicion ato që quhen “fisha analitike të vendeve” apo “profile të vendeve”, ku jepet informacion i gjerë mbi profilin e një vendi konkret, duke përfshirë këtu edhe atë të kriminalitetit të lidhur me migracionin e këtyre vendeve - p.sh., pakistanezët janë shumë të njohur në përdorimin e dokumenteve false apo nigerianët për mashtrimet.

Pavarësisht se flasim për “gjeopolitikë”, globalizmi dhe teknologjia ka bërë që distancat gjeografike të shkurtohen dhe gjeopolitika të kthehet në “globopolitikë”. Pra, pyetja që shtrohet është e thjeshtë: Pavarësisht nga burimet modeste, duke qenë vend i vogël, a duhet Shqipëria të ketë vëmendjen e duhur ndaj këtyre vendeve? Apo të bazohet në bashkëpunimin me vende të treta, që të garantojë sigurinë e saj kombëtare? A mjafton modernizimi i ushtrisë dhe pjesëmarrja në NATO për të garantuar sigurinë kombëtare? A paraqitet vendi ynë si rrezik për vendet e tjera?

Pozita gjeografike dhe perspektiva europiane e Shqipërisë do ta kthejnë jo shumë vonë edhe Shqipërinë një vend destinacioni. Është koha që koncepti i sigurisë kombëtare në vendin tonë të *ridimensionohet dhe t'u përshtatet realiteteve kërcënuese* jo vetëm si vend ballkanik, por edhe si vend anëtar i NATO-s dhe kandidat i Bashkimit Europian. Vlerat europiane që ndan Shqipëria tani dhe në perspektivë mund të kthehen edhe ato në objekte rreziku. Duhet krijuar institucione permanente me detyra të sakta e bashkërenduese, që të ushqejnë vendimmarrjen për të garantuar sigurinë kombëtare në gjithë dimensionet e saj.

Nako, P.
«Migracioni
i parregullt
si sfidë
ndërmjet
humanizmit dhe
sigurisë»

Policimi
dhe
Siguria
nr.1, 2015

Referenca

1. Ministère de la Défense. *French White Paper*, Achievé d'imprimer en juillet 2013 par le Pôle graphique de Tulle, France (Ministère de la Défense / SGA / SPAC). Francè: Dépôt légal: juillet 2013.
2. "European Agency for the Management of Operational Cooperation at the External Borders of the Member States of the European Union" (FRONTEX). *Annual Risk Analysis 2014, Printed version: OPOCE Catalogue number: TT-AC-14-001-EN-C, PDF: TT-AC-14-001-EN-N. Warsaw, April 2014.*
3. "European Agency for the Management of Operational Cooperation at the External Borders of the Member States of the European Union" (FRONTEX). *Annual Risk Analysis 2013, Printed version: OPOCE Catalogue number: TT-AC-13-001-EN-C, PDF: TT-AC-13-001-EN-N. Warsaw, April 2013.*
4. Rocco, Gianluca. Dabizzi, Andrea. Oropeza, José Angel. "Audizione di rappresentanti dell'Organizzazione Internazionale per le Migrazioni (OIM), competenti per l'area dei Balcani". *Atti Parlamentari, Camera Deputati - Senato Repubblica, xvii Legislatura, Discussioni, Accordo Schengen*, Seduta del 27 Maggio 2014.
Transkriptim i diskutimeve të: "Comitato Parlamentare di Controllo sull'Attuazione dell'Accordo di Schengen, di Vigilanza sull'attività di Europol, di Controllo e Vigilanza in Materia di Immigrazione"; zhvilluar në 27 maj 2014.
5. De Bonis, Andrea. "Audizione di Andrea De Bonis, rappresentante dell'Alto Commissariato delle Nazioni Unite per i Rifugiati (UNHCR)". *Atti Parlamentari, Camera Deputati - Senato Repubblica, xvii Legislatura, Discussioni, Accordo Schengen*, Seduta del 25 marzo 2014.
Transkriptim i diskutimeve të: "Comitato Parlamentare di Controllo sull'Attuazione dell'Accordo di Schengen, di Vigilanza sull'attività di Europol, di Controllo e Vigilanza in Materia di Immigrazione"; zhvilluar në 25 mars 2014.
6. "European Agency for the Management of Operational Cooperation at the External Borders of the Member States of the European Union" (FRONTEX). *Western Balkans Annual Risk Analysis 2013*, Frontex reference number: 6476/2013. Warsaw, May 2013.
7. OCRIEST, Central Office for the Suppression of Irregular Migration and the Employment of Irregular Migrants, "*Fiches analytiques*", janar-shkurt 2015.

Nako, P.
«Migracioni
i parregullt
si sfidë
ndërmjet
humanizmit
dhe
sigurisë»

Policimi
dhe
Siguria
nr.1, 2015

ENGLISH

ABSTRACTS

"POLICIMI DHE SIGURIA", NR. 1, DECEMBER, 2015

Public security and the Police management

Senior Leader Bilbil MEMAJ

General Director, Academy of Security

ABSTRACT

Police is an important factor in the entire security environment; however, its role becomes more evident on issues related to public security. The main mission of police is to ensure public order and security, prevent crime, and provide support to all contributing factors to security in order to improve the quality of life of the society. State Police, apart from the responsibility of ensuring order, plays at the same time an important role in supporting the other agencies whose principal mission is to protect national security. In order to carry out successfully its duty and accomplish its mission, it is necessary that police increases the managing capacities, improve the structures, and accomplish its continuous modernization, etc.

If society is concerned about the security situation, that means that there are factors which produce insecurity, in this security environment that is so complicated and global. Such national and international factors must be at first recognized and have ready-made plans to implement them, in order to control and manage the security environment. This is a mission for all the state agencies and institutions, but especially it is for the State Police, as a specialized structure, to play a main role in providing security.

History and progress in Police Education - Progress toward a European Police

Prof. Ilir MANDRO
Dean, Crime Investigation Faculty
Academy of Security

ABSTRACT

Police education has had changes and its development curb sometimes went up and some other times down, dependant on the mentality, intellectual level of the leaders or even from the request of the time itself. The information you will have in this piece of writing, is a product of the long individual experience within the police educational system and of the numerous materials prepared in years in the positions I had as a lecturer, department head, deputy-director of the Police Academy and lastly as the Dean of the Crime Investigation Faculty.

The title of the material in itself is attractive and not without any purpose, I tried to attract the attention of that part of the students, who have been graduated in the halls of this school, that part of the intellectuals who want to bring forth the education with all their administrative and decision-making possibilities in order to contribute in the development of the Albanian Police Education as part of the higher education in our country and a developed model of a European Police Education and beyond. I am not taking on my shoulders to make a full history of the police education development, sometimes rising and some other times falling, because that would require numerous pages, but I feel the obligation that for these many years in this school, I need to emphasize the good results and shortcomings, the strengths and weaknesses of the police education process development. In this material through the analysis of the situation, traditional and actual experience of this institution, facing the reality with the required standards, I want to offer priorities that lead to the realization of the future of the police education, whereby the academic competences and the high professional qualities are accompanied by the elements of a contemporary structure and infrastructure.

Public order and security issues are delicate. From them it is dependant the quality of the citizens' life safety. Their standard is the indicator of the existence or not of the state of law. In the today's reality, where the fight against criminality is even tougher and more sophisticated, the role of the police school in general and the contribution that it generates through the participants and students education in particular, is still a challenge which you should not react through old methods or not as developed ones, as per the requirements of the actual development rhythm. The quality of the plans development, teaching and progressive curricula in the police education, contribute in guaranteeing the public order and security in the fight against the crime for the protection of the human rights and freedoms.

“Bachelor” Program of Study for the Public Security and Order and the Reformation of the Police Educational Institutions

Prof. Assoc. Dr. Pandeli TAÇI
Dean of Public Security Faculty
Academy of Security

ABSTRACT

Involvement of the police education institutions in the major reform of the higher education in the country is one of the most effective approaches through which the state addressed and put in the right path the solution of the increasing needs of the Police professional capabilities and capacities, in order to fulfill the requirements of the community for a more efficient and correct police in their service.

The re-opening of the Academy of Security and the approval of the request for opening the “Bachelor” program of studies on behalf of the Public Security and Order Faculty, is an indicator of one of the milestones of the Albanian Police, for the elimination of the negative consequences in the field of education, caused by the closure of the Police Academy and interruption without any proper reasoning of the higher education for the public order and security and the fight against crime.

In different analysis on the causes and factors that influenced the state of the order and security of the fight against the crime and the state of illegal activities as a whole, apart from other factors is also an evidence of the non-efficiency of the higher education institutions for a police qualification, and even more the closure or interruption of their activity. Thus, apart from the need for a qualified and educated police troop, this situation brings into attention one more time the requirement that the activity of the police academic and scientific institutions, despite being efficient, must be integrated and in accordance with the concrete needs of the country. This is one of the reasons that for the work done in the higher education reform and scientific research what counts is the care of the government for which, to the development and modernization process, all the educational and schooling institutions may be joined along the security structures, and more concretely all the levels of the Albanian Police personnel, as an institution or structure with a very important role, as well as with special expectations and contributions for the future and integration of the country in the European institutions.

The objectives to prepare high ranking police specialists with higher education culture and knowledge, with high ethic and professional standards to know the law, mission and Police responsibilities very well, in order to face the perfection of the methods of the criminal elements and their activity, as well as learning the innovative capabilities and initiatives for the management of the security and order situations, make a real challenge for the students and academic personnel. It is exactly the problematic of the increasing productivity of the academic and research activity of the structures, institutions and personnel, but also the increasing of the responsibility of a more active role of the students and lecturers that make the essence of this work.

Civilian Society and State Police

Associate Prof. Qetësor ORHANI
Academy of Security

ABSTRACT

State Police during all this period of transition, for almost 25 years, as a result of coordination and education from our partners, has made and continues to make visible and qualitative progress for the fulfillment of its mission.

Visible progress has been made also in the legal aspect and its functional one. Within the coordination aspect with civilian society it has also made visible progress, despite the fact that this partnership is not yet functional, i.e. does not answer to the required standards, because policing in the community is policing that includes citizens actively in order to minimize, prevent and discover crimes.

In other words, partnership through police and citizens means that police, from the security aspect, may continually offer citizens a qualitative service. On the other side, the community or citizens themselves must be active to help or feed police with the necessary information. Only in this way, this partnership helps identifying and solving the problems that are a concern for the citizens.

Undisputable help given by our partners towards "Policing in Community", made it possible for the requisition of this new philosophy, but it is time that this successful philosophy must be the motto of police work, because without a successful cooperation with the citizens, there is no chance to ever pretend for a functioning of this vital binomial for security.

Implementation and adaptation of the conditions in our country, of policing in the community as a philosophy and work practice for keeping order and safety, makes without any hesitations a new effective approach for achieving the policing objectives. Creation and establishment of a partnership relationship between the police and civil society, for which it serves, is the foundation of such a policing approach. This has its own basis on the compilation of the police basic work documents within this prism, as well as in orders and manifold regulations issued by representatives of police in all levels.

Albanian Question and Regional Security Complex in the Balkans

PhD. Xhavit SHALA
Academy of Security

ABSTRACT

The object of study and research in this paper is the "Albanian Question and Regional Security Complex in the Balkans." The Study and research of the Albanian issue and its impact on regional security presents an interest in national perspective and Balkan one. This paper aims to prove the mutual relationship between the degree of resolution of the Albanian issue and regional security as well as giving possible options for developments in the future.

In the estimation, establishing equilibrium and distribution of power in the Balkans, regional and international actors, expelled Albanian factor and their national interests since the beginning. Lack of settlement in time of the Albanian cause and their exclusion during the configuration process of regional balances, after the fall of the Ottoman Empire continually, has made fragile the balances located in the region and have threat the safety.

To test the mutual relationship between the degree of resolution of the Albanian issue of regional security and the possible developments in future, besides the theory of balance of power, this paper will use at the Balkan level the theory and analysis of regional security complex of Copenhagen School.

But what is the meaning today for regional security complex of Balkans and Albanian issues and what are the relations between them? To these questions and other matters related to them.

Violent extremism a long term potential threat

PhD. Mimoza XHARO

Academy of Security

ABSTRACT

Three to four years ago the Islamic State did not exist meanwhile today controls a large critic strategic territory in Middle East. Considering the atrocities, latest terrorist acts of large impact, unforeseen propaganda machinery, large use of social media networks, new virtual generation of supporters that may involve "lone wolfs attack", make ISIS now a threat not only to the region stability but also to international security. It is an evident fact know that the phenomenon of foreign fighters involved even voloonteers from Balkan region. Direct menaces for terrorist acts in Balkans posted under Islamic State's networks propaganda has been often present. The attention of ISIS toward Balkans is raised, unfortunately virtual jihad this time has started to "speak also Albanian".

The terrorist acts in Paris, Mali, Tunisia, warnings about more terrorist acts targeting Europe, show a possible rivalry among two biggest jihadist groups:Al-Qaeda and ISIS, which can be considered a new wave of terrorism. ISIS wants what Al-Qaeda has:"reputation" among global jihad movement.

The long lasting Syrian conflict caused even by the luck of an internationally agreed political solution, the possible use by ISIS of the wage of refugees from the conflict regions directed toward " the doors" of Europe to export fighters with the purpose of undertaking more terrorist acts or establish radical cells for the future, the return home of foreign fighters in the future, constitutes a real challenge for the democratic societies as whole and intelligence and rule of law agencies in particular.

No country is immune of this threat nor Albania, known as symbol of religious harmony and sided since the beginning to democratic values and anti terrorism coalition. Radicalization to violent extremism is now a long term threat. It is time to "talk about it" and address in comprehensive way the challenge.

Suicide investigation

PhD. Sofokli DUKA

PhD. Stavri SINJARI

Academy of Security

ABSTRACT

Suicide intertwines in itself human, criminological, criminal, social, and other phenomena. Suicide, as a human phenomenon, is not presently considered a penal offence by most of the legislations of the countries in the world, but may be related directly or indirectly to a criminal activity. The investigation of the suicide offence is exactly the process which clarifies and proves the above elements and utterly certifies whether we are dealing with a mere suicide offence or it is an outcome, a consequence, or a simulation of another penal act.

Suicide, though characterized by an increasing trend with each passing year, is a phenomenon generally ignored and not properly contemplated by the society, the government, and the institutions, which is easily supported by the lack of institutions, legal framework, and the proper preventing and victim rehabilitation instruments. The same consideration is reflected at the level of suicide investigations compared to the investigation of other penal offences

In order to have a full, objective, and professional investigation of suicide offences, there must be a thorough knowledge on the mechanism the suicide is committed with, the existence of the conditions and the suicide tools, the suicide attempt, pre-suicide, self infliction, the difference between suicide and murder, natural death, accidental death, accidental suicide, suicide accomplice, forced to commit suicide, causing suicide, suicide committed due to involvement in a criminal activity, as well as the information about the key signs which must be found at the crime scene or the victim as indicators of suicide committing patterns.

Amongst the main suicide investigation objectives, priority should be given to the confirmation or exclusion of the elements of a penal offence which precede, go along with, or perpetrate the suicide. In general, the present Albanian experience of suicide investigations is characterized by simple and minimal investigative procedures bypassing the proactive investigation and its discovery feature.

The importance of the police cooperation with partner organizations for efficiency in the fight against crime

PhD. Myzafer ELEZI
Academy of Security

ABSTRACT

At the time in which we live crime has assumed large dimensions. It comes to those types of offenses which affect two or more countries, and that affect the global security and that of the country. We can mention terrorist crimes, which are facing all law enforcement structures in the area of security and justice, organized crime, especially trafficking of people, where we can mention the trafficking of children, of women for prostitution, organ; trafficking of drugs etc. International police cooperation is a topic hardly addressed by researchers. There are some available literature addressing the association, but not particularly focused on levels and forms of police cooperation at the European level or beyond.

In general, there is no standard definition that labels police cooperation, but given the procedural activity practices for conducting exchange and coordination between police organizations and from personal experience can be defined as a mutual activity between organizations, law enforcement agencies based on the main principles fixed in the relevant international documents, in order to exchange information, conduct joint operations and pro - active planning and coordinated actions between them. Seen in this context, it must be admitted that in practical the design and implementation of a law that helps relevant institutions in their activity, to prevent and combat crime, it is often incomplete, and not applicable. Therefore it becomes necessary a more accurate study to analyze and reflect the current situation and to recommend legislative and institutional changes that make a positive difference in the three areas described above, legal, institutional and operational.

Irregular Migration as a Challenge between Humanism and National Security*

**Pëllumb NAKO, Leader
Academy of Security**

ABSTRACT

For many years, especially during the last year, the Mediterranean Sea and the Balkan countries, in particular those of the Western Balkan, have been affected by illegal migration, which has occurred through massive displacement of Asian and African-Arab populations towards the developed countries of the European Union. This wave of migration has caused the Balkan countries (Albania amongst them) to face numerous challenges, mostly, the challenge of these countries being obliged to address migration issues in full respect of human rights and ensuring their national security at the same time.

The current migration of the Asian and African-Arab populations, initially supported by criminal groups in the sea and networks of smugglers in the ground, was transformed into a massive influx towards some EU countries. The immediate reaction towards it was far from being aligned. Several European countries, with different profiles of democracy, offered diverse solutions, culminating in the reinforcement of the state borders with barbed wires. In other words, the Schengen borders were surrounded with barbed wire, some countries restored border controls, others have already being silently applying it for quite some time (the Italian ports where Greek vessels dock).

** This expertise has been published in a more elaborated version by the author at the Center of Higher Studies of the French Ministry of Interior, where he attended a study course in the field of security during 2014-2015:*

"NAKO, Pëllumb. L'immigration irrégulière qui transite à travers les Balkans vers l'europe occidentale. CHEMI –Jun 2015. Paris: Ministère de l'Intérieur, République Française."


The version that is being published in the journal "Policing and Security" contains updated information and provides an analysis current issues based on the most recent data.

"Policimi dhe siguria",
rev. shkenc.
nr. 1, dhjetor 2015,
ISSN 2413-1334.
Botues: Akademia e Sigurisë
Tirazhi:
Përmasa: 160X240 mm

Policimi
dhe
Siguria
nr.1, 2015

143

ISSN 2413-1334
AKADEMIA E SIGURISË



2 413 1 334000 3



POLICIMI DHE SIGURIA

DHJETOR 2015



AKADEMIA E SIGURISË

Qendra Kërkimore Shkencore
Rruga e Elbasanit, Sauk, Tiranë



NR

1